# RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

## MBI
## “AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”

## “BASHKIA MIRDITË”

**Tiranë 2023**

# PËRMBAJTJA

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE....4
1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit....4
2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve....5
3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit....9
II. HYRJA....11
1. Objektivat e auditimit....12
2. Qëllimi i auditimit....12
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese....13
5. Përgjegjësitë e audituesve....13
6. Kriteret e vlerësimit....13
7. Standardet e auditimit....14
8. Metodologjia e auditimit....14
9. Dokumentimi i auditimit....16
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT....16
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin....16
2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit....16
2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik....17
2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit....26
2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare të vitit 2022....55
2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve....75
2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike....128
2.5 Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit....147
2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtes së Territorit....147
2.7 Të ndryshme të dala gjatë auditimit....166
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME....168
V. ANEKSET....189

**Lista e shkurtimeve**

| | |
|---|---|
| KLSH | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MFK | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli |
| NA | Nëpunës Autorizues |
| NZ | Nëpunës Zbatues |
| GMS | Grupi i Menaxhimit Strategjik |
| NJAB | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| AB | Auditi i Brendshëm |
| MAB | Manuali i Auditimit të Brendshëm |
| FZHR | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve |
| AQT | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara |
| UMF | Udhëzim i Ministrisë së Financave |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| VKB | Vendim i Këshillit Bashkiak |
| ASHK | Agjencia Shtetërore e Kadastrës |
| NJA | Njësi Administrative |
| SHA | Shoqëri Anonime |
| NJP | Njësia e Prokurimit |
| BOE | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë |
| OE | Operator Ekonomik |
| KVO | Komisioni i Vlerësimit të Ofertave |
| ISSAI | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit |
| INTOSAI | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit |
| IFAC | Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve |
| IPSAS | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik |

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### 1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektiv vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Mirditë, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, etj. Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.10.2018 deri në datën 31.12.2022 për auditimin financiar dhe nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022 për auditimin e përputhshmërisë. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësive kryesore nga Bashkia Mirditë si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Gjendja e llogarisë *212 "Ndërtesa Konstruksione"* paraqitet në vlerë historike në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,690,376,124 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,506,661,463lekë. Referuar analizës aktiv për aktiv të gjendjes së kësaj llogarie u konstatuan aktive të cilat ose janë gërmadha ose janë jashtë funksionit, të cilat duhet të kalojnë në debi të llog. 24 " Aktive afatgjata të dëmtuara", duke kredituar llog. ***212 "Ndërtesa Konstruksione" për*** vlerën 13,008,561 lekë që i përkasin 10 aktiveve të konstatuara të dëmtuara;

- Gjendja e llogarisë 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 48,633,621 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, vlerë e cila paraqitet ne llog.401-408. Gjendja e kësaj llogarie përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera për fatura të pa financuara deri në nëntor të vitit ushtrimor, pasi kalojnë në detyrime të prapambetura. Gjendjes së kësaj llogarie i përkasin 32 fatura të paraqitura në llog.401-404 "furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën 55,803,024 lekë;

- Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2022 me urdhër-shpenzime në 41 raste faturash me vlerë 41,896,055 lekë, *mbi afatin 30 ditor të faturave* për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Mirditë, *ku 34* raste në vlerën 10,956,731,lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llog. 602 "shpenzime operative" dhe në 7 raste në vlerën 36,012,981,lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llog.231 "investime", të cilat në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë të punimeve;

- Nga auditimi i IMTV Mirditë u konstatua, mos përmbushje e detyrave funksionale nga Kryeinspektori i IMTV dhe mos përputhshmëria e emërimit të inspektorëve për shkak të arsimimit.

- Nga auditimi i zbatimit të kontratave për punë publike me objekte: "Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3), Mirditë"; "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe

sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar “Ndrec N. Gjoka”, Fan Mirditë”; “Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen” Bashkia Mirditë”; “Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen” Bashkia Mirditë; “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)” Bashkia Mirditë, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mirditë nuk është kryer Oponenca Teknike;
- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit u konstatua se në gjashtë raste të audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, siç janë mangësi në dokumentin e rilevimit topografik, projekti arkitektonik nuk është i plotësuar me të gjitha detajet e domosdoshme, etj;
- Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste të audituara, nuk është kërkuar dhe / ose respektuar mendimi i autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.
- Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2021 është në vlerën **16,418,632 lekë,** vlera e borxhit e krijuar **gjatë vitit 2022** është **6,160,335lekë** dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2022** është në vlerën **22,578,967 lekë** e cila përbëhet nga**:**
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesit të vogël në shumën 2,045,473lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesit të madh në shumën 5,694,982lekë;
- Detyrime nga personat fizikë/juridikë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë” në vlerën prej 14,838,512 lekë, që i përkasin 4 subjekteve të mbartura që nga viti 2010;
- Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të 9 kontratave, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 3,354,949 lekë pa tvsh;
- Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2018-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 11 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim dhe në 9 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.

## 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

| Nr. | Përmbledhje e gjetjeve | Rëndësia | Rekomandimi |
|---|---|---|---|
| 1 | Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2018-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 11 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “*Për prokurimin publik*”, neni 1, 2, 20, si dhe neni 26, pika 5 të VKM-së nr. 914, datë 24.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*”, me Ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”. | E lartë | Kryetari i Bashkisë Mirditë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet. |
| 2 | Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit publik, të | E lartë | Kryetari i Bashkisë Mirditë, në cilësinë e Titullarit |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2018-31.12.202, u konstatua se në 9 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, shkronjat a), b), d) dhe dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" shkronjat (a), b) dhe c), neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*" pika 1 dhe neni 55 "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3 dhe VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin rregullave të prokurimit publik*", me Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 69-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* | | të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës. |
| 3 | Nga auditimi i IMTV Mirditë u konstatua mos përmbushje e detyrave funksionale nga Kryeinspektori i IMTV.<br>Puna e kryer nga IMTV është bazuar më shumë gjatë kontrolleve rutinë në territor dhe nuk ka evidencë shkresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, kjo duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë.<br>Nga Kryeinspektori i IMVT pranë Bashkisë Mirditë nuk janë marrë masat në kohë për parandalimin e këtyre ndërtimeve pa leje, ndonëse në zona lehtësisht të dukshme dhe të aksesueshme. Nuk ka proces verbale konstatimi apo ndonjë masë tjetër administrative për këto raste.<br>Mosmbajtja në kontroll e territorit sipas përcaktimeve ligjore është dhe mund të jetë shkak për pasoja jo vetëm në mbrojtjen e territorit por bëhet shkak dhe për shmangien nga detyrimet që parashikohen për taksat e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 209-216 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* | E lartë | Kryetari i Bashkisë Mirditë të marrë masa që IMTV të ketë bashkëpunim me DPZHKT, Policinë Bashkiake, Policinë e Shtetit, administratorët e njësive vendore, kryepleq apo dhe çdo organ në nivel qendror e vendor, të dërgojnë e kërkojnë informacione periodike mbi gjendjen në territor. Të ushtrojnë inspektime të planifikuara mbi zona të caktuara por sidomos ato me rëndësi kombëtare, pyje, lumenj apo zona të mbrojtura. |
| 4 | Nga auditimi i zhvillimit i zbatimit të kontratave për punë publike me objekte: "Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3), Mirditë", "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar "Ndrec N. Gjoka", Fan Mirditë"; "Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen" Bashkia Mirditë"; "Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen" Bashkia Mirditë; "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)" Bashkia Mirditë, u konstatua se nga AK Bashkia Mirditë nuk është kryer Oponenca Teknike, në mospërputhje me Ligjin Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 6, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 148-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* | E lartë | Bashkia Mirditë të marrë masa që të pajisin me Oponencë Teknike për çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre. |
| 5 | Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë, | E lartë | Nga Bashkia Mirditë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | distancat urbane ndërtesë – kufi prone, lartësia maksimale e lejuar e matur me metra dhe numër katesh, intensiteti i ndërtimit dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit.<br>Anomalitë e mësipërme, nuk janë në përputhje me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, Neni 35; Neni 38, pika 1; Ligjin 107/2014, *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"*, i ndryshuar, Neni 38, pika 1; Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mirditë, e ndryshuar dhe pasaportat e njësive strukturore të mësipërme.<br>*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 181-209 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)* | | rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon, të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk i plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara në dispozitat ligjore. |
| 6 | Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste të audituara, nuk është kërkuar dhe / ose respektuar mendimi i autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.<br>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",* i ndryshuar, Neni 10/1 *"Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi"*, pika 6; Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Mirditë, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 2, datë 20.06.2018 (e rishikuar me Vendim nr. 9, datë 14.10.2020), dokumenti i rishikimit, pika 2, nënpika c); Ligjin nr. 111/2012, *"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"*, i ndryshuar, Neni 33; VKM-në nr. 550, datë 15.07.2020, *"Për miratimin e formularëve për miratimin, në parim, për dhënien me koncension..."*, pika III. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 181-209 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* | E lartë | Nga DPZHTS Mirditë të merren masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, sipas rastit. Gjithashtu, DPZHTS Mirditë, të shqyrtojë me përparësi të gjitha kërkesat e parashtruara nga këto autoritete dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi deri në plotësimin e kërkesave. |
| 7 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion dhe riparimi i ambienteve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, të dëmtuara nga tërmeti, në qytetin Reps, Nj.A. Orosh", Bashkia Mirditë, me vlerë të kontratës (pa tvsh) 184,001,854 lekë, realizuar nga BOE "L." SHPK & "K." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 540,416 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5372/15 prot., datë 28.02.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë dhe BOE "L.VII" SHPK & "K." SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 148-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* | E mesme | Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **540,416 lekë pa tvsh** nga BOE "L." SHPK & "K." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5372/15 prot., datë 28.02.2022, me objekt "Rikonstruksion dhe riparimi i ambienteve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, të dëmtuara nga tërmeti, në qytetin Reps, Nj.A. Orosh", Bashkia Mirditë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. |
| 8 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit "Arjana Arapi" Rrëshen", Bashkia Mirditë,*** me vlerë të kontratës (me tvsh) 63,269,169 lekë, realizuar nga BOE "A..." SHPK & "J..." SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 638,120 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4616 prot., datë 23.10.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë dhe | E mesme | Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **638,120 lekë pa tvsh** nga BOE "A..." SHPK & "J..." SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4616 prot., datë 23.10.2018, me objekt "Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit "Arjana Arapi" Rrëshen", Bashkia Mirditë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera. |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | BOE “A...” SHPK & “J...” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 148-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* | | |
| 9 | Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)” *Bashkia Mirditë*, me vlerë 187,417,132 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “U...” SHPK, *rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara* për zërat e punimeve: (Zëri 3(An-3). Prishje çatie me llamarinë; Zëri 34(An-21). Skeleri metalike me tubo në fasadë >12 m) në vlerën **412,102 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3711/3 prot., datë 02.12.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë “U...” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 148-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* | E lartë | Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **412,102 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria “U...” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3711/3 prot., datë 02.12.2022, me objekt “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)” Bashkia Mirditë”. |
| 10 | Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2021 është në vlerën **16,418,632 lekë,** vlera e borxhit e krijuar **gjatë vitit 2022** është **6,160,335 lekë** dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2022** është në vlerën **22,578,967 lekë** e cila përbëhet nga**:**<br>- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesit të vogël në shumën 2,045,473lekë;<br>- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesit të madh në shumën 5,694,982lekë;<br>- Detyrime nga personat fizikë/juridikë për “Taksën e ndikimit në infrastrukturë” në vlerën prej 14,838,512 lekë, që i përkasin 4 subjekteve të mbartura që nga viti 2010.<br>Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, me ndryshime, Kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara” neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181. me VKB nr. 100, datë 24.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale vendore 2022”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 18-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).* | E lartë | Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive 22,578,967 lekë, ku përveç masave shtrënguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),n*ë funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar:*<br>-Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar dhe n*ëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet*, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.<br>- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Mirditë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.<br>- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve. |
| 11 | Bashkia Mirditë për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 43 kontrata për dhënien me qira të tyre. Nga të dhënat e nxjerra nga dokumentacioni i dosjeve | E lartë | Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 12 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | dhe ai financiar rezulton se, paraqiten 5 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të pa paguara **me vlerë progresive debitore prej 15,176,566 lekë,** ndërsa në **fund të vitit 2022** paraqiten 12 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të pa paguara në ***vlerën debitorë progresive prej 14,945,988 lekë,*** vlerë e cila nuk rakordon me kontabilitetin. Në këtë gjendje debitorësh detyrime të pa paguara më të mëdha i kanë subjektet e dy kontratave: Subjekti qiramarrës "Sh."shpk me aktivitet "HEC", kontrate e vitit 2017 me afat 10 vjecar, me detyrime të papaguara në vlerën 10,569,197 lekë, me aktivitet te pezulluar dhe Subjekti P... me aktivitet "HEC" kontrate e vitit 2018 me afat 10 vjecar, me detyrime të papaguara në vlerën 1,784,791 lekë lekë, me aktivitet te pezulluar.<br>Gjithashtu referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezulton se në territorin e Bashkisë Mirditë ushtrojnë aktivitetin 8 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullosor, asete të Bashkisë Mirditë. Nga Bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për vend depozitimit të mineralit në rastet e subjekteve me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali si dhe shfrytëzim karriere dhe shtrati lumi, me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim inertesh, duke sjellë të ardhura të mungura për Bashkinë Mirditë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 826-840, me ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" dhe me kontratat përkëtëse neni 5 "Pagesa e tarifës së qirasë". | | subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në ***vlerën* 17,661,3767 lekë** dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave. Nga strukturat e Bashkisë të merren masa për evidentimin e problematikave dhe ndërmarrjen e hapave për negocime me qiramarrësit debitorë, si dhe në kushtet e mosmarrëveshjeve ndërmarrjen e veprimeve ligjore për prishjen e në mënyrë të njëanshme të kontratave me qiramarrësit, që nuk paguajnë detyrimet për tarifat e qirave.<br>Gjithashtu nga strukturat drejtuese për 8 rastet e subjekteve private për prodhim dhe nxjerrje minerare e inertesh, që ushtrojnë aktivitetin e licencuar në parcelat e fondit pyjor-kullosor, asete të Bashkisë Mirditë, të shqyrtohet dokumentacioni i tyre dhe të kryhet kontrolli dhe matja në terren i parcelave, që shfrytëzohen dhe finalizimi i procesit me lidhjen e kontratave të qiradhënies për sigurimin e të ardhurave dhe rehabilitimin e sipërfaqeve nga shfrytëzimi nga ana e këtyre subjekteve të aseteve të bashkisë. Nëse ka pengesë në realizimin e këtij procesi të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse deri në pezullimin e veprimtarisë. |

## 3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

## Opinioini i auditimit

**I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare.**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të konsoliduara të Bashkisë Mirditë për vitin ushtrimor 2022, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dhe shënimet në relacionin për llogaritë, që shoqëronin këto pasqyra.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një ***opinion të pamodifikuar/pakualifikuar me theksim të çështjes*** për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Mirditë, duke arritur në përfundimin se, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin e Pakualifikuar", pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale (pa anomali materiale), pozitën financiare të njësisë vendore më 31 dhjetor 2022, në përputhje me bazën ligjore që rregullon raportimin financiar dhe atë buxhetor, mbi të cilat

subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes, janë adresuar disa çështje (jo thelbësore), të cilat paraqiten te paragrafi "Theksimi i Çështjes" dhe duhet të jenë në vëmendje të njësisë vendore për sistemin e tyre.

**Baza për opinion:**
Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare", pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 - Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30 - Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000 - Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare - Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipër përmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.
Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 3,361 mijë lekë.
Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2022 kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbanin gabime materiale, por ekzistojnë aspekte që duhen nënvizuar, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Këto aspekte nuk konsiderohen materiale, prandaj vetëm meritojnë evidentim, si theksim çështjesh. Për këto arsye kemi dhënë opinion të pakualifikuar me theksim të çështjes, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në paragrafin e mëposhtëm:
**"Theksimi i çështjes"**
- Referuar analizës aktiv për aktiv të gjendjes në vlerë bruto prej 2,506,661,463 lekë të llogarisë *212 "Ndërtesa Konstruksione"* u konstatuan aktive të cilat ose janë gërmadha ose janë jashtë funksionit, të cilat duhet të kalojnë në debi të llog. 24 " Aktive afatgjata të dëmtuara", duke kredituar llog. *212 "Ndërtesa Konstruksione" për* vlerën 13,008,561 lekë që i përkasin 10 aktiveve të konstatuara të dëmtuara(të paraqitura në aneks).
- Gjendja e llogarisë 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 48,633,621 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, vlerë e cila paraqitet ne llog.401-408. Gjendja e kësaj llogarie përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera për fatura të pa financuara deri në nëntor të vitit ushtrimor, pasi kalojnë në detyrime të prapambetura. Gjendjes së kësaj llogarie i përkasin 32 fatura të paraqitura në llog.401-404 "furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën 55,803,024 lekë.

**II. Opinioni mbi përputhshmërinë.**
Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Mirditë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.10.2018-31.12.2022.
Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Mirditë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin "Baza për Opinionin",

të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të modifikuar për përputhshmërinë.

**Baza për dhënien e opinionit të modifikuar:**

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

- Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2018-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 11 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim dhe në 9 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST;
- Nga auditimi i zbatimit të kontratave në 9 objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën 3,319,949 lekë, si rezultat i diferencave në volume pune.
- Detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në vlerën 27,295,747 lekë;
- Mos arkëtim i detyrimeve për tarifën e autorizimit të ushtrimit të aktivitetit për subjektet që tregtojnë lëndë djegëse në vlerën 2,400,000 lekë;
- Mos taksim i plotë i kategorisë taksapaguese "Familje", për tarifat e ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit për vitin 2022, në vlerën 6,129,800 lekë;
- Debitorë për taksën e tokës bujqësore në vlerën 6,731,799 lekë.

**Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë**

Drejtimi i njësisë vendore, është përgjegjës për përgatitjen dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi të raportimit financiar. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit dhe të gjithë veprimtarisë që zhvillon Bashkia Mirditë.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH**

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe fushave të tjera të auditimit dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 521/1 Prot, datë 20.06.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-$^{së}$, nga data 20.06.2023 deri në datën 15.09.2023, në subjektin Bashkia Mirditë u krye "Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë" për auditimin financiar për periudhën nga data 01.01.2022 deri me datën 31.12.2022, për auditimin

e përputhshmërisë nga data 01.10.2018 deri me datën 31.12.2022. Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit[1]:

1. A. Z – *Përgjegjës Grupi*
2. S. M – *Auditues*
3. I. Sh – *Audituese*
4. R. L – *Auditues*
5. E. K – *Audituese*
6. P. Xh – *Auditues*

**1. Objektivat e auditimit**

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë në Bashkinë Mirditë ka si objektiva kryesor:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;
- Vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)[2];
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

**2. Qëllimi i auditimit**

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Mirditë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejtë dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

**3. Identifikimi i çështjes**

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Mirditë dhe përgjegjësive, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

**Pika 1.** Mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.

**Pika 2.** Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.

---

[1] *Pjesë e grupit të auditimit ka qenë edhe z. Sadin Ahmagjokaj, i cili aktualisht nuk është pjesë e organikës së Kontrollit të Lartë të Shtetit.*

[2] *Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.*

**Pika 3.** Vlerësimi i raportimit financiar.
**Pika 4.** Mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike**.**
**Pika 5.** Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimin e territorit.
**Pika 6.** Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtës të Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)
**Pika 7.** Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.
**Pika 8.** Të ndryshme të dala gjatë auditimit.

**4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Mirditë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me në përputhje me kuadrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

**5. Përgjegjësitë e audituesve**

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

**6. Kriteret e vlerësimit**

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Mirditë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kritereve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Mirditë. Burimet e kritereve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit";
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative";
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik";
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;

- VKM nr. 894, datë 04.11.2015 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore";
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël";
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura";
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve";
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore";
- UMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme";
- Etj.

**7. Standardet e auditimit**

Për kryerjen e Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë në Bashkinë Mirditë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik":
- ISSAI 400 "Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë", që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë:
- ISSAI 4000 "Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë"; si dhe ISSAI 4200:
  Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilisteve IFAC.

**8. Metodologjia e auditimit**

<u>1. Kontrolli aritmetik</u>.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

<u>2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese</u>.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin.

<u>3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese</u>.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

<u>4. Kontrolli i vlerësimit</u>.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

<u>5. Konfirmim nga të tretët.</u>

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

*6. Kontrolli sipas një treguesi.*

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *"jashtë normales",* që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

*7. Intervistimi*

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Mirditë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

*8. Raporte dhe Informacione*

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

*Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit*

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale[3].

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-[ja] aplikon[4].

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur*;*

[3] ISSAI 1315

[4] Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

*dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

**9. Dokumentimi i auditimit**

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

## III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

### 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Bashkia Mirditë kufizohet në veri me Bashkitë e Fushë Arrësit dhe Pukës, në perëndim me të Lezhës dhe në lindje me Bashkinë e Kukësit, në jug-lindje me bashkinë Dibër, në jug me Bashkinë Mat ndërsa në jugperëndim me bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj Bashkie është Qyteti i Rrëshenit. Sipas Censusit të vitit 2011, Mirdita ka 22,103 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrit Civil kjo bashki numëron 37,384 banorë. Me një sipërfaqe prej 869.71 km2 , me densitet prej 42.98 banorë/km2 sipas Regjistrit Civil dhe 24.64 banorë/km2 sipas Censusit 2011.
Bashkia e Mirditës shtrihet në një territor me trashëgimi të larmishme kulturore dhe etnografike, ndërkohë që nëntoka e saj është gjithashtu e pasur me minerale. Mirdita mori rëndësi si rrugë kalimi dhe si porta natyrore hyrëse për në Kosovë, pas ndërtimit të autostradës Përveç cilësisë së udhëtimit, kjo rrugë solli një impakt modest për zhvillimin social-ekonomik të zonës. Sipërfaqja e pyjeve në Bashkinë e Mirditës është 10 herë më e madhe se fondi i tokës bujqësore. Për këtë arsye, problemet ekologjike të zonës, të tilla si përpunimi i drurit, ai i frutave të pyllit, prodhimi i lëngjeve vitaminore dhe zhvillimi i gjuetisë sportive janë të lidhura me pyjet. Një nga fushat më interesante është edhe shfrytëzimi i kapaciteteve hidro – energjetike të lumenjve të Fanit të Madh dhe Fanit të Vogël, Urakës, Zallit të Dodajve, dhe përrenjve të tjerë malorë, ku vlerësohet se mund të sigurohen kapacitete prodhuese energjetike deri në 60 MŴ/H.
Pasuritë e mëdha nëntokësore të Mirditës kanë bërë që në territorin e kësaj krahine të krijohen katër qytete, të cilat janë të lidhura me industrinë minerare. Pjesa më e madhe e kësaj industrie është e mbyllur tashmë.
Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

### 2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

### 2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

**1. Mbi mjedisin e kontrollit**

(Në zbatim të kërkesave të nenin 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010)

Bashkia Mirditë funksionon bazuar në Rregulloren e Brendshme të Bashkisë Mirditë, nr. 4600 prot, datë 27.10.2022.Referuar formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, përsa i përket pjesës për Rregullorene Brendshme të Njësisë Publike, vihet re se është hartuar bazuar në këtë manual, duke përmbajtur disa elemente thelbësore që çdo rregullore duhet të ketë.

**Kodi i Etikës**

Kodi i Etikës që funksionon për vitin 2022 është miratuar në vitin 2020, shkresa nr.502/1 prot., 06.02.2020, në bazë të Urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, Urdhër Nr. 28, datë 06.02.2020, nr. 502 prot., bazuar në legjislacionin përkatës, ku mbështetet Njësia Publike për hartimin dhe përpilimin e tij. Rezulton se si grup pune, për hartimin e Kodit të Etikës Profesionale për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë, Kryetari i Bashkisëka ngarkuar Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun; dhe Drejtorinë Juridike dhe Prokurimeve.

**Mbi rekrutimin e punonjësve në marrëdhëniet e punës:**

**Për vitin 2022,** numri i punonjësve në administratën e Bashkisë Mirditë, referuar Strukturës së Detajuar për vitin 2022, Nr.764. prot., datë15.02.2022, është gjithsej **380 punonjës,** përfshirë këtu edhe punonjësit e Institucioneve (agjencive) në varësi të Bashkisë edhe ata të Njësive Administrative.

Nga të cilët në pozicione pune, trajtuar sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, në muajin janar 2022 janë, 44 punonjës me status, 289 punonjës me kontratë pune dhe 47 vakanca. Ndërsa në dhjetor 2022 janë, 45 punonjës me status, 297 punonjës me kontratë pune dhe 38 vakanca. Ky informacion i referohet shkresës nr.764. prot., datë 15.02.2022nga zyra e Burimeve Njerëzore (struktura).

**2. Mbi menaxhimin e riskut**

(Në zbatim të kërkesave të nenin 21, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010)

**Regjistri i Riskut, viti 2022**

Regjistri i Riskut për vitin 2022 në Bashkinë Mirditë, nr. 5351 prot., datë 23.12.2021, është hartuar sipas formatit që përcaktohet në Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Në përgjithësi, është i plotësuar për të gjitha kategoritë që përmban një regjistër risku.

**3. Mbi veprimtaritë e kontrollit**

**Grupi i Menaxhimit Strategjik**

(Në zbatim të kërkesave të nenin 22, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010)

Referuar shkresës, Urdhër Nr. 86, datë11.03.2022, nr. 1168 prot., “Për ngritjen e grupit të Menaxhimit Strategjik”, të përbërë nga 15 anëtarë, për përgatitjen e Buxhetit 2023 dhe PBA 2023-2025 të Bashkisë Mirditë.

**Deklarata e Cilësisë për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm, viti 2022**

Deklarata e Cilësisë për vitin 2022 në Bashkinë Mirditë është hartuar dhe dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në MFE me shkresën nr. 753/1 prot., datë 22.02.2023.

**Pyetësori i Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, viti 2022**

Shkresa nr. 753/1 prot., datë 22.02.2023, Pyetësori i Vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për Bashkinë Mirditë, është hartuar dhe miratuar sipas formatit standard të manualit MFK.
Përgjithësisht pyetësori është realizuar duke u mbështetur në manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe ligjin Nr.10 296, datë 8.7.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Vlerësimi i riskut është bërë sipas katër seksioneve, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informacioni dhe komunikimi, monitorimi.

**Raporti vjetor për funksionimin e sistemi të kontrollit të brendshëm, viti 2022**

Për vitin 2022, është hartuar dhe përpiluar sipas manualit për Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022,bazuar në Neni 18, Ligji Nr.10 296, datë 8.7.2010, Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke përmbajtur të gjitha rubrikat kryesore si përmbledhja ekzekutive, vlerësimi i sistemit të MFK-së, gjetjet dhe rekomandimet e auditit të brendshëm dhe të jashtëm, masat e marra gjatë vitit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësi dhe plan veprimi për të ardhmen.

**Harta e Proceseve të Punës**

Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në Bashkinë Mirditë, për periudhën objekt auditimi 2022, funksionon me hartën e proceseve të punës të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, me shkresen nr 975 dt 28.02.2022. Kjo drejtori është e ndarë në Sektorin e Buxhetit dhe Sektorin e Financës.
Ky dokument është hartuar sipas formatit të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin duke iu referuar gjithashtu edhe bazës ligjore përkatëse. Nëpërmjet hartës së proceseve të punës, garantohet uniformiteti në kryerjen e proceseve të punës, identifikohen aktivitetet e kryera, përgjegjësitë për kryerjen e një aktiviteti, si dhe afatet brenda të cilave këto aktivitete duhet të kryhen, së bashku me një pamje të përgjithshme të veprimtarive të kontrollit, që identifikohen brenda një procesi dhe që garantojnë përmbushjen e objektivave të tij.
Janë përgatitur formatet e hartave të proceseve për vitin 2022, që paraqesin nën - procese si, ekzekutimi i transaksioneve të ndryshme financiare dhe kontabilizimi i tyre; përgatitja dhe saktësimi i projekt – buxhetit vjetor të Bashkisë; përgatitja dhe saktësimi i PBA-ve të Bashkisë; Përgatitja e tabelave të monitorimit të buxhetit në çdo 4-mujor; rakordimi mujor me degën e thesarit për shpenzimet; përgatitja e bilancit vjetor; evidentimi në Këshillin Bashkiak të të gjitha ngjarjeve ekonomiko – financiare. Te kategoria afati, specifikohet se pagesat financiare ekzekutohen sipas nevojës, ndërsa për përgatitjen e buxhetit të PBA dhe të gjithë dokumentat financiare kalojnë nëpër afatet e paracaktuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi

**Plani i Veprimit për Kontrollin e Brendshëm**

Plani i Veprimit për Kontrollin e Brendshëm, si një instrument për përshkrimin dhe organizimin e aktiviteteve të kontrollit me qëllim menaxhimin e risqeve kryesore dhe dhënien e sigurisë së arsyeshme se objektivat dhe qëllimet do të arrihen për periudhën objekt auditimi, është i hartuar dhe miratuar për periudhën 2022, nr. 978 prot., datë28.02.2022. Përgjithësisht ka strukturë dhe format të ngjashëm me manualine Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pika 3.3.
Plani i Veprimit për Kontrollin e Brendshëm për vitin 2022,me nr. 978 prot., datë 28.02.2022,është hartuar nga njësia e menaxhimit financiar dhe miratuar nga Kryetari i Bashkisë, sipas formatit standard,që ka manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pika 3.3 e tij, duke përfshirë një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve të planifikuara për periudhën e përmendur më lart.

**Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin**

Plani i Veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, për periudhën objekt auditimi, është i hartuar dhe miratuar për periudhën 2022 me shkresën nr. 976 prot., datë28.02..2022.Është hartuar sipas formatit që ka manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, kapitulli IV i tij, duke përfshirë një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve të planifikuara për periudhën e përmendur më lart.

**Gjurma e Auditimit e Bashkisë Mirditë**

Në Bashkinë Mirditë,bazuar në Urdhër Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., "Për miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK", janë hartuar gjurmët e auditit për gjithë aktivitetin ekonomiko – financiar, duke marrë në konsideratë ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", si më poshtë:

**Gjurma e Auditit në përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm PBA (2023-2025)**

Referuar Urdhërit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., "Për miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK", gjurma e auditit për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm PBA ështëe miratuar nga Kryetari i Bashkisë dhe hartimi i saj është për periudhën 2023 – 2025sipas shkreses Nr. 974 prot , datë 28.02.2022.Ky dokument është mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në tëpërshkruhen si vijon, përgatitja e kërkesave buxhetore; kërkesa shtesë për shpenzime në programin buxhetor afatmesëm; raportimi i kërkesave buxhetore. Gjithashtu janëparaqitur të gjitha proceset e kategorive të sipërpërmendura, duke adresuar edhe strukturat përgjegjëse që angazhohen me secilin nga proceset.

**Gjurma e Auditit e zbatimit të Buxhetit (viti 2022)**

Referuar Urdhërit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., "Për miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK",, gjurma e auditit për zbatimin e buxhetit është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë dhe hartimi i saj është për periudhën 2022 sipas shkreses Nr. 974 prot , datë 28.02.2022. Ky dokument është mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në tëpërshkruhen si vijon, procedurat standarde të shpërndarjes së fondeve të buxhetit vjetor (rishpërndarja e fondeve buxhetore, numri i punonjësve buxhetorë); procedurat për kryerjen e shpenzimeve publike; marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike; rakordimi mujor i shpenzimeve; titulli për arkëtim dhe paraqitja e tij në bankat e nivelit të dytë; rakordimi mujor i tëardhurave; raportet e monitorimit. Gjithashtu janë paraqitur proceset e kategorive të sipërpërmendura, duke adresuar edhe strukturat përgjegjëse që angazhohen me secilin nga proceset.Bashkangjitur me gjurmën e auditit për programin buxhetor afatmesëm PBA, është hartuar edhe përshkrimi i punës,për detyrat specifike, që kryhen në Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit.

**Gjurma e Auditit për prokurimet me vlerë mbi 1.000.000 lekë pa TVSH**

Referuar Urdhërit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., "Për miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK", gjurma e auditit për prokurimet me vlerë mbi 800.000 lekë pa TVSH është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria Jurdike dhe Prokurimeve Publike. Ky dokument është mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në të përshkruhen si vijon, organizimi i prokurimit publik; zhvillimi i procedurës; lidhja e kontratës; zbatimi i kontratës; dhe dokumentet për pagesë në thesar.

**Gjurma e Auditit për prokurimet me vlerë nën nën 1.000.000 lekë pa TVSH**

Referuar Urdhërit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., "Për miratimin e dokumenteve të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK", gjurma e auditit për prokurimet me vlerë nën 800.000 lekë pa TVSH është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria Jurdike dhe Prokurimeve Publike. Ky dokument është mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në tëpërshkruhen si vijon, organizimi i prokurimit

publik; zhvillimi i procedurës; lidhja e kontratës; zbatimi i kontratës; dhe dokumentet që duhet të dorëzohen në thesar.

**Gjurma e Auditit për përgatitjen e Paketës Fiskale**

Referuar Urdhërit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., "Për miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK", gjurma e auditit për përgatitijen e paketës fiskale është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria e të ardhurave, taksave, tregut, transportit dhe aseteve. Ky dokument është mbështetur në bazën ligjore specifike dhe në të përshkruhen si vijon, Faza përgatitore për përgatitjen e PF; hartimi i ftesave për dëgjesa publike; procesi i dëgjesave publike; përfundimi i dëgjesave dhë përgatitja e paketës së re fiskale; dërgimi i PF në komisionin e këshillit; dhë dërgimi në Këshillin Bashkiak për miratimin e PF.

**Gjurma e Auditit për Borxhin Tatimor**

Referuar Urdhërit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., "Për miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK", gjurma e auditit për borxhin tatimor është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria e të ardhurave, taksave, tregut, transportit dhe aseteve. Në këtë dokument përshkruhen si vijon, ekstrakti i regjistrit për të dhënat e subjektit shpk; njoftimi i detyrimit të vitit; fatura për arkëtim; refuzimi ose ankimimi; letër kujtese; njoftim dhe kërkesë për tu paguar; urdhër bllokimi të llogarive bankare për subjektin; urdhër ekzekutimi detyrimi; urdhër për zhbllokim të llogarive bankare; vendosje barre hipotekore; masa e sigurimit detyrimi tatimor; sekuestrimi i pasurive; transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë; e drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë; dhe përgjegjësia e administratorit.

**Gjurma e Auditit për Paketën Fiskale**

Referuar Urdhërit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., "Për miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK", gjurma e auditit për paketën fiskaleështë e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria e të ardhurave, taksave, tregut, transportit dhe aseteve. Në këtë dokument përmenden pikat si vijon, kërkesa për shqyrtim dhe miratim projekt vendimi; projekt vendim për miratimin e treguesve fiskalë; ftesë për dëgjesë publike; informacione nga ASHSAK Mirditë; informacion për tarifën e shërbimeve publike; informacion nga drejtoria e pyjeve në email; vendimi i Këshillit të Bashkisë Mirditë për Miratimin e treguesve fiskalë; urdhër për krijim komisioni; komisioni ekonomik i këshillit; informacione nga të gjitha drejtoritë; dhe organizimi i dëgjesave dhe protokollimi i tyre.

**Gjurma e Auditit për dhënie licence karburante**

Referuar Urdhërit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., "Për miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK", gjurma e auditit për dhënien e licencës për karburante është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria e të ardhurave, taksave, tregut, transportit dhe aseteve. Në këtë dokument përmenden pikat si vijon, kërkesa për marrje licence; ekstrakti i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit shpk; licencë për veprimtari që kanë ndikim në mjedis; certifikatë pronësie; kontratë shit-blerje; vendim për miratim të deklaratës për kryerje punimesh; leje mjedisore e tipit C; leje ndërtimore; harta treguese; dhe miratim autorizimi.

**Gjurma e Auditit për leje transporti**

Referuar Urdhërit Nr. 38, datë 22.02.2018, nr. 821 prot., "Për miratimin e dokumentave të gjurmës së auditit sipas manualit të MFK", gjurma e auditit për leje transporti është e miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe hartimi i dokumentit është kryer nga Drejtoria e të ardhurave, taksave, tregut, transportit dhe aseteve. Në këtë dokument përmenden pikat si vijon, kërkesëpër aplikim; leja e qarkullimit; ekstrakti i QKB; vërtetim për shlyerje të

detyrimeve tatimore nga DRT Lezhë; vërtetim për shlyerje taksash lokale; dokumenti që vërteton pagesën; dhe miratimi i lejes së transportit.

**Plani i punës së Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit**

Plani i punës**, për vitin 2022,** nr. 977 prot., datë 28.02.2022, miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, përgjithësisht paraqet disa nga detyrat kryesore që parashikon të kryejë Drejtoria e Financës brenda këtij viti. Plani është i hartuar në mënyrë të tillë që, paraqet edhe një afat brenda të cilit duhet të realizohen këto detyra, duke u mbështetur edhe në bazën ligjore përkatëse.

**Strategjia e Menaxhimit të Riskut për vitet 2021-2023**

Është hartuar për një periudhë tre-vjeçare duke filluar nga viti 2021deri në vitin 2023.Është e mbështetur në bazën ligjore specifike dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë. Në përmbajtje të saj përshkruhen pikat kryesore mbi të cilat është menduar të organizohet i gjithë procesi i menaxhimit të riskut.

**4. Informacioni dhe komunikimi**

(Në zbatim të kërkesave të nenin 23, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010)

Informimi dhe komunikimi, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar në rregulloren e funksionimit të brendshëm dhe kodin e etikës.

Bazuar në pikën 12.3 të Rregullores së Brendshme, komunikimi i brendshëm në Bashkinë e Mirditës realizohet në mënyrë shkresore, verbale dhe nëpërmjet rrjetit të brendshëm elektronik (internetit). Komunikimi dhe shkëmbimi elektronik i dokumenteve zyrtare brenda Bashkisë apo jashtë saj nga nëpunësit dhe punonjësit e saj bëhet gjithmonë duke përdorur postën elektronike (e-mail).

**5. Monitorimi**

(Në zbatim të kërkesave të nenin 24, ligji nr. 10296, datë 8.07.2010)

Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisionet përkatëse. Një formë e monitorimit, është deklarata e vetëvlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

***Mbi aktivitetin e Njësisë së Auditit të Brendshëm***

Bashkia Mirditë ka parashikuar në strukturën e saj shërbimin e Auditit të Brendshëm. Për vitin 2022 është miratuar me Urdhër Nr. 17, datë 10.01.2022, nr.764prot., datë15.02.2022. Detyra e kësaj strukture është të programojë, organizojë dhe kryejë auditime të brendshme me miratim të Kryetarit të Bashkisë në strukturat e varësisë së drejtpërdrejtë të Bashkisë Mirditë, për të konstatuar dhe evidentuar shkallën e zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi, bazuar në Manualin e Procedurave të Auditimit të Brendshëm Publik.

Në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", është krijuar njësia e auditimit të brendshëm, e cila është e organizuar në nivelin e Sektorit të Auditimit të Brendshëm duke përmbushur detyrimin ligjor të pavarësisë, i parashikuar nga Standardi Atributiv nr.1100, i Institutit Ndërkombëtar të Auditëve të Brendshëm.

Kapaciteti auditues i strukturës së Njësisë së Auditit të Brendshëm të Bashkisë Mirditë, është në bazë të VKM nr.83, datë 03.02.2016 "Për miratimin e kritereve të krijimit të Njësive të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik", i ndryshuar.

Njësia e Auditit të Brendshëm per periudhen2022 ka funksionuar me 1 (një) Përgjegjës njësie dhe 2 (dy) Specialistë, sipas strukturës organizative të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë. Ku përgjegjës i NJAB është emëruar Znj. A. M. e cila ka qenë në pozicionin e

specialistes së audititnga data 12.04.2017 deri në datë 12.10.2022 dhe 2 (dy) specialistët janë, z. G.M dhe z.Gj. N.

Përbërja e sektorit NJAB, për vitet objekt auditimi paraqitet si më poshtë:

| Nr. | Nga data 01.01.2022 deri 31.12.2022 | Funksioni | Arsimimi | Vjetërsia në punë | Vjetërsia në auditim | Certifikimi | Trajnime të vijueshme |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | A.M | Përgjegjëse | I lartë ekonomik | 9 | 5 vite 8 muaj | 06.07.2018 | 40 orë çdo vit |
| 2 | G.M | Specialist | I lartë juridik | 10 | 5 vite 5 muaj | 05.07.2019 | 40 orë çdo vit |
| 3 | Gj. N | Specialist | I lartë ekonomik | 25 | 1 vit e 1 muaj | Në proces | ------ |

Nga auditimi rezultoi se:

1. **Karta e Auditimit** është përgatitur nga Drejtuesi i njësisë së Auditit të Brendshëm dhe miratuar tek titullari i Bashkisë Mirditë, me shkresën nr.3935/1 prot., datë 14.10.2022, dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresë përcjellëse nr.3935/2 prot., datë 14.10.2022.
   - Ky veprim është në përputhje me kërkesat e nenit4, pika 12, të Ligjit nr. 114/2015 "Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik" dhe në përputhje me kërkesat e pikës 2.6.1, Kapitulli II të Manualit të Auditimit të Brendshëm, miratuar me Urdhërin nr.100 datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave.

2. **Plani Strategjik dhe vjetor për 2022** është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitet 2022 – 2024, me shkresën nr. 3998/1 prot., datë 14.10.2021, përpiluar në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm, Kapitulli III, pika 3.1.6 dhe pika 3.3.

Referuar shkresës me Nr. 3998/1 prot., datë 14.10.2021, rezulton se nga plani i auditimeve për vitin 2022, janë planifikuar 7 (shtatë) subjekte për tu audituar, 5 (pesë) përputhshmërie dhe 2 (dy) financiare; *12 (dymbëdhjetë) subjekte për vitin 2023; 13(trembëdhjetë) subjekte për vitin 2024.*

Plani Vjetor i vitit 2022 me kërkesë të sektorit të auditit të brendshëm në Bashkinë Mirditë, është dërguar me ndryshimet përkatëse në datë 28.12.2022 pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE**.** Shkresë përcjellëse Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me Nr. 5449/2 prot., datë 28.12.2022, bashkangjitur Urdhëri Nr. 414, Nr. 5449/1 prot., datë 28.12.2022, për ndryshimin e planit vjetor të angazhimeve të auditmit për vitin 2022, bashkangjitur relacion shpjegues 5449 prot., datë 28.12.2022, ku janë planifikuar 5 (pesë) subjekte për tu audituar, 5 (pesë) përputhshmërie.Arsyet e ndryshimit të planit vjetor të auditmit për vitin 2022,moskrijimi i mbivendosjeve, pasi detyrimet e prapambetura janë audituar nga KLSH; riorganizimi i Ujësjellës Kanalizime Sh.a Mirditë, mbështetur kjo në pasqyrën nr.3 të ndryshuar.

3. **Programi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të NJ.A.B Mirditë për vitin 2022**,gjatë fazës së terrenit të grupit të auditimit si dhe gjatë intervistave të zhvilluara me personat përgjegjës për dërgimin e materialit, është reflektuar dhe është dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm me shkresën nr. 1341 prot., datë

13.04.2022. Programi për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë së NJ.A.B të Bashkisë Mirditë është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, nr.1341/1 prot. datë 13.04.2022.

4. NJAB e Bashkisë Mirditë ka përgatitur Regjistrin e riskut në funksion të objektivave institucional, miratuar nga Titullari i Bashkisë Mirditë.

**Hartimi i planeve të auditimit, përgatitja dhe hartimi i programeve dhe llojet e auditimeve të ushtruara.**

**Për vitin 2022,** i janë nënshtruar procesit të auditimit: Auditim në Agjencinë e Inspektimit Kontrollit dhe Emergjencave,Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik; Auditim në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore Veterinare dhe Pyjore, Sektori i Monitorimit dhe Shërbimit Pyjor; Auditim në Njësinë Administrative Rubik; Auditim në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore Veterinare dhe Pyjore, Sektori i Shërbimit Veterinar, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; Auditim në Njësinë Administrative Fan.

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura për vitet 2022, u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr.114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, bazuar edhe te "Manuali i Auditimit të Brendshëm" (MAB).

Nga auditimi i projekt-raportit dhe raportit përfundimtar, rezulton se në procesin e auditimit në përgjithsi, nga audituesit e brendshëm, janë zbatuar standardet e përcaktuara në MAB, në përmbajtje dhe në formë.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm, (Kapitulli VI, "*Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese*", në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Gjithashtu referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

**Në dosjet e auditimit të vitit 2022**, ka këtë dokumentacion:

- Në rastin e auditimit të Agjencisë së Inspektimit Kontrollit dhe Emergjencave, Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik ka në dosje:

Projekt-axhende,axhende,procesverbal mbi takimin fillestar,autorizim për fillimin e angazhimit të auditimit, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, program i angazhimit të auditimit, deklaratat e pavarësisë, procesverbal mbi takimin përfundimtar, projekt-raport, observacion, raport përfundimtar, plan veprim, memo, vlerësimi i riskut, vlerësimi i brendshëm i cilësisë, rishikimi i cilësisë, urdhër mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga sektori i auditimit të brendshëm të Bashkisë Mirditë.

- Në rastin e auditimit në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore Veterinare dhe Pyjore, Sektori i Monitorimit dhe Shërbimit Pyjor ka në dosje dokumentacionin si më poshtë:

  Projekt-axhende, axhende, procesverbal mbi takimin fillestar, autorizim për fillimin e angazhimit të auditimit, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, program i angazhimit të auditimit, deklaratat e pavarësisë, procesverbal mbi takimin përfundimtar, projekt-raport, observacion, raport përfundimtar, plan veprim, memo, vlerësimi i riskut, vlerësimi i brendshëm i cilësisë, rishikimi i cilësisë.

- Në rastin e auditimit në Njësinë Administrative Fan në dosje gjenden:

Projekt-axhende, axhende, procesverbal mbi takimin fillestar, autorizim për fillimin e angazhimit të auditimit, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, program i angazhimit të auditimit, deklaratat e pavarësisë, procesverbal mbi takimin përfundimtar, projekt-raport, observacion, raport përfundimtar, plan veprim, memo, vlerësimi i riskut, vlerësimi i brendshëm i cilësisë, rishikimi i cilësisë.

- Në rastin e auditimit në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore Veterinare dhe Pyjore, Sektori i ShërbimitVeterinar në dosje gjenden dokumentat si:

Projekt-axhende, axhende, procesverbal mbi takimin fillestar, autorizim për fillimin e angazhimit të auditimit, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, program i angazhimit të auditimit, deklaratat e pavarësisë, procesverbal mbi takimin përfundimtar, projekt-raport, observacion, raport përfundimtar, plan veprim, memo, vlerësimi i riskut, vlerësimi i brendshëm i cilësisë, rishikimi i cilësisë

- Në rastin e auditimit në Njësinë Administrative Rubik në dosje gjenden:

Projekt-axhende, axhende, procesverbal mbi takimin fillestar, autorizim për fillimin e angazhimit të auditimit, njoftim për fillimin e angazhimit të auditimit, program i angazhimit të auditimit, deklaratat e pavarësisë, procesverbal mbi takimin përfundimtar, projekt-raport, observacion, raport përfundimtar, plan veprim, memo, vlerësimi i riskut, vlerësimi i brendshëm i cilësisë, rishikimi i cilësisë

**Vlerësimi i Brendshëm i Cilësisë, Sigurimi i Cilësisë gjatë vetëvlerësimit periodik dhe Rishikimi i cilësisë,** për angazhimin e auditimit të brendshëm për vitin 2022, janë në dosjet e përhershme të auditimeve përkatëse.

## I. Zbatimi i planeve të auditimit të brendshëm. Hartimi dhe mbajtja e dokumentacionit të auditimit.

Për veprimtarinë e Sektorit të AB për periudhën 2022,është raportuar në mënyrë sistematike Kryetari i Bashkisë Mirditë.

Për çdo mision auditimi, nga audituesit janë hartuar programet e auditimit, të cilat janë miratuar, nga Përgjegjësi i NJAB, në bazë të Planit Vjetor. Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me urdhërin e ministrit të financave nr.100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Vend të veçantë në programin dhe në procesin e auditimit ka zënë edhe ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme.

**Për vitin 2022 i janë nënshturar procesit të auditimit**Auditim në Agjencinë e Inspektimit Kontrollit dhe Emergjencave, Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik; Auditim në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore Veterinare dhe Pyjore, Sektori i Monitorimit dhe Shërbimit Pyjor; Auditim në Njësinë Administrative Rubik; Auditim në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore Veterinare dhe Pyjore, Sektori i Shërbimit Veterinar, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; Auditim në Njësinë Administrative Fan.

**Pasqyra e planifikimit dhe realizimit të auditimeve të brendshme për vitin 2022**

| Viti 2022 | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Plan | Fakt | Rekom | Zbat. | Pa zbat. | Në proc. | Përputhsh. | Perform. | Financ. | Kombinuar | Me kërkesë |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | titullari |
| 5 | 5 | 11 | 5 | - | 6 | 5 | - | - | - | - |

**10. Raporti i Veprimtarisë të Njësisë së Auditimit të Brendshëm për vitin 2022**është përgatitur dhe dërguar në afat në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm për vitin 2022**,** me shkresën nr. 604 prot., datë 13.02.2023, në përputhje me Kapitullin IV të Manualit të Auditimit të Brendshëm, të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 i ndryshuar.
Ky raport i veprimtarisë së Njësisë së Auditmit të Brendshëm për vitin 2022 përmban, të dhëna për Burimet Njerëzore të Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 (pasqyra nr.1); Realizimi i planit të angazhimeve 2022 (pasqyra nr.2); Përmbledhje e gjetjeve me dëm ekonomik nga angazhimet e auditimit 2022 (pasqyra nr.3); Përmbledhje e parregullsive të identifkiuara sipas sistemeve për vitin 2022 (pasqyra nr.4); Rekomandimet e dhëna sipas kategorive për vitin 2022 (pasqyra n. 5); Çështje të dërguara për investigim për vitin 2022 (pasqyra nr. 6); Pyetësori i vetëvlerësimit për auditimin e brendshëm; Raport shpjegues.
Bazuar në pasqyrën nr.2, për vitin 2022 janë realizuar 5 (pese) angazhime auditimi, të cilat janë auditime përputhshmërie.
Por bazuar në UrdhërNr. 414, Nr. 5449/1 prot., datë 28.12.2022, për ndryshimin e planit vjetor të angazhimeve të auditimit për vitin 2022, bashkangjitur relacion shpjegues 5449 prot., datë 28.12.2022 , ku te ky i fundit ishte përcaktuar se do të kryheshin gjithsej 5 (pesë) auditime përputhshmërie.
Referuar pasqyrës nr. 3, nuk ka gjetje me dëm ekonomik.
Referuar pasqyrës nr. 4, gjetjet sipas fushës ose sistemeve janë, 11 (njëmbëdhjetë) gjithsej, të cilat i përkasin të gjitha kategorisë Të tjera. Gjithsej 11 (njëmbëdhjetë) gjetje të parregullsive, të konstatuara gjatë auditimit të brendshëm të vitit 2022.
Referuar pasqyrës nr. 5, rekomandime 11 (njëmbëdhjetë) gjithsej, 5 (pesë) të zbatuara dhe 6 (gjashtë) në proces zbatimi.
Referuar pasqyrës nr. 6, çështje të dërguara për investigim për vitin 2022 nuk ka.

**11. Nga auditimi i dokumentacionit të rekrutimit të punonjësve të Njësisë së Auditimit të Brendshën në Bashkinë Mirditë, rezulton se:**

a) Znj. A.M, me arsim të lartë, MSC profili Ekonomik, me status Auditues i Brendshëm 06.07.2018, nr.regjistri 1917, është emëruar në detyrën e specialist auditi të NJAB07.03.2019 në Bashkinë Mirditë, me Akt Emërimi nr. 1045 prot., datë 07.03.2019, duke qenë e pajisur me certifikatën e audituesit. Nga data 12.10.2022 është emëruar Përgjegjëse auditi i NJAB me C
b) Z. G.M, me arsim të lartë, profili Jurist, me status Auditues i Brendshëm 05.07.2019, nr.regjistri 1978 është emëruar në detyrën e specialist auditi të NJAB 01.08.2017, në Bashkinë Mirditë me Akt Emëriminr. 3522 prot., datë 01.08.2017, duke qenë i pajisur me certifikatën e audituesit.
c) Z. Gj.N, me arsim të lartë, MSC profili Financë- Kontabilitet, është emëruar në detyrën e specialist auditi të NJAB 24.11.2021, në Bashkinë Mirditë me Akt Emërimi nr. 4619/3 prot., datë 24.11.2021.

Referuar përbërjes së grupit të NJ.A.B për vitin ka funksionuar me 3 (tre) anëtarë, ku 2(dy)janë në pozicionin Specialist, konkretisht Gj.N dhe G.M, ndërsa A.M si Përgjegjës i NJAB, bazuar në Akt Emërimi nr.3679/7 dt.12.10.2022

## 2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

***1. Auditimi i procedurave të ndjekura për hartimin, e PBA dhe programimit të buxheteve vjetore.***

- *<u>Përgatitja e Programeve Buxhetore Afatmesme 2022-2024</u>*

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024 rezultoi se:

- Për realizimin e fazave të përgatitjes ka dalë Urdhri i Titullarit nr.25 datë 29.01.2021 mbi bazën e të cilit është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) i përbërë prej 19 punonjësish dhe Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP). Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 dhe buxheti i vitit 2022, si dhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara janë miratuar në Këshillin Bashkiak.

- Është përgatitur dhe dërguar për miratim në Këshillin Bashkiak kalendari i programit buxhetor afatmesëm dhe i buxhetit vjetor, i cili është miratuar me VKB nr.118 datë 23.12.2020 dhe konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.prot 1153/10, datë 08.01.2021 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 33/1.

- Janë miratuar në Këshillin Bashkiak tavanet përgatitore të shpenzimeve të PBA me VKB nr.22 datë 30.03.2021 dhe konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.prot 319/8, datë 16.04.2021 në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 34/6.

- Kryetari i Bashkisë ka miratuar udhezimin e brendshëm nr.1, datë 01.04.2021 "Për pergatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024" në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" neni 35/1, i cili u është shpërndarë njesivë shpenzuese të bashkisë.

-Programi Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 është miratuar me VKB nr.68, datë.30.06.2021, konfirmuar nga Prefektura me shkresën nr.prot 584/6, datë 12.07.2021. Nga auditimi i dokumentacionit të praktikës së përgatitjes dhe hartimit të PBA rezultoi se, në përgjithësi ishin respektuar kërkesat e Udhëzimin e MFE nr. 7, datë 26.02.2021 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024" dhe të Udhëzimit plotësues të MFE nr.20, datë 09.07.2021 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024".

- Në këtë programim është përfshirë Instrumenti të planifikimit financiar, shoqëruar me relacionin shpjegues, i cili është dërguar në MFE me shkresën nr.prot.2126, datë 31.05.2021 dhe përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzime të viteve të kaluara, burimet e financimt të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashigimi me destinacion (kontratat në vazhdim), angazhimet (detyrimet e prapambetura sipas llojit), tavanet, llogarija e konomike, vlerësimi i burimeve (të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme. (kostot direkte dhe të ardhurat e pritshme).

- Në dokumentin e PBA janë përcaktuar drejtimet e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, duke u bazuar në analizën e zërave të buxhetit në tre vitet e fundit dhe tendencat nga viti në vit për tre vitet që përfshin PBA-ja 2022-2023-2024.

- Janë përcaktuar fushat prioritare në shpenzimet për investime për funksionet më të rëndësishme si në infrastrukturë, në funksionin e arsimit, në bujqësi për të thithur projekte investimi me financim nga FZHSH. Këshilli Bashkiak ka miratuar draftin e parë të programit buxhetor afatmesëm, dhe ka marrë rekomandimet e Ministrisë së Financave;

- Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore, nëpërmjet procesit të "Buxhetimit me pjesëmarrje", ku për të cilat ishin mbajtur relacionet dhe protokollet përkatëse.

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur të hartimit të PBA 2022-2024 dhe buxheteve vjetore, rezulton se janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative dhe nga Drejtorët e Drejtorive të Bashkisë Mirditë në rolin e menaxherëve të programeve buxhetore përkatëse, si dhe kërkesa nga sektorë të ndryshëm, që mbulojnë këto programe
- Në fazën përfundimtare të PBA, duke iu referuar realizimeve të viteve paraardhëse, si dhe duke respektuar tavanet e përcaktuara në fazat e para të përgatitjes, janë hartuar formatet e detajuara me kërkesat për fonde për harkun kohor tre vjetor sipas programeve si për shpenzimet korrente, investime dhe të ardhurat.
Kërkesat buxhetore për PBA janë dërguar në MFE me shkresën nr.prot.911/1, datë31.05.2021.

- *Hartimi dhe programimi i buxhetit vjetor 2022*

*Për vitin 2022*, buxheti është miratuar me Vendim të KB nr. 125, datë .22.12.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhe me shkresën nr. 1055/15 date 07.01.2022, i paraqitur në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/lekë*

| Nr. | Emërtimi | Plani i vitit 2022 | |
|---|---|---|---|
| | | Të Ardhurat | Shpenzimet |
| 1 | Plani i të ardhurave viti ushtrimor | 75 000 | |
| 2 | Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar | 207 162 | |
| 3 | Të ardhura nga Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale | 168474 | |
| 4 | Paga (600) | | 240392 |
| 5 | Sigurime shoqërore (601) | | 39380 |
| 6 | Shpenzime operative (602) | | 112782 |
| 7 | Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë | | 7344 |
| 8 | Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike | | 50738 |
| **Totali i buxhetit** | | **450 636** | **450 636** |

Me Vendim të KB nr.19, datë 28.02.2022 është miratuar edhe pjesa e buxhetit për fondet e trashëguara nga viti paraardhës, i cili është konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhe me shkresën nr.155/7, datë 15.03.2022, konkretisht këto fonde të trashëguar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/lekë*

| Nr. | Emërtimi | Të Ardhurat | Shpenzimet |
|---|---|---|---|
| 1 | Diferencë nga transferta e pakushtëzuar | 15979 | |
| 2 | Grant i pashperndare(detyrimet e prapambetura) | 0 | |
| 3 | Të ardhurta të trashëguara | 1508 | |
| 4 | Të çelura të papërdorura | | |
| 5 | Grant i trashëguar | | |
| 6 | Transferte e pakushtezuar sektoriale e paperdorur | 8801 | |
| | | | |
| 8 | Paga (600) | | 0 |
| 9 | Sigurime shoqërore (601) | | 0 |
| 10 | Shpenzime operative (602) | | 695 |
| 11 | Transferta (604 - 609) Fondi Rezervë | | 6048 |
| 12 | Inv. (230 +231) nga ardhurat e Tr. Pakushez+tr.Specifike | | |
| 13 | Investime ne proçes | | 19,545 |
| **Totali i buxhetit** | | **26,288** | **26,288** |

Sipas tabelës së mësipërme buxhetii vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiçite, ku të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën 450,636 mijë lekë dhe me trashëgimet e fondeve në vlerën 26, 288 mijë lekë.

- *Krahasimi planeve buxhetore me PBA respektive*:

PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

*Në 000/lekë*

| Nr. | Emërtimi | Plan fillestar 2022 | Sipas PBA 2022-2024 | Ndryshimi |
|---|---|---|---|---|

| Nr. | Emërtimi | Plan fillestar 2022 | Sipas PBA 2022-2024 | Ndryshimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Shpenzime për pagat (600+601) (nga te ardhur e grant i pakush e spec) | 279772 | 267360 | 12412 |
| 2 | Shpenzime (602.shp Op.+604 nd.ek.609) (nga ardhura e grant i pakushtez e specif) | 120126 | 92051 | 28075 |
| 3 | Investime Bashkia (nga te ardhura e grant i pakushtez) | 50738 | 61020 | -10282 |
| 4 | Investime nga FZHSH | | | |
| | **Total I planit fillestar** | **450636** | **420431** | **30205** |
| | **Shtesat nga Pushteti Qendror** | | | |
| 5 | Investime grant i kushtëzuar | | | |
| 6 | Shpenzime për pagat (600+601) | | 4598 | |
| 7 | Shpenzime (602.604.609) | | | |
| 8 | Grant i kushtëzuar (230-231) FZHR | | 30672 | |
| 0 | **Gjithsej** | **450,636** | **455,971** | **-5335** |

***Burimi:*** *Nga Përpunimi i të dhënave nga KLSH sipas planeve të paraqitura nga subjekti*

Referuar tabelës së mësipërme, nga krahasimi i planit fillestar të buxhetit 2022 me vitin e parë të planit buxhetor afatmesëm 2022-2024, rezulton se ka diferencë prej - 5,335 mijë lekë nën tavanin e përcaktuar në PBA. Diferenca prej - 5,335 mijë lekë e rezultuar nga krahasimi i planit fillestar me vitin e parë PBA (2022) i përket shpenzimeve në llogarive të 600 dhe 601, që është vlera e shtuar nga akordimi i fondit të transfertes sektoriale per financimin e shtesës së pagave për funksionet e kaluara ne varësi në Bashkisë. Këto fonde janë planifikuar në mënyrë të përafërt, pasi nuk dihej transferta.

***2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizmit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.***

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit.

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Mirditë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.
- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Nga përpunimi i të dhënave të paraqitura nga subjekti Bashkia Mirditë dhe auditimi i tyre, konstatohet se buxheti vjetor gjatë vitit ka pësuar ndryshime, duke shtuar disa llogari dhe pakësuar disa të tjerë, sipas nevojave të Bashkisë Mirditë.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit. Këto lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB. Ndryshimet buxhetore gjatë vitit ushtrimor 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në lekë

| Buxheti Fillestar | | Ndryshime gjate viteve | | Pakësuar/shtuar artikulli (me emër) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr./datë** | **Vlera** | **Nr./datë** | **Vlera** | **Shtesa art.** | **shuma** | **Paksime art.** | **Shuma** |
| Nr.125, dt 22.12.2021 | **450,636,000** | Nr.63-27/07/2022 | 2 404 371 | 231, investime | 2 404 371 | 231, investime | 2 404 371 |
| | | Nr.85-28/09/2022 | 1 500 000 | 231, investime | 1 500 000 | 600 paga | 500 000 |
| | | | | | | 602 shpenz op | 1 000 000 |
| | | VKM.465, DT.06.07.2022,shkr MFE nr 16040-29.08.22 | 1 072 389 | 600+601 pg sig | 1 072 389 | | |
| | | Akt-normativ 17 - 01.12.2022 | 21 452 000 | (602-606) shp.op,nd. finan | 11 280 000 | | |
| | | | | 231 investime | 10 172 000 | | |
| | | Urdher titullari nr.08 dt.09.01.2023 | 4 414 000 | 606 nd.financiare | 4 414 000 | 602 shpenz op | 4 414 000 |
| | | Vkb pastrimi nr 60 dt.27.07.2022 | 5029770 | 600 pg | 4 310 000 | 602 shpenz op | 5029770 |
| | | | | 601 sig | 719 770 | | |
| | | | | | | | |

**Burimi**: *Nga të dhënat e buxheteve të hartuara nga Bashkia Mirditë*

Nga sa më sipër konstatojmë se, për vitin 2022 kanë ndodhur 2 ndryshime me VKB dhe 3 ndryshime me akte normative dhe VKM në vlerën 30,842,760 lekë.

***3. Auditim mbi saktësinë e realizmit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.***

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Mirditë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse.

Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Mirditë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv 2022, të miratuar me Vendim të KB, ose të diktuara nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. nga auditimi i shkresave, evidencave të celjeve, shpërndarjes së fondeve gjatë vitit, të akt-rakordimeve periodike me degën e Thesarit Mirditë u konstatua se, si në planifikim dhe në realizim të buxhetit është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

| Nr. | Emërtimi | 2022 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **Plan** | **Fakt** | **Real.%** |
| 1 | Paga 600 | 246,065 | 240,302 | 97.6 |
| 2 | Sigurime shoqërore 601 | 40,943 | 39,387 | 96 |
| 3 | ShP. Operat 602+ F. Rezervë +606 transfert individ | 117,639 | 105,342 | 89 |
| 4 | Nd/Ekonom invalid 606 | 315,654 | 312,008 | 99.5 |
| 5 | Investime (230/231 ) | 99,768 | 58,319 | 58.4 |
| 6 | Mjete ne ruajtje 466 | 0 | 3,310 | |
| 7 | Rindertimi investime | 1,167,638 | 1,153,949 | 98.8 |
| 8 | Rindertimi transferta (606 DS1,2,3,4) | 54,854 | 31,239 | 57 |
| 9 | Rindertimi bonus qeraje min10 | 32,211 | 32,211 | 100 |
| 10 | Bonus qeraje pastrehet min 10 | 13,073 | 13,073 | 100 |
| 11 | Fond i emergjencave civile min 17 (604) | 6,483 | 6,483 | 100 |
| | **Totali** | **2,094,328** | **1,995,623** | **95.3** |

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërm, niveli i realizmit të treguesve të buxhetit:

- Për **vitin 2022** janë realizuar 1,995,623 mijë lekë nga 2,094,328,mijë lekë të planifikuara, ose në masën 95.3%.

Kjo tregon se treguesit e buxhetit planifikohen, sipas nevojave që ka Bashkia Mirditë. Në këtë masë realizim ka ndikuar realizimi në masë të konsiderueshme në zërat e buxhetit:

a. Shpenzimet operative llog.602 janë realizuar në masën 89%.
b. Shpenzimet për investime llog.231 nga buxheti i Bashkisë, si dhe transferta e

kushtëzuar pa përfshirë rindërtimin nga pasojat e tërmetit i vitit 2019 janë realizuar në masën 58%. Realizimin në këtë masë ka ardhur si rezultat i shtesës se planit të investimeve nga shtesa e buxhetit sipas aktit normativ nr.17, datë 01.12.2022, si dhe ndryshimeve ne buxhet gjatë vitit, të cilat janë bërë me VKB përkatëse.

c. Investimet nga rindertimi nga pasojat e tërmetit i vitit 2019 janë realizuar në masen 98.8%, ndërsa transfertat tek individët llog. 606 për rindërtimin janë realizuar në masën 57%, kjo për faktin se këto fonde nuk janë përdorur, pasi sipas procedurave të ndjekura për rindërtimin sipas akteve ligjore kanë ndryshuar metodologjia e ndërtimit të banesave për përfituesit dhe këto fonde të pa përdorura janë gjendje (akt rakordimi me degen e Thesarit Mirditë për fondet e trashëguara me datë 31.12.2022)

Peshën specifike me të madhe në buxhet ndaj totalit e zënë investimet për programin e Rindërtimit si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019, e ndjekur nga transferimet tek individët për ndihmë ekonomike e invaliditeti dhe shpenzimet për paga personeli ,tregues të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| **Nr.** | **EMËRTIMI** | **Përqindja ndaj totalit** |
|---|---|---|
| | | **Viti 2022** |
| 1. | Investime Rindërtimi | 57.8 % |
| 2. | Transferta Nd.Ek+Invalid | 15 % |
| 3. | Shpenzime për paga +sig | 14 % |

- *Miratimi i realizimit faktik të buxhetit*

Në fund të periudhës ushtrimore nga Bashkia Mirditë është miratuar buxheti vjetor, ku për vitin 2022 eshte miratuar me vendim te KB nr.125, datë.22.12.2021.

- *Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe i kontigjencës*

Fondi rezervë për vitin 2022 është në total në shumën 1 500 mijë lekë, i cili është miratuar që nga buxheti fillestar i vitit buxhetor me VKB nr.125, datë.22.12.2021 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhe dhe është përdorur e gjithë shuma sipas vendimeve të KB.

- *Raportet e Monitorimit.*

Për vitin 2022, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit, realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" neni 6.Për vitin 2022 është dërguar "Raport monitorimi Buxhetit Janar-Prill" me shkresën nr.prot.2487, date.31.05.2022,"Raport monitorimi Buxhetit Janar-Gusht" me shkresën nr.4122 prot, date.22.09.2022,"Raport monitorimi Buxhetit Janar-Dhjetor" me shkresën nr.815 prot, date 27.02.2023.

Raportet e monitorimit janë hartuar në përputhje me kërkesat e Shtojcës 2 "Përmbajtja e raportit të monitorimit" dhe Shtojcës 5 "Treguesit e monitorimit të performancës së programeve dhe treguesit financiarë", të Udhëzimit të MFE nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore". Raportet e monitorimit janë të plota me të gjitha anekset sipas kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", neni 48 dhe Udhëzimit nr. 22, datë 30.07.2018, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore", pikat 10, 12, 28, 29, 48.

***4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve dhe niveli realizmit të të ardhurave***

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës. Bashkia në planifikimin e procedurave, fillimisht duhet që në buxhet të planifikojë detyrimet e prapambetura (kreditor) gjë e cila ndodh, por që

nuk mbahet në konsideratë gjatë zbatimit të tij dhe në raport me fondet e mbetura të planifikoje procedurat e domosdoshme për vitin pasardhës**,** kjo për të shmangur në maksimum rritjen e nivelit të kreditorëve në fund të periudhave ushtrimore.

- *Evidentimi, raportimi, ndjekja dhe likujdimi i faturave të palikujduara*

Me fondet e vitit buxhetor 2022, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikujduara të viteve të mëparshme, duke bërë pagesat pjesë-pjesë të detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara Basshkia, nga Ministritë e linjës apo FZHSH, AKUM, sipas fondeve të çelura për çdo vit buxhetor të përcaktuar në PBA e periudhës përkatëse në bazë të shkresave përkatëse të alokimit të fondeve.

Situata e planifikimit të detyrimeve të papaguara nga viti paraardhës në buxhet respektivisht paraqitet si vijon:

| Periudha | Detyrimet në fund të periudhës | Vlera e detyrimeve të planifikuara | VKB nr. /datë | Llog 602 | Llog. 230-231 |
|---|---|---|---|---|---|
| Viti 2022 | 23,209,964 | 21,399,815 | 125 date 22.12.2021/ 117 datë 13.12.2022 | 10,810,491 | 10,589,324 |

**Burimi:***Nga të dhënat e subjekti sipas pasqyrave.*

Diferenca ndërmjet detyrimeve në fund të periudhës dhe detyrimeve të planifikuara në shumën prej 1,810,149 lekë i përket faturave të mbartura të pa likujduara për mungesë dokumentacioni, për të cilën i është bërë shkresë degës së Thesarit Mirditë për t'i hequr nga sistemi. Këto detyrime i përkasin: 1,455,835 lekë llog. 602 "shpenzime operative" dhe 354,314 lekë llog. 230 kolaudime, mbikqyrje.

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës "*Detyrimet e prapambetura*", sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

*Detyrimet e prapambetura deri në fund të periudhës 31.12.2022:*

| Detyrime e NJQV | Detyrimi në fillim të vitit I mbartur 31.12.2021 (lekë) | Detyrimi I krijuar në periudhën 01/01/2022 - 31.12.2022 (lekë) | Total detyrime (lekë) | Shlyerja e detyrimeve 2022 (lekë) | Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2022 (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|
| **a** | **1** | **2** | **3=1+2** | **4** | **5=3-4** |
| a. Investime nga Ministritë e linjës e FZHSH | 25 423 657 | 47 605 741 | 73 029 398 | 20 350 000 | 52 679 398 |
| b. Investime nga Bashkia | 10 943 638 | 0 | 10 943 638 | 10 589 324 | 354 314, |
| **INVESTIME :** | | | | | |
| Mallra dhe shërbime | 12 266 326 | 0 | 12 266 326 | 10 810 491 | 1 455 835 |
| Rindertimi | 0 | 1 313 477 | 1 313 477 | 0 | 1 313 477 |
| **Totali :** | **48 633 621** | **48 919 218** | **97 552 839** | **41 749 815** | **55 803 024** |

**Burimi:***Nga të dhënat e subjekti sipas pasqyrave*

Referuar shkresës nr.prot.763prot, datë.15.02.2022 "Mbi publikimin e detyrimeve të prapambetura" të Bashkisë Mirditë dërguar në MFE e për rrjedhojë dhe publikimit të detyrimeve të prapambetura në faqen e MFE në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën *48 633 621 lekë* dhe në fund të vitit 2022 referuar shkresës nr.prot. 469/1 datë 15.02.2023 "Mbi publikimin e detyrimeve të prapambetura" në shumën *55 803 024 lekë.* Gjatë vitit 2022 janë krijuar , 48 919 218 lekë, por njëkohësisht është likujduar vlera prej 41 749 815 lekë, dhe vlera e detyrimit është 55 803 024 e ndarë:

-Detyrime te ministrive të linjës……….. ………………….52,679,398 lekë

- Detyrime nga Rindërtimi……………………………………1,313,477 lekë

-Fatura të pa likujduara për mungesë dokumentacioni……...1,810,149 lekë

**Shënim :** Detyrimet e raportuara në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë **për vitin 2022** me shkresën nr.496/1 prot datë 15.02.2023 janë në vlerën 1,810,149 lekë, që i përkasin detyrimeve të krijuara ndër vite dhe për mungesë dokumentacioni, të cilat nuk janë likujduar. Ndërsa **vlera 52,679,398 lekë janë detyrime nga Ministritë e Linjës, AKUM dhe 1,313,477 lekë janë detyrime nga Rindërtimi, të cilat nuk janë përfshirë në raportim**, pasi likujdimi i tyre është i varuar nga alokimi i fondeve nga Pushteti Qendror.
Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 nga analiza e këtyre detyrimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme rezultojnë që në fund të vitit 2022 janë të palikujduara gjithsej 33 fatura me vlerë **55,803,024 lekë.** Detyrimet e prapambetura të detajuara paraqiten në Aneks:

**Konkluzion:** Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të periudhës ushtrimore 2021 Bashkia Mirditë ka gjendje të detyrimeve të prapambetura në shumën prej 23,209,964 lekë, e cila është ulur në masën 1,810,149 lekë fatura, të cilat nuk kanë dokumentacion të rregullt për likujdim. Nga auditimi i dokumentacionit të miratimit të buxhetit vjetor 2022 rezultoi se, është bërë planifikimi i fondeve të veçuara për financimin e detyrimeve të prapambetura në përputhje me kërkesate Udhëzimit të MFE nr.09, datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të e buxhetit”.
Detyrimet e prapambetura për vitin 2022 të paraqitura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr.496/1 prot datë 15.02.2023 jepen në tabelën si më poshtë :

| N.R | Emërtim | Stoku në vlerë | Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në | Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së |
|---|---|---|---|---|
| **I** | **Borxhe (a+b)** | **0** | | |
| **a** | **Hua afatgjatë** | **0** | | |
| a,1 | Principali | | | |
| a,2 | Interesi | | | |
| **b** | **Hua afatshkurtër** | **0** | | |
| b,1 | Hua | | | |
| b,2 | Overdrafte | | | |
| b,3 | Kredi të furnitorëve | | | |
| | | | | |
| **II** | **Detyrime (a+b+c)** | **1,810,149** | | **0.35%** |
| **a** | **Shpenzime korrente** | **1 455 835** | | |
| a,1 | Mallra dhe shërbime | 1 455 835 | | |
| a,2 | Paga dhe sigurime | | | |
| a.3 | Të tjera | | | |
| | | | | |
| **b** | **Shenzime kapitale** | **354 314** | | |
| b,1 | Insitucione buxhetore | 354 314 | | |
| b,2 | Subjekte private | | | |
| | | | | |
| **c** | **Vendime gjyqësore** | **0** | | |
| c,1 | Marrëdhënie pune | | | |
| c,2 | Mallra dhe shërbime | | | |
| c,3 | Investime | | | |
| c,4 | Të tjera | | | |
| | | | | |
| **III** | **Totali (I+II)** | **1,810,149** | **522,600,493** | **0.35%** |

Analiza e vlerës së e detyrimeve të krijuara gjatë vitit 2022 dhe raportuar në MFE paraqitet më poshtë:

***a. Me financim nga Bashkia Mirditë***

- Fatura të pa likujduara, për mungesë dokumentacioni 1,810,149 lekë

b. ***Me financim nga Ministritë e linjës dhe AKUM***

- Ndërtim ujsjellsi Rubik 52,679,378 lekë fatura të pa likujduara, për arsye se fondet për financimin e tyre nuk janë çelur nga MIE.

c. ***Me financim nga fondet e Rindërtimit***

- Akt ekspertiza per dëmtime të banesave 1,313,477 lekë, të pa likujduara sepse nuk janë çelur fonde nga MIE për rindërtimin.

Krijimi dhe akumulimi idetyrimeve të papaguara në fund të vitit ushtrimor është në papajtueshmëri me Udhëzimin e MFE nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", pikat 82-91.

**Vështirësia Financiare**

Nga auditimi është konstatuar se **detyrimet e papaguara** (*të akumuluara*) në fund të vitit 2022 paraqiten në vlerën **1,810,140 lekë fatura të cilën nuk mund të likujdohen për mungesë dokumentacioni** .Pesha specifike e stokut të detyrimeve të konstatuara të Bashkisë ndaj palëve të treta është 0.35 % kundrejt fondeve të miratuara. Kjo situatë tregon se, Bashkia Mirditë nuk mund të konsiderohet në vështirësi financiare në fund të vitit ushtrimor 2022, pasi raporti i detyrimeve ndaj fondeve vjetore të miratuara për shpenzime është nën nivelin prej 25 %, sipas nenit 56 "Vështirësia financiare" të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

- *Çelja dhe ekzekutimi i fondeve për investime, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.*

Me miratimin e buxhetit vjetor janë miratuar dhe projektet për invetime. Investimet kryesisht janë me burim financimi nga transferta e pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta (minimale) të Bashkisë Mirditë.

- Për **vitin 2022** janë planifikuar fonde për investime në shumën ***99,768,028 lekë*** (të cilat janë nga grant i pakushtëzuar + tarsnsferta sektoriale + të ardhura), realizuar dhe likujduar në vitin 2022 në vlerën 58,319,948 lekë. Realizimi ne masen 58.4% i investimeve ka ardhur si rezultat i disa shkaqeve si: nuk është prerë faturë nga operatori fitues dhe një pjesë e tyre nuk janë prokuruar brenda vitit.

Gjatë vitit ka pasur ndryshime si shtesa dhe pakësime, të cilat janë shqyrtuar nga GMS, i cili ka vendosur miratimin e tyre dhe më pas janë miratuar me VKB për secilin rast.

Këto projekte me të dhënat analitike për datën dhe vlerën e kontratës, si dhe likuidimet e tyre paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Objekti i kontratës | Fond Planifikim | Kontrata me subjektin | | | Subjekti i kontraktuar | Paguar Viti 2022 | Mbetja 31.12.2022 | Komente |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Datë lidhjes se kontratës | Afati | Vlerë kontrate me TVSH | | | | |
| 1 | Tvsh Rehabilitimit kanalit Malaj-Tarazh | 4 148 999 | 08.11.2021 | 3 muaji | 7 043 517 | L… | 3 978 790 | 170209 | Përfunduar |
| 2 | Plotësimi rrjet ujitës Malaj 2 (kanali koder Rreshen) | 7 524 974 | 18.05.2022 | 4 muaji | 7 520 603 | A… | 7 517 084 | 7890 | Perfunduar |
| 3 | Plotësimi I rrjetit ujitës Malaj 2 (kanali koder Rreshen zalli I zmese | 1 500 000 | 17.11.2022 | 4 muaji | 5 689 694 | A… | 1 500 000 | 0 | vazhdim |
| 4 | Mbikqyrje punimesh | 3 000 000 | 08.06.2022 | 4 muaji | 797,294 | A… | 1 001 567 | 1 998 433 | Pa prokurua |
| 5 | Blerje kompjutera dhe pajisje komp | 675 000 | 19.10.2022 | 5 ditë | 672 000 | I… | 672 000 | 3000 | Përfunduar |
| 6 | T.v.sh blerje automjet teknologjik | 1 940 580 | 14 07.2021 | 30 ditë | 1 940 580 | T… | 1 940 580 | 0 | Përfunduar |
| 7 | Tuba vija vaditëse | 1956552 | 30.05.2022 | 15 ditë | 1 938 072 | A… | 1 938 072 | 18480 | Përfunduar |
| 8 | Rikonstruks puseta hyrse ujmbl.geziq | 1 052 400 | 13.12.2021 | 30 ditë | 1 052 400 | A… | 1 052 400 | 0 | Përfunduar |
| 9 | "Rik kompl godina 123" bashkefinanc 10% nga fondet e bashkise | 5 112 170 | 29.07.2019 | 6 muaji | 120 924 793 | U… | 5 112 170 | 0 | 10% nga fonde bashki |
| 10 | "Rik shk.mesme Fane" bashkefinanc | 3 232 700 | 29.07.2019 | 4 muaji | 69 805 421 | K… | 3 232 700 | 0 | Perfunduar |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 10% nga fondet e bashkise | | | | | | | | |
| 11 | Zhbllokim ujeleshuesit ujmbledhe geziq | 705 803 | 29.03.2022 | 15 ditë | 398000 | A... | 398 000 | 307803 | Përfunduar |
| 12 | Tvsh etiketa vizibiliteti | 170 316 | 22.06.2021 | 12muaji | 170316 | E... | 170 316 | 0 | Përfunduar |
| 13 | Bl. Materjale e vegla pune per investime | 20 000 000 | 2.12.2021 | 16 muaji | 32 557 002 | A... | 9 455 820 | 10 544 180 | Marrv kuader vazhdi 2023 |
| 14 | Rikonstruksion kanali Dushaj Ashtë | 2 400 000 | 28.12.2022 | 3 muaji | 2 400 000 | K... | 0 | 2 400 000 | Punime 2023 |
| 15 | Ndertim ujsjellsi rubik shtesë kontrate | 16 000 000 | 17.08.2022 | 3 muaji | 26 526 068 | A... | 0 | 16 000 000 | Pa sjelle fatur |
| 16 | Mbarshtrim pyjesh | 6 199 030 | 09.12.2022 | 7 muaji | 6 199 030 | L... | 0 | 6 199 030 | Pa sjelle fatur |
| 17 | Mobilim zyrat e Këshillit | 800 000 | | | | | | 800 000 | Pa prokuruar |
| 18 | Asfaltim rrugesh Bashkia Mirditë | 3 000 000 | | | | | | 3 000 000 | Pa prokuruar |
| | **Totali grant i pakushtezuar + tarsnsferta sektoriale + të ardhura** | **79 418 524** | | | | | **37 969 949** | **41 448 575** | |
| | **466 garanci punimesh të paguara** | | | | | | **1 894 490** | | |
| | | | | | | | | | |
| | **Buxheti shtetit AKUM MIE** | | | | | | | | |
| 1 | Mdertim I ujsjellësit Rubik) | 20 000 000 | 15.07.2020 | 12 muaj | 144 513 025 | C... | 20 000 000 | 0 | Fond pa çelu |
| 2 | Mbikq punime ndërtim ujsjellsi Rubik | 350 000 | 07.07.2022 | 12 muaj | 2 365 338 | I... | 350 000 | 0 | Fond pa çelu |
| | **Totali transfert e kushtezuar M.linje** | **20 350 000** | | | | | **20 350 000** | | |
| | **Buxheti shtetit RINDËRTIMI** | | | | | | | | |
| 1 | Mbikq. Pallat Rrëshen Rubik faza I | 4 750 000 | 10.09.2021 | 14 muaj | 4 750 000 | E... | 4 750 000 | 0 | perfunduar |
| 2 | Mbikqyrje punimesh palate Reps | 2 346 313 | 15.03.2022 | 8 muaj | 2 346 313 | H... | 2 346 313 | 0 | perfunduar |
| 3 | Mbikq punimesh objektet arsimore | 1 601 580 | 13.10.2021 | 14 muaj | 1 601 580 | N... | 1 601 580 | 0 | perfunduar |
| 4 | Mbikq punimesh objketet publike | 1 815 000 | 13.10.2021 | 14 muaj | 1 815 000 | A... | 1 815 000 | 0 | perfunduar |
| 5 | Kolaud:1.Rik i objekte bashkëpro faza I | 410 000 | 02.11.2022 | 2 muaj | 410 000 | H... | 410 000 | 0 | perfunduar |
| 6 | Kolaud 2.Rik I objekteve publike | 145 000 | 02.11.2022 | 2 muaji | 145 000 | H... | 145 000 | 0 | perfunduar |
| 7 | Kolaud 3.Rik I objekteve arsimore | 145 000 | 02.11.2022 | 2 muaji | 145 000 | H... | 145 000 | 0 | perfunduar |
| 8 | Mbikq.Rik spital Shejt Mari Rreshe | 1 532 039 | 15.07.2022 | 7 muaj | 1 062 591 | I... | 1 532 039 | 0 | Pa përfun ob |
| 9 | Rik pallat Rreshen Rubik faza e I | 269 357 401 | 07.09.2021 | 14 muaj | 361 731 224 | U... | 255 668 429 | 13 688 972 | perfunduar |
| 10 | Rik pallat Rreshen Rubik faza e II | 287 149 080 | 13.07.2022 | 12 muaj | 362 526 402 | U... | 287 149 080 | 0 | perfunduar |
| 11 | Rik pallatet Rreshen Rubik faza e tretë | 43 197 338 | 02.12.2022 | 10 muaj | 187 417 132 | U... | 43 197 338 | | Pa përfun ob |
| 12 | Rik ambjente përbashk pallat Reps | 183 991 365 | 28.02.2022 | 7.5 muaj | 184 001 854 | L... | 183 991 365 | 0 | përfunduar |
| 13 | Rik objkete arsimore qyteti rreshen | 77 315 517 | 13.10.2021 | 13 muaj | 97 860 882 | U... | 77 315 517 | 0 | perfunduar |
| 14 | Prishja e banesave individuale dhe përgatitja e shesheve të ndërtimit | 36 899 698 | 22.09.2021 | 5 muaj | 40 998 520 | L... | 36 898 668 | 0 | perfunduar |
| 15 | Rik I objekteve publike qyteti Rreshen | 81 450 486 | | 11.5 muaj | 103 177 350 | A... | 81 450 486 | 0 | perfunduar |
| 16 | Rik spitali Shejtja Mari Rreshen | 156 343 174 | 05.07.2022 | 350 dite | 407 524 613 | E... | 156 343 174 | 0 | Pa perfundu |
| 17 | Ndërt.godin kopësh çerdh zona re zhvil | 19 190 193 | 05.07.2022 | 8 muaj | 76 757 242 | E... | 19 190 193 | 0 | Pa perfundu |
| | **TOTALI RINDËRTIMI** | **1 167 639 184** | | | | | **1,153,949,182** | **13 688 972** | |
| **Totali i vitit 2022** | | | | | | | | | |

- Faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e investimeve në nivel projekti paraqiten si më poshtë:

Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e investimeve me fondet e veta Bashkia Mirditë ka programuar 18 projekte investimesh nga ku rezultoi se, janë realizuar procedurat e prokurimit dhe finalizuar me kontratë 15 projekte me vlerë 73,620,091, nga të cilat janë realizuar plotësisht punimet në 11 projekte, në 4 projekte punimet janë në vazhdimsi për vitin 2023,si dhe fondet për financimin e tyre janë trashëguar në buxhetin e këtij viti, ndërsa 2 projekte investimesh dhe 1 mbikqyrje punimesh nuk janë prokuruar në vlerën 5,798,433 lekë .

Projekte të pa prokuruara për vitin 2022:

1. Mbikqyrje studime e projektime........ 1,998,433 lekë.
2. Mobilim zyrat e Këshillit Bashkiak......800,000 lekë
3. Asfaltim Rrugësh të Bashkisë...........3,000,000 lekë.

Si rezultat i moskryerjes së objekteve të investimit nuk janë realizuar dhe fondet ë akorduara për mbikqyrje kolaudime në vlerën 1,998,433 lekë.

- Nga auditimi i procedurave të ndjekura për realizimin dhe financimin e 18 projekteve të investimeve Bashkia Mirditë me financim nga fondet e veta, 1 projekt me financim nga FZHSH dhe 17 projekte tëfinancuara nga fondet e Rindërtimit nga tërmeti, rezultoi se janë ndjekur hapat:

Për çdo procedure prokurimi, urdhri është regjistruar në kohë dhe ka vulën/ datën e depozitimit të tyre në Degën e Thesarit Mirditë . Kontratat janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Mirditë dhe të shtrira në kohë sipas financimit brenda vitit buxhetor koherent. Kontrata është regjistruar e plotë me qëllim pagesën e saj në afate mujore, pra nuk janë regjistruar kontrata të copëtuara, ndërsa pagesa është kryer sipas limitit mujor.Për çdo rast të depozitimit të kontratave në Degën e Thesarit është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit .

- *Burimet e financimit të buxhetit vjetor*

Realizimi i buxhetit për vitin 2022 sipas burimit të financimit paraqitet në tabelën e mëposhtme.

000/lekë

| Nr | Emertimi | 2022 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Plan | Fakt | Real.% |
| 1 | **Paga 600** | **246 065** | **240 302** | **98** |
| | grant I kushtezuar | 4 610 | 4 587 | 99 |
| | grant I pakushtezuar + tarsnsferta sektoriale | 216 641 | 213 449 | 98 |
| | te ardhura | 24 814 | 22 266 | 90 |
| 2 | **Sigurime shoqërore 601** | **40 943** | **39 387** | **96** |
| | grant I kushtezuar | 956 | 767 | 80 |
| | grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike | 39 200 | 38004 | 97 |
| | te ardhura | 787 | 616 | 78 |
| 3 | **Shpenz.operative 602+ F.rezerve** | **117 639** | **105 342** | **89** |
| | grant I kushtezuar | 1 502 | 1 363 | 91 |
| | grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike | 70 568 | 68 534 | 97 |
| | te ardhura | 45569 | 35 445 | 78 |
| 4 | **K.Qarkut Transferime 604** | **6483** | **6483** | **100** |
| | grant | 0 | 0 | 0 |
| | grant I kushtezuar | 6483 | 6483 | 100 |
| | te ardhura | 0 | 0 | 0 |
| 5 | **Nd ekonomike invalid 606 ,bonus strehimi ,ndihma financiare** | **415 792** | **388 531** | **93** |
| | grant I kushtezuar | 401767 | 376 705 | 94 |
| | grant I pakushtezuar + tarsnsferta specifike | 10 695 | 8 496 | 79 |
| | te ardhura | 3 330 | 3 330 | 100 |
| 6 | **Investime 230-231** | **1 267 406** | **1 212 268** | **96** |
| | grant I kushtezuar Rindertimi | 1 167 638 | 1 153 949 | 99 |
| | grant I kushtezuar AKUM | 20 350 | 20 350 | 100 |
| | grant I pakushtezuar + trasnsferta specifike | 78 918 | 37 469 | 47 |
| | te ardhura | 500 | 500 | 100 |
| | **Totali Bashkia Mirditë** | **2 094 328** | **1 992 313** | **95** |
| | **Mjete në ruajtje** | | **3 310** | |
| | **Total Bashkia Mirditë +466 mjete ne ruajtje** | **2 094 328** | **1 995 623** | **95** |

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se nga të ardhurat e veta kjo bashki përballon në fakt:
- Shpenzimet në artikullin 600 “paga e shpërblime” për vitin 2022 në masën 1.12%
- Shpenzimet në artikullin 601 “kontributin për sigurime shoqërore e shëndetësore” për vitin 2022 në masën 0.03%.
- Shpenzimet në artikullin 602 “shpenzime operative për mallra e shërbime” për vitin 2022 në masën 1.78%.
- Shpenzimet në artikullin 230-231 “investime” për vitin 2022 në masën 0.03 %.

Duke u nisur nga burimi i financimit **për vitin 2022** shpenzimet buxhetore janë përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 62,157 mijë lekë ose në masën 3.12 %, nga transferta e pakushtëzuar dhe transferta specifike në shumën 365,952 mijë lekë ose në masën 18.36%, nga transferta e kushtëzuar në shumën 1,564,204 mijë lekë ose në masën 78.52% .

### *5. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave.*

- *Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*

**Për vitin 2022** numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr.**114**, datë 22.12.2021 dhe urdhrit te Kryetarit të Bashkisë nr. 17 datë 15.02.2022 "Për miratimin e strukturës, organigrama e Bashkisë Mirditë, viti 2022", ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore, e cila përbëhet nga 10 punonjës: 1 drejtor, 3 përgjegjës dhe 6 specialistë.

- *Të dhëna mbi numrin e subjekteve, regjistrimet dhe mbylljet*

Nga të dhënat e paraqitura nga Drejtoria i Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Mirditë në lidhje me numrin e subjekteve aktiv, regjistrimeve të reja dhe atyre që kanë kërkuar mbyllje aktiviteti, rezulton se:

Për periudhën objekt auditimi, gjendja dhe ndryshimet mbi statusin e subjekteve paraqitet: **në vitin 2022** janë subjekte biznesi 439, nga të cilat 327 subjekte të biznesit të vogël dhe 90 subjekte të biznesit të madh, institucione 22.Bizneset që ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Mirditë në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| NR | Lloji Biznesit | Viti | Gjendja në fillim | Regjistrime të Reja | Mbyllur Aktiviteti | Gjendja në fund të vitit | Biznese të palicencuar deri ne fund te vitit ushtrimor | Asetet Me kontrate |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | BIZNES I VOGEL | 2022 | 339 | 21 | 36 | 324 | | - |
| 2 | BIZNESI MADH | 2022 | 82 | 10 | 2 | 90 | | - |
| 3 | INSTITUCIONE | 2022 | 22 | 0 | 0 | 22 | | - |
| | TOTALI | 2022 | 176 | 10 | 8 | 178 | 59 | 14 |

Për 59 subjekter të palicencuara nga DAV, Bashkia Mirditë është dërguar shkresë Drejtorisë së Hetimit Tatimor me nr.prot.2551/1 date 19.7.2021, për vënien në dijeni të dhe detyrimin e tyre për licencim, ndërkohë që këto subjekte janë evidentuar dhe janë ngarkuar me taksa e tarifa vendore, ku edhe ata kanë paguar këto detyrime.

- *Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve*

**Për vitin 2022**, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Mirdite është miratuar me VKB nr. 10, datë 24.11.2021, "Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Mirditë". Referuar planit vjetor të miratuar dhe bazuar në akt-rakordimet me Degën e Thesarit Mirdite, parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për Bashkinë e Mirditës për 2022 paraqitet i detajuar në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

| | TË ARDHURAT viti 2022 | Plan | Fakt | Realizimi ne % |
|---|---|---|---|---|
| A | Të Ardhura nga Burimet e Veta | | | |
| **A.1** | **Të Ardhura nga Taksat Lokale** | ***35,659,809*** | ***39,352,886.82*** | |
| **A.1.1** | **Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin mbi biznesin e vogël (DRTT)** | | ***106,620*** | |
| A.1.2.1 | Taksa mbi ndërtesën | *9,289,500* | *2,824,687.1* | 30.4 |
| A.1.2.2 | Taksa mbi tokën bujqësore | *342,700* | *51,278.5* | 14.96 |
| A.1.2.3 | Taksa mbi truallin | *746,082* | *11,561,912.80* | 1549.68 |
| **A.1.3** | Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja | *7,000,000* | *3,297,835.42* | 47 |
| | Taksa e zënies së hapsirave publike | *379,652* | *93,280* | 24.56 |
| **A.1.4** | Taksa e tabelës | *967,000* | *1,743,758* | 180.3 |
| | Takse hoteli | *50,000* | *150,000* | 300 |
| **A.2.1** | **Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme** | *184,875* | *0* | |
| **A.2.2** | **Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura** | *10,500,000* | *12,455,624* | 118.6 |
| **A.2.3** | **Taksa e rentës minerare** | *0* | *0* | |
| **A.2.4** | **Taksa mbi të ardhurat personale** | *6,200.000* | *7,067,891* | 113.99 |
| **A.3** | **Të Ardhurat nga Tarifat Vendore (jo tatimore)** | **32,256,274** | **17,376,883** | |
| A.3.1.1 | Tarifa e pastrimit për familjet, institucionet, biznesi | *18,900,200* | *7,026,044* | 37.17 |
| A.3.1.2 | Tarifa e ndricimit për familjet, institucionet, biznesi | *560,000* | *11,600* | 2,07 |
| A.3.1.3 | Tarifa e gjelbërimit për familjet, institucionet, biznesi | *635,000* | *0* | 0 |
| A.3.4.1 | Tarifa për vulosje veterinarie të bagëtive të therura | | | |
| A.3.4.2 | Tarifa e liçensimit të veprimtarive të transportit | 639,770 | 1,110,189 | 173.5 |
| A.3.4.3 | Tarifa për dhënie liçense për tregtimin e naftës bruto e nënprodukte të saj | | 4,250,000 | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Tarife për qira ndërtesa | 821,304 | 0 | |
| A.3.4.4 | Tarifa qira për troje, parcela nga fondi pyjor dhe kullosor | 10,400,000 | 4,593,830 | 42.97 |
| A.3.4.5 | Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja(MNZ) | 300,000 | | |
| A.3.4.6 | Tarifa për qira repititor | | 194,808 | |
| A.3.5.1 | Kamatvonesa | | 190,412 | |
| **A.4** | ***Të Ardhurat e Tjera(kopeshte dhe cerdhe )*** | ***7,040,600*** | ***7,151,246*** | |
| **A.4.1** | **Pagesa për cerdhe** | 1,960,000 | 952,360 | 48.58 |
| | **Pagesa e kopshtit** | 1,980,600 | 2,041478 | 103 |
| **A.4.2** | **Të tjera të ardhura sekondare** | 3,100,000 | 4,157,408 | 129.4 |
| | **TOTALI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË** | **75,007,000** | **63,881,015.82** | 85 |

**Për vitin 2022** realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Mirditë paraqitet në masën 85.1% nga 75,007 mijë lekë të parashikuara janë realizuar në vlerën 63,881 mijë lekë. Në këtë realizim ka ndikuar dhe realizimi jo i pritshëm i disa taksave dhe tarifave vendore, për të cilat nuk është bërë i mundur planifikimi i saktë tyre si:
- Tatimi mbi të ardhurat përsonale i derdhur nga DTTV realizuar realizimi në masën 113.99 %;
- Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme realizimi në masën 0 %;
- Taksa vjetore për qarkullimin e automjeteve të përdorurarealizimi në masën 118.6%;
- Taksa mbi tatimin e thjeshtuar për biznesin e vogël e pa planifikuar dhe realizuar në vlerën 106,620 lekë.

Referuar tabelës së mësipërme konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet më shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Kështu :

a. Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim mbi planin si:

- ***Taksa e tabelës*** është realizuar 1,744 mijë lekë nga 967 mijë lekë e planifikuar ose në masën 180.3%,
- ***Taksë hoteli*** është realizuar 150 mijë lekë nga 50 mijë lekë e planifikuar ose në masën 300%,
-***Taksa e truallit*** është realizuar 746 mijë lekë nga 11,562 mijë lekë e planifikuar ose në masën 1549.68%,
- ***Tarifa e licencimit të veprimtarisë së transportit*** është realizuar 1,110 mijë lekë nga 640 mijë lekë e planifikuar ose në masën 173.5%,
-***Tarifa për dhënie licensë për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj*** është realizuar 4,250 mijë lekë, ndërkohë që për këtë tarifë nuk ka planifikim.

b.Taksat dhe tarifat e paraqitura me realizim të ulët të planit si:

- ***Taksa mbi ndërtesën*** është realizuar 2,825 mijë lekë nga 9,290 mijë lekë e planifikuar ose në masën 30.4%,
- ***Taksa mbi tokën bujqësore*** është realizuar 51 mijë lekë nga 342 mijë lekë e planifikuar ose në masën 14.96%,
- ***Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja*** është realizuar 3,298 mijë lekë nga 7,000 mijë lekë e planifikuar ose në masën 47%,
- ***Tarifa e pastrimit*** (tarifë pastrami+gjelbërim+ndricim për biznes,institucione dhe familjarë) është realizuar 20,095 mijë lekë nga 7,038mijë lekë e planifikuar ose në masën 35%,
- ***Tarifa e qirasë për pyjet dhe kullotat*** është realizuar 4,593 mijë lekë nga 10,400 mijë lekë e planifikuar ose në masën 42.97%,
-***Tarifa të institucioneve të arsimit, kopshte e çerdhe*** është realizuar 2,994 mijë lekë nga 3,941 mijë lekë e planifikuar ose në masën 75.9%,
- ***Tarifa për shërbimet nga zjrrfiksja (MNZ)*** është realizuar 0 lekë nga 300 mijë lekë e

planifikuar ose në masën 0%,

- *<u>Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor;</u>*
    - *<u>Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022 .</u>*

Në bazë përpunimit të të dhënave të regjistrit të taksave dhe tarifave si dhe të informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë rezultoi se, ka nivel të lartë **debitorësh** në numër dhe në vlerë, duke përfshirë biznesin, individët, familjarët, **(**për taksën e ndërtesës, tabelës, trualli, reklame, zënie hapësire publike, tarifë pastrim-gjelbërim-ndriçim, tarifë veterinarie, tarifa e qirasë për objekte,toka,pyje, dru zjarri etj), i cili nga viti në vit ka ardhur duke u rritur, kështu në fund të **vitit 2021** vlera debitorëve është **17,829,856 lekë** dhe në fund të **vitit 2022** vlera debitorëve është **22,578,967 lekë.** Informacion më i detajuar lidhur me debitorët progresivë paraqitet në Aneks.

| Nr | | **Periudha (12 VJECARE) 31.12.2021 deri me 31.12.2022** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **LLOJI I DEBITOREVE** | **Lloji i Detyrimeve** | | **Shuma e Detyrimeve nga 2021** | Shtesa gjatë vitit 2022, duke hequr pagesat | Shuma | **Shuma e Detyrimeve Progresiv 2022** |
| **1** | Biznes i Vogel | Taksa e Tarifa vendor | Tarife pastrimi, ndricimi, gjelbrimi, Takse ndertese, Takse tabele | 587,587 | 1,457,886 | 2,045,473 | 2,045,473 |
| **2** | Biznes i Madh | Taksa e Tarifa vendor | Tarife pastrimi, ndricimi, gjelbrimi, reklame, Tarife leje e licenca, Takse ndertese, Takse Tabele, | 992,533 | 4,702,449 | 5,694,982 | 5,694,982 |
| **4** | **Detyrime te mbartura nga 2010** | Takses së ndikimit në infrastruturë | Taksës së ndikimit në infrastruturë | 14,838,512 | | 14,838,512 | 14,838,512 |
| **TOTALI** | | | | **16,418,632** | **6,160,335** | **22,578,967** | **22,578,967** |

Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2021 është në vlerën **16,418,632 lekë,** vlera e borxhit e krijuar **gjatë vitit 2022** është **6,160,335 lekë** dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2022** është në vlerën **22,578,967 lekë** e cila përbëhet nga**:**
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesi i vogël në shumën 2,045,473lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesi i madhnë shumën 5,694,982lekë;
- Detyrime nga personat fizikë/juridikë për"Taksën e ndikimit në infrastrukturë" të mbartura që nga viti 2010, që i përkasin 4 subjekteve në vlerën prej 14,838,512 leke detyrime te mbartura nga viti 2010. Për këtë shumë debitore për subjektet përkatëse janë marrë masa shtrënguese deri në vendosjen e kufizimit në përdorimin e pasurive të tyre. Këto subjekte nuk kanë asnjë lloj të drejte për shitje apo dhënie certifikate pronësie pa arkëtuar të gjithë shumën e detyrimit.

Per vitin 2023 është paraqitur subjekti me peshë më të madhe debitore "J. K." shpk për kryerjen e pagesës se kësaj gjendje debitore me shkresen nr.prot. 2363, datë 26.06.2023 për vlerën e detyrimit 9,419,533 lekë. Të dhënat për këta debitorë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Nr | Emërtimi i Subjektit | Detyrimi i trasheguar principal plus kamatvonesë trashëguar që nga viti 2010 | Statusi | Shenime |
|---|---|---|---|---|
| **1** | J... | 9,419,533 | I mbyllur | Proces gjyqësor |
| **2** | A... | 4,000,000 | I mbyllur | |
| **3** | D ... | 679,979 | I mbyllur | |
| **4** | K... | 738,900 | Detyrime nga KLSH | Per punime të pakryera |
| | **Shuma** | **14,838,512** | | |

- **Masat e marra për uljen e borxhit**

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Mirdite është përgjegjëse për të mbledhur detyrimet e papaguara në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi. Në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008, hapat që duhet të ndërmerren me qëllim mbledhjen e detyrimeve të papaguara vijnë duke u përshkallëzuar si:

1. Njoftimi dhe kërkesa për të paguar;
2. Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit;
3. Masa e sigurimit të detyrimit tatimor;
4. Vendosje te kufizimit te pasurive ne ASHK
5. Sekuestrimi i pasurisë.
6. Urdhër ekzekutimi per llogarite bankareReferuar dokumentacionit të vënë në dispozicion lidhur hapat që janë ndjekur për të mbledhur detyrimet rezulton se, janë njoftuar të gjithë bizneset debitorë për kalimin e afatit të pagesave të detyrimit për taksat dhe tarifat vendore.

Pas dërgimit të njoftimeve, për subjektet që kanë vazhduar të rezultojnë debitorë për detyrimet vendore, janë nxjerrë urdhrat përkatës për të ndërmarrë masa të tjera bazuar në përcaktimet e kuadrit ligjor të sipër cituar. Përkatësisht, janë nxjerrë urdhrat që ju janë dërguar bankave të nivelit të dytë për bllokimin e llogarive bankare të 71 tatimpaguesve debitorë të biznesit të vogël, 24 subjekte të biznesit të madh dhe subjekteve për marrje me qira të aseteve.
Si rezultat i këtyre masave të marra nga debitorët që rezultonin brenda 3-mujorit të parë të vitit 2023 kanë likuiduar detyrimet ndaj Bashkisë **43 subjektenë vlerën 10,992,626 lekë, vlerë e cila përbëhet përvec pagesave të vitit ushtrimor dhe nga pagesat për detyrimet të viteve të mëparshme**.
Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 9 pika1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "Për sistemin e taksave vendore", me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", me ndryshime, Kreut XI-"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara" neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181, me VKB nr. 100, datë 24.11.2021 "Për miratimin e paketës fiskale vendore 2022".

**Titulli gjetjes*:*** *Mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, nivelin e borxhit tatimor të krijuar në fund të vitit ushtrimor dhe masat e marra për uljen e tij.*

**Situata:** Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se, për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave. Referuar tabelës së mësipërme, vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2021 është në vlerën **16,418,632 lekë,** vlera e borxhit e krijuar **gjatë vitit 2022** është **6,160,335lekë** dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2022** është në vlerën **22,578,967 lekë** e cila përbëhet nga**:**

- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesit të vogël në shumën 2,045,473lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesit të madhnë shumën 5,694,982lekë;
- Detyrime nga personat fizikë/juridikë për"Taksën e ndikimit në infrastrukturë"në vlerën prej 14,838,512 lekë,që i përkasin 4 subjektevetë mbartura që nga viti 2010.

**<u>Kriteri:</u>** Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar neni 9 pika1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "Për sistemin e taksave vendore", me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", me ndryshime, Kreut XI-"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara" neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.VKB nr. 100, datë 24.11.2021 "Për miratimin e paketës fiskale vendore 2022".
**<u>Impakti:</u>** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Mirditë.
**<u>Shkaku:</u>** Strukturat e Bashkisë Mirditë nuk kanë respektuar përcaktimet e VKB-së për paketën fiskale për arkëtimin e të ardhurave.
**<u>Rëndësia:</u>**E lartë

**<u>Për këtë rekomandojmë:</u>** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive **22,578,967 lekë,** ku përvec masave shtërnguese të masrra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),n*ë funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar:*
-Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar dhe n*ëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet*, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.
- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Mirditë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

- **<u>Taksat dhe tarifat familjare</u>**

Në Bashkinë Mirditë aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për taksën e ndërtesës e truallit dhe tarifat pastrim-gjelbërim-ndricimit. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Mirditë dhe NJA taksohen gjithësej 4848 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Planifikimi i të ardhurave nga taksat familjare paraqitet në Aneks:

-Me qëllim vlerësimin nëse nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Mirditë është bërë planifikimi saktë i taksave dhe tarifave për kategorinë "familjar", u kryqëzua informacioni i administruar nga DAV Bashkia Mirditë me informacionin e administruar nga Zyra e Gjendjes Civile në Bashkinë Mirditë e NJA.

-Nga përllogaritjet e kryera rezultoi se gjithsej nuk janë përfshirë në taksat dhe tarifat vendore 6183 familje, diferencë e cila është analizuar sipas Njësive të Bashkisë Mirditë në tabelën e më poshtme:

| Nr | Njësi Administrative | 2022 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **Familje gjithsej të taksuara dhe tarifuara për vitin 2022** | Familje sipas Gj.Civile | Diferenca |
| | | NR | Nr | Nr |
| 1 | Fan | 700 | 1268 | 568 |
| 2 | Kacinar | 177 | 283 | 106 |
| 3 | Kthell | 428 | 1222 | 794 |
| 4 | Orosh | 397 | 976 | 579 |
| 5 | Selite | 141 | 175 | 34 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 6 | Rresheni +fshatrat | 1995 | 4542 | 3333 |
| 7 | Rubiku+fshatrat | 1010 | 2565 | 2049 |
| | Shuma | 4848 | 11031 | 7463 |

Burimi: DAV Bashkia Mirditë dhe Zyra e Gjëndjes Civile Mirditë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Kjo situatë ndikon negativisht në të ardhurat që mund të arkëtojë Bashkia Mirditë nga kategoria "Familjar", situatë e cila është krijuar nga braktisja e familjeve të vendit të tyre dhe DAV takson vetëm ato familje që realisht banojnë në qytet apo ne fshat, kategori të cilën e ka të mundur indetifikimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore.
Drejtoria e Taksave Tarifave Vendore është në proces të konsolidimit të rregjistrit të përditësuar të taksapaguesve familjarë, që identifikon të gjitha familjet, që jetojnë apo janë me leje banimi në territorin e saj, duke krijuar një database për tatimpaguesit me të dhënat e duhura për ngarkesën dhe faturimin me taksa dhe tarifave, duke patur në konsideratë edhe gjeneralitetet (Adresën, sipërfaqen, qëllimin e përdorimit, të dhënat për taksapaguesin) që përcaktohen në VKM Nr. 132, datë 7.3.2018, e ndryshuar, detyrim për t'u pasqyruar në regjistrin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "Familjar".

- *Debitorët "Familjar" të cilët nuk kanë likujduar detyrimet për taksat dhe tarifat vendore në Bashkinë Mirditë.*

Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e shërbimit (gjelbërim, pastrim), ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, tokës bujqësore:

Numri i familjeve sipas NJA-ve, të cilat rezultojnë debitorë në një ose disa taksa/tarifa

| | | | 2022 | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Nr** | **Njësi Administrative** | **Familje Debitore në fillim të vitit 2022** | **Likujduar gjate vitit 2022** | **Familje gjithsej të taksuara dhe tarifuara për vitin 2022** | **Familje Debitore krijuar brenda vitit 2022** | **Progresive me 30.12.2022** |
| | | Nr | Nr | Nr | Nr | |
| 1 | Fan | 358 | 203 | 700 | 370 | 525 |
| 2 | Kacinar | 125 | 87 | 177 | 130 | 168 |
| 3 | Kthell | 296 | 193 | 428 | 322 | 425 |
| 4 | Orosh | 43 | 40 | 397 | 70 | 73 |
| 5 | Selite | 137 | 92 | 141 | 125 | 170 |
| | Rresheni +fshatrat | **278** | 130 | 1995 | **531** | **679** |
| | Rubiku+fshatrat | **226** | 160 | 1010 | **430** | **496** |
| | Shuma | **1463** | **905** | **4848** | **1978** | **2536** |

Burimi: DAV Bashkia Mirditë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Sa më sipër rezulton se në fund të vitit 2022 janë 2536 familje debitore, nga të cilat brenda vitit 2022 janë krijuar gjithësej 1978 familje debitore për një ose disa taksa dhe tarifa vendore, ç'ka do të thotë se 51,9 % e familjeve që taksohen janë debitor.

Të dhënat për familjet debitore sipas llojit të taksës/tarifës në vlerë paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| **Nr.** | **Loji i Taksës dhe Tarifës** | **Debitor deri në fillim të vitit** | **Debitorët krijuar brenda vitit** | **Arkëtuar debitorë për periudhën 2011-2021** | **Totali Debi** |
|---|---|---|---|---|---|
| | | **2022** | **2022** | **2011-2022** | **Progresive** |
| 1 | Ndërtesë | 3,036,233 | 3,469,520 | 3,339,007 | 3,166,746 |
| 2 | Tarife Pastrimi | 1,190,600 | 1,390,380 | 1,540,254 | 1,040,726 |
| 3 | Tarife Ndricim | 183,400 | 201,770 | 215,232 | 131,198 |
| 4 | Tarife Gjelbërimi | 183,400 | 201,770 | 215,232 | 169,938 |
| 5 | Tarife Arsimi | | | | |
| 6 | Takse Trualli | 52,668 | 40,946 | 44,741 | 169,938 |
| **Totali** | | **4,646,301** | **5,304,404** | **5,354,466** | **4,596,239** |

Burimi: DAV Bashkia Mirditë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar tabelës së mësipërme rezulton se vlera debitore e kategorisë "Familjar" për taksat dhe tarifat vendore, në krahasim me fillimin e vitit 2022 është ulur në 4,596,239 lekë.
Në mënyrë të përmbledhur, konstatohet senë fund të vitit 2021 janë trashëguar 1461 familje me vlerë debitorë prej **4,646,301 lekë dhe në fund të vitit 2022** në Bashkinë Mirditë dhe

NJA, janë gjithsej **2536 familje** debitore për vlerën **4,596,239 lekë**, nga të cilat 558 familje janë të trashëguara nga viti 2021, te cilat nuk janë paguar as në vitin 2022dhe 1978 janë debitor të **krijuar brenda vitit 2022**.

Nga zyrat e taksave në çdo njësi, taksa familjare është maturuar bashkë me taksën e biznesit, si dhe është maturuar për fshatrat bashkë me taksën e tokës bujqësore.

Nga regjistri i taksës familjare janë faturuar të gjitha detyrimet për çdo familje në territorin e Bashkisë Mirditë.

Për familjet debitore nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore janë dërguar njoftime për detyrimin dhe marrjen e masave shtrënguese ose masat jane kufizuar. pasi nuk ka agjent tatimor per vjeljen ketyre detyrimeve, kjo bëhet nga inspektoret e taksave.

Drejtoria e Taksave Tarifave Vendore është në proces të konsolidimit të rregjistrit të përditësuar të taksapaguesve familjarë, që identifikon të gjitha familjet, që jetojnë apo janë me leje banimi në territorin e saj, duke krijuar një database për tatimpaguesit me të dhënat e duhura për ngarkesën dhe faturimin me taksa dhe tarifave, detyrim ligjor për tu paguar nga taksapaguesit për njësinë vendore në këmbim të shërbimeve që marrin nga shërbimet e Bashkisë.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr.100, datë 24.11.2021, "Për miratimin e paketës fiskale 2022",pika C.1, me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar neni 9 pika1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, neni 4 pika 7,me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenin 70 dhe 117[5].

**Titulli gjetjes***:* *Mos arkëtim i taksave nga taksapaguesit familjarë për detyrimet vendore.*

**Situata:** Në Bashkinë Mirdite aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për taksën e ndërtesës e truallit dhe tarifat pastrim-gjelbërim-ndricimit. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Mirditë dhe NJA taksohen gjithësej 4848 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". DAV takson vetëm ato familje që realisht banojnë në qytet apo ne fshat, kategori të cilën e ka të mundur indetifikimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, ku vetëm për qytetin Rreshen e fshatarat përreth dhe qytetin e Rubikut dhe fshatrat përreth , duke përjashtuar 5 NJA diferenca e numrit të planifikuar të familjeve me numrin sipas Gjendjes Civile është 5,382 familje. Nga familjarët e taksuar konstatohet se **në fund të vitit 2021** janë trashëguar 1461 familje me vlerë debitorë prej **4,646,301 lekë dhe në fund të vitit 2022** në Bashkinë Mirditë dhe NJA, janë gjithsej **2536 familje** debitore për vlerën **4,596,239 lekë**, nga të cilat 558 familje janë të trashëguara nga viti 2021, te cilat nuk janë paguar as në vitin 2022 dhe 1978 janë debitor të **krijuar brenda vitit 2022**.

**Kriteri:** VKB nr.100, datë 24.11.2021, "Për miratimin e paketës fiskale 2022",pika C.1, me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"i ndryshuar neni 9 pika1.3, neni 35, me ligjin

---

[5] *Neni 117 "Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave"*
*Agjenti i mbajtjes së tatimit, agjenti i taksave apo ai i tarifave detyrohen të paguajnë gjobë, në masën e mëposhtme: a) Gjobë në masën 0,06 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës, në rast se e ka mbajtur, llogaritur dhe deklaruar tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën, por nuk e ka transferuar atë në Buxhetin e Shtetit. Ky dënim aplikohet për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer, por jo për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike.*
*b) Gjobë në masën 50 për qindtë shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës në rast se nuk mban tatimin në burim apo tatimin apo nuk mbledh taksën ose tarifën;*
*c) Gjobë në masën 100 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës nëse mban dhe nuk deklaron e paguan tatimin në burim apo tatimin, taksën ose tarifën e mbledhur.*

nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, neni 4 pika 7,me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 70 dhe 117.
**Impakti:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Mirditë.
**Shkaku:** Strukturat e Bashkisë Mirditë nuk kanë respektuar përcaktimet e VKB-së për paketën fiskale duke mos arkëtuar tëradhurat nga takasat dhe tarifat për kategorinë familjar.
**Rëndësia:** E lartë
**Për këtë rekomandojmë:** Bashkia Mirditë nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksa dhe tarifat vendore të debitorëve familjarë në vlerën vlerën **4,596,239 lekë**, si dhe të plotësojë e përditësojë regjistrin për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Mirditë.

- **Taksa mbi tokën bujqësore**

Bashkia Mirditë, sipas Aneksit 1 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23[6]klasifikohet në kategorinë e katërt.Referuar VKB-së nr. 100 datë 24.11.2021 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Mirdite për vitin 2022”, toka bujqësore në Bashkinë Mirditë, klasifikimi i kategorisë dhe çmimi lekë/ha në vit për tokën bujqësore është si në Aneks:

| Kategoria e tokës bujqësore | Niveli i taksës së tokës bujqësore sipas ligjit | Niveli i takses sipas VKB |
|---|---|---|
| I | 1,400 | 980 |
| II | 1,200 | 840 |
| III | 1,100 | 770 |
| IV | 1,000 | 700 |
| V | 900 | 630 |
| VI | 800 | 560 |
| **VII-X** | **700** | **490** |

Nga auditimi konstatohet se,realizimi i taksës bujqësore është në vlerën 51,278 mijë lekë nga 188,700 mijë lekë ose në masën 27%. Në bashkinë Mirditë planifikimi i taksës së tokës bujqësore nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pasqyrohet në tabelën si më poshtë vijon:

| Kategoria e tokës | Sip/HA-Fanë | Sip/HA-Kaçinar | Sip/HA-Kthellë | Sip/HA-Orosh | Sip/HA-Selitë | Sip/HA-Rrëshen | Sip/HA-Rubik | Vlera/Ha | Zbritja 30% | Plani/ Lekë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Kategoria VII | 106 | 23 | 336 | 41 | 22 | 324 | 80 | 652,400 | 456,680 | 456,680 |

Me qëllim vlerësimin nëse nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Mirditë është bërë planifikimi saktë i taksës së tokës bujqësore, u kryqëzua informacioni i administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Mirditë me informacionin e administruar nga agronomët e NJA mbi sipërfaqen e tokës bujqësore, familjet që kanë në pronësi/përdorim tokë bujqësore, sipas NJA. Nga verifikimi i përllogaritjeve dhe informacioni i paraqitur për këtë qëllim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, në planifikim është marrë në konsideratë vetëm sipërfaqja e fermerëve që kanë tapitë e tokave (ATM) për sipërfaqe të ndarë prej 932 ha, duke përjashtuar

[6]Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23, pika 1, ankesi 1.

pjesën tjetër prej 2915 ha të ndarë sipas ligjit 7501, gjë e cila ka ardhur nga fakti se mungon informacioni, identifikimi dhe evidentimi i kësaj sipërfaqeje nga NJA, e si rrjedhojë nuk është krijuar një rregjistër dhe nuk ngarkohen me këtë taksë fermerët që e kanë në përdorim këtë sipërfaqe e që në fakt duhet të jenë objekt i taksës bujqësore.

Drejtoria e Taksave dhe tarifave Vendore ka pasqyruar përmbledhëse të fondit te tokës bujqësore sipas kadastres vendore.

| Nr | Bashkia Mirdite | Nr fshatrave | Siperfaqe totale e tokes bujqesore | Siperfaqja e ndare | Siperfaqe e indentifikuar me pronare |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | NjA.Rreshen | 14 | 1856 | 892 | 324 |
| 2 | Rubik | 11 | 566 | 340 | 80 |
| 3 | Kthelle | 9 | 1485 | 777 | 336 |
| 4 | Selite | 8 | 505 | 321 | 22 |
| 5 | Orosh | 14 | 648 | 446 | 41 |
| 6 | Fan | 17 | 731 | 512 | 106 |
| 7 | Kacinar | 7 | 526 | 256 | 23 |
| | **Total** | **80** | **6318** | **3847** | **932** |

Nga DAV ne bashkëpunim me ASHK, Njësitë Administrative dhe Kryetaret e Fshatrave ka filluar identifikimi në terren i të gjithë pronarëve sipas gjendjes civile dhe formularit nr. 6, që ndodhet në Kadastrën Vendore.

Në Bashkinë Mirditë nuk ngarkohen familjet fermerë për pagesën e taksës së tokës bujqësore dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore nuk ka të dhëna të sakta për numrin familjeve, që kanë detyrimin të paguajnë këtë taksë dhe sipërfaqes së tokës bujqësore që familjet fermere kanë në përdorim apo zotërojnë me AMTP mbi të cilën llogaritet dhe planifikohen të ardhurat nga taksa e tokës bujqësore. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet, kur fermerët paraqiten në Bashki apo NJA në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifat vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokësnë kategorinë VII-X me vlerë 490 lekë/ha/vit, kur Bashkia ka të dhëna.

Debitorët për taksën e tokës bujqësore në fund të vitit 2021 janë në vlerën 188,474 lekë, gjatë vitit 2022 janë krijuar debitorë në vlerën 278,627 lekë dhe në fund të vitit 2022 debitorët në vlerë progresive janë 197,777 lekë. Të dhënat për debitorët e taksës së tokës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| nr | Lloji i taksës dhe tarifës | Debitorë në fillim të vitit 2022 | Maturimi | Arkëtimet | Debitorë të krijuar brenda vitit 2022 | Arkëtuar debitorë për periudhen 2021-2022 | Debitorë progresiv në fund të vitit 2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Taksë e tokës bujqësore | 188,474 | 454,482 | 177,854 | 278,627 | 269,324 | 197,777 |

Regjistri i taksës për tokën bujqësore ka mangësi në numrin e subjekteve objekt taksimi, pasi në këtë regjistër nuk janë kryer përditësimet për çdo vit ushtrimor. Arkëtimi i kësaj takse paraqitet me problem në NjAKacinar, Fan, Rubik etj, për arsye se familjet të cilat taksohen për tokën bujqësore njoftohen, por nuk pranojnë të bashkëpunojnë për identifikimin e personave, sipas adresave pasi janë larguar dhe nuk disponojnë adresë dytesore.

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 pika1, Aneksi 1 dhe me VKB nr.nr. 100 datë 24.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”,pika A.2 nëpika (b)

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: zj. D.N.me detyrë Drejtore e Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore dhe zj.M. N. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Taksave dhe Tarifave.

**Titulli gjetjes:** *Mos arkëtim i taksës së tokës bujqësore nga familjet fermere në Bashkinë*

*Mirditë.*

**Situata:** Nga auditimi konstatohet se,realizimi i taksës bujqësore është në vlerën 51,278 mijë lekë nga 188,700 mijë lekë ose në masën 27%. Nga kryqëzimi i informacionit të administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me informacionin e administruar nga Agjencia e Shërbimeve Bujqësore,Veterinare dhe Pyjore/Sektori i Kadastrës.mbi sipërfaqen e tokës bujqësore, që familjet kanë në pronësi apo në përdorim rezultoi se, në planifikim është marrë në konsideratë vetëm sipërfaqja e fermerëve që kanë tapitë e tokave (ATM) për sipërfaqe të ndarë prej 932 ha, duke përjashtuar pjesën tjetër prej 2915 ha të ndarë sipas ligjit 7501, gjë e cila ka ardhur nga fakti se mungon informacioni, identifikimi dhe evidentimi i kësaj sipërfaqeje e si rrjedhojë nuk është krijuar një rregjistër dhe nuk ngarkohen me këtë taksë fermerët që e kanë në përdorim këtë sipërfaqe e që në fakt duhet të jenë objekt i taksës bujqësore. Të vetmet pagesa që bëhen për taksën e tokës bujqësore janë rastet, kur fermerët paraqiten në Bashki apo NJA në mënyrë vullnetare për të paguar taksat dhe tarifat vendore apo për të marrë shërbime dhe nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave ju mbahet edhe taksa e tokësnë kategorinë VII-X me vlerë 490 lekë/ha/vit, kur Bashkia ka të dhëna. Debitorët për taksën e tokës bujqësore në fund të vitit 2021 janë në vlerën 188,474 lekë, gjatë vitit 2022 janë krijuar debitorë në vlerën 278,627 lekë dhe në fund të vitit 2022 debitorët në vlerë progresive janë 197,777 lekë.

**Kriteri:** Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 23 pika1, Aneksi 1 dhe me VKB nr.nr. 100 datë 24.11.2021 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022", pika A.2 nëpika (b).

**Impakti:** Bashkia Mirditë nuk ka të dhëna se sa është numri i familjeve që zotërojnë tokë bujqësore dhe sa është sipërfaqja që duhet të tatohet referuar paketës fiskale duke sjellë mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë.

**Shkaku:** Mos angazhim i strukturave të bashkisë për të krijuar regjistrin e familjeve që kanë në pronësi"apo në përdorim tokë bujqësore.

**Rëndësia:** E lartë

**Për këtë rekomandojmë:** Bashkia Mirditë, nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksën e taksës bujqësore nga debitorët fermerë në vlerën 197,777 lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Agjencia e Shërbimeve Bujqësore,Veterinare dhe Pyjore/Sektori i Kadastrës të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve, që kanë në pronësi apo në përdorim tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë, planifikimin e plotë dhe përllogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Mirditë.

**Taksa e ndikimit në infrastrukturë**

Në Bashkinë Mirditë struktura që administron dokumentacionin dhe përllogarit vlerën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për subjektet që pajisen me certifikatën e pronësisë është Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit.

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në Infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga ASHK Rajonale Lezhë, u audituа i gjithë dokumentacioni për vitin 2022, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit.

Nga korespondenca zyrtare e Bashkisë Mirditë me ASHK Rajonale Lezhë rezulton se, në fillim të vitit 2022 vlera debitore për taksën e infrastrukturës është 1,282,663 lekë, që i përket 40 individëve, gjatë vitit 2022 është krijuar gjendje debitore prej 635,484 lekë e 27

përfituesve dhe në fund të vitit 2022 vlera progresive debitore është 1,972,156 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mirditë.

Këto veprime janë në kundërshtim me:

- ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,“Për sistemin e taksavevendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27,
- me ligjin nr. 95/2018 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,“Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 3/c në të cilën përcaktohet: *“për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit. Leja e legalizimit lëshohet vetëm pasi të jetë vërtetuar pagesa e taksës nga taksapaguesi”.*
- me ligjin nr. 98/2020 “për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,“Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 1, “në nenin 27, pika 3, shkronja “c”, me
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “ Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimittë të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vleravetë zbatueshme për legalizim” pika 5 në të cilën përcaktohet se:“*Taksa vendore e ndikimit në infrastrukturë, për ndërtimet e legalizuara, pavarësisht nga funksioni i tyre, të llogaritet, arkëtohet dhe administrohet nga njësitë e qeverisjes vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Për zbatimin e kësaj pike, drejtoritë e ALUIZNI-t, të vënë në dispozicion të njësive të qeverisjes vendore, në momentin e dërgimit për regjistrim në ZVRPP, të dhënat e ndërtimeve që pajisen me leje legalizimi*”.
- VKB nr. 100, datë 24.11.2021 “Për miratimin e paketës fiskale vendore 2022”, pika A.4, nënpika (f). Në mënyrë të detajuar debitorët në mënyrë progresive deri në fund të vitit 2022 paraqiten në Aneks:

| **Nr.** | **Emer** | **Mbiemri** | **Viti** | **Mbetet Debitor** | **Nr.** | **Emer** | **Mbiemri** | **Shuma** | **Mbetet debitor** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **1** | | | 2019 | 54,009 | **35** | | | 2021 | 55,163 |
| **2** | | | 2019 | 16,874 | **36** | | | 2020 | 6,532 |
| **3** | | | 2019 | 29,411 | **37** | | | 2020 | 113,160 |
| **4** | | | 2019 | 6,753 | **38** | | | 2020 | 45,744 |
| **5** | | | 2019 | 13,226 | **39** | | | 2020 | 121,984 |
| **6** | | | 2019 | 47,697 | **40** | | | 2020 | 54,032 |
| **7** | | | 2019 | 17,328 | | **Totali I vitit 2021** | Sipas KLSH | **1,071,878** | **1,282,663** |
| **8** | | | 2019 | 9,431 | **41** | | | 2022 | 17,033 |
| **9** | | | 2019 | 53,693 | **42** | | | 2022 | 20,423 |
| **10** | | | 2019 | 75,838 | **43** | | | 2022 | 57,983 |
| **11** | | | 2019 | 29,939 | **44** | | | 2022 | 66,261 |
| **12** | | | 2019 | 68,069 | **45** | | | 2022 | 14,213 |
| **13** | | | 2019 | 9,974 | **46** | | | 2022 | 9,357 |
| **14** | | | 2019 | 11,071 | **47** | | | 2022 | 24,267 |
| **15** | | | 2019 | 12,363 | **48** | | | 2022 | 9,797 |
| **16** | | | 2019 | 10,460 | **49** | | | 2022 | 21,148 |
| **17** | | | 2019 | 9,974 | **50** | | | 2022 | 66,167 |
| **18** | | | 2019 | 22,947 | **51** | | | 2022 | 5,039 |
| **19** | | | 2019 | 85,270 | **52** | | | 2022 | 16,329 |
| **20** | | | 2019 | 12,363 | **53** | | | 2022 | 24,347 |
| **21** | | | 2019 | 13,854 | **54** | | | 2022 | 33,066 |
| **22** | | | 2019 | 21,742 | **55** | | | 2022 | 23,269 |
| **23** | | | 2019 | 10,790 | **56** | | | 2022 | 58,895 |
| **24** | | | 2019 | 11,071 | **57** | | | 2022 | 22,428 |
| **25** | | | 2019 | 21,742 | **58** | | | 2022 | 17,799 |
| **26** | | | 2019 | 32,453 | **59** | | | 2022 | 22,206 |
| **27** | | | 2019 | 42,158 | **60** | | | 2022 | 9,089 |
| **28** | | | 2019 | 16,802 | **61** | | | 2022 | 42,228 |
| **29** | | | 2019 | 26,403 | **62** | | | 2022 | 21,393 |
| **30** | | | 2019 | 94,074 | **63** | | | 2022 | 3,659 |
| **31** | | | 2019 | 6,887 | **64** | | | 2022 | 8,850 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **32** | | | 2019 | 9,431 | **65** | | | 2022 | 12,297 |
| **33** | | | 2019 | 31,960 | **66** | | | 2022 | 1,568 |
| **34** | | | 2019 | 4,000 | **67** | | | 2022 | 6,375 |
| | | | | | | | | | **635,483.86** |
| | | | | | | **TOTALI 31.12.2022** | | | **1,972,155.86** |

Përsa më sipër ngarkohet zj.A.D me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit.

**Titulli gjetjes***: Mos arkëtim i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale.*

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale rezulton se, në Bashkinë Mirditë ka detyrime të papaguara në vlerën **1,282,663 lekë** për 40 objekte, që janë legalizuar që nga viti 2019 deri në 31.12.2021. Nga korespondenca zyrtare e Bashkisë Mirditë me ASHK Rajonale Lezhë për periudhen objekt auditimi rezulton se, gjatë vitit 2022 është krijuar gjendje debitore prej 635,484 lekë e 27 përfituesve dhe në fund të vitit 2022 vlera progresive debitore është 1,972,156 lekë të 67 përfituesve të legalizimit, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mirditë.
**Kriteri:** Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksavevendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, me ligjin nr. 95/2018 "për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesanë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c", me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 " Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimittë të ardhurave përndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" pika 5 dhe me VKB nr. 100, datë 24.11.2021 "Për miratimin e paketës fiskale vendore 2022", pika A.4, nënpika (f).
**Impakti:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Mirditë nga mos arkëtimi i vlerës prej 1,972,156 lekë për ndërtimet informale, që legalizohen.
**Shkaku:** Mos marrje e masave efektive nga Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit dhe Sektori i Tatimeve të bërë të mundur pagesën e taksës së legalizimeve.
**Rëndësia:**E lartë
**Për këtë rekomandojmë:**
Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit në Bashkinë Mirditë të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 67 debitorë në vlerën 1,972,156 lekë,** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Mirditë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) Rajonale, Lezhë për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen, si dhe të bëhen marrëveshje për bllokimin e veprimeve në dhënien e certifikatës së pronësisë deri në kryerjen e pagesave të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

➢ *Të ardhura të munguara nga mos pagesa e qirave të kontratave të aseteve.*

Pronat e kaluara nga pushteti qendror parnë Bashkisë Mirditë paraqiten sipa VKM-ve përkatëse:
**1. Njësisë Administrative Rreshen** i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim 2132 prona në total në bazë tëVKM nr. 243 date 6.3.2009 "Për Miratimin e listës përfundimtare të pronave

të palujtëshme publike shtetrore, që transferohen në pronësi ose në përdorim te Bashkisë Mirditë".
**2.Njësisë Administrative Rubik** i kanë kaluar në përdo në pronësi ose në përdorim 173 prona në total në bazë të VKM nr. 21 date 9.01.2013 "Për Miratimin e listës përfundimtare të pronave të palujtëshme publike shtetrore, që transferohen në pronësi ose në përdorim te Bashkisë Mirditë".
**3.Njësia Administrative Orosh** i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim 839 prona në total në bazë tëVKM nr.163, date 13.02.2008 "Për Miratimin e listës përfundimtare të pronave të palujtëshme publike shtetrore, që transferohen në pronësi ose në përdorim te Bashkisë Mirditë".
**4. Njësia Administrative Fanë** i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim 9874 prona në total në bazë tëVKM nr.126, date 3.2.2008 "Për Miratimin e listës përfundimtare të pronave të palujtëshme publike shtetrore, që transferohen në pronësi ose në përdorim te Bashkisë Mirditë" .
**5. Njësia Administrative Kaçinar** i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim 440 prona në total në bazë tëVKM nr.185, date 19.2.2009 "Për Miratimin e listës paraprake të pronave të palujtëshme publike shtetrore, që transferohen në pronësi ose në përdorim te Bashkisë Mirditë"
**6.Njësia Administrative Kthellë** i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim 515 prona në total në bazë të VKM nr.326 date 18.04.2013 "Për Miratimin e listës paraprake të pronave të palujtëshme publike shtetrore, që transferohen në pronësi ose në përdorim te Bashkisë Mirditë".
**7. Njësia Administrative Selitë** i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim 697 prona në total në bazë tëVKM nr.1085 date 23.07.2008 "Për Miratimin e listës paraprake të pronave të palujtëshme publike shtetrore, që transferohen në pronësi ose në përdorim te Bashkisë Mirditë".
Me *VKM* nr.*684*, datë *02.09.2020* "Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike"dhe me VKM nr 60 "Parku Kombetar Munelle". Nga pronat e kaluara në përdorim nga fondi pyjor kullosor me sipërfaqe 61,771.58 ha janë hipotekuar nga Bashkia Mirditë vetëm parcela pyjore me sipërfaqe 168 ha, të cilat janë dhënë subjekteve private nëpërmjet kontratave të qiradhënies. Gjithashtu nuk ka filluar procesi i rregjistrimit në ASHK të 14,671 pasurive/aseteve të kaluara në pronësi/përdorim Bashkisë Mirditë dhe NJA-ve të saj me VKM nga Pushteti Qendror, veprime këto në kundërshtim me VKM nr.500 datë 14.08.2001 "Për inventarizimin e pronave të paluajtshme Shtetërore dhe ransferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendor" pikën 18,22, me ligjin nr.20/2020 datë 05.03.2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", Kreu IV "Përditësimi, invenatrizimi, transferimi dhe rregjistrimi i pronave të paluajtshme publike"nenet 35-44, me Udhëzimin nr.15 datë 30.06.2003 "Për mënyrën e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike".
Bashkia Mirditë për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre në vite ka lidhur 43 kontrata për dhënien me qira të aseteve që i kanë kaluar me VKM nga pushteti qendror. Këto kontrata janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës në vijimësi me subjekte të ndryshëm fizik/ juridik që kanë shprehur interes, për afate kohore nga 1-10 vjet. Kontratat janë lidhur për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore dhe kullosore, për aktivitet bujqësor, për pemtari, objekte banimi, Antena, vend-depozitim minerali dhe ngritje fabrike përpunimi, studim-kërkim-zbulim, agroturizëm

etj.Kontratat e lidhura me të dhënat e detajuar për to, detyrimet, pagesat dhe debitë e qiramrrësve paraqiten në Aneks.

**Debitorët e Kontratave për asetet e dhëna me qira**

| Nr. | Subjekti | Aktiviteti | Afati I Kontratës | | Vlera Vjetore e Qirasë | Debitor 31.12. 2021 | Detyrimi në 2022 | Shuma e detyrimit | Paguar gjate vitit 2022 | Debitore 31.12.2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Fillimi | Mbarimi | | | | | | |
| 1 | | Antenë | 29/10/2018 | 28/10/2027 | 140120 | | 140120 | 140120 | 0 | 140120 |
| 2 | | Antenë | 22/09/2016 | 21/09/2021 | 200000 | | 200000 | 200000 | 0 | 200000 |
| 3 | | Antenë | 01/01/2021 | 31/12/2025 | 170000 | | 170000 | 170000 | 0 | 170000 |
| 8 | | Antenë | 10/12/2018 | 09/12/2023 | 60300 | | 60300 | 60300 | | 60300 |
| 13 | | Antenë | 02/06/2017 | 01/06/2022 | 280000 | | 280000 | 280000 | | 280000 |
| 14 | | Antenë | 21/12/2020 | 20/12/2029 | 247500 | | 247500 | 247500 | | 247500 |
| 19 | | Matje Erës | 18/11/2022 | 17/11/2025 | 65560 | | 65560 | 65560 | 0 | 65560 |
| 23 | | Turizëm | 03/04/2019 | 03/04/2029 | 353738 | | 353738 | 353738 | 193906 | 159832 |
| 29 | | HEC | 04/04/2018 | 03/04/2028 | 405995 | 596407 | 405995 | 1002402 | 1002402 | 0 |
| 30 | | HEC | 20/06/2018 | 19/06/2028 | 610471 | 1220942 | 610471 | 1831413 | 1567954 | 263459 |
| 32 | | HEC | 05/12/2018 | 04/12/2023 | 1005229 | 1005229 | 1005229 | 2010458 | 1005229 | 1005229 |
| | **SHUMA :** | | | | | **2822578** | **3538913** | **6361491** | **3769491** | **2592000** |
| | | HEC | 25.10.2017 | 24.10.2020 | 10569197 | 10569197 | 0 | 10569197 | | 10569197 |
| | | HEC | 19.11.2018 | 18.11.2028 | | 1784791 | | 1784791 | | 1784791 |
| | **TOTALI** | | | | | **15176566** | **3538913** | **18715479** | **3769491** | **14945988** |

[4] Referuar tabelës së kontratave të qirave me të dhënat të nxjerrë dokumentacioni i dosjeve nga rezulton se, në **fund të vitit 2021** paraqiten 5 subjekte **me vlera debitore prej 15,176,566 lekë,** ndërsa në **fund të vitit 2022** paraqiten 12 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të pa paguara në ***vlerën progresive prej 14,945,988 lekë, vlerë*** e cila nuk rakordon me kontabilitetin. Në këtë gjendje debitorësh vlerat më të mëdha i kanë:

- Subjekti qiramarrës "S..." shpk me aktivitet "HEC" me detyrime të papaguara në vlerën 10,569,197 lekë, të cilit i ka mbaruar kontrata që në vitin 2020. Nga Bashkia janë marrë të gjitha masat shtërnguese në lidhje me arkëtimin e këtij detyrimi, ku për shkak të kësaj procedure të ndjekur në zbatim të ligjit subjekti ka kërkuar lidhje marrëveshje pajtimi për dhënien e mundësisë për likujdimin e detyrimit të tarifës së qirasë në vlerë të plotë deri në fund të vitit 2023, pasi deri më sot aktiviteti i tij është i pezulluar për këtë arsye.
- Subjekti ... ka lidhur kontratë me Bashkinë Mirditë me datë 19.11.2018, me afat 10 vjecar (perfundimi me datë 18.11.2028). Vlera vjetore fillestare e qirasë në vitin e parë eshte 683,315 lekë, viti dyte pas heqjes se faunes dhe flores vlera e tarifës së qirasë ka zbritur në 597,815 lekë. Nga data e lidhjes së kontratës është paguar vlera pjesore e tarifës së vitit 2018-2019 prej 200,000 lekë, duke mbetur debitor për këtë vit në vlerën 483,315 lekë. Ndërsa në vitin 2021 ky subjekt ka mbyllur aktivitetin, pasi edhe në QKB figuron me aktivitet të pezulluar. Ky subjekt është në proces gjyqësor me Agjencinë e Zhvillimit të Territorit për mospaisje me lejet e duhura për ndertimin dhe ushtrimin e aktivitetit. Vlera debitore për periudhen 2018-2021 është përllogaritur në shumën 1,784,791 lekë (tarifa e qirasë 1,678,945 + 105846 lekë kamtvonesë).

Referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezulton se në territorin e Bashkisë Mirdite ushtrojnë aktivitetin 9 subjekte private me aktivitet për nxjerrje, prodhim dhe shfrytëzim minerali dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullosor, asete të Bashkisë Mirditë. Nga

Bashkia është lidhur kontratë për qiradhënie të hapësirës për vend depozitimin e mineralit me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali "Bakër" vetëm me subjektin "..." shpk për sip.4.9 ha me tarifë qiraje në vlerën 3,082,000 lekë/vit (trajtuar në tabelën e kontratave). Ndërsa në 8 rastet e tjera të subjekteve nuk është marrë asnjë masë kundrejt këtyre subjekteve që shfrytëzojnë asetete e bashkisë pa qira. Nuk është kryer asnjë procedurë për të rënë në marrëveshje me këto subjekte për përgatitjen e terrenit për të lidhur kontrata qiraje për sipërfaqen, që shfrytëzojnë në parcelat pyjore, pasi janë akoma në proces të shqyrtimit të raportit tekniko-ekonomik nga Agjencia e Shërbimit Bujqësor, Veterinar dhe Pyjor pranë Bashkisë Mirditë dhe më pas vazhdimi i procedurës me shpalljen dhe kalimin për miratim në Këshillin Bashkiak. Vonesa dhe zgjatja e procedurave për lidhjen e kontratave ka sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë. Rastet e subjekteve që ushtrojnë aktivitet nxjerrje prodhim minerale dhe inertesh në mënyrë të detajuar paraqiten në tabelën e mëposhtme:

| Nr | Nr. Leje | Datë akt-miratimi | Emri i subjektit | Nipt | Emërtimi i vendburimit | Lloji i mineralit | Ha | Lloji i lejes |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 990/1 | 18.06.2013 | | | Perlat ,Mirdite | Baker | | Shfyrtezim |
| 2 | 1068 | 20.08.2007 | | | Spac,Mirdite | Baker | 4.9 | Shfyrtezim |
| 3 | 1402/1 | 24.08.2009 | | | Nderfushaz , qafe Mollaj | Bazalte | | Shfyrtezim |
| 4 | 1510 | 29.10.2010 | | | Suke e kuqe Orosh | Bazalte | | Shfyrtezim |
| 5 | 1513 | 09.11.2010 | | | Nderfushaz Mirditë | Bazalte | | Shfyrtezim |
| 6 | 1515 | 12.11.2010 | | | Lajthize | Krom | | Shfyrtezim |
| 7 | 1749 | 21.04.2015 | | | Blinisht | Bazalte | | Shfyrtezim |
| 8 | 1751 | 23.04.2015 | | | Laku I rrepes | Krom | | Shfyrtezim |
| 9 | 1823 | 07.11.2016 | | | Lufaj | Krom | | Shfyrtezim |

Moslidhja e kontratave për shfrytëzim të parcelave pyjore dhe mosshlyerja e detyrimeve kontraktore nga qiramarrësit është në kundërshtim me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, nenet 826-840, me ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" dhe me kontratat përkëtëse neni 5 "Pagesa e tarifës së qirasë".

Përsa më sipër ngarkohen më përgjegjësi: z.T.M me detyrë ish-Drejtor i Agjencisë së Shërbimit Bujqësor dhe Pyjor, zj.E.V me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Pronave të Palujtshme, Aseteve, Riskut dhe z. E.D me detyrë specialiste e menaxhimit të aseteve në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore që monitoron dhe evidenton arkëtimin e tarifave të qirave të kontratave të qiradhënies.

**Titulli gjetjes:***Të ardhura të munguara nga mos pagesa e qirave nga qiramërrësit e aseteve sipas kontratave të lidhura me Bashkinë Mirditë.*

**Situata:**

Bashkia Mirditë për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 43 kontrata për dhënien me qira të tyre. Nga të dhënat e nxjerra nga dokumentacioni i dosjeve dhe ai financiar rezulton se, paraqiten 5 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të pa paguara **me vlerë progresive debitore prej 15,176,566 lekë,** ndërsa në **fund të vitit 2022** paraqiten 12 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të pa paguara në ***vlerën debitorë progresive prej 14,945,988 lekë,*** vlerë e cila nuk rakordon me kontabilitetin. Në këtë gjendje debitorësh detyrime të pa paguara më të mëdha i kanë subjektet e dy kontratave: Subjekti qiramarrës "..." shpk me aktivitet "HEC",

kontrate e vitit 2017 me afat 10 vjecar, me detyrime të papaguara në vlerën 10,569,197 lekë, me aktivitet te pezulluar dhe Subjekti ...me aktivitet “HEC” kontrate e vitit 2018 me afat 10 vjecar, me detyrime të papaguara në vlerën 1,784,791 lekë lekë, me aktivitet te pezulluar.

Nga strukturat e Bashkisë nuk janë kryer veprime të mjaftueshme për evidentimin e problematikave dhe ndërmarrjen e hapave për negocime me qiramarrësit debitorë për pagesat me këste apo marrjen e masave për anullimin e kontratave. Gjithashtu nga referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezulton se në territorin e Bashkisë Mirditë ushtrojnë aktivitetin 8 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullosor, asete të Bashkisë Mirditë. Nga Bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për vend depozitimit të mineralit në rastet e subjekteve me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali si dhe shfrytëzim karriere dhe shtrati lumi, me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim inertesh, duke sjellë të ardhura të mungura për Bashkinë Mirditë.

**Kriteri:**

ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 “Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë”,I ndryshuar, nenet 826-840, me ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave” dhe me kontratat përkëtëse neni 5 "Pagesa e tarifës së qirasë".

**Impakti:**

Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Mirditë nga mos arkëtimi i detyrimeve nga qiramarrësit.

**Shkaku:**

Strukturat e Bashkisë Mirditë nuk kanë qenë efektive në mbledhjen e detyrimeve të qirave nga subjektet qiramarrëse si dhe nuk kanë respektuar përcaktimet ligjore për dhënien me qira të aseteve të tyre

**Rëndësia:** E lartë

**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 12 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të papaguara në ***vlerën 14,945,988 lekë*** dhe për vonesat në pagesa të llogarisë kamatëvonesat referuar kushteve të kontratave. Nga strukturat e Bashkisë të merren masa për evidentimin e problematikave dhe ndërmarrjen e hapave për negocime me qiramarrësit debitorë, si dhe në kushtet e mosmarrëveshjeve ndërmarrjen e veprimeve ligjore për prishjen e në mënyrë të njëanshme të kontratave me qiramrrësit, që nuk paguajnë detyrimet për tarifat e qirave.

Gjithashtu nga strukturat drejtuese për 8 rastet e subjekteve private për prodhim dhe nxjerrje minerare e inertesh, që ushtrojnë aktivitetin e licencuar në parcelat e fondit pyjor-kullosor, asete të Bashkisë Mirditë, të shqyrtohet dokumentacioni i tyre dhe të kryhen kontrolli dhe matja në terren i parcelave, që shfrytëzohen dhe finalizimi i procesit me lidhjen e kontratave të qiradhënies për sigurimin e të ardhurave dhe rehabilitimin e sipërfaqeve nga zhfrytëzimi nga ana e këtyre subjekteve të aseteve të bashkisë. Nëse ka pengesë në realizimin e këtij procesi të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse deri në pezullimin e veprimtarisë.

***Sqarim dhe shpjegime:*** *Observacioni i sjellë me shkresën nr.3386/23, datë 17.11.2023, dërguar dhe me email nga zj.D.N, zj.E.V, zj. M.N, zj. E.D dhe z.T.P , ku shprehen se:*

***<u>Pretendimet e Subjektit të audituar</u>***

*Sipas projekt raportit të ardhur nga auditimi i ushtruar në Bashkinë Mirditë me datë 20.06.2023* ***Sqarojmë:*** *Në këtë projekt-raport janë pasqyruar nga ana juaj debitorët për vitet 2022 progresive nga viti 2010 me vlerë 22,578,967 lekë, <u>ku rëndësia e riskut është lënë e lartë.</u>* ***Kundërshtojmë rëndësinë e riskut të lartë për këto arsye:***

*-Vlera e detyrimit 14,838,512 lekë taksa ndikimi në infrastructure që nga viti 2010 ,ku administrate e taksave vendore e krujuar në vitin 2016 në Bashkinë Mirditë e ka evidentuar këtë detyrim. Për këtë vlerë detyrimi janë marrë të gjitha masat që parashikon ligji 9920 "Për Procedurat Tatimore Në Republiken e Shqipërisë"ne 89,90 e vijim dhe nga ajo periudhe jane arkëtuar 2.000.000 leke dhe jemi në negociom për arkërtimin e vleres se mbetur pasi subjkti është paraqitur ne Drejtorine e Taksave të Bashkisë Mirditë për pagesën e plotë të drtyrimit. Ky risk i lartë është përcaktuar qe nga viti 2010 dhe përcaktohet dhe sot në vitin 2023!Ne vazhdojmë ndjekjen e arkëtimit deri në fund të gjithe shumës detyrimit.*

*-Vlera e detyrimit prej 2.045.473 detyrimeve nga Biznesi i vogel deri me datë 20.11.2023 janë shlyer 1.621.926 leke ose 80 % e detyrimit.*

*- Vlera ne biznesit të madh 5.694.982 leke është shlyer e gjithë vlera pra 100 % e kesaj vlere*

*-Taksa familjare : Nga Drejtoria e Taksave dhe tarifave vendore pranë Bashkisë Mirditë është bërë regjistrimi në terren i gjithë familjeve që jetojnë realisht në territorin e bashkisë Mirditë. Nuk mund të ngarkojmë me detyrime një subjekt që nuk është pjesë e këtij komunitetit pasi në baze të ligjit 68/2017"Për Financat e Veteqeverisjes Vendore"dhe formula e përfitimit të grantit është bazuar në Popullsinë relative, Dendësinë e popullsise, nr faktik të fëmijëve në shkolla,kopshte,çerdhe etj, Ekualizimin e kapacitetit fiskal. Familjet të cilat nuk janë taksuar janë familje që nuk jetojnë në teritorin e Bashkisë Mirditë që nga viti 1994 te cilat nuk janë llogaritur në planifikimin e të ardhurave. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore ka bërë konsolidimin e rregjistrit të përditësuar të taksa paguesve familjare ,që identifikon të gjitha familjet që jetojnë realisht në territorin e Bashkisë Mirditë. Është bërë azhornimi për gjithë familjet i taksës pasurisë. Debitorët familjarë në fund të vitit 2022 sipas regjistrit të taksës familjare ishin 2536 familje lekë dhe deri me tani janë shlyer detyrimin 788 familje.*

***<u>Përgjigjet e Grupit të KLSH</u>.*** *Në lidhje me gjetjet e konstatuara mangësitë në punën e pa mjaftueshme në mbledhjen e borxhit të shkaktuar nga debitorët e taksave dhe tarifave vendore si ato të biznesit dhe ato familjarë sqarojmë se, mbledhja apo arkëtimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore është detyrim ligjor (dizpozitat ligjore të trajtuara më lart)dhe moszbatimi I ligjit ka efekte negative financiar në realizimn e të ardhurave të Bashkisë,ku mbi bazën e të ardhurave njësia vendore mbështet realizimin e shërbimeve ndaj komunitetit, funksion kryesor i Bashkisë, atëherë risku është i nivelit të lartë. Për sa kohë ekzistojnë debitorët dhe realizimi i të ardhurave është në nivele të ulta, përmendim këtu vetëm realizimin e taksave dhe tarifave për famijarët që është në masën 37%, taksa e tokës nga fermerët është 14.9 % pa përmendur të tjerat të paraqitura më lart sipas planifikimit të bërë, ku edhe këtu planifikim i të ardhurave lë për të dëshiruar se nuk është i saktë dhe real, atëherë nuk ka vend për të diskutuar dhe flasim vetë planifikimin tuaj dhe asgjë më shumë. Gjithashtua theksojmë se nuk janë ndjekur të gjitha masat shtërnguese në mbledhjen e taksave dhe tarifave në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", me ndryshime, Kreut XI- "Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara" neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181.*

***<u>Pretendimet e Subjektit të audituar</u>***

***Asetet.*** *Vlera debitore e mospageses së qirase sipas kontratave është 17.661.376 lekë nga kjo shume janë shlyer:*

*-HEC S...ne vleren 4.000.000 leke me date 13.10.2023 ose perafersisht 40 % e detyrimit jemi ne pritje te shlyerjes së plotë të detyrimit.*

*-E... ka shlyer ne vleren 247.675 leke me datë 01.11.2023*

*-Z...ka shlyer vleren 203.490 leke me datë 26.10.2023*

*-N...ka shlyer vleren 15.420 leke në datë 11.09.2023*

| |
|---|
| *-D... shpk ka shlyer vleren 193.906 leke ne datë 26.10.2023*<br>*-S...e ujit ka shlyer detyrimin 760.750 leke në datë 22.10.2023*<br>*-N...ne vleren 113.450 leke*<br>*-SHPK ... ne vleren 200 000 leke*<br>*Në saje të masave të marra gjatë kësaj periudhe vazhdon shlyerja e detyrimeve për të gjitha subjektet.Kjo punë është nisur tashmë nga ana jonë kjo e vërtetuar dhe me këto pagesa të kryera nga subjektet debitore (bashkelidhur ekstraket e pagesës)*<br>***<u>Përgjigjet e Grupit të KLSH</u>***<br>*Në lidhje me observacionin e bërë për pagesat e detyrimeve kontraktore të subjekteve debitorë qiramarrës të listuara dhe të dokumentuara me mandatpagesat e bankës apo ekstraktet bankare, sqarojmë se ato në të gjitha rastet janë përfshirë në kolonën pagesa të vitit 2022që kur ishim në fazën e auditimit në terren, përvec rastit të subjektit debitor Shoqëria "D..." ka shlyer vleren 193,906 leke në datë 26.10.2023, i cili ishte evidentuar në mënyrë të gabuar, ku dhe u bënë korrigjimet përkatëse në tabelën e debitorëve për detyrimet kontraktore të subjekteve qiramarrës, nga e cila rezultoi se vlera progresive debitore në fund të vitit 2022 është* ***14,945,988 lekë.*** *Rregullimet janë reflektuar edhe në materialin që trajton kontrata e qiradhënies dhe menaxhimi i tyre.*<br>*Ndërsa Shoqëria* ***"****HEC S..." me pagesën në vlerën 4.000.000 leke në datën 13.10.2023 nuk mund të përfshihet në këtë fazë të auditimit në pagesat e vitit 2022, por do të trajtohet në pagesat e vitit 2023 në auditimin e ardhshëm.*<br>*Referuar shpjegimeve të mësipërme observacioni nuk merret në konsideratë, sepse nuk ka argument ligjor përvec pjesës së dokumentacionit financiar të paraqitur për pagesat e kryera në lidhje me detyrimet kontraktore nga subjektet debitorë qiramarrës.* |

- **Subjektet që ushtrojnë aktivitet në fushën e hidrokarbureve**

Nga auditimit i dokumentacionit lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqirezulton se, Bashkia Mirditë ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë.Referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se, në territorin e Bashkisë Mirditë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 14 subjekte të paraqitura në tabelën në vijim.

| *Nr* | *Operatori Ekonomik* | *NIPTI* | *Adresa* | *Autorizimi Bazë* | *Niveli tarifës sipas VKM nr. 344* | **Pagesa viti 2021-2022** | **Detyrime për t'u paguar për autorizime 31.12.2022** | **Shënime** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | Fan | 08.05.2016-08.05.2021 | 1,000,000 | 400,000 | 600,000 | pa rinovuar (bllokuar) |
| 2 | | | Fan | 18.09.2017-18.09.2022 | 1,000,000 | 150.000 | 850.000 | pa rinovuar (bllokuar) |
| 3 | | | Reps | 05.05.2020-05.05.2025 | 1,000,000 | 1.000.000 | 0 | Paguar |
| 4 | | | Rreshen | 12.05.2020-12.05.2025 | 1,000,000 | 1.000.000 | 0 | Paguar |
| 5 | | | Rreshen | 01.09.2021-01.09.2026 | 1,000,000 | 1.000.000 | 0 | Paguar |
| 6 | | | Rreshen | 05.10.2020-05.10.2025 | 1,000,000 | 1.000.000 | 0 | Paguar |
| 7 | | | Vaushkeze | 01.05.2020-12.05.2025 | 1,000,000 | 800.000 | 200.000 | |
| 8 | | | Tarazh | 12.11.2021-12.11.2025 | 1,000,000 | 1.000.000 | 0 | Paguar |
| 9 | | | Fang | 30.07.2020-30.07.2025 | 1,000,000 | 1.000.000 | 0 | Paguar |
| 10 | | | Munaz | 21.09.2018-21.09.2023 | 1,000,000 | 1.000.000 | 0 | Paguar |
| 11 | | | Munaz | 30.05.2022-30.05.2027 | 1,000,000 | 1,000,000 | 0 | Pagaur |
| 12 | | | Reps | 31.10.2022-31.10.2027 | 1,000,000 | 1,000,000 | 0 | Paguar |
| 13 | | | Rubik | Pa paraqitur | 1.000.000 | 0 | 1.000.000 | Mbyllur aktiviteti |
| 14 | | | Rreshen | 21.03.2023-21.03.2028 | 1,000,000 | | | Paguar |
| | **Shuma:** | | | | **14.000.000** | **11.350.000** | **2.650.000** | |

Referuar dosjeve të subjekteve dhe të dhënave sipas tabelës përmbledhëse të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë konstatohet se, 3 subjekte:

1. Shoqëria "K..." shpk ka detyrim të papaguar vlerën 600,000 lekë për autorizimin e përfunduar në datën 08.05.2021, ku për shkak të këtij detyrimi Bashkia nuk i ka rinovuar autorizim/licencën për periudhën e mëvonshme, duke i bllokuar dhe aktivitetin.
2. Shoqëria "L..." shpk ka detyrim të papaguar vlerën 850,000 lekë për autorizimin e përfunduar në datën 11.09.2022, ku për shkak të këtij detyrimi Bashkia nuk i ka rinovuar autorizim/licencën për periudhën e mëvonshme, duke i bllokuar dhe aktivitetin.
3. Shoqëria "N..." shpk ka detyrim të hershëm të papaguar vlerën 1000,000 lekë për autorizim/licencën të përfunduar në vitin 2015, lëshuar nga ish-Bashkia Rubik,ku aktualisht në QKB kjo shoqëri paraqitet i mbyllur aktiviteti.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me përcaktimet ligjore, përkatësisht:

- Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", të ndryshuar, neni 4 "*Ushtrimi i veprimtarive në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre bëhet vetëm nga persona juridikë, pasi të jenë pajisur paraprakisht me lejet dhe autorizimet përkatëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji. Në mungesë të këtyre lejeve dhe autorizimeve, veprimtaria e kryer quhet e paligjshme*", neni 15"*...Stacionet e shitjes së karburanteve lejohen të ushtrojnë veprimtarinë e tyre vetëm pasi të jenë pajisur nga organi kompetent me autorizimin përkatës, sipas këtij ligji...",* neni 20-Autorizimet pika 2, "*Autorizimet për personat juridikë, që ushtrojnë veprimtaritë e parashikuara në pikat "ç" dhe "d" të nenit 11, jepen nga organi i pushtetit vendor për një periudhë deri në 5 vjet me të drejtë përsëritjeje*"; *Neni 11" Personat juridikë, që i nënshtrohen këtij ligji, në përputhje me natyrën e veprimtarisë së ushtruar, klasifikohen si vijon: ç) stacionet e shitjes se karburanteve, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjete; d) njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë".*
- VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kreu II, pika 3 "*Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga organet e qeverisjes vendore*".
- VKB nr. 100, datë 24.11.2021 "Për miratimin e paketës fiskale vendore 2022", pika C.6.

Përsa më sipër ngarkohen më përgjegjësi: z. T. P. me detyrë përgjjegjës i Sektorit të Transportit Licencimit dhe Tregut të Lirë në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.

**Titulli gjetjes:** *Mbi pajisjen me autorizim për ushtrimin e aktivitetit të subjekteve që tregtojnë lëndë djegëse.*

**Situata:** Bashkia Mirditë ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Në territorin e Bashkisë Mirditë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 14 subjekte nga të cilat, 4 subjekte konstatohet se kanë detyrime të papaguara në vlerën 2,650,000 lekë, si: Shoqëria "K..." shpk në vlerën 600,000 lekë, Shoqëria "L..." shpk në vlerën 850,000 lekë, Shoqëria "D..." shpk në vlerën 200,000 lekë dhe Shoqëria "N..." shpk ka detyrim të hershëm në vlerën 1,000,000 lekë, ku aktiviteti i tyre figuron i pezulluar apo i mbyllur.

**Kriteri:** Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999,nenet 4,15 dhe 20/2"dhe meVKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kreu II, pika 3.
**Impakti:** Mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Mirditë.
**Shkaku:** Puna jo efektive e Drejtorise të Tatim Taksave në identifikimin në kohë të përfundimit të afateve të autorizimeve për ushtrimin e aktivitetit si dhe mos ndjekja e hapave ligjorë për subjektet që vazhdojnë të ushtrojnë aktivitet pa autorizim.
**Rëndësia:** E lartë
**Për këtë rekomandojmë:**
Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën për ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, të papaguar nga subjektet: Shoqëria "K..." shpk në vlerën 600,000 lekë, Shoqëria "L..." shpk në vlerën 850,000 lekë, Shoqëria "D..." shpk në vlerën 200,000 lekë dhe Shoqëria "N..." shpk në vlerën 1000,000 lekë, si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve.

**2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin për pasqyrat financiare të vitit 2022.**

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2022 nga njësia shpenzuese "Aparati i Bashkisë Mirditë" për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022, me VKM nr.783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël".

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Bashkia Mirditë për vitin 2022 ka hartuar Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, pasi ka në varësi njësi shpenzuese me nipt më vete që është APPM. (Agjensia e Punëve Publike dhe Mirëmbajtjes).

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga Kontabilistja, NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Mirditë për vitin ushtrimor 2022 me shkresë përcjellëse nr.prot.1295, datë 31.03.2023.Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është nën/Kryetari i Bashkisë Mirditë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtoresha e Menaxhimit Financiarë dhe Buxhetit.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Për vitin 2022 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klases 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrate banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca.Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në rregjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mosndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabiltetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:
- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program “Excel”.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjke dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Eshtë mbajtur centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera , duke kaluar nga ditarët në centralizator deri në bilancin vërtetues. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi pershkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, permban te dhena per shkakun e veprimit, daten dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato te vleres, personat qe kane urdheruar dhe ekzekutuar veprimin me te dhenat te nevojshme qe i japin dokumentit forcen e nje prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financaiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomiko - financiar 01.01.2022 deri më datën 31.12.2022.

*Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhen nën auditim*
**Përkatësia:** Transaksionet dhe ngjarjet që janë të rregjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.
**Plotësia:** Të gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin rregjistruar janë rregjistruar, përveç rastit të kontratave të investimeve në vlerë të plotë dhe vlerës së faturave të palikujduara për investime në fund të vitit ushtrimor 2022.
**Saktësia:** Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e rregjistruara dhe ngjarjet janë rregjistruar në mënyrë të përshtatshme.
**Periudha:** Transaksionet dhe ngjarjet janë rregjistruar në periudhen e saktë kontabël, përvec disa rasteve të shpenzimeve të kryera për investime, të cilat nuk janë rregjistruar në momentin e celjes së fondeve dhe mbërritjes së faturës.
**Klasifikimi:**Transaksionet dhe ngjarjet janë rregjistruar në llogaritë e duhura.
**Ligjshmëria dhe rregullsia:** Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

*Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhes*
**Ekzistenca:** Asetet, detyrimet dhe fondet e veta ekzistojnë.
**Të drejtat dhe detyrimet:** Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.
**Plotësia:** Të gjitha asetet dhe fondet e veta janë rregjistruar.
**Vlerësimi dhe alokimi:** Aktivet, pasivet dhe fondet e veta janë të përfshira në pasqyrat financiare me shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, si dhe rregullimet që rezultojnë janë të rregjistruara.
*Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese*
**Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:** Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.
**Plotësia:** Të gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.
**Klasifikimi dhe kuptueshmëria:** Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara, si dhe janë mbajtur shënimet shpjeguese, të cilat shprehin paqartësitë e ndodhura .
**Saktësia dhe vlerësimi:** Informacioni financiar dhe të tjera në përgjithësi është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasinë e duhur.
Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Menaxhimit Financiarë dhe Buxhetit. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celje për vitin 2022 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2021.**
Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2022 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjese e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;
**Konkluzion:** Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabel ne llogarine e 520 “Disponibilitete në

Thesar" dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në me formatin nr.5 "Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022".

**Totali i Aktivit** për vitin 2022 është në vlerën 123,639,818,423 lekë dhe i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

**Formati nr.1 Aktivi i Bilancit 2022 Në lekë**

| Nr. Reshti | Referenca e Logarive | E M E R T I M I | Ushtrimi I Mbyllur | Ushtrimi Paraardhes |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **A** | **A K T I V E T** | **123,639,818,423** | **122,887,872,371** |
| 2 | | **I.Aktivet Afat shkurtra** | **296,564,176** | **598,065,512** |
| 3 | | **1.Mjete monetare dhe ekujvalent te tyre** | **161,032,045** | **419,142,155** |
| 4 | 531 | Mjrete monetare ne Arke | | |
| 5 | 512,56 | Mjrete monetare ne Banke | | |
| 6 | 520 | Disponibilitete ne Thesar | 161,032,045 | 419,142,155 |
| 7 | 50 | Letra me vlere | | |
| 8 | 532 | Vlera te tjera | | |
| 9 | 54 | Akreditiva dhe paradhenie | | |
| 10 | 59 | Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-) | | |
| 11 | | **2.Gjendje Inventari qarkullues** | **8,528,349** | **8,041,076** |
| 12 | 31 | Materiale | 8,528,349 | 8,041,076 |
| 13 | 32 | Inventar I imet | | |
| 14 | 33 | Prodhim nre proces | | |
| 15 | 34 | Produkte | | |
| 16 | 35 | Mallra | | |
| 17 | 36 | Kafshe ne rritje e majmeri | | |
| 18 | 37 | Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve | | |
| 19 | 38 | Diferenca nga cmimet e magazinimit | | |
| 20 | 39 | Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-) | | |
| 21 | | **3.Llogari te Arketushme** | **127,003,782** | **122,248,660** |
| 22 | 411 | Kliente e llogari te ngjashme | | |
| 23 | 423,429 | Personeli, paradhenie, deficite, gjoba | 6,681,630 | 6,693,900 |
| 24 | 431 | Tatim e Taksa | | |
| 25 | 432 | Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal | | |
| 26 | 433 | Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti | | |
| 27 | 435 | Sigurime Shoqerore | | |
| 28 | 436 | Sigurime Shendetsore | | |
| 29 | 437,438, | Organizma te tjere shteterore | | |
| 30 | 44 | Institucione te tjera publike | | |
| 31 | 465 | Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere | | |
| 32 | 468 | Debitore te ndryshem | 34,407,543 | 29,634,139 |
| 33 | 4342 | Operacione me shtetin(Te drejta) | 85,914,609 | 85,920,621 |
| 34 | 45 | Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike | | |
| 35 | 49 | Shuma te parashikuara per xhvleresim(-) | | |
| 36 | | **4.Te tjera aktive afatshkurtra** | | **48,633,621** |
| 37 | 409 | Parapagime | | |
| 38 | 473 | Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin | | |
| 39 | 477 | Diferenca konvertimi aktive | | |
| 40 | 481 | Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime | | |
| 41 | 486 | Shpenzime te periudhave te ardhshme | | 48,633,621 |
| 42 | | **II.Aktivet Afat gjata** | **123,343,254,247** | **122,289,806,859** |
| 43 | **20** | **1.Aktive Afatgjata jo materiale** | **6,582,402** | **6,582,402** |
| 44 | 201 | Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave | | |
| 45 | 202 | Studime dhe kerkime | 6,582,402 | 6,582,402 |
| 46 | 203 | Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme | | |
| 47 | **21** | **2.Aktive Afatgjata materiale** | **122,711,343,021** | **122,033,644,052** |
| 48 | 210 | Toka, T,roje, Terene | 9,962,953 | 9,962,953 |
| 49 | 211 | Pyje, Plantacione | 119,419,757,580 | 119,419,757,580 |
| 50 | 212 | Ndertesa e Konstruksione | 2,123,344,459 | 1,376,682,113 |
| 51 | 213 | Rruge, rrjete, vepra ujore | 1,110,966,634 | 1,151,457,447 |
| 52 | 214 | Iinstalime teknike, makineri e paisje | 20,766,909 | 38,086,783 |
| 53 | 215 | Mjete Transporti | 840,719 | 3,795,436 |
| 54 | 216 | Rezerva Shteterore | | |
| 55 | 217 | Kafshe pune e prodhimi | | |
| 56 | 218 | Inventar ekonomik | 25,703,767 | 33,901,740 |
| 57 | 24 | Aktive afatgjata te demtuara | | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 58 | 28 | Caktime te Aktiveve Afatgjata | | |
| 59 | 25-26 | **3.Aktive Afatgjata Financiare** | **70,867,000** | **70,867,000** |
| 60 | 25 | Huadhenie e Nenhuadhenie | | |
| 61 | 26 | Pjesmarrje ne kapitalin e vet | 70,867,000 | 70,867,000 |
| 62 | | **4.Investime** | **554,461,824** | **178,713,405** |
| 63 | 230 | Per Aktive Afatgjata jo materiale | | |
| 64 | 231 | Per Aktive Afatgjata materiale | 554,461,824 | 178,713,405 |

## A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

**Klasa 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre"** në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 161,032,045 lekë**,** të cilat rakordojnë me rubrikën VI " Teprica e likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor" në Formatin nr.3 "Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas metodës direkte" .

- ***Gjendja e llogarisë 520 "Disponibilitete në Thesar",*** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 161,032,045 lekë, gjëndje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në formatin nr.5 "Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2022".

**Në klasën 3 "Gjendja e inventarit qarkullues"** të aktiveve qarkulluese paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 8,041,076 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 8,528,349 lekë , ku diferenca e tyre në rritje në vlerën prej - 487 273 lekë rakordon me gjëndjen e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në formatin nr.2 "Pasqyra e performancës financiare". Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

- ***Gjendja e llogarisë 31 "Materiale"*** paraqitet paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 8,041,076 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 në vlerën 8,528,349, lekë, me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 487,273 lekë, e cila përfaqëson shtim të gjendjes së mallrave ne fund te vitit 2022.

- ***Gjendja e llogarisë 32 "Inventari i imet "*** paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 0 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë .

**Klasa 4 "Llogari të arkëtueshme"** paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 122,248,660 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 në vlerën 127,003,782 lekë , ku kemi shtim duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i shtimit të debitorëve të tatimeve dhe debitorëve të kopshtit e çerdhes.

**-Gjendja e llogarisë 423-429 "Personeli, paradhënie,defiçite, gjoba**, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2021 ka vlerën 6,693,900 lekë dhe në mbyllje tëvitit 2022 është në vlerën 6,681,630 lekë. Kjo shumë përfaqëson vlerën debitore nga rekomandimet "shpërblim dëmi" të lëna nga auditimet e Prefekturës dhe KLSH për 125 persona, që kanë qenë pjesë e strukturave të Bashkisë në vite të evidentuara, që nga viti 2004 deri në vitin 2016.Nga analiza e kësaj llogarije rezulton se për një pjesë të punonjësve prezent në Bashki është kryer arkëtimi i shumave,ndërsa për një pjesë të debitorëve arkëtimi është bërë më i vështirë me kalimin e viteve, pasi personat janë larguar pa adresë, duke kaluar afati ligjor i kërkimit për arkëtim. Analiza e gjendjes së kësaj llogarije paraqitet në Aneks.

| Nr | Emri | Mbiemri | Shuma | A. Kontroll | Nr | Emri | Mbiemri | Shuma | A. Kontroll |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | 1160 | Prefektura | 47 | | | 400 | Prefektura |
| 2 | | | 3220 | Prefektura | 48 | | | 3800 | Prefektura |
| 3 | | | 2040 | Prefektura | 49 | | | 850 | Prefektura |
| 4 | | | 5156 | Prefektura | 50 | | | 22033 | Prefektura |
| 5 | | | 3492 | Prefektura | 51 | | | 78906 | Sig.Shoq. |
| 6 | | | 2156 | Prefektura | 52 | | | 1200 | Prefektura |
| 7 | | | 3220 | Prefektura | 53 | | | 1247 | Prefektura |
| 8 | | | 2220 | Prefektura | 54 | | | 408 | Prefektura |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | | | 2200 | Prefektura | 55 | | | 382 | Prefektura |
| 10 | | | 3317 | Prefektura | 56 | | | 8887 | Prefektura |
| 11 | | | 1660 | Prefektura | 57 | | | 2621 | Prefektura |
| 12 | | | 1548 | Prefektura | 58 | | | 38679 | Prefektura |
| 13 | | | 1158 | Prefektura | 59 | | | 27280 | Prefektura |
| 14 | | | 2670 | Prefektura | 60 | | | 17280 | Prefektura |
| 15 | | | 1380 | Prefektura | 61 | | | 46313 | KLSH |
| 16 | | | 2695 | Prefektura | 62 | | | 27280 | Prefektura |
| 17 | | | 1140 | Prefektura | 63 | | | 15840 | Prefektura |
| 18 | | | 1585 | Prefektura | 64 | | | 15840 | Prefektura |
| 19 | | | 2580 | Prefektura | 65 | | | 210000 | Prefektura |
| 20 | | | 1736 | Prefektura | 66 | | | 47025 | Prefektura |
| 21 | | | 1836 | Prefektura | 67 | | | 32500 | Prefektura |
| 22 | | | 1220 | Prefektura | 68 | | | 4578451 | Prefektura |
| 23 | | | 2220 | Prefektura | 69 | | | 46313 | KLSH |
| 24 | | | 3200 | Prefektura | 70 | | | 46313 | KLSH |
| 25 | | | 3600 | Prefektura | 71 | | | 5244 | KLSH |
| 26 | | | 3600 | Prefektura | 72 | | | 26000 | KLSH |
| 27 | | | 3900 | Prefektura | 73 | | | 48900 | KLSH |
| 28 | | | 3600 | Prefektura | 74 | | | 32150 | Dif- inven |
| 29 | | | 1800 | Prefektura | 75 | | | 25000 | KLSH |
| 30 | | | 3600 | Prefektura | 76 | | | 9000 | KLSH |
| 31 | | | 4420 | Prefektura | 77 | | | 23135 | KLSH |
| 32 | | | 51973 | Prefektura | 78 | | | 128000 | KLSH |
| 33 | | | 77000 | Prefektura | 79 | | | 211121 | KLSH |
| 34 | | | 53628 | Prefektura | 80 | | | 242121 | KLSH |
| 35 | | | 3008 | Prefektura | 81 | | | 5600 | KLSH |
| 36 | | | 2574 | Prefektura | 82 | | | 50000 | |
| 37 | | | 9760 | Prefektura | 83 | | | 138533 | klsh |
| 38 | | | 2581 | Prefektura | 84 | | | 63866 | klsh |
| 39 | | | 6588 | Prefektura | 85 | | | 31693 | klsh |
| 40 | | | 840 | Prefektura | 86 | | | 17493 | klsh |
| 41 | | | 1126 | Prefektura | 87 | | | 31693 | klsh |
| 42 | | | 400 | Prefektura | 88 | | | 8333 | klsh |
| 43 | | | 400 | Prefektura | 89 | | | 17493 | klsh |
| 44 | | | 400 | Prefektura | 90 | | | 6000 | klsh |
| 45 | | | 400 | Prefektura | | | | | |
| 46 | | | 400 | Prefektura | | SHUMA | | 6681630 | |

***- Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm",*** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, ku në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 29,634,139 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 34,407,543 lekë. Vlera e debitorëve në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar njërritje prej 4,773,404 lekë. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar dhe gjendja e debitorëve të taksave në vlerën 27,780,101lekë, që zënë 80.7 % te vlerës debitore. Pjesa tjetër janëdetyrimet e lindura nga rekomandimet "shpërblim dëmi" të lëna nga KLSH në vite në ish-Komuna në vlerën 6,375,182 lekë, ku shuma më e madhe i takon dëmit ekonomik në vlerën 5,074,882 lekëtë konstatuar në zbatimin e kontratës me OE "C." shpk në ish-Komunën Kaçinar për të cilën Bashkia vazhdon të jetë në proces gjyqësor. Pjesa tjetëre debitorëve në vlerën 1,300,300 lekë përfaqëson detyrimet e 26 personave të ish-Komunave të lindura nga rekomandimet të KLSH, për të cilët nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkimit. Ndërsa vlera prej 252,260 lekë i takon debitorëve të vitit 2022 të paguara në vitin 2023 për detyrimet e lindura për tarifat e kopshteve dhe çerdheve. Analiza e gjendjes së llog. "Debitorë të ndryshëm"dhe lëvizjet e pësuara në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Gjendja e llogarise 468"Debitore te ndryshem" me date 31.12.2022**

| NR | DEBITORET LLOGARIA 468 | GJENDJA ME 01.01.2022 | Shtesa per vitin 2022 | Paksime per vitin 2022 | GJENDJA ME 31.12.2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| | BASHKIA MIRDITË | | | | 0 |
| 1 | | 4,000,000 | | | 4,000,000 |
| 2 | | 679,979 | | | 679,979 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 3 | | 9,419,533 | | | 9,419,533 |
| 4 | | 739,000 | | | 739,000 |
| 5 | | 4,589,397 | 4,702,449 | 3,596,864 | 5,694,982 |
| 6 | | 1,346,238 | 1,457,886 | 758,651 | 2,045,473 |
| 7 | | 2,484,810 | 3,789,910 | 1,073,586 | 5,201,134 |
| 8 | | 5,074,882 | | | 5,074,882 |
| 9 | | 152,500 | | | 152,500 |
| 10 | | 145,000 | | | 145,000 |
| 11 | | 15,000 | | | 15,000 |
| 12 | | 10,000 | | | 10,000 |
| 13 | | 15,000 | | | 15,000 |
| ,14 | | 40,000 | | | 40,000 |
| 15 | | 32,500 | | | 32,500 |
| 16 | | 32,500 | | | 32,500 |
| 17 | | 42,500 | | | 42,500 |
| 18 | | 40,000 | | | 40,000 |
| 19 | | 40,000 | | | 40,000 |
| 20 | | 5,000 | | | 5,000 |
| 21 | | 60,000 | | | 60,000 |
| 22 | | 17,500 | | | 17,500 |
| 23 | | 437,500 | | | 437,500 |
| 24 | | 10,000 | | | 10,000 |
| 25 | | 22,500 | | | 22,500 |
| 26 | | 10,120 | | | 10,120 |
| 27 | | 34,120 | | | 34,120 |
| 28 | | 10,120 | | | 10,120 |
| 29 | | 20,120 | | | 20,120 |
| 30 | | 10,120 | | | 10,120 |
| 31 | | 10,120 | | | 10,120 |
| 32 | | 21,120 | | | 21,120 |
| 33 | | 9,120 | | | 9,120 |
| 34 | | 26,120 | | | 26,120 |
| 35 | | 31,720 | | | 31,720 |
| 36 | | 0 | 205,340 | | 205,340 |
| 37 | | 0 | 46,920 | | 46,920 |
| | **Totali** | **29,634,139** | **10,202,505** | **5,429,101** | **34,407,543** |

- ***Gjendja e llogarisë 4342*** "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)" në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në shumën 85,914,609 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2022 që trashëgohen në vitin 2023 .Kjo gjendje në analizë përfshin gjëndjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.401-408 "Furnitore e llogari te lidhura me to" ne vleren 62,841,597 leke, llog.42 "Detyrime ndaj personelit" për vlerën 16,488,015 lekë, llog.431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" për vlerën 1,182,133 lekë, llog.435 "Sigurime shoqërore" për vlerën 4,751,025 lekë, llog.436 "Sigurime shëndetësore" për vlerën 651,839 lekë .

**Klasa 4 "Të tjera aktive afatshkurtra" e cila përbëhet nga :**

- Gjendja e llogarisë ***486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"***në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë, gjendje e cila përfaqëson detyrimet të prapambetura ndaj të tretëve e përfshirë në gjendjen e llogarisë4341 "Operacione me shtetin (te drejta)".

## II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

### Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

**1. *Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale***, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

***2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve***:

- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme si:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjëndjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

***3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:***

**a.** Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave te UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

**b.** Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:
- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 **"Aktivet Afatgjata" në aktiv të bilancit** paraqiten në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 122,289,806,859 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 123,343,254,247 lekë, ku diferenca përfaqëson vlerën e amortizimit të llogaritur shtesat gjatë vitit si dhe investimet në proces.Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)"paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 123,384,549,678 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 124,206,877,087 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

**Klasa 20 "Aktive Afatgjata jo materiale"** që përbëhet nga**:**

- **Gjëndja e llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime"*** në aktiv të bilancitparaqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,582,402 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën prej 6,582,402 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,582,402 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 6,582,402 lekë. Kjo llogari nuk ka ndryshime gjatë vitit 2022. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon.

**Inventari i llogarise 202 "Studime dhe kerkime "**

| NR | Emërtimi i aktiveve sipas Njësive Administrative | Gjendja me 31.12.2021 | Shtesa gjate vitit 2022 | Pakesime gjate vitit 2022 | Gjendja më 31.12.2022 | Realizimi I Investimit |
|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Hartim projekti ujsjellesi rreshen e reps | 3,684,816 | | | 3,684,816 | Investim I pa bere |
| 2 | Hartim projekti ujsjellesi fan.fang.rrasfik. | 2,897,856 | | | 2,897,856 | Investim I pa bere |
| | **TOTALI 2020** | **6,582,402** | | | **6,582,402** | |

Referuar tabelës vlera prej6,582,402 lekë i përket 2 projekteve, të cilët pritet të vihen në funksionim në vitet e mëvonshme. Këto projekte janë bërë hyrje dhe ruhen në Drejtorinë e Planifikim dhe Zhvillimit Urban dhe magazinën e Institucionit.

*U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2022*.

**Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) "Aktivet afatgjata materiale"** paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 122,033,644,052 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në shumën totale prej 122,711,343,021 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 123,377,967,006 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 124,200,294,415 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- ***Gjendja ellog. 210 "Toka, Troje, Terrene"*** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 9,962,953 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në në vlerën9,962,953 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" si në mbyllje të vitit 2021dhe në mbyllje të vitit 2022 ështe në të njëjtën vlerë prej 9,962,953 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuara sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

**Inventari kontabel i llogarise 210 "Toka Troje Terrene" me date 31.12.2022**

| Nr | **Emërtimii I aktiveve sipas Njësive Administrative** | **Gjendja me 31.12.2022** | **Shtesa gjate vitit 2022** | **Gjendja më 31.12.2022** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Toka terrene sportive fusha e futbollit | 9,962,953 | | 9,962,953 |
| | **BASHKIA MIRDITË TOTALI** | **9,962,953** | **0** | **9,962,953** |

***Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Plantacione"*** paraqitet në vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 119,419,757,580 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)" si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në vlerë të njëjtë prej 119,419,757,580 lekë.Vlerësimi i siparfaqeve pyjore kaluar në përdorim bashkisë Mirditë nga pushteti qendror është bërë në bazë të VKM nr. 89 datë 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë" sipas inventarit të detajuar tëkaluar nga pushteti qendror Bashkisë me VKM.

| Nr | **Emërtimii I aktiveve sipas Njësive Administrative** | **Gjendja me 31.12.2022** | **Shtesa gjate vitit 2022** | **Gjendja më 31.12.2022** |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Pyje, kullota | 119,419,757,580 | | 119,419,757,580 |
| | **BASHKIA MIRDITË TOTALI** | 119,419,757,580 | **0** | 119,419,757,580 |

- ***Gjendja e llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione"*** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,376,682,237 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,123 344 459 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,690,376,124 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,506,661,463lekë. Gjatë vitit 2022 janë krijuar aktive shtesë në vlerën816,285,385 lekë, ku diferenca në rritje prej808,312,597 lekë ka ardhur si rezultat nga rritja e AAGJM me pagesë si: rikonstruksione shkollash, pallatesh, objekte publike (me fondet e rindërtimit) etj. Shtesë pa pagesë nga jashtë sistemitnë vlerën 7,973,788 lekë,që përfaqëson kalimin kapital të Godinës së SHIK, Bashkisë Mirditë nga Shërbimi Informativ i Shtetit Drejtoria Rajonale Nr.3 me shkresën nr.prot. 91/1, datë 06.07.2022 mbi bazën e sëcilës është hartuar procesverbali i dorëzimit të aktivit me shkresënnr.3034 prot, datë 06.07.2022 i nënshkruar nga të dy palët. Analiza e gjëndjes së kësaj llogarije dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Aneks.

**Konkluzion:** Referuar analizës aktiv për aktiv të gjendjes së kësaj llogarije u konstatuan aktive të cilat ose janë gërmadha ose janë jashtë funksionit, të cilat duhet të kalojnë në debi të llog. 24 "Aktive afatgjata të dëmtuara" duke kredituar llog. ***212 "Ndërtesa Konstruksione" për*** vlerën 13,008,561 lekëqë i përkasin 10 aktiveve të konstatuara të dëmtuara. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar Aneksi nr. 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" Kap 2.1 "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i I grupit 21 "Aktive afatgjat materiale" pika (d). Rastet në mënyrë të detajuar paraqiten në Aneks.

| I. | BASHKIA MIRDITË | Gjendja me 31.12.2021 | Gjendja me 31.12.2022 |
|---|---|---|---|
| 1 | Shkolla 8-Vjeç. Kulme | 112 000 | 112 000 |
| 2 | Ndertesa e ish-parkut te Mallrave | 7 332 000 | 7 332 000 |
| 3 | Studim projektime | 296 000 | 296 000 |
| 4 | Rikonst. Banjo Publike(Bashkf.COPL) | 400 000 | 400 000 |
| 5 | Ndertesa ish-Parku Ura-fanit | 2 298 421 | 2 298 421 |
| 6 | Depo 2 cope (ish-rezervet) | 457 516 | 457 516 |
| | **Qyteti Rreshen** | **10,895,937** | **10,895,937** |
| 7 | Fjetore Nr.2 | 1 131 450 | 1 131 450 |
| 8 | Magazine ushqimore Kati 1 | 181 174 | 181 174 |
| 9 | Ndert Vendqendrime FUN Shpal | 400 000 | 400 000 |
| 10 | Ndert Vendqendrime FUN Shmri | 400 000 | 400 000 |
| | **NJA Orosh** | **2,112,624** | **2,112,624** |
| | | **13,008,561** | **13,008,561** |

**Titulli gjetjes:** *Mbi kontabilizimet e bëra në llogarinë **212 "Ndërtesa Konstruksione"***

**Situata:** - ***Gjendja e llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione"*** paraqitet në vlerë historike në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,690,376,124 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,506,661,463lekë. Referuar analizës aktiv për aktiv të gjendjes së kësaj llogarije u konstatuan aktive të cilat ose janë gërmadha ose janë jashtë funksionit, të cilat duhet të kalojnë në debi të llog. 24 " Aktive afatgjata të dëmtuara" duke kredituar llog. ***212 "Ndërtesa Konstruksione" për*** vlerën 13,008,561 lekë që i përkasin 10 aktiveve të konstatuara të dëmtuara(të paraqitura në aneks).

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar Aneksi nr.1"Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" Kap 2.1"Trajtimi kontabël dhe funksionimi i I grupit 21 "Aktive afatgjat materiale" pika (d).

**Impakti:** Mos evidentim dhe kontabilizim jo i saktë i AAGJM në llog.***212 "Ndërtesa Konstruksione"***.

**Shkaku:** Zyra e Financës ka kontabilizuar gabimisht akteve tëdëmtuara në llog.***212 "Ndërtesa Konstruksione"***.

**Rëndësia:** *I lartë*

**Për këtë rekomandojmë:**

Strukturat Drejtuese në bashkëpunim me Drejtorinë e Menxhimit Financiar dhe Buxhetit në Bashkinë Mirditë të marrin masa, që të kryhet inventari i aktiveve gjendje në llogarinë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione", ku nga komisioni i inventarizimit të identifikohen dhe të vlerësohen aktivet ndërtesa të dëmtuara ose inekzistente, të cilat të evidentohen në llog. 24 " Aktive afatgjata të dëmtuara" derisa të kryhen procedurat ligjore për nxjerrjen jashtë përdorimi si dhe veprimet kontabël përkatëse.

***- Gjendja e Llogarisë 213"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,151,457,447 lekë dhenë mbyllje të vitit 2022 në 1,110,966,634 lekë, ku diferenca prej 59,327,732 lekë është amortizimi i llogaritur për vitin 2022. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,095,650,298 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,114,487,217 lekë. Gjatë vitit 2022 janë bërë shtesat në vlerën 20,775,068 lekë, e përbërë ngavlera 16,140,140 lekë që përfaqësoninvestime të kryera me pagesë brenda sistemit në kanale vaditëse, ujsjellës etj, nga vlera prej 4,634,928 lekë që përfaqëson investime pa pagese jashtë sistemit nga donatorët për ndertim ura ne fshatin Shebe. Gjatë vitit 2022 pakësimet janë në vlerën 1,938,072 lekë, që i përket vlerës së investimeve (blerje tuba e vija vaditëse),që i kanë kaluar njësisë vartëse Agjencia e Punëve Publike dhe Mirmbajtje. Analiza e gjëndjes së kësaj llogarije si dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Aneks.

***- Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 38,086,783 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 20,766,909 lekë, ku diferenca është amortizimi i perllogaritur i vitit ushtrimor për këtë grupaktivesh. Ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 73,704,100 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 63,306,529 lekë, për të cilat ka inventar fizik. Në këtë grup aktivesh nuk ka shtesa për vitin 2022, por vetëm pakësime në vlerën prej 10,397,571 lekë, e cila përbëhet nga nxjerrjet jashtë përdorimit të këtyre aktiveve në vlerën 2,511,008 lekëtë vitit 2021 sipas proces-verbaleve mbi asgjësimin fizik te nxjerra jashtë përdorimit me nr.prot.3825/1,datë 29.09.2022, si dhevlerën prej7,886,563 leke që përfaqëson kalimin në përdorim tëkontinjerëve të mbeturinave të kaluara me transferim inventari njësisë vartëse Agjencia e Punëve Publike dhe Mirmbajtje, sipas urdhërit të kryetarit nr.prot.3980, datë14.09.2022.Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2021 në vitin 2022 paraqitet në Aneks.

| **I.** | **BASHKIA MIRDITË** | **Gjendja me 31.12.2021** | **Shtesa Viti 2022** | **Pakesime viti 2022** | **Gjendja me 31.12.2022** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Njësia Administrative Rrëshen | 36 929 752 | | 8 888 404 | 28 041 348 |
| 2 | Njësia Administrative Rubik | 22 368 411 | | 731 303 | 21 637 108 |
| 3 | Njësia Administrative Selitë | 1 325 300 | | 311 000 | 1 014 300 |
| 4 | Njësia Administrative Kthellë | 1 144 962 | | 106 290 | 1 038 672 |
| 5 | Njësia Administrative Kaçinarë | 1 202 445 | | 59 390 | 1 143 055 |
| 6 | Njësia Administrative Orosh | 6 046 735 | | 207 600 | 5 839 135 |
| 7 | Njësia Administrative Fanë | 4 686 495 | | 93 584 | 4 592 911 |
| | **Llog. 214 "Instalimeteknike,vegla"** | **73,704,100** | **0** | **10,397,571** | **63,306,529** |

***- Gjendja e llogarisë 215*** "Mjete Transporti" në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,795,436 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 840,719 lekë, ndërsa gjendja me kosto historike sipas Formatit nr.7/B paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 30,859,458 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 28,092,230 lekë. Shtesat gjatë vitit 2022 janë në vlerën 2,743,272 lekë që përfaqësojnë blerjen me pagesë likujdimin e faturës për diferencë të makinës multifunksionale të njësisë vartëse Agjencia e Punëve Publike dhe Mirmbajtjepër vlerën 1,940,580 lekë si dhe shtesa pa pagesë të automjetit zjarrfikës për vlerën 802,692 lekë, sipas letër- dhuratë, e konfirmuar me aktin administrativ nr.prot.1287/1,datë15.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë, mbi bazën e të cilit është bërë hyrja e magazinës përkatëse.Paksimet për vitin 2022 janë në vlerën 5,510,500 lekë, që janë dy automjete të kaluara me transferim inventari të njësisë vartëse Agjencia e Punëve Publike dhe Mirmbajtje në bazë të urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr.prot.3980,datë14.09.2022. Analiza e gjëndjes së kësaj llogarije dhe lëvizjet e këtyre aktiveve në fund të vitit 2022 paraqiten në Aneks:

**Inventari kontabel i llogarise 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2022**

| | **BASHKIA MIRDITË llog.215** | **Gjendja me 31.12.2021** | **Shtesa Viti 2022** | **Paksime Viti 2022** | **Gjendja me 31.12.2022** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Autobuz | 2,570,000 | | | 2,570,000 |
| 2 | Benz Mercedes-250 autoveturë (jo ne pune) | 960,000 | | | 960,000 |
| 3 | Makine teknologjike për pastrim(jo ne pune) | 8,741,600 | | | 8,741,600 |
| 4 | Makina e prokurorisë(jo ne pune) | 368,916 | | | 368,916 |
| 5 | Automjet zjarrfikës Steyer | 14,727 | | | 14,727 |
| 6 | Automjet zjarrfikës Steyer vinç | 14,727 | | | 14,727 |
| 7 | Mitsubishi i MZSH | 2,827,200 | | | 2,827,200 |
| 8 | Fuoristrada pic up e pyjores | 2,544,000 | | | 2,544,000 |
| 9 | Automjet Benz | 1,496,000 | | | 1,496,000 |
| **10** | Makinë teknologjike transporti mbeturinave | 3,720,000 | | 3,720,000 | 0 |
| 11 | Fadromë | 1,790,500 | | 1,790,500 | 0 |
| **12** | Ambulancë tip Volsvagen(jo ne pune) | 1,489,000 | | | 1,489,000 |
| 13 | Dyshek plus krevattëVolsvagen-it | 12,488 | | | 12,488 |
| **14** | Gomë makine të Volsvagen-it | 41,800 | | | 41,800 |
| 15 | Mjet transporti Land-Rover | 1,495,000 | | | 1,495,000 |
| **16** | Benz Mercedes(jo ne pune) | 788,500 | | | 788,500 |
| 17 | Foristrade nisan terana AA280EH(jo ne pune) | 1,985,000 | | | 1,985,000 |
| **18** | Makine teknologjike | | 1,940,580 | | 1,940,580 |
| **19** | Automjet zjarrfikes Mercedez Bens | | 802,692 | | 802,692 |
| | **TOTALI** | **30,859,458** | **2,743,272** | **5,510,500** | **28,092,230** |

***- Gjendja e llogarisë 218 "Inventar Ekonomik"*** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 33,901,740 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 25,703,767 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)"gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 57,656,493 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 58,026,443 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa në vlerën 1,004,048 lekë, nga të cilat me pagesë në vlerën prej 672,000 lekë dhe trasferimet kapitale nga institucionet e tjera qendrore në vleren 332,048 leke, që i përkasin paisjeve kompjuterike. Për aktivet (paisjeve kompjuterike) e dhuruara Bashkisë Mirditë nga Projekti "STAR"mbi bazën e akt-marrëveshjes të konfirmuar nga të dy palët. për të cilat janë ndjekur procedurat financiare e ligjore për evidentimn e tyre dhe hyrjen e tyre në magazinë. Pakësimet janënë vlerën 634,098 lekë, që përfaqësojnëaktivet e inventarit ekonomik të nxjerrë jashtë përdorimi për llogari të vitit 2021,sipas proces - verbaleve mbi asgjësimin fizik te nxjerra jashtë përdorimit me nr.prot.3825/1,datë29.09.2022. Në mënyrë të përmbledhur gjendja e kësaj llogarije paraqitet në Aneks.

| **I.** | **BASHKIA MIRDITË** | **Gjendja me 31.12.2021** | **Shtesa Viti 2022** | **Pakesime viti 2022** | **Gjendja me 31.12.2022** |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Njësia Administrative Rrëshen | 34 606 964 | 1 004 048 | 373 285 | 35 237 727 |
| 2 | Njësia Administrative Rubik | 15 595 015 | | 111 980 | 15 483 035 |
| 3 | Njësia Administrative Selitë | 1 088 546 | | 65 000 | 1 023 546 |
| 4 | Njësia Administrative Kthellë | 1 272 690 | | | 1 272 690 |
| 5 | Njësia Administrative Kaçinarë | 657 243 | | | 657 243 |
| 6 | Njësia Administrative Orosh | 2 842 767 | | | 2 842 767 |
| 7 | Njësia Administrative Fanë | 1 593 268 | | 83 833 | 1 509 435 |
| | **Llog. 218 "Inventari ekonomik "** | **57 656 493** | **1 004 048** | **634 098** | **58 026 443** |

**- Gjendja e aktiveve afatgjata**në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/a "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" të PF si më poshtë:

| **Nr. Refere Llogar** | **E M E R T I M I** | **Teprica ne fillim** | | | **Shtesat gjate vitit** | | **Paksimet gjate vitit** | **Teprica ne Fund** | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Kosto Historike** | **Amortizim Akumuluar** | **Teprica Neto** | **Kosto Historike** | **Amortizim** | **Kosto Historik** | **Kosto Historike** | **Amortizim Akumuluar** | **Teprica Neto** |
| **b** | **c** | **1** | **2** | **3** | **4** | **5** | **6** | **8** | **9** | **10** |
| **20** | **I. AAGJ/JO MATERIALE** | **6,582,672** | | **6,582,672** | | | | **6,582,672** | | **6,582,672** |
| 202 | Studime dhe kerkime | 6,582,672 | | 6,582,672 | | | | 6,582,672 | | 6,582,672 |
| **21- 28** | **II. AAGJ/ MATERIALE** | **123,377,967,006** | **1,344,322,830** | **122,033,644,176** | **840,807,773** | **144,628,564** | **18,480,241** | **124,200,294,415** | **1,488,951,394** | **122,711,343,021** |
| 210 | Toka,troje,Terene | 9,962,953 | 0 | 9,962,953 | 0 | | 0 | 9,962,953 | 0 | 9,962,953 |
| 211 | Pyje,Kullota Plantacione | 119,419,757,580 | 0 | 119,419,757,580 | 0 | | 0 | 119,419,757,580 | 0 | 119,419,757,580 |
| 212 | Ndertime e Konstruksione | 1,690,376,124 | 313,693,887 | 1,376,682,237 | 816,285,385 | 69,623,117 | 0 | 2,506,661,463 | 383,317,004 | 2,123,344,459 |
| 213 | Rruge,rrjete,vepra ujore | 2,095,650,298 | 944,192,851 | 1,151,457,447 | 20,775,068 | 59,327,732 | 1,938,072 | 2,114,487,217 | 1,003,520,583 | 1,110,966,634 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 214 | Insta tekn,makin,pais,vegl pun | 73,704,100 | 35,617,317 | 38,086,783 | | 6,922,303 | 10,397,571 | 63,306,529 | 42,539,620 | 20,766,909 |
| 215 | Mjete transporti | 30,859,458 | 27,064,022 | 3,795,436 | 2,743,272 | 187,489 | 5,510,500 | 28,092,230 | 27,251,511 | 840,719 |
| 216 | Rezerva shtetrore | 0 | | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 217 | Kafshe pune e prodhimi | 0 | | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 218 | Inventar ekonomik | 57,656,493 | 23,754,753 | 33,901,740 | 1,004,048 | 8,567,923 | 634,098 | 58,026,443 | 32,322,676 | 25,703,767 |
| 24 | A. te Qend.te trupez te demtu | | | 0 | 0 | | | 0 | 0 | 0 |
| 28 | Caktime | | | 0 | 0 | | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **T O T A L I ( I + II )** | **123,384,549,678** | **1,344,322,830** | **122,040,226,848** | **840,807,773** | **144,628,564** | **18,480,241** | **124,206,877,087** | **1,488,951,394** | **122,717,925,693** |

- ***Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale*** paraqitet në bilanc në vlerën 1,488,951,394 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7, kolona 9.
"Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara" është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018"Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"pika 36 Përllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje te periudhes ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikmit.

***<u>Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Mirditë</u>***

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:
Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2022 për Bashkinë Mirditë dhe Njësite Administrative ne varesi.
Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitin 2022 kanë dalë urdheri me nr,364, dates 07.11.2022 "Për ngritjen e komisioneve të inventarizimit për vitin 2022".Nga komisioni i inventarizimit janë mbajtur procesverbale nga çdo komision sipas objekteve ku është kryer inventari si në godinëne bashkisë, kopshte, cerdhe, shkolla, konvikt dhe NJA. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventareve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Mirditë dhe për Njësitë Administrative ne varesi. Fletët e inventareve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2022 dhe rezultojnë pa diferenca.Nuk është hartuar një relacion përmbledhës për gjithë inventarin e AAGJM, ku të përshkruhen mënyra e ruajtjes së këtyre aktiveve dhe konfirmimi i rezultatit të inventarit.
Nga komisioni i inventarizimit është mbajtur relacion shpjegues për gjendjen e aktiveve sipas llogarive perkatëse në lidhje me amortizimin dhe nëse kanë vlerë përdorimi si dhe janë hartuar proces-verbale për propozim për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve që kanë humbur funksionin e tyre. Të gjitha proceset e kryerjes së inventareve për vitin 2022 janë me dokumentacion bashkëlidhur.Për vitin 2022 është ngritur komisioni për asgjësimin e aktiveve të nxjerra jashtë përdorimit në vitin 2021 me Urdhrin e Titullarit nr.300 datë 02.09.2022. Vlerësimi i këtyre aktiveve është bërë me relacion përkatës me shkresat nr.prot 5431/1 ,datë 31.12.2021 nga komisioni i ngritur me urdhërin e kryetarit të Bashkisë nr.285 , datë 01.11.2021. Për asgjësimin e këtyre aktiveveështë mbajtur proces verbal asgjësimit me nr.3825/1 prot date 29.09.2022 nga komisioni i asgjësimit përkatësisht "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"në vlerën 2 511 008 lekë dhe "Inventarë ekonomik " me vlerë 634 098 lekë si dhe janë shoqëruar me foto dhe shpjegimet për procesin e kryer për asgjesimin.

**Konkluzion: G**jendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2022 në vlerën **124,200,294,415**lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivi. **Inventari kontabël i aktiveve materiale** gjendje në fund të vitit 2022 në llogaritë: ***210 "Toka, Troje, Terrene"*** është në vlerën 9,962,953 lekë; ***211 "Pyje, Plantacione"*** në vlerën 119,419,757,580 lekë, ***212 "Ndërtesa Konstruksione"*** në vlerën 2,506,661,463 lekë; ***213"Rrugë, rrjete, vepra ujore"*** në vlerën 2,114,487,217 lekë;

***214"Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*** në vlerën 63,306,529 leke. Në këto inventare janë azhornuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit, sipas emërtesave të projekteve të investimeve, pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale per çdo aktiv në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" kapitulli III, pika 30.

Për vitin 2022 nga auditimi i procedurës se mbajtjes dhe kontabilizimit te aktiveve rezultoi se çdo aktiv ishte i regjistruar dhe i kontabilizuar sipas dispozitave ligjore.

Gjendja e llog. 231"Shpenzime në proces për rritjen e AQT" në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 554,461,824 lekë. Kjo shumë përfaqëson investimet që janë në proces të pa përfunduara si më poshtë:

| Llog | Emertimi Objekteve | Vlera në leke |
|---|---|---|
| 231 | Plotesimi i rrjetit ujites fshati K/Rreshen lagja Zalli Zmese | 1,500,000 |
| 231 | Mbikqyrje punimesh godina e spitalit Shenjta Mari, & D.SH.P. Rreshen | 1,532,039 |
| 231 | Rikon I ambjenteve perbashketa (pallatet) Rreshen -Rubik faza II | 287,149,080 |
| 231 | Rikon I ambjenteve perbashketa (pallatet) Rreshen -Rubik faza III | 43,197,338 |
| 231 | Rikonstruks godina e spitalit Shenjta Mari, & D.SH.P. Rreshen ish infektiv | 156,343,174 |
| 231 | Ndertimi godines kopesht/çerdhe zona e re per zhvillim | 19,190,193 |
| 231 | Ndertim Ujesjellesi Rubik | 45,550,000 |
| | Shuma | 554,461,824 |

## Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

në lekë

| Nr.Res hti | Referenca e Llogarive | E M E R T I M I | Ushtrimi I Mbyllur 2022 | Ushtrimi Paraardhes 2021 |
|---|---|---|---|---|
| **65** | **B** | **PASIVET(DETYRIMET)** | **201,336,245** | **187,978,186** |
| 66 | | **I.Pasivet Afat shkurtra** | **201,336,245** | **187,978,186** |
| 67 | | **1. Llogari te Pagushme** | **201,336,245** | **187,978,186** |
| 68 | 401-408 | Furnitore e llogari te lidhura me to | 62,841,597 | 65,941,205 |
| 69 | 42 | Detyrime ndaj personelit | 16,488,015 | 14,415,623 |
| 70 | 16,17,18 | Hua Afat shkurtra | | |
| 71 | 460 | Huadhenes | | |
| 72 | 431 | Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa | 1,182,133 | 875,891 |
| 73 | 432 | Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal | | |
| 74 | 433 | Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore | | |
| 75 | 435 | Sigurime Shoqerore | 4,751,025 | 4,122,554 |
| 76 | 436 | Sigurime Shendetsore | 651,839 | 565,349 |
| 77 | 437,438, | Organizma te tjere shteterore | | |
| 78 | 44 | Institucione te tjera publike | | |
| 79 | 45 | Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike | | |
| 80 | 464 | Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere | | |
| 81 | 466 | Kreditore per mjete ne ruajtje | 74,332,463 | 17,095,904 |
| 82 | 467 | Kreditore te ndryshem | | 48,633,621 |
| 83 | 4341 | Operacione me shtetin( detyrime | 41,089,173 | 36,328,039 |
| 84 | 49 | Shuma te parashikuara per xhvleresim(-) | | |
| 85 | | **2.Te tjera pasive afatshkurtra** | **0** | **0** |
| 86 | 419 | Kreditore, Parapagime | | |
| 87 | 475 | Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese | | |
| 88 | 478 | Diferenca konvertimi pasive | | |
| 89 | 480 | Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar | | |
| 90 | 487 | Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se ttitullit | | |
| 91 | | **II.Pasivet Afat Gjata** | **0** | **0** |
| 92 | Klase 4 | Llogari te pagushme | | |
| 93 | 16.17,18 | Huate Afat gjata | | |
| 94 | | Provigjonet afatgjata | | |
| 95 | Klasa 4 | Te tjera | | |
| 96 | **C** | **AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)** | **123,438,482,178** | **122,699,894,185** |
| 97 | **D** | **FONDI I KONSOLIDUAR :** | **123,438,482,178** | **122,699,894,185** |
| 98 | 101 | Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar | 123,280,915,596 | 122,226,980,934 |
| 99 | 12 | Rezultatet e mbartura | | |
| 100 | 85 | Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore | 86,699,582 | 402,046,251 |
| 101 | 111 | Rezerva | | 0 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| 102 | 115 | Nga Fondet e veta te investimeve | | |
| | 15 | Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime | | 0 |
| 103 | 105 | Teprica e Granteve kapitale Te Brendshmne | | 0 |
| 104 | 106 | Teprica e Granteve kapitale Te Huaja | 0 | 0 |
| 105 | 107 | Vlera e mjeëteve te caktuara ne perdorim | 0 | 0 |
| 106 | 109 | Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata | 0 | 0 |
| 107 | | Te Tjera | 70,867,000 | 70,867,000 |
| 108 | **E** | **TOTALI I PASIVEVE(B+C)** | **123,639,818,423** | **122,887,872,371** |

**<u>Pasivet afatshkurtra.</u>** Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 201,336,245 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

***- Gjendja e llogarisë 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"*** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Gjendja e kësaj llogarije në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 65,941,205lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 62,841,597 lekë, vlerë e cila ka ardhur në ulje, duke paksuar faturat e palikujduara për mallra, shërbime dhe investime të periudhës së fundvitit ushtrimor. Kjo llogari ka vlerën e detyrimeve të prapambetura të regjistruara në Degën e Thesarit me vlerë 55,803,024 lekë si dhe fatura të pa likujduara ndaj të tretëve, borxh i krijuar në nentor-dhjetor të vitit 2022 në vlerën 7,038,573 lekë,faturat e të cilit nuk kishin përmbushur afatin 60 ditë të cilin e kërkon Dega e Thesarit si detyrim i prapambetur, ku në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

**Analiza e llogarisë 401 "Furnitorë e llogari të lidhura me to (mallra e shërbime)"**

| NR | EMERTIMI | PERSHKRIMI | NR | DATE | Vlera e pa likujduar |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | Lyerje objektesh | 809 | 06.10.2017 | 150,635 |
| 2 | | Materiale pastrimi | 30 | 13.12.2017 | 97,560 |
| 3 | | Materiale elektrike | 32 | 16.12.2017 | 252,960 |
| 4 | | Dru zjarri | 15 | 20.02.2018 | 565,440 |
| 5 | | Emergjenca e borës | 34 | 15.04.2019 | 243000 |
| 6 | | Nafte | 75 | 03.03.2022 | 146,240 |
| 7 | | Gaz i lengshem | 352 | 31.12.2022 | 49555 |
| 8 | | Buke | 7 | 31.12.2022 | 32,400 |
| 9 | | Buke | 8 | 31.12.2022 | 17,280 |
| 10 | | Ushqime | 9 | 30.12.2022 | 210,204 |
| 11 | | Ushqime | 14 | 30.12.2022 | 78,288 |
| 12 | | Ushqime | 16 | 30.12.2022 | 67,212 |
| 13 | | Ushqime | 18 | 30.12.2022 | 25,896 |
| 14 | | Ushqime | 1307 | 30.12.2022 | 288470 |
| 15 | | Mish | 1308 | 30.12.2022 | 12,120 |
| 16 | | Mish | 1309 | 30.12.2022 | 53,136 |
| 17 | | Mish | 1307 | 30.12.2022 | 30,096 |
| | | **T O T A L I I LLOGARISE 401** | | | **2,320,492** |

**Analiza e llogarisë 404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to (për investime)"**

| Nr. | Subjekti | Pershkrimi I Kontrates | Numri fatures | Data | Gjendje 31.12.2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | Mbikqyrje punimesh rruga kodër rrëshen | 56 | 17.05.2018 | 33557 |
| 2 | | Kolaudim punimesh ujembledhësi Malaj 1 | 143 | 18.12.2018 | 25,448 |
| 3 | | Kolaudim punimesh kalçeto Reps | 144 | 18.12.2018 | 16099 |
| 4 | | Kolaudim punimesh ndertim shpatulla urave | 145 | 18.12.2018 | 25,065 |
| 5 | | Kolaud punimesh mbrojtja lumore zmeja e madhe | 146 | 18.12.2018 | 28,705 |
| 6 | | Kolaudim punimeshskema ujitëse Bukmir | 147 | 18.12.2018 | 22.640 |
| 7 | | Rikon zyrave njesia administrative Rubik | 315 | 13.10.2020 | 100,382 |
| 8 | | Kol punimesh furnizim me enrgji godina bashkise | 47 | 31.12.2020 | 65,218 |
| 9 | | Ndertim I ujesjellesit Rubik | 18 | 06.04.2021 | 4,690,402 |
| 10 | | Mbik ndertim I ujesjellesit Rubik | 25 | 20.09.2021 | 383,255 |
| 11 | | Blerje makine teknologjike | 4 | 21.09.2021 | 37,200 |
| 12 | | Ndertim I ujesjellesit Rubik | 80 | 06.11.2021 | 6,581,032 |
| 13 | | Mbikqyrje ndertimi ujesjellesit Rubik | 45 | 06.12.2021 | 107,922 |
| 14 | | Nderimi I ujesjellesit Rubik | 90 | 09.12.2021 | 9,169,099 |
| 15 | | Nderimi I ujesjellesit Rubik | 5 | 12.01.2022 | 7,841,624 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 16 | | Oponence teknike | 118 | 15.02.2022 | 100,000 |
| 17 | | Ndertimi i ujesjellesit Rubik | 19 | 28.02.2022 | 4,866,212 |
| 18 | | Ndertim i ujesjellesit Rubik | 41 | 06.05.2022 | 2,392,154 |
| 19 | | Ekspertiza termeti | 548 | 27.05.2022 | 50,589 |
| 20 | | Nderimi i ujesjellesit Rubik | 63 | 07.07.2022 | 9,542,197 |
| 21 | | Nderimi i ujesjellesit Rubik | 75 | 08,08,2022 | 1,614,725 |
| 22 | | Ekspertiza termeti | 603 | 13.06.2022 | 43,000 |
| 23 | | Ekspertiza termeti | 760 | 21.07.2022 | 47,000 |
| 24 | | Nderimi i ujesjellesit Rubik | 81 | 09.09.2022 | 5,490,776 |
| 25 | | Ekspertiza termeti | 942 | 09.09.2022 | 8,400 |
| 26 | | Ekspertiza termeti | 1007 | 30.09.2022 | 283,458 |
| 27 | | Ekspertiza termeti | 1008 | 30.09.2022 | 781,030 |
| 28 | | Plotes rrjetit ujites fshati Koder/Rreshen | 17 | 28.12.2022 | 299,040 |
| 29 | | Ndertimi i ujesjellesit Rubik | 105 | 14.11.2022 | 4,793,858 |
| 30 | | Mbik ndertim i ujesjellesit Rubik | 83 | 08.11.2022 | 598,704 |
| 31 | | Ekspertiza termeti | 1264 | 02.12.2022 | 103484 |
| 32 | | Ekspertiza termeti | 1265 | 02.12.2022 | 103,000 |
| 33 | | Mbik. Punimesh godina e spitalit Rreshen | 11 | 27.12.2022 | 275,830 |
| | | **TOTALI I** | | | **60,521,105** |

- ***Gjendja e llogarisë 42 "Detyrime ndaj personelit"*** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 16,488,015lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2023.

- ***Gjendja e llogarisë 431 "Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat"*** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën kontabël 1,182,133lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2022 për detyrimet tatimit mbi pagënper shumen 1,070,251 lekë dhe tatimin ne burim per shumën 111,882 lekë, që do të paguhen në janar të vitit 2023.

- ***Gjendja e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore"*** paraqitet në fund të vitit 2022 në vlerën 4,751,025lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasaardhës e analizuar si vijon:.
a.Sigurimet shoqërore 9.5% punëmarrësi vlera 1,821,356 lekë.
b.Sigurimet shoqërore 15% punëdhënësi vlera 2,875,794lekë.
c.Sigurim suplementarë punëmarrësi me vlerë 53,875 lekë

- ***Gjendja e llogarisë* 436** "*Sigurime shëndetësore*" në fund të vitit 2022 është në vlerën kontabël 651,839 lekë, e cila përbëhet nga:
a.Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarsi vlera 325,919 lekë
b.Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlera 325,920 lekë.

***Gjendja e llogarisë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 41,089,173 lekë, vlera të cilat rakordojnë me gjendjet e llogarive kundërparti 423,429 "Personeli, paradhenie,deficite,gjoba me vleren 6,681,630 lek dhe llog.468 "Debitorë të ndryshëm" per shumen 34,407,543 lekë në aktiv të bilancit.

**- Gjendja e llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*"** përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarije paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 74,332,463 lekë.Për këtë gjendje të llog 466 është bërë rakordimi në degën e Thesarit Mirditë, ku në mënyrë analitike paraqitet në Aneks.
**Konkluzion:** Gjendja e llogarisë 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 48,633,621 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, vlerë e cila paraqitet ne llog.401-408. Gjendja e kësaj llogarije përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera për fatura të pafinancuara deri në nëntor të vitit ushtrimor, pasi kalojnë në detyrime të prapambetura. Gjendjes së kësaj llogarije i përkasin 32 fatura të paraqitura në llog.401-404 "furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën 55,803,024 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar

Kreu 3.1 pika 42,Aneksi nr.1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" Kap 3.3"Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)pika (b,d) në të cilat përcaktohet:

"*c) Konstatohen e paguhen shpenzime korrente e kapitale:*

- *Debitohet klasa 6 ose 23 (sipas analizave përkatëse);*
- *Kreditohet 401, 404, 467 e të tjera me analiza, kur detyrimi paguhet më vonë;*
- *Kreditohet klasa 5 llogaritë financiare (kur paguhet menjëherë).*

*d) Paguhen detyrime të konstatuara më parë:*

- *Debitohen llogaritë 401, 404, 467;*
- *Kreditohet klasa 5 e "Llogarive financiare".*

**Titulli gjetjes:** *Mbi kontabilizimet e bëra në llogarinë* 467 *"Kreditorë të ndryshëm"*
**Situata:** Gjendja e llogarisë 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 48,633,621 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën 0 lekë, vlerë e cila paraqitet ne llog.401-408. Gjendja e kësaj llogarije përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera për fatura të pafinancuara deri në nëntor të vitit ushtrimor, pasi kalojnë në detyrime të prapambetura. Gjendjes së kësaj llogarije i përkasin 32 fatura të paraqitura në llog.401-404 "furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën 55,803,024 lekë.
**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar Kreu 3.1 pika 42,Aneksi nr.1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" Kap 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) pika (b,d).
**Impakti:** Evidentim dhe kontabilizim jo i saktë i AAGJM në llog. 467 *"Kreditorë të ndryshëm".*
**Shkaku:** Zyra e Financës ka kontabilizuar gabimisht fatura të prapmbetura në llog 401-404"Furnitorë e llogari të lidhura me to".

**Rëndësia:** *I mesëm*

**Për këtë rekomandojmë:**
Drejtoria e Menxhimit Financiar dhe Buxhetit në Bashkinë Mirditë të marrin masa, që faturate e prapambetura që paguhen në përiudha të ardhshme të kontabilizohen në llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm", ndërsa faturat e fundvitit ushtrimor që paguhen në janar-shkurt të vitit pasardhës për llogari të vitit ushtrimor të kontabilizohen në llog. 401-404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to".

**Analizë e llogarive** sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 "Pasqyra e përformancës financiare" të PF të vitit 2022 paraqitet në Aneks.

**Analiza e llogarive të të ardhurave** për vitin 2022, të cilat në total janë në vlerën 817,369,359 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Mirditë paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike ***70*** **"Të ardhurat nga taksat dhe tatimet"** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën **39,352,886** lekë, i cili kuadron me Akrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisëanalitike ***7002 "Tatim mbi Biznesin e vogël*"** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 106,620lekë e cila përfshin *taksën mbi Biznesin e vogël* , ecila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.
b. Gjendja e llogarisë ***7020 "Tatim mbi pasurinë e palujtshme"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 14,437878lekë e cila përfshin *taksën mbi ndërtesën, token bujqesore dhe truallin*, ecila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.
c.Gjendja e llogarisë ***7033 "Taksa mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"***pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 19,523,515lekë e cila përfshin *taksën mbi regjistrimin e pervitshem te mjeteve.*
d. Gjendja e llogarisë ***7035 "Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie"*** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 5,284,873lekë e cila përfshin taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja,takse hoteli,takse e tabeles reklame,takse e tabeles, zënie hapësire publike.
- Gjendja e llogarisë***71* "Të ardhurat jo tatimore"**paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 24,528,129lekë, i cila kuadron me Akrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
a. Gjendja e llogarisë ***7109*** "***Të ardhura te tjera jo tatimore nga ndermarrjet dhe pronesia"***paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 4,593,830 lekë, e cila përfshin taksën e qerase mbi troje, e cila kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
b.Gjendja e llogarisë ***711*** "***Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare"*** paraqitet në bilancin e 2022 në vlerën 19,934,299 lekë, e cila përfshin tarifat epastrimit,ndriçimit,autorizime karburanti,tarifa parkimit, kamatvonesa, tarifa transporti, licenca pagesa per çerdhe e kopeshte,etj. Kjo vlerë rakordon me Akrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
- Gjendja e llogarisë së fondeve ***7206 "Financim i pritshëm nga buxheti"*** është në vlerën prej 85,914,609 lekë.

<u>Analiza e shpenzimeve </u>në vitin 2022 , të cilat në total janë në vlerën 730,669,777 lekë paraqitet më poshtë:
- Gjendja e llogarisë ***600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"*** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 207,279,911 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 207,279,911 lekë diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë ***601 'Kontribute për sigurime"*** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 33,879,917 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 33,879,917 lekë , diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë ***602 "Blerje mallra e shërbime"*** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 132,356,204 lekë dhe sipa aktrakordimit me Thesarinështënë vlerën 93,820,110 lekë , diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë së fondeve ***604 "Transferime korente te brendshme"*** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 6,482,804lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarinështënë vlerën 17,230,403 lekë, diferenca nuk ka.
- Gjendja e llogarisë së fondeve ***606 "Transferime per Buxhetet familjare e Individe"*** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 389,694,308lekë, e cila rakordon me aktrakordimin me Thesarin.
**Per vitin 2022** totali i te ardhurave ne vlere eshte 817,369,359 lekë dhe totali shpenzimeve eshte 730,669,777lekë. Diferenca e tyre ne vleren 86,699,582rakordon me gjendjen e llog.85 "Rezultatin e ushtrimit".

Gjithashtu gjendja e llogarisë ***63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"*** është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2022 është në vlerën -487,273 lekë .

*Nga testi kontrollit për vitet 2022 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:*
*Rregullariteti i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:*
Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve.gjendja e arkës nuk e kalon limit e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likujduese të institucionit.
Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 *"Për limitin e arkës"*.

*Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë*
Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga regjistruesi nëpunësi autorizues dhe zbatues si dhe nga nëpunësi i Thesarit me firmat elektronike.
Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.
Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.
Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- *Pagesat e kryera jashtë afatit 30 ditë të paraqitjes së faturës*.

**Konkluzion:**Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2022 me urdhër-shpenzime në 41 raste faturash me vlerë 41,896,055lekë lekë, *mbi afatin 30 ditor të faturave* për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Mirditë, *ku 34* raste në vlerën 10,956,731,lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llog. 602 "shpenzime operative" dhe në 7 raste në vlerën 36,012,981,lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llog.231 "investime", ku në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë i punimeve. Likuidimi me vonese i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh është në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor

në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52[7], me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 44 "Kontrolli i shpenzimeve".Rastet më konkretisht paraqiten në tabelat e mëposhtme:

**Pagesat me vonesë për mallra e shërbime llog. 602**

| Nr | Urdher shpenzimi VITI 2022 | | | | Fatura | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Ush | Datë | Vlera | Përshkrimi | Nr | datë | vlera |
| 1 | 80 | 20.01.2022 | 467150 | | 4 | 04.05.2021 | 467150 |
| 2 | 81 | 20.01.2022 | 467150 | | 5 | 14.06.2021 | 467150 |
| 3 | 85 | 20.01.2022 | 91836 | | 518 | 31.07.2021 | 91836 |
| 4 | 82 | 20.01.2022 | 310000 | | 8 | 31.05.2021 | 310000 |
| 5 | 83 | 20.01.2022 | 310000 | | 11 | 31.05.2021 | 310000 |
| 6 | 84 | 20.01.2022 | 310000 | | 13 | 16.06.2021 | 310000 |
| 7 | 87 | 20.01.2022 | 696000 | | 15 | 29.06.2021 | 696000 |
| 8 | 79 | 20.01.2022 | 2321280 | | 3 | 08.04.2021 | 2 321 280 |
| 9 | 127 | 03.02.2022 | 69511 | | 18 | 30.06.2021 | 69511 |
| 10 | 128 | 03.02.2022 | 67920 | | 15 | 30.06.2021 | 67920 |
| 11 | 130 | 03.02.2022 | 320000 | | 22 | 24.07.2021 | 320000 |
| 12 | 131 | 03.02.2022 | 320000 | | 04 | 24.07.2021 | 320000 |
| 13 | 132 | 03.02.2022 | 125120 | | 301 | 27.07.2021 | 2,613,404 |
| 14 | 133 | 03.02.2022 | 468000 | | 48 | 23.07.2021 | 468000 |
| 15 | 134 | 03.02.2022 | 7884 | | 45 | 31.07.2021 | 7884 |
| 16 | 137 | 03.02.2022 | 58782 | | 564 | 31.08.2021 | 58782 |
| 17 | 223 | 09.03.2022 | 480000 | | 7 | 13.08.2021 | 480000 |
| 18 | 256 | 23.02.2022 | 31020 | | 27 | 31.08.2021 | 31020 |
| 19 | 257 | 23.02.2022 | 583200 | | 2006 | 11.08.2021 | 583200 |
| 20 | 255 | 23.02.2022 | 467144 | | 1 | 03.08.2021 | 467144 |
| 21 | 272 | 25.02.2022 | 467149 | | 2 | 09.09.2021 | 467149 |
| 22 | 270 | 25.02.2022 | 8424 | | 113 | 02.09.2021 | 8424 |
| 23 | 276 | 25.02.2022 | 106860 | | 30 | 30.09.2021 | 106860 |
| 24 | 263 | 24.02.2022 | 39080 | | 284440 | 27.08.2021 | 39080 |
| 25 | 273 | 25.02.2022 | 12500 | | 21818 | 28.09.2021 | 12500 |
| 26 | 278 | 25.02.2022 | 540000 | | 113 | 02.09.2021 | 540000 |
| 27 | 274 | 25.02.2022 | 224766 | | 679 | 30.09.2021 | 224766 |
| 28 | 287 | 01.03.2022 | 305184 | | 746 | 29.10.2021 | 305184 |
| 29 | 283 | 01.03.2022 | 24516 | | 168 | 01.10.2021 | 24516 |
| 30 | 285 | 01.03.2022 | 61992 | | 212 | 29.10.2021 | 61992 |
| 31 | 289 | 01.03.2022 | 126540 | | 34 | 29.10.2021 | 126540 |
| 32 | 362 | 10.03.2022 | 218000 | | 47 | 22.10.2021 | 218000 |
| 33 | 361 | 10.03.2022 | 437384 | | 3 | 07.10.2021 | 437387 |
| 34 | 363 | 10.03.2021 | 412339 | | 4 | 02.11.2021 | 412339 |
| | | | **10956731** | **Totali 602** | | | **10956731** |

**Pagesat me vonesë për investime llog.231**

| Urdhër shpenzimi VITI 2022 | | | | Fatura | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ush | Datë | Vlera | Përshkrimi | Nr | datë | vlera |
| 431 | 24.03.2022 | 5112170 | Rikonstruksion i kompleksit god,123 Ulza | 106 | 12.09.2020 | 5112170 |
| 253 | 02.02.2022 | 1940580 | Blerje automjeti teknologjik Timak | 4 | 21.09.2021 | 1 977 780 |
| 292 | 16.03.2022 | 204273 | Oponence teknike Malaj 1 Instituti Ndertimit | 89 | 10.12.2020 | 204273 |
| 123 | 10.03.2022 | 3232701 | Rik. shkoll mesme Ndrec N.Gjoka Fan Kthella | 14 | 06.05.2020 | 3232701 |
| 385 | 16.03.2022 | 99600 | Mbikq punim god sherb qytetaret Nrb engeniring | 16 | 13.12.2018 | 99600 |
| 1085 | 27.07.2022 | 20000000 | Ndertim ujesjellesi Rubik Curri | 18 | 06.04.2021 | 24690402 |
| 1086 | 27.07.2022 | 350000 | Mbikqy punim Ndertim ujesjellesi Rubik Instituti Konsulences Ndertimit | 25 | 20.09.2021 | 733255 |
| | | | | | | |
| | | **30939324** | **Totali 231** | | | **36050 181** |

**<u>Titulli gjetjes</u>:***Mbi pagesat nëpërmjet bankës të faturave të mbërritura mbi afatin 30 ditor.*
**<u>Situata:</u>** Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se janë kryer pagesa në vitin 2022 me urdhër-shpenzime në 41 raste faturash me vlerë 41,896,055

[7]në të cilën përcaktohet se*: "Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik."*

lekë lekë, *mbi afatin 30 ditor të faturave* për shpenzime mallra e shërbime/investime të mbërritura në Bashkinë Mirditë, *ku 34* raste në vlerën 10,956,731,lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për mallra e shërbime llog. 602 “shpenzime operative” dhe në 7 raste në vlerën 36,012,981,lekë janë kryer pagesa të vonuara për fatura për investime llog.231 “investime”, të cilat në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave apo realizim me vonesë të punimeve.
**Kriteri:** Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 44 “Kontrolli i shpenzimeve”.
**Impakti:** Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të pa likuiduara.
**Shkaku:** Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh i pjesës më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh.

**Rëndësia:** *I mesëm*

**Për këtë rekomandojmë**
Bashkia Mirditë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përjashtuar kufizimet e MFE)*, për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijim borxhi për fatura të pa likuiduara dhe krijimin e vështirësisë në aftësinë paguese.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi: zj. V.Gj me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës në Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit dhe në cilësinë e hartueses së pasqyrave financiare.

### 2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.

***Verifikimi i shpenzimeve të programuara me nivelin e fondeve të buxhetuara***
Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SPE, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, *si vijon:*
Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Mirditë *(regjistrat e parashikimit dhe realizmit)*, për periudhën 01.10.2018 – 31.12.2022, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

| **Procedura 01/10/2018 - 31/12/2022** | **Nr.** | **Vl.Fond Limit** | **Vl.Kontrate** |
|---|---|---|---|
| **GJITHESEJ** | **129** | **2 707 460 265** | **2 598 871 258** |
| - Të hapura | 13 | 649 707 495 | 614 906 845 |
| - Të kufizuara (Rindertim) | 19 | 1 900 534 036 | 1 845 705 897 |
| - Kërkesë me propozim / e hapur thjeshtuar | 46 | 128 427 176 | 113 923 599 |
| Me negocim pa shpallje | 2 | 4 500 000 | 3 952 500 |
| Blerje me vlere te vogel | 49 | 24 291 558 | 20 382 417 |

**Burimi:** *Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Mirditë*

| **Procedura 01/10/2018 – 31/12/2018** | **Nr.** | **Vl.Fondit Limit** | **Vl.Kontrate** |
|---|---|---|---|
| **GJITHSEJ** | **10** | **246 430 469** | **228 621 887** |
| -Të hapura | **5** | **235 411 331** | **218 749 657** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| -Kërkesë për propozim | 5 | 11 019 138 | 9 872 230 |

| **Procedura per vitin 2019** | **Nr.** | **Vl.Fondit Limit** | **Vl.Kontrate** |
|---|---|---|---|
| **GJITHSEJ** | **25** | **235 315 838** | **228 472 623** |
| -Të hapura | **3** | **204 421 195** | **199 549 454** |
| -Kërkesë për propozim | **11** | **24 896 062** | **23 717 286** |
| -Me negocim pa shpallje | **1** | **1 500 000** | **1 452 500** |
| -Blerje me vlere te vogel | **10** | **4 498 581** | **3 753 383** |

| **Procedura per vitin 2020** | **Nr.** | **Vl.Fondit Limit** | **Vl.Kontrate** |
|---|---|---|---|
| **GJITHSEJ** | **28** | **178 422 937** | **168 755 687** |
| -Të hapura | **2** | **135 640 174** | **129 229 521** |
| -Kërkesë për propozim | **14** | **36 522 105** | **34 090 919** |
| -Blerje me vlere te vogel | **12** | **6 260 658** | **5 435 247** |

| **Procedura per vitin 2021** | **Nr.** | **Vl.Fondit Limit** | **Vl.Kontrate** |
|---|---|---|---|
| **GJITHSEJ** | **30** | **893 399 229** | **859 613 404** |
| -Të hapura | **2** | **47 391 736** | **45 106 490** |
| -Të Kufizuara (Rindertim) | **9** | **826 153 271** | **796 636 410** |
| -E hapur e thjeshtuar | **6** | **10 533 848** | **9 705 998** |
| -Me negocim pa shpallje | **1** | **3 000 000** | **2 500 000** |
| -Blerje me vlere te vogel | **12** | **6 320 374** | **5 664 506** |

| ***Procedura per vitin 2022*** | **Nr.** | **Vl.Fondit Limit** | **Vl.Kontrate** |
|---|---|---|---|
| ***GJITHSEJ*** | **36** | **1 150 558 459** | **1 113 407 657** |
| *-Të hapura* | **1** | **26 843 059** | **22 271 723** |
| *-Të Kufizuara (Rindertim)* | **10** | **1 074 380 765** | **1 049 069 487** |
| *-E hapur e thjeshtuar* | **10** | **42 122 690** | **36 537 166** |
| *-Blerje me vlere te vogel* | **15** | **7 211 945** | **5 529 281** |

Referuar të dhënave të pasqyrës mësipërme për periudhën 01.10.2018 – 31.12.2022, janë realizuar gjithsej **129** procedura me fond limit **2 707 460 265** mijë lekë pa TVSH dhe vlerë kontrate **2 598 871 258** mijë lekë, me një diferencë për vlerën **108 589 007** lekë pa tvsh *nga e cila:* për ***vitin 2018*** (1.10.2018-31.12.2018) janë realizuar gjithsej **10** procedura me fond limit **246 430 469** lekë pa tvsh dhe vlerë kontrate **228 621 887** lekë pa tvsh, për ***vitin 2019*** janë realizuar gjithsej **25** procedura me fond limit **235 315 838** lekë pa tvsh dhe vlerë kontrate **228 472 623** lekë pa tvsh, për ***vitin 2020*** janë realizuar **28** procedura me fond limit **178 422 937** lekë dhe vlerë kontrate **168 755 687** lekë pa tvsh, për vitin **2021** janë realizuar **30** procedura me fond limit **893 399 229** leke pa tvsh dhe vlere kontrate **859 613 404** leke pa tvsh, per vitin **2022** janë realizuar **36** procedura me fond limit **1 150 558 459** leke pa tvsh dhe vlere kontrate **1 113 407 657** mije lekë.
Sipas llojit të aktivitet, konstatohet se në fushën e ndërtimit (investime), janë **27** procedura me fond limit **2 497 863 480** lekë pa tvsh dhe me vlere kontrate **2 410 500 155** lekë pa tvsh dhe në të tjera janë **102** procedura me fond limit **209 596 785** lekë pa tvsh dhe me vlere kontrate **188 371 103** lekë pa tvsh.

Në fazën e auditimit në terren, për shkaqe objektive, megjithë komunikimin e grupit të auditimit dhe subjektit me APP-në, nuk u bë i mundur aksesimi në kohë i SPE, për kryerjen e auditimit të katër procedurave të prokurimit, të realizuara me fondet e Buxhetit të Shtetit për Rindërtimin, nga të cilat një procedurë e vitit 2021 dhe 3 procedura të vitit 2022, si më poshtë:
Për vitin 2021

- “Rikonstruksion dhe riparim i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në Bashkinë Mirditë (qyteti Reps)”, me fond limit 193,728,994 lekë.
Për vitin 2022
- “Rikonstruksion dhe riparim i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në Bashkinë Mirditë qyteti Rrëshen dhe Rubik, faza 2”, me fond limit 378,646,408 lekë
- “Rikonstruksioni i godinave, spitali "Shenjta Mari" dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-Spitali Infektiv), Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë”, me fond limit 408,071,262 lekë.
- “Ndërtimi i godinës kopsht/çerdhe në zonën e rë për zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë”, me fond limit 77,231,323.
Për këto procedura prokurimi, grupi I auditimit nuk mund të shprehet.

**Viti 2018**
Programi i nevojave është bërë mbi bazën e studimit të nevojave reale që ka njësia vendore për punë, mallra e shërbime, si dhe në përputhje të parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB.
- Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve buxhetore
Për vitin 2018: Bashkia Mirditë referuar regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit ka zhvilluar gjithsej 19 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 259,993,471 lekë pa TVSh, vlerë të kontratës 235,425,843 lekë pa TVSh, diferenca midis tyre prej 24,567,628 lekë pa TVSh, ose në masën 9 % të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:
- Blerje me vlerë të vogël, 3 procedura, me fond limit në total prej 1,598,334 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 706,500 lekë, duke kursyer shumën prej 891,834 lekë;
- E hapur, 5 procedura, me fondin limit në total prej 235,441,331 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 218,749,657 lekë, duke kursyer shumën prej 16,691,674 lekë;
- Kërkesë për propozim, 11 procedura, me fondin limit në total prej 22,983,806 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 15,969,686 lekë, duke kursyer shumën prej 7,014,120 lekë.

Janë audituar të 2 procedurat e hapura ku ka rezultuar si mëposhtë vijon:

***1. Procedura e prokurimit me objekt “Rikonstruksion i plote Pallati i Sportit 'Arjana Arapi' Rrëshen”, viti 2018***

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *“Rikonstruksion i plote Pallati i Sportit 'Arjana Arapi' Rrëshen”, viti 2018.* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 249, datë 13.07.2018<br>**4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** “e hapur” | **2. Njësia e Prokurimit:**<br>1. M. D (Kryetare)<br>2. A. M (Anëtar)<br>3. M. M (Anëtare) | **3. Komisioni Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 250, datë 13.07.2018:**<br>1. M. P (Kryetar)<br>2. T. P. (Anëtar)<br>3. A. D. (Anëtare) |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>58,831,910 lekë | **6. Oferta fituese**<br>BOE, A... ShPK dhe J... ShPK, me vlerë 52,724,307 lekë pa TVSh | **7. Diferenca me fondin limit**<br>6,107,603 lekë |
| **8. Data e hapjes së ofertave:**<br>13.07.2018 | **9. Burimi Financimit:**<br>Nga buxheti i shtetit | **10. Operatorët Ekonomikë**<br>1. K...ShPK<br>2. BOE K... ShPK dhe A...<br>3. BOE L... ShPK dhe K... ShPK<br>4. K... ShPK |

| | | |
|---|---|---|
| | | 5. BOE A...ShPK dhe J... ShPK<br>6. E...ShPK |
| **11. Ankimime AK,**<br>Ka | **12. Përgjigje ankesës nga AK,**<br>Ka | **13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,** Nuk ka |

| **b. Kontrata** | | |
|---|---|---|
| **14. Lidhja e kontratës** 23.10.2018 | **15. Vlera e kontratës (me TVSh)** | **63,269,169 lekë** |

Me shkresë nr. 6320, datë 08.06.2018, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me lëndë "Detajim të fondit për zhvillimin e rajoneve sipas Vendimit nr. 7, datë 11.05.2015, të Komitetit për Zhvillimin Rajonal", është akorduar fondi për Rikonstruksion i plote Pallati i Sportit 'Arjana Arapi' Rrëshen. Titullari i Bashkisë Mirditë ka hartuar Urdhrin nr. 250, datë 13.07.2018, "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit", me përbërje z. M.P, z. T.P dhe zj. A.D.

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**
Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 58,831,910 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit.

**Mbi projektpreventivin e zbatimit:**
- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria "E..." ShPK në vitin 2018 dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. N.D.

**Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:**
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 19.07.2018, të hedhur në SPE.

Për këto kritere ka pasur ankesë në datë 07.08.2018 nga "A..." ShPK, për certifikatat ISO 9001-2008, PAS 99-2012 dhe ISO 9001-2012 për prodhimin ose furnizimin e tjegullave dhe FSF të elementeve të drurit, është kthyer përgjigje nga AK me email në datë 10.11.2018, por në sistem nuk ka asnjë ndryshim në kritere.

**Titulli i gjetjes:** Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit
**Situata 1:** Kriteret e vendosura për kualifikim, u konstatuan kritere të paargumentuara duke iu referuar përshkrimit të punimeve të bëra në preventiv si vijon:

1. Nuk është argumentuar numri i punonjësve të përcaktuar në pikën 2.3.2 të DT "*Të ketë mesatarisht të punësuar minimalisht 80 (tetëdhjetë) persona për periudhën (Janar 2017 – Qershor 2018), të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar, si dhe me formularët E-SIG.*";
2. Nuk është argumentuar kërkesa për inxhinier mjedisi në pikën 2.3.3 të DT "*Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për ketë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe te regjistruar në kompaninë e tij:1 (një) inxhinier mjedisi. Të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë pune, libreze pune, CV si dhe deklaratën që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.*";
3. Nuk është argumentuar kërkesa për mjekun e shoqërisë në pikën 2.3.4 të DT "*Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij nga Janari 2017 e në vazhdim mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003. Për ketë duhet të paraqesë kontratën e punës, Urdhrin e Mjekut, CV, diplomën dhe librezën e punës. Në rast bashkimi të*

*Operatoreve Ekonomike secili nga operatoret duhet ta ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë.*";

4. Nuk është argumentuar kërkesa për eksperience minimumi 1(një) vjeçare të certifikuar të 2 (dy) Inxhinierë pjesë të stafit teknik në pikë të DT 2.3.5 "*Bazuar në VKM Nr. 312 date 05/05/2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier" duhet që të ketë në stafin e tij minimalisht 2 (dy) Inxhinierë pjesë të stafit teknik, të Certifikuar për Sigurinë në Kantier me një eksperience minimumi 1(një) vjeçare të certifikuar. Për ketë të paraqitet dëshmia e certifikimit nga organet kompetente. Këta punonjës duhet të figurojnë në listë*pagesat e shoqërisë.*";
5. Nuk është argumentuar kërkesa për punimet e përgjithshme të ndërtimit në pikë të DT 2.3.8, "*NP – 12/A-Punime të inxhinierisë së mjedisit*";
6. Nuk është argumentuar kërkesa për certifikatat në pikë 2.3.9 të DT, "*Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, (kjo për gjithë stafin teknik)"...*;
7. Nuk është argumentuar kërkesa për certifikatat në pikë 2.3.10 të DT "*Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatat: ...PAS 99:2012, ISO 39001:2012...*";
8. Nuk është argumentuar lloji dhe sasia e makinerive dhe mjeteve të kërkuara nga OE të interesuar veçanërisht e makinerive/mjeteve si vijon në pikën 2.3.14 të DT "*Ekskavator me zinxhir, 2 copë*".

**Kriteri:** Këto kritere, janë në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, Ligjin nr. 6643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 23, pika 1 dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 26, pika 5, "<u>Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës</u>".

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga zj. M. D., z. A. M. dhe zj. M. M.*

**Hartimi i fondit limit**

Proces Verbali për "Rikonstruksion i plote Pallati i Sportit 'Arjana Arapi' Rrëshen" është hartuar nga studio projektuese "E..." me vlerë totale 58,831,910 lekë pa TVSh sipas fondeve në dispozicion të Bashkisë Mirditë. Rezulton se sipas verifikimeve me zgjedhje të zërave të punimeve me vlerën më të madhe, çmimet përputhen me manualet e çmimeve të ndërtimit në fuqi.

**Vlerësimi i ofertave**

Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 250, datë 13.07.2018 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. M. P.(Kryetar), z. T. P. (Anëtar) dhe zj. A.D (Anëtare).

KVO më datë 03.09.2018 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion i plote Pallati i Sportit 'Arjana Arapi' Rrëshen", me fond limit 58,831,910 lekë pa TVSh. Konstatohet se për këtë procedurë kanë aplikuar 6 operatorë ekonomik:

1. "K..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 43,611,427 lekë pa TVSh;
2. "K..." ShPK dhe "A..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 50,422,402 lekë ta TVSh;
3. "L..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 50,979,043 lekë ta TVSh;

4. “K...” ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 54,073,688 lekë pa TVSh;
5. BOE “A...” dhe “J...” ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 52,724,307 lekë pa TVSh;
6. “E...” ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 0 lekë.

KVO më datë 24.09.2018 ka hartuar raportin e vlerësimit për procedurën e prokurimit “e hapur” me objekt “Rikonstruksion i plote Pallati i Sportit 'Arjana Arapi' Rrëshen”. Pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e OE, KVO ka kualifikuar Bashkimin e Operatorëve Ekonomik **“A...” dhe “J...” ShPK me ofertën e paraqitur në vlerën 52,724,307 lekë pa TVSh** dhe “K...” ShPK me ofertën e paraqitur në vlerë 54,073,688 lekë pjesëmarrës për plotësimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit. Gjithashtu, është hartuar në datë 24.09.2018 raporti përmbledhës. Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 4386 prot., është hartuar me datë 08.10.2018.
Nga auditimi në SPE rezulton se vlera e ofertave të OE është ndryshe nga Proces verbali mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave të OE të shënuara nga KVO, pra vlerat e ofertave të OE nuk janë të sakta për OE “K...” ShPK, BOE “A...” ShPK dhe “J...” ShPK, BOE “L...” ShPK dhe “K...” ShPK dhe BOE “K...” ShPK dhe “A...”.

**Situata 2:**
***Nga auditimi në SPE dhe në dosjen e prokurimit janë skualifikuar operatorët ekonomikë:***
1. OE “E...” ShPK, është skualifikuar me të drejtë nga KVO;
2. OE “K...” ShPK, është skualifikuar me të drejtë nga KVO;
3. BOE “L...” ShPK dhe “K...” ShPK, është skualifikuar me të drejtë nga KVO;
4. BOE “K...” ShPK dhe “A...” ShPK, është skualifikuar me të drejtë nga KVO.

***Nga auditimi në SPE, konstatohet se,*** BOE “A...” ShPK dhe “J...” ShPK i shpallur fitues, nuk plotëson kriteret si mëposhtë;
1. Kriteri i veçantë “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.3 në DT, për inxhinierin elektrik nuk është bashkëlidhur CV-ja, për arkitektin nuk është bashkëlidhur libreza e punës;
2. Kriteri i veçantë “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.4 në DT, për inxhinierin e mjedisit nuk është bashkëlidhur CV-ja dhe libreza e punës;
3. Kriteri i veçantë “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.14 në DT për mjetet:
   a) për autobetonieren është vetëm fatura e zhdoganimit dhe mungon leja e qarkullimit, certifikata e kontrollit teknik, siguracioni dhe foto;
   b) për autobotin e ujit me targë A..., foto është e paqartë çka nuk tregon qartë llojin e mjetit dhe tek leja e qarkullimit të këtij mjeti është kodi i karrocerisë F1 që është për mjetet kamion vetëshkarkues dhe jo autobot uji, që i përket kodit C6 ose C7;
   c) mungon foto për ekskavatorin me goma.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 63,269,169 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.

**Kriteri:** Nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës i përbërë nga z. M.P., z. T. P.dhe zj. A. D.*

**Ndikimi:** Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
**Shkaku:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Mirditë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

***<u>2. Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtim Kopshti Fëmijëve Qyteti Rrëshen, Mirditë", viti 2018</u>***

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtim Kopshti Fëmijëve Qyteti Rrëshen, Mirditë", viti 2018</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 258, datë 17.07.2018</td><td rowspan="2">2. Njësia e Prokurimit:<br>1. M.D (Kryetare)<br>2. A.M (Anëtar)<br>3. M.M (Anëtare)</td><td rowspan="2">3. Komisioni Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 259, datë 17.07.2018:<br>1. M.P (Kryetar)<br>2. T.P (Anëtar)<br>3. A.D (Anëtare)</td></tr>
<tr><td>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "e hapur"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)<br>52,200,498 lekë</td><td>6. Oferta fituese<br>K..., me vlerë 48,167,294 lekë pa TVSh</td><td>7. Diferenca me fondin limit<br>4,033,204 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së ofertave:<br>20.08.2018</td><td>9. Burimi Financimit:<br>Nga buxheti i shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë<br>1. K...ShPK<br>2. K... ShPK<br>3. L...ShPK<br>4. K... ShPK<br>5. A...ShPK<br>6. E...ShPK<br>7. J... ShPK<br>8. H... ShPK<br>9. J... ShPK<br>10. D...ShPK<br>11. A...ShPK</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK,<br>Nuk ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK,<br>Nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka</td></tr>
<tr><td colspan="3">b. Kontrata</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës 11.10.2018</td><td>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</td><td>57,025,710 lekë</td></tr>
</table>

Me shkresë nr. 6320, datë 08.06.2018, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me lëndë "Detajim të fondit për zhvillimin e rajoneve sipas Vendimit nr. 7, datë 11.05.2015, të Komitetit për Zhvillimin Rajonal", është akorduar fondi për Ndërtim Kopshti Fëmijëve Qyteti Rrëshen, Mirditë. Titullari i Bashkisë Mirditë ka hartuar Urdhrin nr. 259, datë 17.07.2018, "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit", me përbërje z. M.P, z. T.P dhe zj. A.D.

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**
Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 52,200,498 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit.

**<u>Mbi projektpreventivin e zbatimit:</u>**

Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria "E. ShPK në vitin 2018 dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. N.D dhe inxhiniere zj. A.D.

**Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:**
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 18.07.2018, të hedhur në SPE.

**Titulli i gjetjes:** Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit
**Situata 1:** kriteret e vendosura për kualifikim, u konstatuan kritere të paargumentuara duke iu referuar përshkrimit të punimeve të bëra në preventiv si vijon:

1. Nuk është argumentuar numri i punonjësve të përcaktuar në pikën 2.3.2 të DT "*Të ketë mesatarisht të punësuar minimalisht 60 (gjashtëdhjetë) persona për periudhën (Janar 2017 – Qershor 2018), të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar, dhe me formularët E-SIG.*";
2. Nuk është argumentuar kërkesa për inxhinier mjedisi në pikën 2.3.3 të DT "*Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe te regjistruar në kompaninë e tij:1 (një) inxhinier mjedisi. Të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë pune, libreze pune, CV si dhe deklaratën që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.*";
3. Nuk është argumentuar kërkesa për mjekun e shoqërisë në pikën 2.3.4 të DT "*Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij nga Janari 2017 e në vazhdim mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003. Për ketë duhet të paraqesë kontratën e punës, Urdhrin e Mjekut, CV, diplomën dhe librezën e punës. Në rast bashkimi të Operatoreve Ekonomike secili nga operatoret duhet ta ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë.*";
4. Nuk është argumentuar kërkesa për punimet e përgjithshme të ndërtimit në pikë të DT 2.3.8, "*NP – 12/A-Punime të inxhinierisë së mjedisit*";
5. Nuk është argumentuar kërkesa për të gjithë stafin teknik të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në pikë 2.3.7 të DT, "*Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, (kjo për gjithë stafin teknik)"*...;
6. Nuk është argumentuar kërkesa për certifikatat në pikë 2.3.8 të DT "*Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatat: ...PAS 99:2012, ISO 39001:2012 dhe EN-ISO 14001:2015*";
7. Nuk është argumentuar lloji dhe sasia e makinerive dhe mjeteve të kërkuara nga OE të interesuar veçanërisht e makinerive/mjeteve si vijon në pikën 2.3.10 të DT "*Ekskavator me zinxhir, 2 copë*" dhe "*Kamion me kapacitet mbajtës mbi 20 (njëzet) ton, 2 copë*".

**Kriteri:** Këto kritere, janë në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 23, pika 1 dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 26, pika 5, "*Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës*".

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga zj. M.D, z. A.M dhe zj. M. M.*

**Hartimi i fondit limit**
Proces Verbali për "Ndërtim Kopshti Fëmijëve Qyteti Rrëshen, Mirditë" është hartuar nga studio projektuese "E." me vlerë totale 52,200,497 lekë pa TVSh sipas fondeve në dispozicion të Bashkisë Mirditë. Rezulton se sipas verifikimeve me zgjedhje të zërave të punimeve me vlerën më të madhe, çmimet përputhen me manualet e çmimeve të ndërtimit në fuqi.

**Vlerësimi i ofertave**
Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 259, datë 17.07.2018 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. M.P (Kryetar), z. T.P (Anëtar) dhe zj. A.D (Anëtare).
KVO më datë 27.09.2018 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt "Ndërtim Kopshti Fëmijëve Qyteti Rrëshen, Mirditë", me fond limit 52,200,498 lekë pa TVSh. Konstatohet se për këtë procedurë kanë aplikuar 11 operatorë ekonomik:

1. "K..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 36,520,681 lekë pa TVSh;
2. "K..." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 45,896,564 lekë ta TVSh;
3. BOE "L..." ShPK dhe "K..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 0 lekë ta TVSh;
4. BOE "K..." ShPK dhe "N..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 48,167,294 lekë pa TVSh;
5. BOE "A..." dhe "U..." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 49,891,343 lekë pa TVSh;
6. "E..." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 0 lekë;
7. "J..." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 47,246,425 lekë;
8. "H..." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 49,870,694 lekë;
9. "J..." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 41,811,248 lekë;
10. "D..." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 41,054,093 lekë;
11. "A..." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 44,772,833 lekë.

KVO më datë 27.09.2018 ka hartuar raportin e vlerësimit për procedurën e prokurimit "e hapur" me objekt "Ndërtim Kopshti Fëmijëve Qyteti Rrëshen, Mirditë". Pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e OE, KVO ka kualifikuar Operatorin Ekonomik "H." ShPK me ofertë ekonomike 49,870,694 lekë pa TVSh dhe **"K." ShPK me ofertën e paraqitur në vlerë 48,167,294 lekë pa TVSh** pjesëmarrës për plotësimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit. Gjithashtu, është hartuar në datë 08.10.2018 raporti përmbledhës. Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 4386 prot., është hartuar me datë 08.10.2018.

Nga auditimi në SPE dhe në dosjen e prokurimit, konstatohet se janë skualifikuar operatorët ekonomikë:

1. OE "J..." ShPK, është skualifikuar me të drejtë KVO;
2. OE "A..." ShPK, është skualifikuar me të drejtë KVO;
3. OE "D..." ShPK, është skualifikuar me të drejtë KVO;
4. BOE "J..." ShPK dhe "E..." ShPK, është skualifikuar me të drejtë KVO;
5. OE "K..." ShPK, është skualifikuar me të drejtë për 5 mangësitë, veç punëve të ngjashme për të cilën KVO shprehet se, njëra nga punët e ngjashme është jashtë afatit, pasi data e përfundimit të punimeve është 09.02.2015, ndërkohë që njëra nga punët e lidhur midis operatorit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve plotëson afatin dhe përqindjen e

vlerës, pra jo më pak se 50% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit;

6. BOE "A..." ShPK dhe "U..." ShPK, KVO është shprehur se, oferta ka një gabim në preventiv në shumën 1,288,980 lekë, ndërkohë që gabimi është në vlerën 643,620 lekë.

<u>**Situata 2:**</u> Nga auditimi në SPE, rezulton se BOE "K..." ShPK dhe "N..." ShPK i shpallur fitues, nuk plotëson kriterin 2.3.10, për makineritë si mëposhtë;

1. Nuk është plotësuar asnjë dokumentacioni për mjetet, Saldatriçe;
2. Për mjetin ekskavator me goma me targë ABMT16, foto është e paqartë dhe nuk identifikohet targa;
3. Kërkohet autobot uji në DST, por BOE fitues ka paraqitur në SPE automjet me kodin e karrocerisë GA që i përket emërtimit "kamion me pajisje për transportin e mallrave të rrezikshëm", dhe jo autobot uji që i përket kodit C6 ose C7;
4. Nuk është plotësuar dokumentacioni për 1 kamionçinë me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton si dhe për kamionçinën me targa A... mungon foto e mjetit;
5. Për motogjeneratorin mungon foto.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 48,167,294 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.
**Kriteri:** Neni 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit".
**Ndikimi:** Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
**Shkaku:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Mirditë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

<u>Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës i përbërë nga z. M.P, z. T.P dhe zj. A. D.</u>

<u>**Viti 2019**</u>

Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, nevojat për prokurime në Bashkinë Mirditë janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat duke marrë për bazë kërkesat e sektorëve përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për secilin vit ushtrimor.
Programi i nevojave është bërë mbi bazën e studimit të nevojave reale që ka njësia vendore për punë, mallra e shërbime, si dhe në përputhje të parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike, të cilat janë miratuar me VKB.
- Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve buxhetore

Për vitin 2019: Bashkia Mirditë referuar regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit ka zhvilluar gjithsej 25 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 235,315,838 lekë pa TVSh, vlerë të kontratës 224,251,189 lekë pa TVSh, diferenca midis tyre prej 11,064,649 lekë pa TVSh, ose në masën 5 % të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

- Blerje me vlerë të vogël, 10 procedura, me fond limit në total prej 4,498,581 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 3,753,383 lekë, duke kursyer shumën prej 745,198 lekë;
- E hapur, 3 procedura, me fondin limit në total prej 204,421,195 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 199,549,454 lekë, duke kursyer shumën prej 4,871,741 lekë;
- Kërkesë për propozim, 11 procedura, me fondin limit në total prej 24,896,062 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 19,495,852 lekë, duke kursyer shumën prej 5,400,210 lekë;
- Me negocim, 1 procedurë, me fondin limit në total prej 1,500,000 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 1,452,000 lekë, duke kursyer shumën prej 47,500 lekë.

Janë audituar të 3 procedurat e hapura ku ka rezultuar si mëposhtë vijon:

***3. Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitimi i skemës ujitëse Ujëmbledhësi Malaj 2 (faza3)", Bashkia Mirditë viti 2019***

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Rehabilitimi i skemës ujitëse Ujëmbledhësi Malaj 2 (faza3)", viti 2019.* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 115, datë 08.04.2019<br>**4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "e hapur-punë" | **2. Njësia e Prokurimit:**<br>1. M.D (Kryetare)<br>2. B.D (Anëtar)<br>3. M.M (Anëtare) | **3. Komisioni Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 116, datë 08.04.2019:**<br>1. M.P (Kryetar)<br>2. T.P (Anëtar)<br>3. A.D (Anëtare) |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>42,532,808 lekë | **6. Oferta fituese**<br>A... ShPK, me vlerë 39,330,071 lekë pa TVSh | **7. Diferenca me fondin limit**<br>3,202,737 lekë |
| **8. Data e hapjes së ofertave:**<br>27.05.2019 | **9. Burimi Financimit:**<br>Nga buxheti i shtetit | **10. Operatorët Ekonomikë**<br>1. A...ShPK<br>2. B...ShPK<br>3. K...<br>4. L...<br>5. Sh... |
| **11. Ankimime AK,**<br>Ka | **12. Përgjigje ankesës nga AK,**<br>Ka | **13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,**<br>Ka |
| **b. Kontrata** | | |
| **14. Lidhja e kontratës** 06.08.201 | **15. Vlera e kontratës (me TVSh)** | **47,196,085 lekë** |

Me VKM nr. 170, datë 27.03.2019, shkresë nr. 1354 prot., datë 29.03.2019, "Për shpërndarjen dhe detajimin e fondit 1,000,000,000 (një miliard) lekë në programin "Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit", është akorduar fondi për rehabilitimin e skemës ujitëse ujëmbledhësi Malaj 2 (faza 3), Mirditë. Me vlerë të plotë të projektit 51,039,370 lekë, financim për vitin 2019 në vlerën 20,000,000 lekë dhe financim në vlerën 31,039,370 lekë për vitin 2020. Titullari i Bashkisë Mirditë ka hartuar Urdhrin nr. 116, datë 08.04.2019, "Për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Fondit Limit", me përbërje z. M.P, z. T.P dhe zj. A.D.

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**
Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 39,330,071 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit.

**Mbi projektpreventivin e zbatimit:**
***Nga auditimi konstatohet se:*** Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria "A..." & "E..." ShPK në vitin 2017 dhe është miratuar nga Inxhinier z. B.D. dhe jo Titullari i Bashkisë Mirditë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin Publik" nenin 41 pika 1.
*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Titullari i Bashkisë Mirditë z. N.D.*

**Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:**
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 19.04.2019, të hedhur në SPE.

Ka pasur ankesë në datë 21.06.2019 nga "B." ShPK, për mos vlerësim të saktë lidhur me mjetet e marra me qira janë për përdorim vetjak, mungesë certifikate PAS 99-2012 dhe ISO 39001:2012, deklarim jo të vërtet për kontratat e lidhura, vërtetim i shlyerjes së detyrimeve të OSHEE është lëshuar për tjetër emër si titullar i kontratës, mungesë dokumentacioni dhe mjetesh. "K.", për mos vlerësimin e saktë për ofertën anomalish të ulët, mangësi dokumentacioni dhe mjetesh, mungesë leje qarkullimi për automjete të ndryshme, është kthyer përgjigje nga AK me e-mail në datë 26.06.2019, bashkëlidhur shkresa nr. 2621/1 prot., datë 26.06.2019, KKP me shkresë nr. 502/1 prot., datë 30.07.2019, ka dërguar Bashkisë Mirditë Vendimin nr. 502/2019, ku shprehet se të vazhdojë procedura.

**Titulli i gjetjes:** Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit
**Situata 1:** kriteret e vendosura për kualifikim, u konstatuan kritere të paargumentuara duke iu referuar përshkrimit të punimeve të bëra në preventiv si vijon:

1. Nuk është argumentuar numri i punonjësve të përcaktuar në pikën 2.3.2 të DT "*Të ketë mesatarisht të punësuar minimalisht 35 (tridhjetë e pesë) persona për periudhën (Janar 2018 e në vazhdim), të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar, si dhe me formularët E-SIG.*";
2. Nuk është argumentuar kërkesa për inxhinier mjedisi në pikën 2.3.3 të DT "*Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon kualifikimet e duhura të stafit drejtues përkatës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt. Për ketë operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacion se ka si të punësuar dhe te regjistruar në kompaninë e tij:1 (një) inxhinier mjedisi. Të shoqëruara për secilin punonjës me diplomë, kontratë pune, libreze pune, CV si dhe deklaratën që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera.*";
3. Nuk është argumentuar kërkesa për mjekun e shoqërisë në pikën 2.3.4 të DT "*Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij nga Janari 2018 e në vazhdim mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003. Për ketë duhet të paraqesë kontratën e punës, Urdhrin e Mjekut, CV, diplomën dhe librezën e punës. Në rast bashkimi të Operatoreve Ekonomike secili nga operatoret duhet ta ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë.*";
4. Nuk është argumentuar kërkesa për eksperience minimumi 1(një) vjeçare të certifikuar të 2 (dy) Inxhinierë pjesë të stafit teknik në pikë të DT 2.3.5 "*Bazuar në VKM Nr. 312 date 05/05/2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier" duhet që të ketë në*

*stafin e tij minimalisht 1 (një) Inxhinier pjesë të stafit teknik, të Certifikuar për Sigurinë në Kantier me një eksperience minimumi 1(një) vjeçare të certifikuar. Për ketë të paraqitet dëshmia e certifikimit nga organet kompetente. Këta punonjës duhet të figurojnë në listë pagesat e shoqërisë.*";

5. Nuk është argumentuar kërkesa për punimet e përgjithshme të ndërtimit në pikë të DT 2.3.8, "*NP – 12/A-Punime të inxhinierisë së mjedisit*";
6. Nuk është argumentuar kërkesa për certifikatat në pikë 2.3.8 të DT, "*Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklaroje se ai nuk është i angazhuar në kontratat të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, (kjo për gjithë stafin teknik)"...*;
7. Nuk është argumentuar kërkesa për certifikatat në pikë 2.3.9 të DT "*Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatat: ...PAS 99:2012, ISO 39001:2012...*".

**Kriteri:** Këto kritere, janë në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, Ligjin nr. 6643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 23, pika 1 dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 26, pika 5, "*Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës*".

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga zj. M.D, z. B. D.dhe zj. M. M.*

**Hartimi i fondit limit**

Proces Verbali për "Rehabilitimin e skemës ujitëse Ujëmbledhësi Malaj 2 (faza3)", viti 2019" është hartuar nga studio projektuese "A..." ShPK dhe "E..." me vlerë totale 42,532,808 lekë pa TVSh sipas fondeve në dispozicion të Bashkisë Mirditë. Rezulton se sipas verifikimeve me zgjedhje të zërave të punimeve me vlerën më të madhe, çmimet përputhen me manualet e çmimeve të ndërtimit në fuqi.

**Vlerësimi i ofertave**

Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 116, datë 08.04.2019 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. M. P. (Kryetar), z. T. P. (Anëtar) dhe zj. A. D. (Anëtare).

KVO më datë 27.05.2019 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt "Rehabilitimin e skemës ujitëse Ujëmbledhësi Malaj 2 (faza3)", viti 2019", me fond limit 42,532,808 lekë pa TVSh. Konstatohet se për këtë procedurë kanë aplikuar 5 operatorë ekonomik:

1. "A..." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 39,330,071 lekë pa TVSh;
2. "B..." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 36,500,175 lekë pa TVSh;
3. "K..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 27,647,765 lekë pa TVSh;
4. "L..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 42,011,994 lekë ta TVSh;
5. "Sh..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertë 40,443,393 lekë pa TVSh.

KVO më datë 17.06.2019 ka hartuar raportin e vlerësimit për procedurën e prokurimit "e hapur" me objekt "Rehabilitimin e skemës ujitëse Ujëmbledhësi Malaj 2 (faza3)", viti 2019". Pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e OE, KVO ka kualifikuar Bashkimin e Operatorëve Ekonomik "A..." me ofertën e paraqitur në vlerën 39,330,071 lekë pa TVSh pjesëmarrës për

plotësimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit. Gjithashtu, është hartuar në datë 05.07.2019 raporti përmbledhës. Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 2800 prot., është hartuar me datë 05.07.2019.

Në SPE dhe në dosjen e prokurimit janë skualifikuar operatorët ekonomik; "B..." ShPK, "K..." ShPK, "L..." ShPK dhe "S..." ShPK janë skualifikuar me të drejtë nga KVO.

**Situata 2:** Nga auditimi në SPE, "A..." ShPK i shpallur fitues, nuk plotëson kriteret si mëposhtë:

1. Kriteri i veçantë "Kapaciteti teknik", pika 2.3.3 në DT, për inxhinierin hidroteknik nuk ka një dokumentacion në SPE;
2. Kriteri i veçantë "Kapaciteti teknik", pika 2.3.3 në DT, inxhinieri i mjedisit zj. M.A. nuk është në formularin E-SIG;
3. Kriteri i veçantë "Kapaciteti teknik", pika 2.3.3 në DT, inxhinieri Gjeodet z. Z. K. nuk ka dokumentacioni e shoqëruar me librezë pune;
4. Kriteri i veçantë "Kapaciteti teknik", pika 2.3.3 në DT, inxhinieri gjeolog z. Gj. K. nuk ka dokumentacioni e shoqëruar me librezë pune, gjithashtu nuk është në formularin E-SIG;
5. Kriteri i veçantë "Kapaciteti teknik", pika 2.3.4 në DT, për mjekun e shoqërisë nuk ka dokumentacioni e shoqëruar me librezë pune;
6. Kriteri i veçantë "Kapaciteti teknik", pika 2.3.11 në DT për kontratën me furnizim me OE tuba PE, mungon certifikata PAS 9:2012 dhe ISO 39001:2012 për prodhimin e materialeve;
7. Kriteri i veçantë "Kapaciteti teknik", pika 2.3.12 në DT për mjetet dhe dokumentacionin:
   a) për ekskavatorin me goma mungon foto ku të jetë targa e dukshme;
   b) për traktorin tipi IM4 mungon foto;
   c) për autobotin e ujit me targë A..., foto është e paqartë çka nuk tregon qartë llojin e mjetit dhe tek leja e qarkullimit të këtij mjeti është kodi i karrocerisë FE që është për mjetet kamion vetëshkarkues nga të tre anët me komandë shërbimi pneumatike me vinç për shkarkimin e mallrave dhe jo autobot uji, që i përket kodit C6 ose C7.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 47,196,085 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.

**Kriteri:** Neni 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit".

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës i përbërë nga z. M.P., z. T. P. dhe zj. A. D.*

**Ndikimi/efekti:** Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
**Shkaku:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Mirditë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

***4. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion i plotë i kompleksit të godinës "Pashko Vasa" Rrëshen", Bashkia Mirditë viti 2019***

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i plotë i kompleksit të godinës "Pashko Vasa" Rrëshen", Bashkia Mirditë viti 2019.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 117, datë 08.04.2019<br>4. Lloji i Procedurës së Prokurimit: "e hapur-punë"</td><td>2. Njësia e Prokurimit:<br>1. M. D. (Kryetare)<br>2. B. D. (Anëtar)<br>3. M. M. (Anëtare)</td><td>3. Komisioni Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 118, datë 08.04.2019:<br>1. M. P. (Kryetar)<br>2. T. P. (Anëtar)<br>3. A. D. (Anëtare)</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)<br>101,744,516 lekë</td><td>6. Oferta fituese<br>U...ShPK, me vlerë 101,366,061 lekë pa TVSh</td><td>7. Diferenca me fondin limit<br>378,455 lekë</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së ofertave:<br>27.05.2019</td><td>9. Burimi Financimit:<br>Nga buxheti i shtetit</td><td>10. Operatorët Ekonomikë<br>1. A...ShPK<br>2. E...ShPK<br>3. G. ...ShPK<br>4. K... ShPK dhe A...ShPK<br>5. K... ShPK<br>6. L...ShPK<br>7. U...</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime AK,<br>Ka</td><td>12. Përgjigje ankesës nga AK,<br>Ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP, Nuk ka</td></tr>
<tr><td colspan="3">b. Kontrata</td></tr>
<tr><td>14. Lidhja e kontratës 29.07.2019</td><td>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</td><td>120,924,793 lekë</td></tr>
</table>

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**
Kjo procedurë është "E Hapur-punë", me vlerë 101,744,516 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit.

**Mbi projektpreventivin e zbatimit:**
- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria "E." ShPK në vitin 2018 dhe është miratuar nga Inxhinier z. B.D dhe jo Titullari i Bashkisë Mirditë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin Publik" nenin 41 pika 1.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Titullari i Bashkisë Mirditë z. N.D.*

**Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:**
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 15.04.2019, të hedhur në SPE si më poshtë:

Për këto kritere ka pasur ankesë në datë 27.04.2019 nga "A." ShPK, për kërkesën e teknikun mekanik, eksperiencën për pas certifikimit të punonjësve, i është kthyer përgjigje me shkresën pa nr prot., datë 02.05.2019 dhe nr. 1902/1 prot., datë 06.05.2019, nr. 2022/1 prot., datë 13.05.2019, si dhe me Urdhër nr. 170, datë 17.05.2019 janë marrë në shqyrtim ankesat. Është pezulluar procedura mbajtur me proces verbalin nr. 2178 prot., datë 17.05.2019.

**Titulli i gjetjes:** Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit
**Situata 1:** kriteret e vendosura për kualifikim, u konstatuan kritere të paargumentuara duke iu referuar përshkrimit të punimeve të bëra në preventiv si vijon:

1. Nuk është argumentuar kërkesa për mjekun e shoqërisë në pikën 2.3.3 të DT "*Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij nga Janari 2018 e në vazhdim mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003. Për ketë duhet të paraqesë kontratën e punës, Urdhrin e Mjekut, CV, diplomën dhe librezën e punës. Në rast bashkimi të Operatoreve Ekonomike secili nga operatoret duhet ta ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë.*";
2. Nuk është argumentuar numri i punonjësve të përcaktuar në pikën 2.3.4 (a) të DT "*Të ketë mesatarisht të punësuar minimalisht 120 (njëqind e njëzet) persona për periudhën (Janar 2018 – Mars 2019), të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar, si dhe me formularët E-SIG.*";
3. Nuk është argumentuar kërkesa për eksperience minimumi 3 (tre) vjeçare të certifikuar të një pjesë të stafit teknik në pikë të DT 2.3.4 (b) "*3(tre) teknik ndërtimi; 1(një) teknik mekanik, 1(një) teknik elektrik, 4 (katër) instalues të sistemeve ngrohëse - ftohëse; 4(katër) instalues elektrik; 2 (dy) hidraulikë; 2 (dy) saldatorë; 4 (katër) karpentier, 3(tre) murator - suvatues. Punonjësit e mësipërm duhet të kenë një eksperiencë minimumi 3 (tre) vjeçare të certifikuar (certifikuar para 3 viteve) të vërtetuar me diplomë shkollës së mesme për teknikët dhe dëshmi kualifikimi profesionale/ diploma/certifikata të shkollës profesionale përkatëse për secilin specialitet të lëshuar nga institucione të licencuara nga organet përkatëse dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën për periudhën janar 2018-mars 2019*";
4. Nuk është argumentuar kërkesa për eksperience minimumi 1 (tre) vjeçare të certifikuar të 2 inxhinier pjesë të stafit teknik në pikë të DT 2.3.7 "*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën 2(dy) inxhinierë nga të cilët njeri drejtues teknik të shoqërisë që të disponojë dëshmi trajnimi si "Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për personat e sipërpërmendur duhet të paraqitet certifikata e trajnimit "Për përgjegjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj dhe të ketë një eksperiencë minimumi 1(një) vjeçare të certifikuar*;
5. Nuk është argumentuar lloji dhe sasia e makinerive dhe mjeteve të kërkuara nga OE të interesuar veçanërisht e makinerive/mjeteve si vijon në pikën 2.3.10 të DT "*Ekskavator me zinxhir, 2 copë*".

**Kriteri:**
Këto kritere, janë në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, Ligjin nr. 6643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 23, pika 1 dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 26, pika 5, "Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës".

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga zj. M.D, z. B. D. dhe zj. M. M.*

**Hartimi i fondit limit**
Proces Verbali për "Rikonstruksion i plotë i kompleksit të godinës "Pashko Vasa" Rrëshen", Bashkia Mirditë viti 2019" është hartuar nga studio projektuese "E." me vlerë totale 101,744,516 lekë pa TVSh sipas fondeve në dispozicion të Bashkisë Mirditë. Rezulton se sipas verifikimeve me zgjedhje të zërave të punimeve me vlerën më të madhe, çmimet përputhen me manualet e çmimeve të ndërtimit në fuqi.

**Vlerësimi i ofertave**
Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 118, datë 08.04.2019 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. M. P. (Kryetar), z. T. P. (Anëtar) dhe zj. A. D. (Anëtare).
KVO më datë 06.06.2019 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion i plotë i kompleksit të godinës "Pashko Vasa" Rrëshen", Bashkia Mirditë viti 2019", me fond limit 101,744,516 lekë pa TVSh. Konstatohet se për këtë procedurë kanë aplikuar 7 operatorë ekonomik:
1. "A..." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 0 lekë pa TVSh;
2. "E..." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 0 lekë pa TVSh;
3. "G." ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 101,667,235 lekë pa TVSh;
4. BOE "K..." ShPK dhe "A..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 81,392,267 lekë pa TVSh;
5. "K..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 94,091,166 lekë pa TVSh;
6. "L..." & "K..." & "K..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 88,343,663 lekë ta TVSh;
7. "U..." ShPK, me vlerë ekonomike të ofertë 101,366,061 lekë pa TVSh.

KVO më datë 02.07.2019 ka hartuar raportin e vlerësimit për procedurën e prokurimit "e hapur" me objekt "Rikonstruksion i plotë i kompleksit të godinës "Pashko Vasa" Rrëshen", Bashkia Mirditë viti 2019". Pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e OE, KVO ka kualifikuar Operatorine Ekonomik "U." me ofertën e paraqitur në vlerën 101,366,061 lekë pa TVSh pjesëmarrës për plotësimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit. Gjithashtu, është hartuar në datë 10.07.2019 raporti përmbledhës. Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 2851 prot., është hartuar me datë 11.07.2019.

Nga auditimi në SPE dhe në dosjen e prokurimit janë skualifikuar me të drejtë nga KVO operatorët ekonomik "A..." ShPK, "E..." ShPK "G..." ShPK, BOE "K..." ShPK dhe "A..." ShPK dhe "L..." & "K..." & "K..." ShPK.

<u>**Situata 2:**</u> në SPE, "U..." ShPK i shpallur fitues, nuk plotëson kriteret si mëposhtë;
1. Kriteri i veçantë "Kapaciteti teknik", pika 2.3.2 në DT, mungon deklarata që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera për inxhinierin elektrik, hidroteknik, gjeodet dhe mekanik;
2. Kriteri i veçantë "Kapaciteti teknik", pika 2.3.4/b në DT, pasi mungon dokumentacioni për 2 instalues elektrik:
3. Kriteri i veçantë "Kapaciteti teknik", pika 2.3.4/c në DT, pasi mungon deklarata e administratorit të shoqërisë që drejtuesit teknik duhet të jenë të pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt;
4. Kriteri i veçantë "Kapaciteti teknik", pika 2.3.10 në DT, për mjetet:
   a) Nuk është plotësuar dokumentacioni për 3 kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 35 ton;

b) Mungon dokumentacioni vërtetues për 1 fadromë me goma, pasi për mjetin me targa A... është vetëm certifikata e pronësisë ndërsa për mjetin me targa M... foto është e paqartë dhe nuk identifikohet targa;
c) mungojnë fotot për gjeneratorët e saldimit, skela metalike, 2 pajisje hekurkthyes kokoret, fikse zjarri, prozhektorë ndriçimi, tabelat paralajmëruese, 1 pompë suvatimi dhe vibratorët;
d) mungon dokumentacioni për 1 vinç kulle me kapacitet ngritës > 1 ton;
e) për vinçin karrel me kapacitet ngritës >1 ton është bashkëlidhur vetëm fatura me nr. 22, datë 116.01.2001, dhe nuk ka asnjë specifikim që të vërtetohet kapaciteti apo foto që të mund të duket mjeti.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 120,924,793 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.

**Kriteri:**
Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit".

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës i përbërë nga z. M.P., z. T.P. dhe zj. A. D.*

**Ndikimi/efekti:** Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
**Shkaku:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Mirditë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

***5. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti Shkolla e Mesme e Bashkuar "Ndrec N. Gjoka" Fan, Bashkia Mirditë viti 2019***

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *"Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti Shkolla e Mesme e Bashkuar "Ndrec N. Gjoka" Fan", viti 2019.* | | |
|---|---|---|
| **1. Urdhër Prokurimi**<br>Nr. 113, datë 08.04.2019<br>**4. Lloji i Procedurës së Prokurimit:** "e hapur-punë" | **2. Njësia e Prokurimit:**<br>1. M.D (Kryetare)<br>2. B.D (Anëtar)<br>3. M.M (Anëtare) | **3. Komisioni Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 114, datë 08.04.2019:**<br>1. M.P (Kryetar)<br>2. T.P (Anëtar)<br>3. A.D (Anëtare) |
| **5. Fondi Limit (pa TVSh)**<br>60,143,871 lekë | **6. Oferta fituese**<br>K...ShPK, me vlerë 58,853,322 lekë pa TVSh | **7. Diferenca me fondin limit**<br>1,290,549 lekë |

| 8. Data e hapjes së ofertave: 27.05.2019 | 9. Burimi Financimit: Nga buxheti i shtetit | 10. Operatorët Ekonomikë<br>1. A...<br>2. A...<br>3. E...<br>4. K...<br>5. L... |
|---|---|---|
| **11. Ankimime AK,** Ka | **12. Përgjigje ankesës nga AK,** Ka | **13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KPP,** Nuk ka |

| **b. Kontrata** | | |
|---|---|---|
| **14. Lidhja e kontratës** 29.07.2019 | **15. Vlera e kontratës (me TVSh)** | **69,805,421 lekë** |

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**
Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 60,143,871 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit.

**Mbi projektpreventivin e zbatimit:**
- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëria "A. " ShPK në vitin 2017 dhe është miratuar nga Inxhinier zj. A. D. dhe jo Titullari i Bashkisë Mirditë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin Publik" nenin 41 pika 1.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Titullari i Bashkisë Mirditë z. N.D.*

**Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:**
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 23.04.2019, të hedhur në SPE.

Për këto kritere ka pasur ankesë në datë 27.04.2019 nga "A." ShPK, për kërkesën e teknikun mekanik, eksperiencën për pas certifikimit të punonjësve, i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 1932 prot., datë 02.05.2019 dhe nr. 1901/1 prot., datë 06.05.2019, ankesa në datë 07.05.2019 nga "K." ShPK, lidhur me fuqinë punëtore dhe eksperiencën e punonjësve të kualifikuar, i është kthyer përgjigje me shkresën nr. 2031/1 prot., datë 13.05.2019 ku është marrë parasysh vetëm vjetërsua e punonjësve të kualifikuar, si dhe me proces verbalin datë 20.05.2019 "Për modifikimin e dokumenteve standarde" është bërë modifikimi për afatin e zhvillimit të tenderit.

**Titulli i gjetjes:** Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit
**Situata 1:** kriteret e vendosura për kualifikim, u konstatuan kritere të paargumentuara duke iu referuar përshkrimit të punimeve të bëra në preventiv si vijon:
1. Nuk është argumentuar kërkesa për mjekun e shoqërisë në pikën 2.3.3 të DT "*Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij nga Janari 2018 e në vazhdim mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003. Për ketë duhet të paraqesë kontratën e punës, Urdhrin e Mjekut, CV, diplomën dhe librezën e punës. Në rast bashkimi të Operatoreve Ekonomike secili nga operatoret duhet ta ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë.*";
2. Nuk është argumentuar numri i punonjësve të përcaktuar në pikën 2.3.4 (a) të DT "*Të ketë mesatarisht të punësuar minimalisht 120 (njëqind e njëzet) persona për periudhën (Janar 2018 – Mars 2019), të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar, si dhe me formularët E-SIG.*";

3. Nuk është argumentuar kërkesa për eksperience minimumi 3 (tre) vjeçare të certifikuar të një pjesë të stafit teknik në pikë të DT 2.3.4 (b) "*3(tre) teknik ndërtimi; 1(një) teknik mekanik, 1(një) teknik elektrik, 4 (katër) instalues të sistemeve ngrohëse - ftohëse; 4(katër) instalues elektrik; 2 (dy) hidraulikë; 2 (dy) saldatorë; 4 (katër) karpentier, 3(tre) murator - suvatues. Punonjësit e mësipërm duhet të kenë një eksperiencë minimumi 3 (tre) vjeçare të certifikuar (certifikuar para 3 viteve) të vërtetuar me diplomë shkollës së mesme për teknikët dhe dëshmi kualifikimi profesionale/ diploma/certifikata të shkollës profesionale përkatëse për secilin specialitet të lëshuar nga institucione të licencuara nga organet përkatëse dhe të figurojnë në listë-pagesat e shoqërisë për të paktën për periudhën janar 2018-mars 2019*";
4. Nuk është argumentuar kërkesa për eksperience minimumi 1 (tre) vjeçare të certifikuar të 2 inxhinier pjesë të stafit teknik në pikë të DT 2.3.7 "*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të paktën 2(dy) inxhinierë nga të cilët njeri drejtues teknik të shoqërisë që të disponojë dëshmi trajnimi si "Specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe VKM nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për personat e sipërpërmendur duhet të paraqitet certifikata e trajnimit "Për përgjegjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" e dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj dhe të ketë një eksperiencë minimumi 1(një) vjeçare të certifikuar*;
5. Nuk është argumentuar lloji dhe sasia e makinerive dhe mjeteve të kërkuara nga OE të interesuar veçanërisht e makinerive/mjeteve si vijon në pikën 2.3.10 të DT "*Ekskavator me zinxhir, 2 copë*".

**Kriteri:** Këto kritere, janë në kundërshtim me përcaktimet e dispozitave ligjore të zbatueshme për prokurimin publik, Ligjin nr. 6643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar, neni 23, pika 1 dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 26, pika 5, "*Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës*".

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga zj. M.D, z. B.D dhe zj. M.M.*

**Hartimi i fondit limit**

Proces Verbali për "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti Shkolla e Mesme e Bashkuar Ndrec N. Gjoka" është hartuar nga studio projektuese "A.SH. Enggineering" me vlerë totale 60,143,871 lekë pa TVSh sipas fondeve në dispozicion të Bashkisë Mirditë. Rezulton se sipas verifikimeve me zgjedhje të zërave të punimeve me vlerën më të madhe, çmimet përputhen me manualet e çmimeve të ndërtimit në fuqi.

**Vlerësimi i ofertave**

Për vlerësimin e ofertave Titullari i AK me urdhrin nr. 114, datë 08.04.2019 ka ngritur Komisionin e Vlerësimit të Ofertave me përbërje z. M.P (Kryetar), z. T.P (Anëtar) dhe zj. A.D (Anëtare).

KVO më datë 06.06.2019 ka mbajtur proces verbalin për hapjen e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti Shkolla e Mesme e Bashkuar Ndrec N. Gjoka", me fond limit 60,143,871 lekë pa TVSh. Konstatohet se për këtë procedurë kanë aplikuar 5 operatorë ekonomik:

1. “A... ” ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 60,412,712 lekë pa TVSh;
2. “A...” ShPK me vlerë ekonomike të ofertës 59,977,563 lekë pa TVSh;
3. “E...” ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 0 lekë pa TVSh;
4. “K...” ShPK, me vlerë ekonomike të ofertës 58,853,322 lekë ta TVSh;
5. “L...” ShPK dhe “K...” ShPK, me vlerë ekonomike të ofertë 54,435,609 lekë pa TVSh.

KVO më datë 04.07.2019 ka hartuar raportin e vlerësimit për procedurën e prokurimit “e hapur” me objekt “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti Shkolla e Mesme e Bashkuar Ndrec N. Gjoka”. Pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e OE, KVO ka kualifikuar **Operatorin Ekonomik “K” ShPK me ofertën e paraqitur në vlerën 58,853,322 lekë pa TVSh** dhe “A.” ShPK me ofertën e paraqitur në vlerën 59,977,563 lekë pa TVSh pjesëmarrës për plotësimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit. Gjithashtu, është hartuar në datë 10.07.2019 raporti përmbledhës. Formulari i njoftimit të fituesit me nr. 2883 prot., është hartuar me datë 15.07.2019.

Në SPE dhe në dosjen e prokurimit janë skualifikuar me të drejtë nga KVO operatorët ekonomik “A.” ShPK, “E.” ShPK dhe BOE “L.” ShPK dhe “K.” ShPK.

**Situata 2:** në SPE, “K.” ShPK i shpallur fitues, nuk plotëson kriteret si mëposhtë;

1. Kriteri i veçantë “Kapaciteti ekonomik dhe financiar”, pika 2.3.1 në DT, për realizimin e punëve të ngjashme OE nuk ka dorëzuar certifikatën e marrjes në dorëzim të përhershme të objektit të kontratës nr. 2841 prot., datë 02.10.2017 që “K.” ShPK ka lidhur me Bashkinë Kolonjë;
2. Kriteri i veçantë “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.2 në DT, inxhinieri elektrik, hidroteknik dhe gjeodet nuk kanë plotësuar deklaratë që nuk janë të angazhuar në kontrata të tjera;
3. Kriteri i veçantë “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.10 në DT për mjetet:
   f) Nuk është plotësuar dokumentacioni për 3 kamionë vetëshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 35 ton;
   g) mungojnë fotot për gjeneratorët e saldimit;
   h) mungon dokumentacioni për 1 pajisje hekurkthyes (tranxhe/elektrobango);
   i) për 2 autobot uji me targë A... dhe A..., tek leja e qarkullimit të mjeteve është kodi i karrocerisë GA që është për mjetet për transport mallrash të rrezikshëm dhe jo autobot uji, që i përket kodit C6 ose C7;

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 69,805,421 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP.

**Kriteri:** Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Komisioni i Vlerësimit të Ofertës i përbërë nga z. M.P, z. T.P. dhe zj. A.D.*

**Ndikimi/efekti:** Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
**Shkaku:** Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandim:** Nga ana e Bashkisë Mirditë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

**Viti 2020**

Për vitin 2020: Bashkia Mirditë referuar regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit ka zhvilluar gjithsej 28 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 178,422,937 lekë pa TVSh, vlerë të kontratës 168,755,687 lekë pa TVSh, diferenca midis tyre prej 9,667,250 lekë pa TVSh, ose në masën 5.4 % të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

- Blerje me vlerë të vogël, 12 procedura, me fond limit në total prej 6,260,658 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 5,435,247 lekë, duke kursyer shumën prej 825,411 lekë;
- E hapur, 2 procedura, me fondin limit në total prej 135,640,174 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 129,229,521 lekë, duke kursyer shumën prej 6,410,653 lekë;
- Kërkesë për propozim, 14 procedura, me fondin limit në total prej 36,522,105 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 34,090,919 lekë, duke kursyer shumën prej 2,431,186 lekë;

Është audituar një procedurë e hapur, ku ka rezultuar si mëposhtë vijon:

## 6. Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtimi I Ujësjellësit qyteti Rubik", Bashkia Mirditë

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtimi I Ujësjellësit qyteti Rubik", Bashkia Mirditë, Nr. REF-54908, datë 03-25-2020. | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 50, datë 04.03.2020<br>2. Lloji i Procedurës –<br>"E hapur, punë" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Urdhër 50, datë 04.03.2020<br>Njësia e Prokurimit<br>1. M.D, (Personi përgjegjës), Jurist<br>2. R.B, Inxhinier<br>3. M.M, Juriste | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhër nr. 51, datë 04.03.2020<br>M.P, Kryetar<br>A.D<br>T.P |
| 5. Fondi Limit (pa TVSh)<br>126,838,174 lekë. | 6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "C." ShPK me ofertë 120,427,521 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 2136 prot, dt. 15.07.2020 me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës. | 7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)<br>6,410,653 lekë ose 5.1 % |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Datë 05.05.2020 | 9. Burimi Financimit<br>Buxheti i Shtetit (MIE) | 10. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 7 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 6 BOE,<br>c) Kualifikuar 1 OE/BOE |
| 11. Ankimime; nuk ka ankesë. | 12. Përgjigje Ankesës nuk ka | 13. Përgjigje Ankesës<br>nuk ka |

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**

Kjo procedurë është “E Hapur”, me vlerë 126,838,174 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit.

**<u>Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi</u>**
Në dosjen e prokurimit administrohet shkresa e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve me nr. 482 prot., datë 14.02.2020, sipas të cilës është bërë ndarja e fondeve për ndërtimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e objektit.
**<u>Mbi projektpreventivin e zbatimit:</u>**
- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëritë “A.” ShPK & “E.” ShPK në vitin 2017 dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. N. D. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 365 ditë nga fillimi i punimeve.
Në dosjen e prokurimit administrohet Oponenca Teknike, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...”.

**<u>Situata 1</u>**
<u>Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:</u>
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 23.03.2020, i cili ka ndryshuar me shtojcën e modifikimeve të hedhur në SPE.
-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 23.03.2020, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 61, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “*Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*
*Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit*”.

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 5 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier ndërtimi, inxhinier topograf, inxhinier elektronik, inxhinier mekanik, inxhinier hidroteknik) të jenë në licencë dhe të punësuar për periudhen Janar 2019 - Dhjetor 2019 dhe në kohë të plotë në kantier, si dhe staf mbështetës 2 teknikë të tjerë ndërtimi. <u>Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.</u>
2. Në listën e stafit inxhinierik, është kërkuar gjithashtu që stafi të jetë i punësuar për disa vite në shoqërinë ofertuese dhe të ketë eksperiencë totale të ndryshme në vite. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën dhe volumin e punimeve, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.

3- Është kërkuar qe operatori ekonomik të ketë të punësuar "Mjekun e shoqërisë", e vërtetuar kjo me Kontrate pune, diploma, license ushtrim profesioni, Urdhër Mjeku. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.
4- Janë kërkuar certifikata cilësie PAS 99 (Sisteme te menaxhimit te integruar), ISO IEC 27001 (Sistemet e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit), ISO 50001 (Sistemi i menaxhimit të Energjisë). Këto certifikata nuk janë në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.
5- Është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ketë nje punësim mesatar i të paktën 120 (njeqind e njezet) punonjës me kohë të plotë pune për periudhën Janar 2019 – dhjetor 2019. Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht në Procesverbalin e hartimit të KVK.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kane **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 5 të nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, z. R. B., Inxhinier.

**Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike**
Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga projektuesit e objektit.
Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

**Situata 2**
**Mbi vlerësimin e ofertave**
AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 12.04.2021. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës |
|---|---|---|
| 1 | OE "..." ShPK | 107,827,478 |
| 2 | BOE "..." ShPK & "..." ShPK | 108,188,434 |
| 3 | BOE "..." ShPK & "..." ShPK | 116,772,649 |
| 4 | OE "..." ShPK | 118,071,889 |
| 5 | OE "C..." ShPK | 120,487,973 |
| 6 | OE P..." ShPK | 121,622,726 |
| 7 | OE " A..." ShPK | 122,837,401 |

*Burimi i të dhënave: SPE*
*Punoi: KLSH*

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën pa nr. prot, datë 01.06.2020, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. N.D.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se OE "..." ShPK, "..." ShPK, BOE "A..." ShPK & "J..." ShPK dhe "A..." ShPK kanë mungesa në dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe janë skualifikuar me të drejtë nga KVO.
- Nga verifikimi i BOE "K..." ShPK & "..." ShPK rezulton se nga arsyet e paraqitura në Raportin Përmbledhës dhe në Njoftimin e Fituesit në SPE, vetëm fakti që "OE "K..." ShPK, në vërtetimin për pagesën e energjisë nuk ka të përfshirë muajin Mars 2020", është i vërtetë. Kjo mangësi, duhet të ishte trajtuar si devijim i vogël, pasi pagesa e energjisë e muajit Mars pa penalitet, duhet të bëhet deri në datën 30 Prill dhe me këtë datë e ndan vetëm 5 ditë nga data e hapjes së tenderit.
- Nga verifikimi i Raportit Përmbledhës dhe në Njoftimin e Fituesit në SPE, rezulton se ky OE është skualifikuar për dy arsyet e mëposhtme:
"*1.Operatori "4 A-M" shpk, nuk ka përmbushur piken 2.3.1 Përvojë të suksesshme në realizimin e punimeve të ngjashme, pasi në kontratën e paraqitur për objektin "Rikonstruksion rrjet ujësjellësi në zonën Babrru Qendër" është jashtë afatit të përcaktuar në kërkesat e DST. Akti i kolaudimit të këtij objekti mban datën 08.03.2017. Në kontratën e dytë të paraqitur për objektin e dytë "Linjë transmetimi nga baseni i presionit ne dalje te tunelit Dajt-takimin me tubacionin e depos gurore (puseta e marrjes Fush Dushk)" mungon certifikata e marrjes në dorëzim.*
*2.OE ka refuzuar te pranoje oferten e korigjuar nga KVO si dhe ka njoftuar terheqjen nga gara*".
Nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të OE "..." SHPK, konstatohet se për eksperiencë të ngjashme, është paraqitur me dokumentacion të rregullt për objektin "Linjë transmetimi nga baseni i presionit ne dalje te tunelit Dajt-takimin me tubacionin e depos gurore (puseta e marrjes Fush Dushk)", pasi objekti është kolauduar nga vetë Investitori dhe ky kolaudim duhet të konsiderohet si marrje në dorëzim.

-Gjithashtu, nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të OE fitues "..." SHPK, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi nga verifikimi i dokumenteve të paraqitura në tender, rezulton se ka patur aktivitet në Vlorë, Divjakë dhe Korçë në vitin 2017 dhe nuk e ka ndryshuar ekstraktin historik të veprimtarisë së shoqërisë, referuar ligjit 9920, datë 19.05.2008 i ndryshuar, "Për procedurat tatimore pika 1/1 ku citohet: "Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia në cdo rast bëhet përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë me numer unik identifikimi të njëjtë me ate të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia. Për këtë rast OE duhet të ishte pajisur me certifikatë dhe të regjistrohej në QKB.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 66, pika 3 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit.*".
Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një

kontrate me vlerë 144,513,025 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së M. P, A. D. dhe T. P.

**Ndikimi/efekti:** Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
**Shkaku**: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandim**: Nga ana e Bashkisë Mirditë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

**Viti 2021**
Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i SEP, u konstatuan disa shkelje të akteve ligjore/nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:
-Nga Autoriteti Kontraktor (AK) Bashkia Mirditë, në disa raste nuk është bërë e mundur që përpara fillimit të një procedure prokurimi, një apo shumëvjeçare, të merret konfirmim nga Ministria përgjegjëse për Financat, në strukturat e degëve të thesarit, që fondet të cilat synohen të prokurohen, janë brenda limitit të miratuar për angazhime, në kundërshtim me pikën 81 të UMF nr. 9, datë 20.07.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit".
Mbi bazën e dokumentacionit të paraqitur nga Bashkia Mirditë (regjistrat e parashikimit dhe realizmit), për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021, të dhënat mbi procedurat e zhvilluara paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

| Procedura 01.01.2021 – 31.12.2021 | Nr. i procedurave | Vl. Fond limit në lekë | Vl.Kontrate në lekë |
|---|---|---|---|
| Gjithsej | 1 | 896,323,917 | 848,819,866 |
| E Hapur | 2 | 47,391,736 | 45,106,490 |
| E Kufizuar | 4 | 829,077,959 | 787,769,830 |
| Negocim pa shpallje | 1 | 3,000,000 | 2,500,000 |
| Kërkesë për propozim | 4 | 4,355,648 | 3,603,012 |
| E hapur e Thjeshtuar | 1 | 4,250,000 | 4,176,030 |
| Blerje e vogël | 12 | 6,320,374 | 5,664,506 |

*Burimi: Hartuar nga grupi i KLSH, sipas të dhënave të regjistrave të subjektit Bashkia Mirditë*

Në lidhje me këtë pikë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se;
Për periudhën objekt auditimi nga 01.01.2021-31.12.2021, Bashkia Mirditë ka realizuar 25 procedura prokurimi (tender) me vlerë të fondit limit (FL) në shumën 896,323,917 lekë dhe me vlerë kontrate të lidhur në shumën 848,819,866 ose 94.6 % e FL.
Për vitin 2021 u audituan me zgjedhje procedurat e mëposhtme:

**7.** Procedura e prokurimit me objekt **"Blerje Automjet teknologjik (kamion) për grumbullimin dhe konteniere (kosha) të përshtatshëm për grumbullimin e mbeturinave për Bashkinë Mirditë"**

| |
|---|
| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "*BlerjeAutomjet teknologjik (kamion) për grumbullimin dhe konteniere (kosha) të përshtatshëm për grumbullimin e mbeturinave për Bashkinë Mirditë* **"** |

| | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi nr.128<br>Nr. 1980/1,prot datë 19.05.2021<br>Lloji i Procedurës –"E hapur, Mallra"REF-96095-05-20-2021 | 2. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Njësia e Prokurimit<br>1. **M.D**, (Personi përgjegjës), Jurist<br>2. **N.N**, (Prgj.Info/kulla)<br>3. **A.P**, Ekonomiste | 3. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhër nr. 129, Nr.1980/2, pro datë 19.05.2021<br>**M.P,** Kryetar<br>**A.D** Inxhiniere<br>**T.P** Ekonomist |
| 4. Fondi Limit (pa TVSh)<br>9,926,100 lekë. | 5. Oferta fituese (pa TVSh) "T..." shpk<br>me ofertë 9,888,900 lekë pa tvsh,<br>sipas kontratës nr.12 me nr. 1980/8 prot, dt. 14.07.2021 me afat 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës. | 6. Diferenca me fondin limit (pa v TVSH) 37,200 lekë ose 0.3% |
| 7. Data e hapjes së tenderit<br>Datë 11.06.2021 | 8. Burimi Financimit;<br>Ambasada Japoneze | 9. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 2 OE<br>b) S'kualifikuar 1 OE,<br>c) Kualifikuar 1 OE |
| 10. Ankimime; ***Nuk ka ankesë.*** | 11. Lidhja e kontratës nr.12 Prot, nr.1980/8 datë 14.07.2021 | 12. Afati i kontratës- 30 ditë nga lidhja e kontratës. |
| 13. Vlera e kontratës;<br>11,866,680 (Njëmbëdhjetë milion e tetëqint e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqint e tetëdhjetë) lekë me (tvsh). | | 14. Titullari i AK, |

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**
Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 9,926,100 lekë pa TVSH, e cila do të financohet nga Ambasada Japoneze.

**<u>Situata 1.</u>**
Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit dhe plotësimit të kushteve nga ana e OE.
-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për miratimin e kriteret eveçanta për kualifikim të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit, më datë 20.05.2021 është mbajtur procesverbal nr.2 pa nr.prot.

**<u>Mbi përllogaritjen e fondit limit.</u>**
**<u>Nuk dokumentohet kryerja e këtij procesi;</u>** veprim jo në përputhje me: VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar Neni 13.
**Titulli i Gjetjes:** Moszbatim i legjislacionit në fuqi mbi Prokurimin Publik.
**Situata:** Nga auditimi i kësaj procedurë është konstatuar se: Nga NJP, fondi Limit nuk është bazuar në kërkesat për nevoja nga sektorët sipas, VKM 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar, neni 13 Studimi paraprak i tregut
Kriteri: Legjislacioni në fuqi për Prokurimin Publik, kryesisht neni 13 i VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar".
Impakti : Ndikim në koston financiare të investimeve, pa garantuar procesin përfundimtar të objektit për të cilin kryhet procedura e prokuruar.
Shkaku: Mos përmbushja e kërkesave të ligjit për prokurimin publik dhe akteve nënligjore.
Rëndësia : I lartë.
Rekomandojmë: Autoriteti/enti kontraktor, përpara se të nisë një procedurë prokurimi për blerje mallrash të ngarkojë me detyrë për studimin e tregut, një ose disa persona, që mund të jenë një grup pune i ngritur çdo fillim viti, ose rast pas rasti. Të studiojë tregun, me qëllim që të përgatisë prokurimin.
*Sa më sipër për periudhën nën auditim ngarkohet me përgjegjësi, z. N.D në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe njësia e prokurimit e përbërë nga: zj. M. D., (Personi përgjegjës), J. , z.J., (Prgj.Info/kulla) dhe zj.A. P., Ekonomiste.*

**Hapja e Tenderit.**

Mbi procedurën e hapjes së tenderit është mbajtur proces verbal Nr.3 datë 11.06.2021 nga personi i autorizuar për procedimin në sistem, zj.M. D.

**Mbi Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.**

Janë kërkuar kushtet për plotësim nga secili ofertues me qëllim kualifikimin dhe vlerësimin e tyre në procedurë, si mëposhtë:

**1.** Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin e Ofertës, sipas Shtojcës 1 ose Shtojcës 2 (në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburante, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje);

b. Deklaratë për paraqitje oferte të pavaruar sipas Shtojcës 2/1;

c. Sigurimine ofertës, (nëseështëe zbatueshme) sipas Shtojcës 4;

ç. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 6;

d. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;

dh. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 8/1;

e. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë**:

**2.1. Kapaciteti ligjor/profesionali operatorëve ekonomikë:**

Operatoret ekonomik pjesemarres ne këtë procedurë prokurimi, duhet që të plotësojnë kapacitetet ligjore, teknike dhe profesionale per kryerjen e ketij prokurimi.

Operatori ekonomik duhet të ketë pjesë të veprimtarisë seë subjektit të tij, të regjistruar prane QKB-s, shitjen e mjeteve.

***OE kanë paraqitur me anë të Ekstraktit të lëshuar objektin e veprimtarisë dhe që përputhet me kërkesat e mësipërme.***

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

-Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore per tre vitet 2018, 2019 dhe 2020 me një vlere jo më të ulët se fondi limit që prokurohet.

**Ka paraqitur vetem xhiron vjetore te vitit 2020.**

-Kopje e vërtetuar te bilanceve të dy viteve të fundit (2019 dhe 2020) të paraqitur pranë Administratës Tatimore të konfirmuar nga ky autoritet.

K**a paraqitur dorëzimin pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (DRTT) vetëm bilancin e vitit 2020, konfirmuar nga DRT me shkresë nr. 8304, Prot datë 19.04.2021.**

-Vertetim te lëshuar nga autoritetet lokale, për shlyerjen e taksave vendore te parashikuara nga Pushteti Vendor per vitin 2020.

**Ka paraqitur vërtetim për likujdimin e taksave vendore pranë Bashkisë Tiranë, me shkresë nr T-3696/1Prot, datë 28.04.2021.**

**2.3 Kapaciteti teknik:**

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

a) Autoriteti Kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, kontrata furnizimi ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**-Nga dokumentet e dorëzuar në SPE, rezulton që ky kriter është i përmbushur.**

c) Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin nje deklarate nga administratori i shoqerise, qe mjeti eshte ne gjendje te rregullt pune dhe sipas gjithe specifikimeve teknike te kërkuara. Operatoret Ekonomik duhet te paraqesin nje deklarate ku merr persiper një garanci 2-vjeçare për mjetin objekt kontrate.
**-Nga dokumentet e dorëzuar në SPE, rezulton që ky kriter është i përmbushur.**

Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalog për mjetin objekt i këtij prokurimi, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara. Në katalogun përkatës të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike.
**Ka paraqitur katalog vetëm OE konkurent, T... shpk.**
**Operatori ekonomik, L...nuk ka patraqitur katalog për mjetin.**
Per mjetin objekt prokurimi, operatori ekonomik duhet të paraqes nje deklarate ku te shprehet qe ne rast te shpalljes fituese te ofertes se tij, mer persiper te gjitha pagesat doganore ne Republiken e Shqiperise.
Automjeti duhet te jete i certifikuar nga prodhuesi.

**<u>Mbi vlerësimin e ofertave</u>**
AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E Hapur". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen, shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave, mbajtur më datë 28.06.2021. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, kanë paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 2 OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës pa tvsh |
|---|---|---|
| 1 | | 9,799,500 |
| 2 | | 9,888,900 |

Burimi i të dhënave: SPEPunoi: KLSH

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, KVO ka konstatuar se; *OE* LEKA-2007ka mungesa në dokumentacion, sipas kërkesës në pikën **2.3 Kapaciteti Teknik,** germa a) të kushteve të vecanta të kualifikimit (KVK), ku është kërkuar ; Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese katalog për mjetin objekt i këtij prokurimi, me qëllim përmbushjen e specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara. Në katalogun përkatës të jetë specifikuar produkti që është paraqitur në ofertë dhe specifikimet teknike. Nuk ka arritur të sjellë katalogun për automjetin dhe paisjet (koshat e mbeturinave) të kërkuara në DST.Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, KVO ka vlerësuarse, oferta e paraqitur nga ***"T..." Shpk*** me një vlerë të përgjithshme prej ***9,888,900*** *Lekë (Nëntë milion e tetëqind tetëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind) lekë pa Tvsh,* është identifikuar si oferta e suksesshme.
**<u>Konkluzione:</u>**
Grupi i auditimit sa më sipër konstaton se:
**1.** Lidhur me vlerësimin dhe shpalljen e pavlefshme ofertën e paraqitur të operatorit ekonomik (OE) L..., KVO ka vlerësuar drejt dhe në përputhje me kërkesat e LPP dhe akteve nënligjore për zbatim.
**2.** Në lidhje me vlerësimin dhe shpalljen si ofertë të suksesshme të Operatorit Ekonomik (OE) T. SHPK, është konstatuar se; KVO ka shpallur si ofertë të suksesshme në tender në kundërshtim me kërkesat e ligjore.
**Konkluzion i gjetjes.**
Në kërkesat e pikës **<u>2.2. të KVK, Kapaciteti ekonomik dhe financiar është kërkuar:</u>**
-Vërtetim nga Administrata Tatimore për xhiron mesatare vjetore për tre vitet 2018, 2019 dhe 2020 me një vlerë jo më të ulët se fondi limit që prokurohet.

**1.*OE,* TIMAC SHPK ka paraqitur vërtetim vetëm për xhiron vjetore te vitit 2020.**
-Kopje e vertetuar te bilanceve te dy viteve te fundit (2019 dhe 2020) të paraqitur pranë Administrates Tatimore te konfirmuar nga ky autoritet.
***2. OE****, Ka paraqitur dorëzimin pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (DRTT) <u>vetëm 1 (një) bilanc të vitit 2020,</u> konfirmuar nga DRT me shkresë nr. 8304, Prot datë 19.04.2021.*
**Mungon bilanci i vitit 2019.**

**3.** Grupi i auditimit ka konstatuar se Administratori i shoqërisë T. SHPK me Nipt, është **zj. A.P**, e cila ligjërisht është emëruar me datë 24.05.2021 sipas të dhënave të QKB, Numri i ceshtjes: CN-714276-06-21 ku paraqiten ndryshimet e ndodhura në T. Shpk. Arsyet e hapjes se ceshtjes: Miratimi i largimit te zj.M. K. nga detyra e administratorit dhe emërimin e zj. A.P. Nga data "24/05/2021 deri në datën 24/05/2026.
Referuar Buletinit të Njoftimeve Publike Nr. 7 Datë 18.01.2021 të APP është konstatuar se: **Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti "T." shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, ,** me seli në Tiranë, përjashtohet – 18 (tetëmbedhjete) muaj (duke filluar nga data 12.01.2021-12.07.2022). Nga të dhënat e marra nga ekstrakti e kësaj historik i kësaj shoqërie ka rezultuar se: zj. A.P është administrator i kësaj shoqërie, referuar;
Numri i ceshtjes: CN-776689-08-21. Arsyet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i vendimit, datë 25.08.2021 për riemërimin e administratorit A.P.
Kane ndodhur ndryshimet e meposhtme tek administratoret:
Kane ndryshuar të dhenat per administratorin: ("A.P."),
Nga Data ishte ("26/08/2016") u be ("26/08/2021").
Kane ndryshuar të dhenat per administratorin: ("A.P."),
Kohëzgjatja ishte ("26/08/2021") u be ("26/08/2026")
Sa më sipër KVO, ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e vecanta të kualifikimit por dhe në kundërshtim me: Ligj.Nr 162, datë 23.12.2020. **Neni.76, pika 3, gërma g ku citohet:**
Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:
**g)** *<u>Operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</u>*
<u>Për veprimet dhe mosveprime, të konstatuara sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO) z. M. P., zj. A. D.dhe z. T.P.</u>

**<u>Gjetje.2</u>**
**Situata:** ***Vlerësimi i ofertave në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik.***
**1.** Në lidhje me vlerësimin dhe shpalljen si ofertë të suksesshme të Operatorit Ekonomik (OE) TIMAC SHPK, është konstatuar se; KVO ka shpallur si ofertë të suksesshme në tender në kundërshtim me kërkesat e ligjore, argumentuar si më poshtë:
**- *OE,* T… SHPK ka paraqitur vërtetim vetëm për xhiron vjetore te vitit 2020.**
*- **OE**, Ka paraqitur dorëzimin pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (DRTT) <u>vetëm 1 (një) bilanctë vitit 2020,</u> konfirmuar nga DRT me shkresë nr. 8304, Prot datë 19.04.2021.*
***- Mungon bilanci i vitit 2019.***
- Referuar Buletinit të Njoftimeve Publike Nr. 7 Datë 18.01.2021 të APP është konstatuar se: Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti

"T…" shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Tiranë, përjashtohet – 18 (tetëmbedhjete) muaj (duke filluar nga data 12.01.2021-12.07.2022). Nga të dhënat e marra nga ekstrakti e këaj historik i kësaj shoqërie ka rezultuar se: zj. A. P. është administrator i kësaj shoqërie

- Administratori i shoqërisë T… SHPK, zj. A. P., e cila ligjërisht është emëruar me datë 24.05.2021 sipas të dhënave të QKB, Numri i ceshtjes: CN-714276-06-21 ku paraqiten ndryshimet e ndodhura në T… Shpk. Arsyet e hapjes se ceshtjes: Miratimi i largimit te zj.M. K. nga detyra e administratorit dhe emërimin e zj. A. P. Nga data "24/05/2021 deri në datën 24/05/2026.

Referuar Buletinit të Njoftimeve Publike Nr. 7 Datë 18.01.2021 të APP është konstatuar se: Operatori ekonomik i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit me emër subjekti "T…" shpk, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Tiranë, përjashtohet – 18 (tetëmbëdhjetë) muaj, (duke filluar nga data 12.01.2021-12.07.2022). Nga të dhënat e marra nga ekstrakti e kësaj historik i kësaj shoqërie ka rezultuar se: zj.Arjeta Puca është poashtu administrator i kësaj shoqërie.

Në Ligjin Nr 162, datë 23.12.2020, Neni.76, pika 3, gërma g citohet:

*Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse është në një nga situatat e mëposhtme:*

…

**g)** *Operatori ekonomik ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi*. Argumentuar sa më sipër KVO duhet të skualifikonte nga gara edhe *OE* TIMAC shpk e për pasojë të propozonte fillimin e një procedure të re.

**Kriteri:** Ligji 162/2020 në fuqi për Prokurimin Publik, kryesisht Neni.76, pika 3, gërma g.
**Ndikimi/efekti**: Vlerësimi dhe shpallja fitues në kundërshtim me parimet dhe aktet ligjore e nënligjore të Prokurimit Publik.
**Shkaku:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të Prokurimit Publik.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandim**: Autoriteti Kontraktor, të marrë masa që zyrtarët e prokurimeve të azhornohen vazhdimisht me vendimet e APP, për tu informuar mbi rastet e përjashtimeve nga procedurat e tenderave të Operatorëve Ekonomikë për shkelje të ndryshme në Prokurimet Publike, bazuar në të gjithë përcaktimet ligjore dhe konseguencat që sjellin rastet e konstatuara. Operatorët ekonomikë të cilët gjenden në këto kushte, nuk duhet të kualifikohen apo të shpallen fitues në tendera publik deri në afatin e përcaktuar nga APP, për sa kohë nuk ka pezullim vendimi nga organet gjyqësore.

## 8. Procedura e prokurimit me objekt "Rehabilitim I rrjetit ujitës Malaj-Tarazh", Bashkia Mirditë

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rehabilitim I rrjetitujitësMalaj-Tarazh faza 3", Bashkia Mirditë</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 52, datë 19.02.2021</td><td rowspan="2">3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Urdhër 52, datë 19.02.2021<br>Njësia e Prokurimit<br>1. M.D, (Personi përgjegjës), Jurist<br>2. R.B, Inxhinier<br>3. A.P, Ekonomiste</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhër nr. 53, datë 19.02.2021<br>M.P, Kryetar<br>A.D, Inxhiniere<br>T.P Ekonomist</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –"E hapur, punë"<br>Nr. REF-88063, datë 23.02.2021</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| 5. Fondi Limit (pa TVSh)<br>37,465,636 lekë. | 6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE "L…"…" shpk<br>me ofertë 35,217,590 lekë pa tvsh,<br>sipas kontratës nr.1 me nr. 276/4 prot, dt. 08.06.2021<br>me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës. | 7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH)<br>2,248,046 lekë ose 7.7 % |
| 8. Data e hapjes së tenderit<br>Datë 06.04.2021 | 9. Burimi Financimit (grant)<br>Programi i Zhvillimit Rajonal Shqipëri (PZHRSH) | 10. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar2 OE/ BOE,<br>c) Kualifikuar 2 OE/BOE |
| 11. Ankimime; ***Nuk ka ankesë.*** | 12. Përgjigje Ankesës nuk ka | 13. Përgjigje Ankesës nuk ka |

**a-Nga auditimi i procedures së tenderit ka rezultuar:**
Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 37,465,636 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Programi i Zhvillimit Rajonal Shqipëri (PZHSH).

**b-Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike.**
-Projekti i zbatimit, specifikimet teknike dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëritë "A…" ShPK & "E…" ShPK dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. N. D., në vitin 2020.

**<u>Situata 1.</u>**
Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e përgjithshme e të veçanta për kualifikim të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit, është mbajtur procesverbal pa nr prot, datë 22.02.2021, veprim në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës *"Hartimi i kërkesave të veçanta për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret e vlerësimit (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit.*
*Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit".*

**c- Mbi hartimin e Kriteret e Veçanta të Kualifikimit.**
Në kuadër të zhvillimit të procedurës së prokurimit me objekt ***"Rehabilitim i kanalit ujites Malaj-Tarazh (Faza 3)"****, Bashkia Mirdite, me fond limit* **37'465'636 lekë** (tridhjetë e shtatë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqint e tridhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH. Njësia e Prokurimit, më datë 24.03.2021 mbi bazën e rekomandimeve te APP-së në lidhje me dokumentet e tenderit, ka kryer ndryshimin e disa prej kritereve. Në mbështetje të nenit 63 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*" i ndryshuar, VKM-së nr.914, datë 29.12.2014, "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*" e ndryshuar, janë bërë ndryshime në shtojcën **12**, me ndryshimet dhe sqarimet perkatese, të cilat janë ngarkuar në SPE por nuk janë njoftuar OE ofertues dhe nuk është mbajtur proces verbal për këto ndryshime. Ndryshimet janë reflektuar vetëm në Raportin Përmbledhës.

**Titulli i gjetjes:** Kriteret e kualifikimit për pjesmarrjen e operatorëve ekonomikë të pa argumentuara shkresërisht.
**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Rehabilitim i rrjetit ujitës Malaj-Tarazh", Bashkia Mirditë Faza 3", me fond limit në shumën 37,465,636 lekë pa TVSh dhe me vlerë kontrate në shumën 35,217,590 lekë pa tvsh, me OE fitues "L…" sha. rezulton se nga Bashkia Mirditë, Njësia e hartimit të kritereve të kualifikimit, miratuar nga titullari i AK, rezulton se në mënyrë të paargumentuar dhe justifikuar, janë hartuar dhe miratuar kritere jo në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, duke ulur ndjeshëm integritetin dhe besueshmërinë e procedurës së prokurimit përmes vendosjes së kritereve për një OE thuasje të paracaktuar. Këto kritere nuk duhet të vendosen pasi referuar LPP vendosja e tyre, *ndikon në një ngushtim të konkurrencës së lirë, duke kufizuar pjesëmarrjen,* dhe mostrajtim të barabartë ndërmjet Operatorëve Ekonomikë. Këto veprime *bien ndesh me qëllimin dhe parimet e kuadrit ligjor për prokurimin publik.* Referuar grafikut të punimeve, specifikimeve teknike të projektit dhe relacionit teknik, *nuk shpjegohet në asnjë moment përllogaritja e orëve të punës apo argumentimi i stafit të kërkuar se si rezultat i kujt llogaritjeve (analize) është kërkuar një numër i tillë punonjësish.*
**-Lidhja e kontratës.**
Është lidhur kontrata nr. 1 me shkresë nr. 276/4 datë 08.06.2021 me objekt "Rehabilitimi i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (FAZA 3) me palë kontraktuese Bashkia Mirditë, e përfaqësuar ligjërisht nga Kryetari i Bashkisë z. N. D. në cilësinë e Autoriteti Kontraktor (AK). Afati i së cilës është përcaktuar 365 ditë kalendarike ose 12 muaj nga momenti i lidhjes.
Kontrata e mësipërme është amenduar me shkresë nr. 276/9 datë 08.10.2021 nga AK z.N.D.
Në nenin 1, të kontratës së amenduar, qëllimi ka qenë respektimi i i afatit të kontratës së grantit Nr.07 datë 27.11.2020 e lidhur ndërmjet Fondacionit "Programi i Zhvillimit Rajonal në Shqipëri" (PZHSH) dhe Bashkisë Mirditë për nevoja të kësaj bashkie.
Në nenin 2 të kësaj kontrate objekt amendimi ka qenë ndryshimi i afatit të kontratës nga ku është ulur afati i realizimit të kontratës nga 12 muaj dhe është bërë 8 muaj, bazuar në kërkesat e parashtruara në Nenin 16, nënpika 16.2 të kontratës ndërmjet PZHRSH dhe Bashkisë Mirditë ku citohet se: Në asnjë rast, shtyrja e periudhës së zbatimit të projektit nuk mund të jetë më vonë se data 28.02.2022. Përsa sipër, marrë parasysh faktin se kjo kontratë përkon me një periudhë në të cilën autoriteti kontraktor dhe hartuesit e dokumenteve te tenderit dhe te kushteve te vecanta te kualifikimit, duhet të kenë pasur dijeni për afatet dhe kërkesat e kontratës për zbatim, kanë llogaritur afate në tejkalim të zbatueshmërisë. Amendimi i kontratës është kryer në një periudhë prej 4 muaj më pas nga lidhja e saj. Kjo tregon se kushtet dhe kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kanë **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.**
**Kriteri:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 1, "Objekti dhe qëllimi", neni 2 "Parimet e përzgjedhjeje", neni 20, "Mosdiskriminimi".
-VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", ndryshuar, neni 26, "Kontratat për punë publike", nenin 46 I LPP-së, "Kriteret e veçanta të kualifikimit".
neni 61, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit".
**Ndikimi/Efekti:** Kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm në tender.
**Shkaku:** Vendosja e kritereve në mospërputhje me kuadrin ligjor të PP.
**Rëndësia**: I lartë.
**Rekomandimi:** Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për

argumentimin e të gjitha kritereve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.
*Lidhur me mangësitë e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi Titullari i AK z. N. D., anëtarët e NJP z .R.B., Inxhinier, zj. M. D. në cilësinë e juristes dhe personit përgjegjës për administrimin dhe pregatitjen e dokumenteve të tenderit.*

**Në lidhje me zhvillimin e procedurës dhe vlerësimin e ofertave nga KVO.**
AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E Hapur". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 12.05.2021. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës pa tvsh |
|---|---|---|
| 1 | | 34,548,266 |
| 2 | | 35,217,590 |
| 3 | | 31,785,592 |
| 4 | | 36,491,284 |

*Burimi i të dhënave: SPE Punoi: KLSH*

**Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**
***1. "S…" shpk,***
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
Nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave konstatohet se ky operator ekonomik nuk plotëson kriteret vendosura në DST dhe konkretisht:
- Mjeti me targë …i ka mbaruar kolaudimi qe me date 26.12.2020.
- Mjeti me targë … Autopompë betoni i ka mbaruar kolaudimi që me datë 23.12.2020.
- Mjeti me targë … nuk është shoqëruar me foto.
- Saldatori i paraqitur si specialist nuk është i kualifikuar me dëshmi kualifikimi sipas standartit UNI EN 13067:2013 të kërkuar në DST.
- Inxhinierët G. M., E. S. dhe V. T. janë te angazhuar në kontrata te tjera sipas deklarates së vetë subjektit, cka bie në kundershtim me deklaraten e paraqitur në tender që inxhiniere Engjellushe Sako, e paraqitur si Drejtuese teknike në objekt është e pa angazhuar.
- Manovratorët: A. Z., F. L., K.M. nuk janë të pajisur me IQT, pra nuk ploteson kerkesën Nr.10 të DST për manovratorët.
- Shoqeria nuk ka specialist ekspert mjedisi të pajisur me licensë kodi III.2.A sipas kerkeses Nr.5 te DST.
- Shoqëria nuk ka specialist të pajisur me certifikatë për sigurimin dhe kontrollin e cilësisë sipas ISO 9001/2015 të kerkuar në pikën nr.5 te DST.

Shoqëria nuk plotëson pikën 13/a te DST. Nuk ka licensë II.2.B për grumbullim, transport, material dhe mbetje të tjera jo te rrezikshme si llumrat etj.
**2."A…",** shpk & U…" shpk.
Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:
Nga ana e Komisionit të Vleresimit të Ofertave konstatohet se ky bashkim operatorësh ekonomik nuk plotëson kriteret vendosura në DST dhe konkretisht:
OE, "U…"shpk ka këto mungesa në dokumentacion:
- Kamioni MT 3419 A mungon certificate e pronësisë.
- Ne punen e ngjashme te paraqitur me objekt "Rehabilitim I Argjinatures se lumit Buna Pentar, Luarez Shkoder" realizuar ne bashkepunim, dokumentacioni ndermjet

operatoreve “V…” shpk, “E…” shpk dhe “V…” shpk, mungon Prokura e Posacme e paraqitur në fazën e tenderimit.

- Mungon deshmia e kualifikimit profesional per 2 (dy) punonjes, kur ne DST është kerkuar:
- OE, “A…” shpk ka këto mungesa në dokumentacion:
- Mjeti autobetoniere dhe nje fadrome me goma janë paraqitur si mjete te patarguara e per rrjedhoje mungojne dokumentacioni teknik i kerkuar si dhe fadromes se dyte te paraqitur … i ka skaduar siguracioni.
- Shoqeria “A…” shpk ka paraqitur pajisjen teknike “kompresor” per te cilen nuk disponon fature tatimore apo doganore.
- Shoqeria “AE…” shpk ka paraqitur autobetonieret e marra me qira nga Shoqeria “D…” shpk me datë 03.04.2021 me Nr. 2058 Rep dhe Nr. 462 Kol te cilat nuk shoqerohen me foto.
- Inxhinieri I paraqitur si Drejtues Teknik ne Licence, Pergjegjes per mbrojtjen e shendetit ne pune nuk ka IQT.
- Specialistit hidraulik i ka skaduar kontrata e punes si dhe nuk ka IQT. Po keshtu dy specialistet karpentier nuk kane IQT. Teknikut te Ndertimit i ka perfunduar kontrata e punes.
- Asnjeri nga BOE pjesëmarrës në Joint-Venture nuk ka paraqitur Licence III.2.B (Grumbullim, magazinim dhe transport I mbetjeve jo të rrezikshme), të lëshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit.

- BOE ka krijuar gabim bashkëpunimin ndermjet tyre. Kjo për arsye sepse në DST kerkohen 80 punonjes për periudhen Korrik 2020-Shkurt 2021, ndërsa “A…” sh.p.k ka mesatarisht 30.5 punonjës për këtë periudhë dhe maksimalisht mund të marre 38.125% në joint-venture nderkohë qe ka marrë 60% duke mos plotesuar kështu kapacitetin ne burime njerëzore të kërkuara ne tender per permbushjen e objektit.

- Asnjeri nga BOE nuk ka paraqitur lejen III.I.A për Impiantin e Betonit të kërkuar në DST.

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës pa nr. prot, datë 21.05.2021, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. N. D.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se “BOE “A…” Shpk & “U…” Shpk dhe “S… Shpk kanë mungesa në dokumentacionin e paraqitur në SPE dhe janë skualifikuar me të drejtë nga KVO.

**9. <u>Procedura</u>: <u>Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të perbashketa në ndërtesa (pallate), rikonstruksionit të objekteve arsimore dhe publike si dhe përgatitja e shesheve të ndërtimit per banesat individuale”, Bashkia Mirditë.</u>**

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Punime Rindertimi ne “ Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të perbashketa në ndërtesa (pallate), rikonstruksionit të objekteve arsimore dhe publike si dhe përgatitja e shesheve të ndërtimit per banesat individuale”, Bashkia Mirditë</td></tr>
<tr><td>1. Lloji i Procedurës së Prokurimit<br>“I kufizuar, marrëveshje kuadër”<br>Urdhri nr 164, nr.2531 Prot, datë 25.06.2021, REF-99877-07-01-2021</td><td>2 Njësia e Prokurimit<br>M.D<br>A.P<br>B.D</td><td>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhri nr 165, nr.2531/1 prot,datë 25.06.2021<br>M.P<br>T.P<br>A.D<br>R.B<br>M.M</td></tr>
</table>

| | | |
|---|---|---|
| **4. Fondi Limit (pa tvsh)**<br>623,224,034 lekë | **5. Ofertat fituese (pa tvsh)**<br>4 OE të kualifikuara për marrëveshjen kuadër | **5.1. Oferta fituese e 4objekteve**<br>**603,767,976** lekë<br>-Pallatet 361,731,224 lekë<br>-Obj. Pub.103,177,350 lekë<br>-Ob. Arsim 97,860,882 lekë<br>-Prishja obj.40,998,520 lekë |
| | | **5.2. Diferenca nga fondi limit**<br>19,456,058 lekë |
| **6/1 Data e hapjes së tenderit**<br>Data 20.07.2021 | **7. Burimi Financimit**<br>Buxheti i shtetit | **8. Kontrata**<br>-Pallatet nr.2531/13 prot,dt 07.09.2021<br>-Obj.Pub. nr.3976 prot, dt.13.10.2021<br>-Obj.Arsimore nr.3974 prot, dt.13.10.2021<br>-Prishja obj. Nr.3510/12 prot, dt.22.09.2021 |
| **6/2 Kohezgjatja e kontrates, (marrveshjes kuadër) 18** muaj | | |

***A. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.***

-Rindërtimi i objekteve arsimore do të realizohet sipas VKM-Nr.131, date 03.03.2021, Për "Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit ose riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkitë Kavajë dhe Mirditë", VKM Nr.281, date 12.05.2021 Per "Përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit dhe të riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallat), në bashkinë Mirditë", VKM Nr.200, date 25.03.2021,Per "Përdorimin e fondit të rindërtimit përf inancimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në bashkitë Mirditë dhe Kamzë dhe caktimin e tyre si njësi zbatuese", VKM Nr.238, date 14.04.2021 per "Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të 3 (tre) objekteve në bashkinë Mirditë dhe caktimin e bashkisë Mirditë si njësi zbatuese", VKM Nr.280, date 12.05.2021, për "Përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e përgatitjes së shesheve të ndërtimit, në bashkinë Mirditë".

-Është miratuar në Këshillin Bashkiak me Vendim nr.47 datë 21.04.2021, lista e mjediseve te përbashkëta, në ndërtesa kolektive (pallate) në qytetet Rrëshen dhe Rubik, Bashkia Mirditë përfituese të grandit për rikonstruksion.

Bazuar korrespondencave midis Institutit të Ndërtimit dhe Bashkisë Mirditë, nëpërmjet shkresës nr.505/1 prot, date 23.03.2021 është bërë konfirmimi i akt konstatimeve nga ana e Institutit të ndertimit, ku është përcaktuar lista e objekteve të cilët janë për rikonstruksion.

**Objektet si më poshtë:**

*-Rikonstruksion Godina nr.3 (3KT), Shkolla 9 vjecare "Pashko Vasa" Rreshen*

*-Rikonstruksion Kopeshti I Femijëve Rreshen (godina e vjetër) 2KT.*

*-Rikonstruksion Kopshti I fëmijëve me aftesi ndryshe (Ish godina e SHIK) 3KT, Rrëshen*

*-Rikonstruksion ish/Godina e bashkise Rreshen 4KT*

*-Rikonstruksion Qendra Kulturore e Femijëve Rreshen (ish/kinemaja)*

*-Rikonstruksion Godina e Muzeut Historik 1KT*

*-Rikonstruksion dhe riparimi I ambjenteve të përbashketa dhe në bashkepronesi (Pallate banimi) në qytetet Rrëshen dhe Rubik.*

*-Pergatitja e shesheve për banesat individuale në Njësite Administrative.*

***b. Llogaritja e fondit limit.***

Llogaritja e fondit limit është bërë mbi bazën e sipërfaqes të rikonstruksionit dhe punimeve që do te kryhen, për të cilat janë hartuar preventivat përkatës për secilin objekt. Në total, fondi limit total është 623,224,034 lekë pa tvsh.

-Me urdhrin e prokurimit të titullarit të Bashkisë Mirditë, urdhërohet të kryhet prokurimi i përshpejtuar në kuadër të procesit të rindërtimit me objekt "*Punime Rindërtimi në " Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të perbashkëta në ndërtesa (pallate), rikonstruksionit të objekteve arsimore dhe publike si dhe përgatitja e shesheve të*

*ndërtimit per banesat individuale", Bashkia Mirditë*", në mbështje të ***nenit 42*** të Aktit normativ nr. 9 datë 16.12.2019 "*Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore*".
Me datë 24.06.2021 hartohet procesverbali i argumentimit të specifikimeve teknike dhe kritereve kualifikuese.

***c. Kriteret e veçanta te kualifikimit.***

Kriteri përzgjedhjes së fituesit (Faza e dytë) përbëhet:
*Kriteret e Vlerësimit*

| | | |
|---|---|---|
| (i) | Çmimi më i ulët | [**0 – 60 Pikë**] |
| (ii) | Koha e zbatimit të kontratës, grafiku i zbatimit | [**0 – 30 Pikë**] |
| (iii) | Cilësia | [**0 – 10 Pikë**] |

*Procedura e prokurimit eshte hedhur në sistem me datë 01.07.2021, nderkohe me date 8 korrik 2021 Koordinimi APP rekomandon AK për rishikim të kritereve të tenderit. Nga AK behet modifikimi i kritereve duke marre ne konsiderate Koordiminim dhe me date 12.07.2021 ngarkohet shtojca ne SPE me ndryshimet perkatese.*

**Është kërkuar:**
**2.3.4** Operatori Ekonomik duhet të ketë pjesë te stafit drejtues Teknik të shoqerisë:

| | |
|---|---|
| *Inxhinier Ndërtimi* | *2 (dy)* |
| *Arkitekt* | *2 (dy)* |
| *Inxhinier Elektrik* | *2 (dy)* |
| *Inxhinier Elektronik* | *2 (dy)* |
| *Inxhinier Hidroteknik* | *2 (dy)* |
| *Inxhinier Mjedisi* | *2 (dy)* |
| *Inxhinier Topograf* | *2 (dy)* |

Per stafin drejtues Teknik të mësipërm Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte:
Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare, Librezë pune. Si dhe të figurojnë në listëpagesat e kompanise per periudhen Shtator 2020 – Prill 2021.
*ËSHTË* kërkuar kriteri 2.3.4, me nderhyrjen e koordinimit te APP-së për rishimikim e kritereve, Autoriteti Kontraktor, me date 12.07.2021 ben ndryshimet e kritereve nepermjet shtojces me modifikim dokumentash.

**Pika 2.3.4 *bëhet* ;**
2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te kete pjese te stafit drejtues teknik te shoqerise :

| | |
|---|---|
| *Inxhinier Ndërtimi* | *2 (dy)* |
| *Arkitekt* | 2 (dy) |
| *Inxhinier Elektrik* | 2 (dy) |
| *Inxhinier Elektronik* | *1 (një)* |
| *Inxhinier Hidroteknik* | *1 (një)* |
| *Inxhinier Mjedisi* | *1 (një)* |
| *Inxhinier Topograf-* | *1 (një)* |

Per stafin drejtues teknik te mesiperm Operatori ekonomik duhet te paraqese dokumentacionin si me poshte: Kontratë pune e vlefshme, Diploma Universitare, Libreze pune. si dhe të figurojnë ne listepagesat e kompanise per periudhen Shtator 2020 – Prill 2021.
Një punësim mesatar I të paktën **250** (dyqint e pesëdhjete) personave të siguruar për periudhen Shtator 2020 – Prill 2021. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:
**a)** Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
**b)** Listë-pagesat e punonjësve të konfirmuar nga Administrata Tatimore lidhur me nr e tyre *nuk është argumentuar saktë nga NJP vendosja e tyre, në përputhje me natyrën.*

**Është** kërkuar te pika 2.3.3, me nderhyrjen e koordinimit te APP-së pë rrishimikim e kritereve, Autoriteti Kontraktor, me date 12.07.2021 ben ndryshimet e kritereve nëpermjet shtojces me modifikim dokumentash.
**Pika 2.3.3 Bëhet;**
2.3.3 Një punësim mesatar i të paktën **200** (dyqind) personave të siguruar për periudhën Shtator 2020 – Prill 2021. Për këtë ofertuesi duhet të paraqesë:
a) Vërtetim të lëshuar nga AdministrataTatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secalin muaj;
b) Listë-pagesat e punonjësve të konfirmuar nga AdministrataTatimore.

*Përsa i përket numrit 200 të punonjësve, nga NjP, nga grupi I auditimit është bërë argumentimi i konstatimit si vijon:*
*Në dosjen e tenderit nuk ka dokument, që të vërtetojë konkretisht argumentimin teknik për numrin 200 të punonjësve. Në lidhje me këtë kriter, konstatohet se NjP ka kërkuar një numër të pa-argumentuar teknikisht punonjësish duke mos u bazuar në asnjë analizë konkrete e cila do të mund të përcaktojë numrin minimal të punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate, pretenduar sipas: pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c/ç), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".*
*Në rastin konkret, NjP i ngritur për hartimin e kritereve, duke kërkuar një numër të pabazuar dhe të paargumentuar punonjësish, vendosja e këtij kriteri eventualisht sjell kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter. Ky kriter me ndjeshmëri në konkurrencën e OE garues, është i pa-argumentuar nga grupi i punës, çka bie në kundërshtim me LPP.*
*Sa më sipër, vendosja e këtij kriteri është në kundërshtim me pikën 2, të nenit 78 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" ku theksohet: "...Në çdo rast hartimi i tyre (kriteret + dokumentet e tenderit) duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal.* Këto veprime janë në papajtueshmëri me Neni 41 të Aktit normativ nr. 9 datë 16.12.2019 "*Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore*" "*Parimet e prokurimit publik për rindërtimin*" pika b 1. Prokurimi publik për rindërtimin siguron nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë.
***Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit, me përbërje*** zj. M.D, zj. A.P dhe z. B.D.
- Në DT përcaktohet Metodologjia që do të aplikohet nga autoriteti përgjegjës në fazën e dytë:
Janë percaktuar planifikimi i kontratave marrveshje kuader, qe në fazën e dytë do të behët minikonkurs për secilin objekt më vete duke ju referuar LPP 162/2020, aktit normativ nr.9 date 16.12.2019.
- Në preventivat e punimeve të përcaktuara në DT, citohet se;
Autoriteti Kontraktor ka percaktuar/pergatitur preventivat e punimeve dhe projektet per secilin objekt dhe ka perzgjedhur llojin e procedurës së prokurimit referuar LPP-së 162/2020 neni 43"Procedure e kufizuar", VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Rregullat e Prokurimit Publik", e ndryshuar neni 39 'Këkesa të veçanta për kontratat per pune publike" pika 1. *Punet publike mund te prokurohen, a) me anë të punimeve me matje në bazë të cmimeve fikse, ne rastet kur vellimi i punimeve te specifikuara ne projekt preventiv mund te ndryshoje gjate realizimit. Në këtë rast, kontraktori eshte i detyruar te ruajë pa asnjë ndryshim çmimet per*

*njesi te percaktuara në ofertën e dorëzuar*. Neni 48 Procedurë e kufizuar si dhe aktit normativ nr. 9 datë 16.12.2019 "*Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore*".

***c. Mbi vlerësimin dhe kualifikimin e operatorëve.***

-Me nr.2531/4 prot, datë 06.08.2021 shpallet njoftimi i operatoreve ekonomik të suksesshëm për procedurën e zhvilluar me datë 20.07.2021. Nga vlerësimi në sistem kualifikohen 4 (katër) OE dhe skualifikohet 1(një) OE. Operatorët ekonomik të kualifikuar janë:
1-BOE "A…" shpk & "G. …" shpk, përfaqësuar nga OE "A…" shpk.
2-BOE "L…"sha & "…" shpk, përfaqësuar nga OE "L…" sha.
3-BOE "U…"shpk& "N…" shpk, përfaqësuarnga OE "U…" shpk.
4-OE "U…"shpk
Operatori ekonomik i skualifikuar është :
1- OE "H…"shpk,
Pas përfundimit të afateve për ankimim, që në rastin kokret nuk ka pasur ankesa, me datë 12.08.2021 miratohet nga titullari i Autoritetit Kontraktor raporti përmbledhës i procedurës. Me nr. 3122 prot. Datë 12.08.2023, nënshkruhet marrëveshja kuadër me 4 Operatorë ekonomikë, ku përcaktohen rregullat për kontratat të cilat do të lidhen përmes konkursit ndërmjet OE-ve që janë palë e marrëveshjes kuadër. Kohëzgjatja e marrëveshjes kuadër është 18 muaj.
Lista e operatorëve ekonomikë të kualifikuar në përfundim të fazës së parë të procedurës dhe palë në marreveshjen kuadër :
**1**- BOE- "A…" shpk& "G…" shpk, për faqësuar nga OE"A…" shpk, me nr.3122 Prot, datë 12.08.2021.
**2**-BOE- "L…"shpk& "…" shpk, përfaqësuar nga OE- "L…" shpk, me nr.3123 Prot, datë 12.08.2021
**3**-BOE- "U…"shpk& "N…" shpk, përfaqësuar nga OE- "U…" shpk, me shkresë nr.3149 prot, datë 13.08.2021
**4**-OE- "U…" shpk, me nr.3121 prot, datë 12.08.2021.
-Në zbatim të Urdhrit të Prokurimit Nr.164, nr.2531 Prot, datë 25.06.2021 dhe Urdhrit për ngritjen e komisionit të vlerësimi të ofertave nr. 165, nr.2531/1 Prot, datë 25.06.2021, Komisioni i Vlerësimit të oferatave (KVO) në zbatim të nenit 43 të Aktit Normativ nr.9/2019, procedoi me hapjen e dorëzimit të ofertave të paraqitur nga operatorët palë në marrëveshjet kuadër.

**Minikonkursi 1:**

- Mbi zhvillimin e procedurës së minikonkursit I (faza II) dhe vlerësimit të ofertave datë 18.08.2021, per objektin;"*Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) ne qytetin Rreshen dhe Rubik"BashkiaMirditë* në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, u është bërë ftesa për ofertë, OE të suksesshme në sistemin e prokurimeve elektronike.
-Faza II hapja e ofertave në minikonkurs. Në datën 18.08.2021 në prezencë të KVO dhe të perfaqësuesve pjesëmarrës të operatorëve, është zhvilluar procesi i hapjes e ofertave. Pas shqyrtimit te ofertave, në fazën e minikonkursit me objekt; "*Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) ne qytetin Rreshen dhe Rubik"Bashkia Mirditë,* me fond limit 372,099,500 (treqint e shtatëdhjetë e dy milion e nëntëdhjetë e nëntë mijë e peseqint) lekë pa tvsh, komisioni ka shpallur fitues OE "…shpk. Në lidhje me ketë procedurë ***nuk ka patur*** ankimime administrative.

**Minikonkursi 2:**
- Mbi zhvillimin e procedurës së minikonkursit II (faza II) dhe vlerësimit të ofertave datë 06.09.2021, per objektin; "*Prishja dhe pergatitja e shesheve të ndërtimit për banesa tindividuale në Njesite Administrative Rrëshen, Rubik, Kthellë, Fan, Kacinar, Orosh, Selite", Bashkia Mirditë* në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, u është bërë ftesa per ofertë OE të suksesshme në sistemin e prokurimeve elektronike. Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj.
**-Faza II** hapja e ofertave në minikonkurs.
Në datën 06.09.2021 në prezencë të KVO dhe të perfaqësuesve pjesëmarrë të operatorëve, u zhvillua procesi i hapjes e ofertave. Kanë qenë pjesëmarrës në fazën e minikonkursit me objekt;"*Prishja dhe pergatitja e shesheve te ndertimit per banesat individuale ne Njesite Administrative Rreshen, Rubik, Kthelle, Fan, Kacinar, Orosh, Selite", Bashkia Mirditë* me fond limit 43'687'591 Lekë (dyzet e tre million e gjashtëqint e tetëdhjetë e shtatëmijë e peseqint e nëntëdhjetë e një) Lekë pa tvsh, operatorët si më poshtë.

| **Nr** | **Operatori Ekonomik** | **Oferta** | | **Afati** | | **Cilesia** | | **Shuma** | **Klasifikimi** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Vlera (lek)** | **Pike** | **Muaj** | **Pike** | **Metodologjia** | **Pike** | **Pike** | **Renditja** |
| 1 | | 40,998,520 | 60 | 5 | 30 | **Po** | **10** | **100** | **I** |
| 2 | | 42,918,413 | 59.64 | 6 | 25 | Jo | 0 | 84.64 | III |
| 3 | | 43,072,720 | 59.36 | 6 | 25 | Po | 10 | 94.64 | II |

Pas shqyrtimit te ofertave, komisioni ka shpallur fitues OE "L.VII" sha. Në lidhje me ketë procedurë nuk ka patur ankimime administrative.

**Minikonkursi 3:**
- Mbi zhvillimin e procedurës së minikonkursit III (faza II) dhe vlerësimit të ofertave datë 15.09.2021, per objektin; "*Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen", Bashkia Mirditë* në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, ju është bëre ftesa për ofertë OE të suksesshme në sistemin e prokurimeve elektronike. Kohëzgjatja e kontrates: **14 muaj**.
-Faza II hapja e ofertave në minikonkurs.
Në datën 06.09.2021 në prezencë të KVO dhe të perfaqësuesve pjesëmarrës të operatorëve, është zhvilluar procesi i hapjes e ofertave. Kanë qenë pjesëmarrës në fazen e minikonkursit me objekt; *Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen", Bashkia Mirditë* me fond limit 100,925,131 (njeqint milion e nëntëqint e njëzet e pesë mijë e njqint e tridhjetë e një) lekë pa TVSH, operatorët si më poshtë.

| **Nr** | **Operatori Ekonomik** | **Oferta** | | **Afati** | | **Cilesia** | | **Shuma** | **Klasifikimi** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Vlera (lek)** | **Pike** | **Muaj** | **Pike** | **Metodologjia** | **Pike** | **Pike** | **Renditja** |
| 1 | | 98'680'044 | 59.2 | 14 | 27.86 | Po | 10 | 97.06 | II |
| 2 | | 97'367'901 | 60 | 13 | 30 | Jo | 0 | 90 | IV |
| 3 | | **97'860'882** | **59.7** | **13+10 dite** | **29.26** | **Po** | **10** | **98.96** | **I** |
| 4 | | 99'343'490 | 58.81 | 14 | 27.86 | Po | 10 | 96.67 | III |

Pas shqyrtimit të ofertave, komisioni i vlerësimit të ofertave (KVO) ka shpallur fitues operatorin ekonomik (OE) "U…" shpk. Në lidhje me ketë procedurë nuk ka patur ankimime administrative.

**Minikonkursi 4:**
- Mbi zhvillimin e procedurës së minikonkursit IV (faza II) dhe vlerësimit të ofertave datë 17.09.2021, per objektin; "*Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen", Bashkia*

*Mirditë* në zbatim të Marrëveshjes Kuadër, ju është bërë ftesa per ofertë OE të suksesshme në datë sistemin e prokurimeve elektronike. Kohëzgjatja e kontrates: 14 muaj.
-Faza II hapja e ofertave në minikonkurs.
Në datën 17.09.2021 në prezencë të KVO dhe të perfaqësuesve pjesëmarrës të operatorëve, u zhvillua procesi i hapjes e ofertave. Kanë qenë pjesëmarrës në fazën e minikonkursit me objekt; *Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen", Bashkia Mirditë* me fond limit 106,558,881 (njeqint e gjashtë milion e pesqint e pesëdhjetë e tetëmijë e tetëqint e tetëdhjetë e një) Lekë pa TVSH, operatorët si më poshtë.

| Nr | Operatori Ekonomik | Oferta | | Afati | | Cilesia | | Shuma | Klasifikimi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Vlera (lek) | Pike | Muaj | Pike | Metodologjia | Pike | Pike | Renditja |
| 1 | | 103,964,900 | 59.55 | 14 | 24.64 | Po | 10 | 94.19 | III |
| **2** | | **103,177,350** | **60** | **11.5** | **30** | **Po** | **10** | **100** | **I** |
| 3 | | 103,246,658 | 59.96 | 13 | 26.54 | Po | 10 | 96.5 | II |
| 4 | | 105,171,710 | 58.86 | 14 | 24.64 | Po | 10 | 93.5 | IV |

Pas shqyrtimit te ofertave, komisioni ka shpallur fitues OE "A…" shpk. Në lidhje me këtë procedurë nuk ka patur ankimime administrative.
*Sa më sipër ka fituar oferta me cmimin më të favorshëm ekonomik.*

**Titulli i gjetjes**: Kriteret e kualifikimit të pa argumentuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.
**Situata:** Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "*Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashketa në ndërtesa (pallate), rikonstruksionit të objekteve arsimore dhe publike si dhe përgatitja e shesheve të ndërtimit për banesat individuale", Bashkia Mirditë* me fond limit në shumën 623,224,034 lekë pa tvsh, rezulton se: *Përsa i përket numrit 200 të punonjësve, të kërkuar për zbatimin e kontratës, në dosjen e tenderit nuk ka dokument që të vërtetojë konkretisht argumentimin teknik për numrin 200 të punonjësve. Në lidhje me këtë kriter, konstatohet se NjP ka kërkuar një numër të pa-argumentuar teknikisht punonjësish duke mos u bazuar në asnjë analizë konkrete e cila do të mund të përcaktojë numrin minimal të punonjësve të domosdoshëm, për realizimin e punimeve objekt kontrate.*
*Në rastin konkret, NjP i ngritur për hartimin e kritereve, duke kërkuar një numër të pabazuar dhe të pa-argumentuar punonjësish, vendosja e këtij kriteri eventualisht sjell kufizimin e pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm, të cilët disponojnë kapacitetin teknik dhe profesional të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës, me një numër më të ulët punonjësish se ai i vendosur në këtë kriter. Ky kriter me ndjeshmëri në konkurrencën e OE garues, është i pa-argumentuar nga grupi i punës, çka bie në kundërshtim me LPP.*
**Kriteri:** VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"*, pika 2, neni 78.
Aktit normativ nr. 9 datë 16.12.2019 "*Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore*" "*Parimet e prokurimit publik për rindërtimin*", Neni 41, pika b 1.
**Ndikimi/Efekti**: Kufizim i pjesëmarrjes së ofertuesve të mundshëm.
**Shkaku:** Vendosja e kritereve jo në përputhje me kuadrin ligjor të PP.
**Rëndësia:** I lartë.
**Rekomandimi:** Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë, të marrë masat e duhura që në procedurat e prokurimit publik të mbahen parasysh kërkesat ligjore për argumentimin e të gjitha kritereve të vendosura dhe specifikimeve teknike, të lidhura me procedurën e prokurimit, me qëllim konkurrencën e lirë dhe shmangien e kërkesave diskriminuese, ndaj operatorëve ekonomikë.

***Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit, me anëtarët si mëposhtë vijon;*** zj. M. D., zj. A. P.dhe z. B. D.

**Viti 2022**

Për vitin 2022: Bashkia Mirditë referuar regjistrit të realizimit të procedurave të prokurimit ka zhvilluar gjithsej 36 procedura prokurimi me vlerë të fondit limit 1,150,558,459 lekë pa TVSh, vlerë të kontratës 1,113,407,657 lekë pa TVSh, diferenca midis tyre prej 37,150,802 lekë pa TVSh, ose në masën 3.2 % të fondit limit pa TVSh të prokuruar, nga të cilat:

- Blerje me vlerë të vogël, 15 procedura, me fond limit në total prej 7,211,945 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 5,529,281 lekë, duke kursyer shumën prej 1,682,664 lekë;
- E hapur, 1 procedurë, me fondin limit në total prej 26,843,059 lekë pa TVSh, kontrata e lidhur pa TVSh në total prej 22,271,723 lekë, duke kursyer shumën prej 4,571,336 lekë;
- Të kufizuar (Rindërtimi), 10 procedura, me fondin limit në total prej 1,074,380,765 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 1,049,069,487 lekë, duke kursyer shumën prej 25,311,278 lekë;
- E hapur, e thjeshtuar, 10 procedura, me fondin limit në total prej 42,122,690 lekë pa TVSh, kontrata të lidhura pa TVSh në total prej 36,537,166 lekë, duke kursyer shumën prej 5,585,524 lekë;

Janë audituar tre procedura të hapur, ku ka rezultuar si më poshtë vijon:

**10. Procedura e prokurimit me objekt "Ndërtimi I Ujësjellësit qyteti Rubik (Shtesë projekti)", Bashkia Mirditë**

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Ndërtimi I Ujësjellësit qyteti Rubik (shtesë projekti)", Bashkia Mirditë, Nr. REF-30640, datë 24-05-2022.</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 163, datë 18.05.2022</td><td rowspan="2">3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Urdhër 163, datë 18.05.2022<br>Njësia e Prokurimit<br>1. M.D (Personi përgjegjës), Jurist<br>2. A.D, Inxhinier<br>3. A.P, Ekonomiste</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhër nr. 164, datë 18.05.2022<br>M.P, Kryetar<br>M.M<br>T.P</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –<br>"E hapur, punë"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)<br>26,843,059 lekë.</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "ASI-2A Co" ShPK<br>me ofertë 22,271,723 lekë pa tvsh,<br>sipas kontratës nr. 2259/5 prot, dt. 17.08.2022 me afat 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës.</td><td>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)<br>4,571,336 lekë ose 17.03 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit<br>Datë 22.06.2022</td><td>9. Burimi Financimit<br>Buxheti i Shtetit</td><td>10. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 4 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 0 BOE,<br>c) Kualifikuar 4 OE/BOE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; nuk ka ankesë.</td><td>12. Përgjigje Ankesës nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës<br>nuk ka</td></tr>
</table>

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**

Kjo procedurë është "E Hapur", me vlerë 126,838,174 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Shtetit.

**Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi**
Në dosjen e prokurimit administrohet shkresa e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës Kanalizimeve me nr. 482 prot., datë 14.02.2020, sipas të cilës është bërë ndarja e fondeve për ndërtimin, mbikëqyrjen dhe kolaudimin e objektit.

**Mbi projektpreventivin e zbatimit:**
- Projekti i zbatimit dhe preventivi i punimeve, i hedhur në Sistemin e Prokurimit Elektronik (SPE) është hartuar nga shoqëritë "A…" ShPK & "E…" ShPK në vitin 2017 dhe është miratuar nga Kryetari i Bashkisë Mirditë, z. N. D. Është caktuar afati i përfundimit të punimeve 365 ditë nga fillimi i punimeve.
Në dosjen e prokurimit administrohet Oponenca Teknike, në përputhje me Ligjin Nr. 3/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", të ndryshuar, neni 6, sipas të cilit "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve do të kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera, të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimeve, **për të gjitha: a) ndërtimet publike;** b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar, së paku, 100 milionë lekë; c) objektet me akses publik...".

**Situata 1**
Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 23.03.2020, i cili ka ndryshuar me shtojcën e modifikimeve të hedhur në SPE.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, pa datë, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, "Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit", pika 2, sipas të cilës "*2. Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*
*Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.*
*Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit*".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Është kërkuar qe operatori ekonomik të ketë të punësuar "Mjekun e shoqërisë", e vërtetuar kjo me Kontrate pune, diploma, license ushtrim profesioni, Urdhër Mjeku. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht dhe nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve, për pasojë nuk duhej vendosur në KVK.
2- Nuk janë kërkuar makineri/pajisje që janë të nevojshme për realizimin e disa zërave pune, si shtresa betoni, prishje shtrese asfaltike dhe shtresa të ndryshme joasfaltike, për të cilat duhen mjete si betoniera, prerëse asfalti, rul, shtruese asfalti, bitumatriçe, etj..

3- Është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të ketë nje punësim mesatar i të paktën 20 (njeqind e njezet) punonjës me kohë të plotë pune për një periudhë tremujore. Ky kriter nuk është i argumentuar teknikisht në Procesverbalin e hartimit të KVK.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kane **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, znj. A. D., e cila ka nënshkruar si specialist i fushës.

**Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike**

Në dosjen e prokurimit administrohet preventivi me çmime i fondit limit në vlerën 26,843,058.7 lekë pa TVSH i hartuar nga ing. A. D., por nuk administrohet relacioni me ndryshimet në objektin bazë me fond limit 126,838,174 lekë pa TVSH, si pasojë e të cilave është bërë prokurimi i këtij objekti. Ky mosveprim ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit me përbërje M. D., A. D. dhe A. P.
Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se çmimet janë vendosur sipas manualeve të miratuara të çmimeve me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

**Situata 2**

**Mbi vlerësimin e ofertave**

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur". Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, datë 22.06.2022. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës |
|---|---|---|
| 1 | | 25,180,226 |
| 2 | | 24,373,112 |
| 3 | | 23,501,974 |
| **4** | | **22,271,723** |

*Burimi i të dhënave: SPE - Punoi: KLSH*

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën pa nr. prot, datë 18.07.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. N. D.
Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se nga KVO janë kualifikuar të gjithë OE pjesëmarrë në procedurën e prokurimit.
- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues "A…" ShPK dhe krahasimi i tij me Formularin e Vetdeklarimit nr. 8, rezulton se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:
- Mungon situacioni përfundimtar në objektin e paraqitur si eksperiencë e ngjashme "Ujësjellësi i fshatit Bishqem Xhami dhe ndërtim pusi", i kërkuar në DT.
-Nuk ka paraqitur ekstraktin historik, mbi të cilin do të gjykohet se cilat janë bashkitë ku është punuar gjatë vitit 2021.

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i

ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit në datën 15.07.2022, i cili është nënshkruar nga titullari i AK z. N. D. dhe dërguar për publikim, me shkresën nr. 2259/4, datë 15.07.2022.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, KVO nuk do të kishte bërë ftesën për ofertë me këtë BOE. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 26,526,067.84 lekë pa TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së M. P., Kryetar, M. M. dhe T. P.

**Ndikimi/efekti:** Vendosja e kritereve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
**Shkaku**: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandim**: Nga ana e Bashkisë Mirditë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

## 11. Procedura e prokurimit me objekt "Blerje karburant, naftë", Bashkia Mirditë

<table>
<tr><td colspan="3">Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerje karburant, naftë", Nr. REF-20614 datë 02-24-2022</td></tr>
<tr><td>1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 27, datë 25.01.2022</td><td rowspan="2">3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Urdhër nr. 27, datë 25.01.2022<br>Njësia e Prokurimit<br>1. M.D, (Personi përgjegjës), Juriste<br>2. M. M, Juriste<br>3. K.P, Ekonomiste</td><td rowspan="2">4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhër nr. 28, datë 25.01.2022<br>M.P, Kryetar<br>A.P<br>T.P</td></tr>
<tr><td>2. Lloji i Procedurës –<br>"E hapur e thjeshtuar-mallra"</td></tr>
<tr><td>5. Fondi Limit (pa TVSh)<br>9,990,288 lekë.</td><td>6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "K." ShPK me ofertë 9,890,000 lekë pa tvsh,<br>sipas kontratës nr. 310/8 prot, dt. 15.03.2022 me afat 4 muaj nga data e lidhjes së kontratës.</td><td>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)<br>100,288 lekë ose 1 %</td></tr>
<tr><td>8. Data e hapjes së tenderit<br>Datë 08.03.2022</td><td>9. Burimi Financimit<br>Buxheti i Bashkisë Mirditë</td><td>10. Operatoret Ekonomike<br>a) Pjesëmarrës në tender 1 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 0 BOE,<br>c) Kualifikuar 1 OE/BOE</td></tr>
<tr><td>11. Ankimime; nuk ka ankesë.</td><td>12. Përgjigje Ankesës nuk ka</td><td>13. Përgjigje Ankesës<br>nuk ka</td></tr>
</table>

Burimi i të dhënave: Bashkia Mirditë
Punoi: KLSH

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**
Kjo procedurë është "E hapur e thjeshtuar ", me vlerë 9,990,288 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë Mirditë.

**Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi**
Në dosjen e prokurimit administrohen kërkesa për karburant nga sektorë të ndryshëm në varësi të institucionit.

**Situata 1**
Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 24.02.2022.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Njësia e Prokurimit është mbajtur procesverbalit pa nr prot, datë 24.02.2022, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 2, "Dokumentimi i procesit", pika 2.2, sipas të cilës "*2. Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti/enti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:*
...
*c) argumentimin e kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit;*".

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura (edhe në shtojcën nr. 1), u konstatua se kriteret e vendosura janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet.

**Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike**
Me Urdhrin nr. 50, datë 15.02.2022 të TAK, është ngritur Komisioni i Përllogaritjes së fondit limit me përbërje Z. M. Kryetar, A.Ll. dhe P. N. Anëtarë.
Në dosje administrohen tre kuponë tatimorë të marrë në datën 18.02.2022 në pikat e shpërndarjes së karburantit "K.", "K." dhe "O." me çmimet respektivë 189 lekë/lt, 191 lekë/lit dhe 192 lekë/lt. Në dosje administrohet gjithashtu një evidencë mbi furnizimet mujore me karburant të mjeteve të bashkisë, nga ku rezulton se bashkia do të furnizojë shkollat për 80 ditë me 36480 litra gjithsej, automjetet e bashkisë për 9 muaj me 17352 litra gjithse, mjetet zjarrëfikës për 12 muaj me 5400 litra gjithsej dhe mjetet e pyjores për 12 muaj me 3600 litra gjithsej. Në total do të blihen 62832 litra naftë, me çmimin 159 lekë/lt, ose 9,990,288 lekë.
Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se nuk ka asnjë kërkesë nga drejtori/sektorë të administratës për furnizim me karburant;
- janë vënë në dispozicion të Drejtorisë së Pyjeve 3600 lt karburant pa u argumentuar;
- Për gatishmërinë e zjarrfikëseve është llogaritur karburant për 24 muaj, nga 12 muaj që është e shkruar, ose 1800 litra më shumë.

Sa sipër, nga rillogaritja, fondi limit duhet të ishte 286,200 lekë më pak (1800 litra x 159 lekë/lit). Sa sipër, ngarkohet me përgjegjësi Komisioni i përllogaritjes së fondit limit.
Hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga Njësia e Prokurimit.

**Mbi vlerësimin e ofertave**
AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit "E hapur e thjeshtuar".
Është hartuar Raporti Përmbledhës i prokurimit në datën 10.03.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor (TAK) z. N. D.
Nisur nga ky Raport dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe ka marrë pjesë në këtë procedurë dhe ështëë kualifikuar nga KVO 1 OE, me ofertën e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës |
|---|---|---|
| 1 | | 9,890,000 |

*Burimi i të dhënave: SPE*
*Punoi: KLSH*

- Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues "K…" ShPK (i cili nuk është marrë me procesverbal dhe është i panumerizuar), dhe krahasimi i tij me Formularin e Vetdeklarimit nr. 8, rezulton se nuk i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:
- Është kërkuar një automjet bot, i cili rezulton të jetë marrë me qera. Në shkresat e administruara në dosjen e prokurimit, dokumentacioni për këtë automjet është fotokopje, por i pavulosur nga noteri në çdo faqe, ose në faqen lidhëse me shkresën e noterit. Shkresa lidhëse e noterit nuk është për këto dokumente, por për vërtetimin e AKSH-t. Gjithashtu, mungon Certifikata për transport mallrash e dhënë nga Njësia e Vetëeverisjes Vendore dhe Certifikata e Kontrollit Teknik nuk është letër, siç kërkohet në Dokumentet e Tenderit.

Sa sipër, kualifikimi i këtij OE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "*Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme*".

Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit në datën 10.03.2022, i cili është nënshkruar nga titullari i AK z. N. D.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Neni 93 "Sigurimi i konkurrencës", pika 2.b, sipas të cilës "*Në rast mungese të sigurimit të konkurrencës, autoriteti/enti kontraktor anulon procedurën, si më poshtë vijon:*
*a).....*
*b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme*", KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re.
Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e një kontrate me vlerë 11,868,000 lekë me TVSH me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së M. P., Kryetar, A. P. dhe T. P.

**12. Procedura e prokurimit me objekt "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), ne qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)", Bashkia Mirditë**

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), ne qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)", Nr. REF-40739 datë 09-06-2022 | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi<br>Nr. 283, datë 19.08.2022<br>2. Lloji i Procedurës –<br>"E kufizuar" | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit<br>Urdhër nr. 283, datë 19.08.2022<br>Njësia e Prokurimit<br>1. M.M, (Personi përgjegjës), Jurist<br>2. B.D, Inxhinier<br>3. A.P, Ekonomiste | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave<br>Urdhër nr. 282, datë 19.08.2022<br>M.P, Kryetar<br>M.D<br>A.D |
| 5. Fondi Limit (pa TVSh)<br>192,851,638 lekë. | 6. Oferta fituese (pa TVSh) OE "U." ShPK me ofertë 187,417,132 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 3711/13 prot, dt. 02.12.2022 me afat 10 muaj nga data e lidhjes së kontratës. | 7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)<br>5,434,506 lekë ose 2.8 % |
| 8. Data e hapjes së tenderit | 9. Burimi Financimit | 10. Operatoret Ekonomike |

| | | |
|---|---|---|
| Datë 30.09.2022 | Buxheti i Shtetit, Fondet e rindërtimit | a) Pjesëmarrës në tender 2 OE/BOE<br>b) S'kualifikuar 0 BOE,<br>c) Kualifikuar 2 OE/BOE |
| 11. Ankimime; nuk ka ankesë. | 12. Përgjigje Ankesës nuk ka | 13. Përgjigje Ankesës nuk ka |

Burimi i të dhënave: Bashkia Mirditë
Punoi: KLSH

**Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:**
Kjo procedurë është "E kufizuar ", me vlerë 192,851,638 lekë pa TVSH. Burimi i Financimit: Fonde të vëna në dispozicion nga buxheti shtetit sipas VKM Nr.490, date 21.07.2022 "Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rikonstruksionit dhe riparimit të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), në Bashkinë Mirditë"..

**Situata 1**
Mbi përcaktimin e kritereve të kualifikimit:
Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga njësia e Prokurimit nëpërmjet Procesverbalit Nr. 1, pa nr. prot, datë 06.09.2022.

- Nga verifikimi i kritereve të vendosura, u konstatua se:
1- Në pikën 2.3.3 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 10 inxhinierë të ndryshëm (2 inxhinierë ndërtimi, 2 arkitektë, inxhinier strukturist, inxhinier elektronik etj.) të jenë në licencë dhe të punësuar për tre muajt e fundit. Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet dhe nuk është e nevojshme që të gjithë inxhinierët t jenë në licencën e shoqërisë.
Në pikën 2.3.14 janë kërkuar në mënyrë të paargumentuar teknikisht 100 punëtorë,
- Është kërkuar që OE pjesëmarrës të kenë një kontratë të lidhur me nje laborator i cili te jete i akredituar nga Drejtoria e Pergjithshme e Akreditimit per kryerjen e analizave per llacet, betonet etj. Ky kriter është të paargumentuara teknikisht.
- Janë kërkuar në mënyrë të paargumentuar 4 kamionë 20-25 ton dhe një Konteiner Ndertimi Stacioner, të cilat, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet, nuk kanë nxitur konkurrencën dhe kane **krijuar mundësinë për të favorizuar operatorë ekonomikë të caktuar.** Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi në cilësinë e specialistit të fushës në Njësinë e Prokurimit, z. B. D, i cili ka nënshkruar si specialist i fushës.

**Mbi përllogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike**
Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit të përafërt, janë hartuar shoqëtia "E…", në vitin 2022. Pas këtij preventivi, për shkak të kushteve të kontratës "me çelësa në dorë", projektpreventivi i zbatimit do të hartohet nga OE fitues.
Nga verifikimi i zërave të preventivit të ofertës, rezultoi se ka zëra pune që janë në manualet e çmimeve në fuqi. Ky veprim ngarkon me përgjegjësi hartuesit e projektidesë dhe preventivit të fondit limit dhe Njësinë e Prokurimit.

**<u>Situata 2</u>**
**<u>Mbi vlerësimin e ofertave</u>**
Nga auditimi i dosjes së prokurimit, konstatohet se është përdorur procedurë "E përshpejtuar, rindërtimi" (Procedurë e përshpejtuar-Rindërtimi), Marrëveshje kuadër. Ky prokurim është kryer me dy faza, bazuar në Aktin Normativ nr. 9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", neni 42, pika 6. Në dosje administrohet procesverbali për hapjen dhe shqyrtimin e ofertave, datë 07.10.2022. Nisur nga verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës | Afati |
|---|---|---|---|
| 1 | | 187,417,132 | 10 muaj |
| 2 | | 190,608,283 | 12 muaj |

*Burimi i të dhënave: SPE*
*Punoi: KLSH*

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës, datë 10.10.2022.
Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se në fazën e parë, atë të vlerësimit të dokumentacionit teknik, janë kualifikuar të dy OE pjesëmarrës.
-Autoriteti Kontraktor, u ka bërë ftesë për paraqitjen e ofertave ekonomike, datë 18.10.2022.
Me Procesverbalin e datës 22.11.2022 është bërë minikonkursi (llogaritja e pikëzimit sipas kritereve të përcaktuara në DT).
Nga verifikimi i këtij Procesverbali, rezultoi se OE "U…" ShPK dhe "H…" ShPK janë vlerësuar përkatësisht me 100 pikë dhe 84 pikë. OE "H…" nuk ka paraqitur metodologjinë e punimeve.

Nga verifikimi në SPE dhe në formatin letër të dokumentacionit të OE fitues "U…", rezultoi se i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar me të drejtë.

**Ndikimi/efekti:** Vendosja e kritereve të kualifikimit në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.
**Shkaku**: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.
**Rëndësia:** E lartë
**Rekomandim**: Nga ana e Bashkisë Mirditë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kritereve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit.

**<u>Blerjet e vogla</u>**
Me analizë të hollësishme për blerjet e realizuara me procedurë "*Vlerë e vogël*", për secilin urdhër prokurimi dhe urdhër shpenzim në periudhën raportuese ushtrimore (*nga data 01 janar 2019 deri 31 dhjetor 2022*), periudhë objekt auditimi në lidhje me dokumentacioni autorizues dhe vërtetues bashkëlidhur procedurës së prokurimit e urdhër shpenzimit në mënyrë kronologjike u konstatua sa më poshtë;

***1. <u>Me urdhër prokurimi nr. 243, datë 26.08.2019</u>***, është kryer procedura blerje "*vlerë e vogël*" me fond limit 500,000 leke pa TVSh me objekt; "*Blerje materiale të ndryshme për lyerjen e institucioneve shkollore dhe parashkollore, bashkia Mirditë"*, në datën 27.08.2019 ora $10^{.00}$. Me urdhër të brendshëm nr. 01, datë 04.01.2019 është ngritur KBVV i përbërë nga zj. M. M., zj. E. V. dhe zj. E. P., kanë paraqitur interes me pjesëmarrje gjithsej ***21 OE***

konkurrues dhe në procesverbalin datë 27.08.2019 ka kualifikuar 13 OE, ndërsa ka skualifikuar 8 OE me argumentin se, vlera e ofertës është më e madhe se vlera limit, në përfundim pas tërheqjeve dhe mos paraqitjeve të OE, me procesverbalin datë 27.08.2019 është shpallur fituese oferta nga OE "*A.*" ShPK me vlerë oferte për ***398,000 lekë pa TVSh***. Në dokumentet vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; (*urdhër prokurimi, kërkesa për blerje artikuj, preventivi përllogaritjes së vlerës së fondit limit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, raporti përmbledhës, procesverbali me operatorët konkurrues dhe operatori ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj.*). Për këtë nuk është sjellë faturë nga OE dhe nga Drejtoria e Financës nuk ka pasur asnjë veprim.

***2. Me urdhër prokurimi nr. 148, datë 14.07.2020***, është kryer procedura blerje "*vlerë e vogël*" me fond limit 786,954 leke pa TVSh me objekt; "*Blerje materiale të ndryshme elektrike, hidraulike, vegla pune, Bashkia Mirditë"*, në datën 16.07.2020 ora 12$^{.00}$. Me urdhër të brendshëm nr. 11, datë 17.01.2020 është ngritur KBVV i përberë nga zj. M. M., zj. E. V. dhe zj. E. P., kanë paraqitur interes me pjesëmarrje gjithsej ***17 OE*** konkurrues dhe në procesverbalin datë 16.07.2020 ka kualifikuar 16 OE, ndërsa ka skualifikuar 1 OE me argumentin se, vlera e ofertës është më e madhe se vlera limit, në përfundim pas tërheqjeve dhe mos paraqitjeve të OE, me procesverbalin datë 16.07.2020 është shpallur fituese oferta nga OE "*M…*" ShPK me vlere oferte për ***748,900 lekë pa TVSh***. Në dokumentet vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; (*urdhër prokurimi, kërkesa për blerje artikuj, preventivi përllogaritjes së vlerës së fondit limit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, raporti përmbledhës, procesverbali me operatorët konkurrues dhe operatori ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj.*).

***Me Urdhër Shpenzimin nr. 889, datë 11.08.2021*** është likuiduar subjekti "*M…l*" ShPK me vlerën e kontratës ***898,680 lekë me TVSh*** për shpenzimin realizuar me procedurë "*vlerë e vogël*", bashkëlidhur së cilit janë dokumentet autorizuese sipas natyrës së shpenzimit të administruara nga Financa përfshirë; (*urdhër prokurimi; ftesa për ofertë; njoftimi fituesit; kërkesa për mallin, QKB, Kontratë, fatura tatimore e shitjes e furnitorit nr. 159, datë 18.08.2020; fletë hyrja e magazinës nr. 8-13, datë 18.08.2020 për artikujt, për fletë hyrjen nr. 8-12 mungon firma e personit përgjegjës*). Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.
1.
***3. Me urdhër prokurimi nr. 101, datë 12.04.2021***, është kryer procedura blerje "*vlerë e vogël*" me fond limit 799,940 leke pa TVSh me objekt; "Blerje buke për institucionet shkollore dhe parashkollore të Bashkisë Mirditë", në datën 13.04.2021 ora 15$^{.00}$. Me urdhër të brendshëm nr. 27, datë 02.02.2021 është ngritur KBVV i përberë nga zj. A. P., zj. E.Gj. dhe zj. D. K. kanë paraqitur interes me pjesëmarrje gjithsej ***5 OE*** konkurrues dhe në procesverbalin datë 12.08.2021 ka kualifikuar 1 OE, ndërsa ka skualifikuar 4 OE me argumentin se, OE nuk ka si objekt të veprimtarisë sipas QKB objektin e prokurimit, në përfundim me procesverbalin datë 14.04.2021, është shpallur fituese oferta nga OE "*S…*ShPK me vlere oferte për ***782,550 lekë pa tvsh***. Në dokumentet vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; (*urdhër prokurimi, kërkesa për blerje artikuj, preventivi përllogaritjes së vlerës së fondit limit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, raporti përmbledhës, procesverbali me operatorët konkurrues dhe operatori ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj.*).

Është likuiduar subjekti “S…” ShPK me vlerën e kontratës ***926,042 lekë me TVSh*** për shpenzimin realizuar me procedurë “*vlerë e vogël*”, bashkëlidhur së cilit janë dokumentet autorizuese sipas natyrës së shpenzimit të administruara nga Financa përfshirë; (*urdhër prokurimi; ftesa për ofertë; njoftimi fituesit; kërkesa për mallin, QKB, Kontratë, fatura tatimore e shitjes e furnitorit; fletë hyrja e magazinës për artikujt)*. Mungon komisioni i marrjes në dorëzim. Likuidimet e OE si më poshtë:

| Nr. | Urdhër Shpenzim | | | Faturë | | Fletë Hyrje | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Nr. | Datë | Vlerë | Nr. | Datë | Nr. | Datë |
| 1 | 1229 | 25.10.2021 | 33,588 | 141/2021 | 07.06.2021 | 18 | 30.05.2021 |
| 2 | 1230 | 25.10.2021 | 36,828 | 142/2021 | 07.06.2021 | 13 | 07.06.2021 |
| 3 | 270 | 25.02.2022 | 3,024 | 112/2021 | 02.09.2021 | 21 | 30.08.2021 |
| 4 | 271 | 25.02.2022 | 4,320 | 113/2021 | 02.09.2021 | 23 | 30.08.2021 |
| 5 | 283 | 01.03.2022 | 16,200 | 167/2021 | 01.10.2021 | 27 | 30.09.2021 |
| 6 | 284 | 01.03.2022 | 8,316 | 168/2021 | 01.10.2021 | 29 | 30.09.2021 |
| 7 | 285 | 01.03.2022 | 29,592 | 211/2021 | 29.10.2021 | 36 | 30.10.2021 |
| 8 | 286 | 01.03.2022 | 32,400 | 212/2021 | 29.10.2021 | 31 | 30.10.2021 |
| 9 | 367 | 10.03.2022 | 21,600 | 274/2021 | 30.11.2021 | 40 | 30.11.2021 |
| 10 | 368 | 10.03.2021 | 28,080 | 275/2021 | 30.11.2021 | 32 | 01.11.2021 |
| 11 | 447 | 05.04.2022 | 29,268 | 372/2021 | 31.12.2021 | 35 | 01.12.2021 |
| 12 | 448 | 05.04.2022 | 23,112 | 371/2021 | 31.12.2021 | 42 | 30.12.2021 |
| 13 | 595 | 27.04.2022 | 26,028 | 48/2022 | 01.02.2022 | 3 | 05.01.2022 |
| 14 | 596 | 27.04.2022 | 20,088 | 47/2022 | 01.02.2022 | 1 | 31.01.2022 |
| 15 | 600 | 27.04.2022 | 37,908 | 93/2022 | 28.02.2022 | 5 | 01.02.2022 |
| 16 | 601 | 27.04.2022 | 16,200 | 94/2022 | 28.02.2022 | 4 | 28.02.2022 |
| 17 | 875 | 16.06.2022 | 41,299 | 159/2022 | 04.04.2022 | 9 | 31.03.2022 |
| 18 | 876 | 16.06.2022 | 19,440 | 160/2022 | 04.04.2022 | 8 | 30.03.2022 |
| 19 | 914 | 27.06.2022 | 36,936 | 202/2022 | 02.05.2022 | 11 | 30.04.2022 |
| 20 | 915 | 27.06.2022 | 21,600 | 201/2022 | 02.05.2022 | 10 | 30.04.2022 |
| 21 | 1095 | 27.07.2022 | 41,731 | 287/2022 | 02.06.2022 | 15 | 31.05.2022 |
| 22 | 1485 | 26.10.2022 | 23,220 | 286/2022 | 02.06.2022 | 15 | 30.05.2022 |
| 23 | 1490 | 26.10.2022 | 16,200 | 472/2022 | 25.08.2022 | 16 | 30.06.2022 |
| 24 | 1491 | 26.10.2022 | 30,996 | 388/2022 | 25.08.2022 | 19 | 05.08.2022 |
| 25 | 1505 | 27.10.2022 | 6,912 | 524/2022 | 10.09.2022 | 24 | 10.09.2022 |
| 26 | 1506 | 27.10.2022 | 4,860 | 525/2022 | 10.09.2022 | 21 | 10.09.2022 |
| 27 | 1714 | 12.12.2022 | 4,860 | 533/2022 | 19.09.2022 | 20 | 30.07.2022 |
| 28 | 1728 | 13.12.2022 | 29,106 | 597/2022 | 06.10.2022 | 27 | 30.09.2022 |
| 29 | 1729 | 13.12.2022 | 20,952 | 58/2022 | 06.10.2022 | 24 | 31.09.2022 |
| 30 | 1815 | 19.12.2022 | 20,520 | 762/2022 | 06.12.2022 | 28 | 30.10.2022 |
| 31 | 1816 | 19.12.2022 | 37,800 | 765/2022 | 08.12.2022 | 33 | 08.12.2022 |
| 32 | 1817 | 19.12.2022 | 39,906 | 761/2022 | 06.12.2022 | 28 | 31.10.2022 |
| 33 | 1874 | 22.12.2022 | 17,820 | 766/2022 | 08.12.2022 | 30 | 30.11.2022 |
| 34 | 150 | 24.02.2023 | 32,400 | 7/2023 | 06.01.2023 | 36 | 30.12.2022 |
| 35 | 151 | 24.02.2023 | 17,280 | 8/2023 | 06.01.2023 | 35 | 30.12.2022 |
| 36 | 231 | 17.03.2023 | 17,820 | 62/2023 | 07.02.2023 | 3 | 30.01.2023 |
| 37 | 232 | 17.03.2023 | 35,208 | 63/2023 | 07.02.2023 | 2 | 31.01.2023 |
| 38 | 325 | 13.04.2023 | 29,160 | 141/2023 | 27.03.2023 | 8 | 28.02.2023 |
| 39 | 326 | 13.04.2023 | 13,464 | 143/2023 | 27.03.2023 | 9 | 28.02.2023 |

***4. Me urdhër prokurimi nr. 203, datë 11.08.2021***, është kryer procedura blerje “*vlerë e vogël*” me fond limit 975,000 leke pa TVSh me objekt; “*Blerje kompjuteri dhe pajisje kompjuterike në funksion të zyrës me një ndalesë dhe për nevoja të Bashkisë Mirditë”*, në datën 12.08.2021 ora $14^{.30}$. Me urdhër të brendshëm nr. 27, datë 02.02.2021 është ngritur

KBVV i përberë nga zj. A. P., zj. E. G. dhe zj. D. K., kanë paraqitur interes me pjesëmarrje gjithsej ***15 OE*** konkurrues dhe në procesverbalin datë 12.08.2021 ka kualifikuar 11 OE, ndërsa ka skualifikuar 4 OE me argumentin se, vlera e ofertës është më e madhe se vlera limit dhe OE nuk ka si objekt të veprimtarisë sipas QKB objektin e prokurimit, në përfundim me procesverbalin për kalimin tek operatori i radhës datë 20.08.2021, është shpallur fituese oferta nga OE "…" ShPK me vlere oferte për ***933,333 lekë pa TVSh***. Në dokumentet vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; (*urdhër prokurimi, kërkesa për blerje artikuj, preventivi përllogaritjes së vlerës së fondit limit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, ofertat konkuruese të printuara të deklaruara në SPE, raporti përmbledhës, procesverbali me operatorët konkurues dhe operatori ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj.*).

***Me Urdhër Shpenzimin nr. 1355, datë 17.11.2021*** është likuiduar subjekti "*J…*" ShPK me vlerën e kontratës ***1,120,000 lekë me TVSh*** për shpenzimin realizuar me procedurë "*vlerë e vogël*", bashkëlidhur së cilit janë dokumentet autorizuese sipas natyrës së shpenzimit të administruara nga Financa përfshirë; (*urdhër prokurimi; ftesa për ofertë; njoftimi fituesit; kërkesa për mallin, QKB, Kontratë, fatura tatimore e shitjes e furnitorit nr. 350/2021, datë 12.11.2021; fletë hyrja e magazinës nr. 41, datë 12.11.2021 për artikujt*). Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

***5. Me urdhër prokurimi nr. 124, datë 12.04.2022***, është kryer procedura blerje "*vlerë e vogël*" me fond limit 715,091 leke pa TVSh me objekt; "*Blerje tonera dhe kancelari, Bashkia Mirditë"*, në datën 12.04.2022 ora $12^{.30}$. Me urdhër të brendshëm nr. 88, datë 15.03.2022 është ngritur KBVV i përberë nga zj. M. M., zj. A.P. dhe zj. M. T., kanë paraqitur interes me pjesëmarrje gjithsej ***23 OE*** konkurrues dhe në procesverbalin datë 14.04.2022 ka kualifikuar 18 OE, ndërsa ka skualifikuar 5 OE me argumentin se, vlera e ofertës është më e madhe se vlera limit dhe OE nuk ka si objekt të veprimtarisë sipas QKB objektin e prokurimit, në përfundim me procesverbalin për kalimin tek operatori i radhës datë 15.04.2022, është shpallur fituese oferta nga OE "…" ShPK me vlere oferte për ***697,000 lekë pa TVSh***. Në dokumentet vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; (*urdhër prokurimi, kërkesa për blerje artikuj, preventivi përllogaritjes së vlerës së fondit limit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, raporti përmbledhës, procesverbali me operatorët konkurrues dhe operatori ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj*).

***Me Urdhër Shpenzimin nr. 166, datë 2.12.2022*** është likuiduar subjekti "*I…*" ShPK me vlerën e kontratës ***836,400 lekë me TVSh*** për shpenzimin realizuar me procedurë "*vlerë e vogël*", bashkëlidhur së cilit janë dokumentet autorizuese sipas natyrës së shpenzimit të administruara nga Financa përfshirë; (*urdhër prokurimi; ftesa për ofertë; njoftimi fituesit; kërkesa për mallin, QKB, Kontratë, fatura tatimore e shitjes e furnitorit nr. 7378/2022, datë 03.06.2022; fletë hyrja e magazinës nr. 18, datë 03.06.2022 për artikujt*). Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

***6. Me urdhër prokurimi nr. 299, datë 28.06.2022***, është kryer procedura blerje "*vlerë e vogël*" me fond limit 537,500 leke pa TVSh me objekt; "*Blerje materiale pastrimi, shërbimi dhe dizinfektante, Bashkia Mirditë"*, në datën 29.06.2022 ora $10^{.00}$. Me urdhër të brendshëm nr. 88, datë 15.03.2022 është ngritur KBVV i përberë nga zj. M. M., zj. A. P. dhe zj. M. T., kanë paraqitur interes me pjesëmarrje gjithsej ***29 OE*** konkurrues dhe në procesverbalin datë

29.06.2022 ka kualifikuar 22 OE, ndërsa ka skualifikuar 7 OE me argumentin se, vlera e ofertës është më e madhe se vlera limit dhe OE nuk ka si objekt të veprimtarisë sipas QKB objektin e prokurimit, në përfundim me procesverbalin për kalimin tek operatori i radhës datë 29.06.2022, është shpallur fituese oferta nga OE "B…" ShPK me vlere oferte për ***441,300 lekë pa TVSh***. Në dokumentet vërtetues të administruara nga NJP në dosjen fizike të kësaj procedure janë përfshirë; (*urdhër prokurimi, kërkesa për blerje artikuj, preventivi përllogaritjes së vlerës së fondit limit, ftesa për ofertë me specifikime teknike, ofertat konkurruese të printuara të deklaruara në SPE, raporti përmbledhës, procesverbali me operatorët konkurrues dhe operatori ekonomik i shpallur fitues, oferta fituese, etj.*).

***Me Urdhër Shpenzimin nr. 1712, datë 12.12.2022*** është likuiduar subjekti "B…" ShPK me vlerën e kontratës ***52,560 lekë me TVSh*** për shpenzimin realizuar me procedurë "*vlerë e vogël*", bashkëlidhur së cilit janë dokumentet autorizuese sipas natyrës së shpenzimit të administruara nga Financa përfshirë; (*urdhër prokurimi; ftesa për ofertë; njoftimi fituesit; kërkesa për mallin, QKB, Kontratë, fatura tatimore e shitjes e furnitorit nr. 50/2022, datë 15.09.2022; fletë hyrja e magazinës nr. 40, datë 15.09.2022 për artikujt)*. Mungon komisioni i marrjes në dorëzim.

**Titulli i gjetjes:** Mos zbatim i kërkesave ligjore mbi marrjen në dorëzim të mallrave.
**Situata:** Në përfundim të procesit të auditimit në lidhje me 6 procedurat e prokurimit të marra me zgjedhje, dhe të realizuara me "*vlerë e vogël*" u konstatua se; Në të gjitha rastet e blerjeve mall, shërbime e punë publike, me OE i shpallur fitues, është lidhur kontrata e shërbimit dhe blerjes me afate dhe kushte të realizimit ndërsa në rastet për procesin e marrjes në dorëzim të mallrave nuk është ngritur komision nga titullari dhe në përputhshmëri me kërkesat ligjore. Mallrat e blera kanë kaluar nga furnitori duke u bërë hyrje në magazinë pa pasur një hallkë kontrolli mbi sasinë, llojin dhe cilësinë e kërkuar sipas kërkesave së procedurës e prokuruar.
**Kriteri:** Veprime në mospërputhje me Pikën 42, 43, 52, 53, 54 të UMF 30 datë 27.11.2011 ku qartësisht citohet se; *Titullari i njësisë miraton urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi material.*
*Veprimet që kryejnë strukturat e Nëpunësit Zbatues:*
52. *Strukturat e Nëpunësit Zbatues para marrjes në dorëzim të dokumenteve nga personat me përgjegjësi materiale, kryejnë kontrollin paraprak të tyre. Ky kontroll përfshin kontrollin e rregullshmërisë së jashtme, kontrollin nga pikëpamja e zbatimit të ligjshmërisë dhe kontrollin e saktësisë së veprimeve aritmetike.*
53. *Kontrollohet numri rendor i dokumentit, si për flete hyrje dhe flete dalje, të cilat duhet të ndjekin rendin kronologjik dhe të mos kenë kapërcim numri, të ketë adresën nga vjen dhe kujt i dërgohet malli. Kur konstatohet kapërcim i numrit rendor apo data jo kronologjike, nëpunësi zbatues mban procesverbal me personat me përgjegjësi materiale, dokumenton dhe sinjalizon çdo parregullsi.*
54. *Për hyrjet që bëhen nga blerjet me fondet buxhetore, strukturat përgjegjëse për financat duhet të kontrollojnë në se flete hyrja ka të bashkëlidhur dokumentacionin justifikues përkatës që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës si proces verbali i firmosur nga komisioni, fatura e furnitorit, situacione te shpenzimeve për investimet, fletë hyrje origjinale, proces-verbal i marrjes në dorëzim të mallit, etj.*

**Ndikimi/efekti:** Ka rritur nivelin e riskut të keqpërdorimit kundrejt humbjeve apo abuzimeve të mundshme me mallrat e blera me fonde publike.
**Shkaku:** Mos ngritja e komisioneve për marrjen e mallrave në dorëzim.
**Rëndësia:** E Mesme
**Rekomandimi:** Titullari i njësisë vendore apo personi i autorizuar prej tij të miratojë për çdo rast urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni të përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision duhen të bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi material.

*Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi z. N.D., me detyrë Kryetar Bashkie.*

### 2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

Në zbatim të programit të auditimit, në Bashkinë Mirditë, u analizua regjistri i realizimit të investimeve që i përket periudhës së auditimit të përputhshmërisë 01.01.2019 deri me datën 31.12.2022.
Nga grupi i auditimit, u arsyetua, për t'u audituar kontrata për punë publike, pasqyruar në tabelën nr. 1, me vlerë **260,920,634.16 lekë pa TVSH ose 313,104,761 lekë me TVSH ,** mbi zbatimin e punimeve të ndërtimit në investimet publike, përputhshmërinë me projektet e zbatimit, kushteve teknike të zbatimit, kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës, kolaudimi, zbatimi i afateve të kontratave si dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera.

**Tabela nr. 1. Kontrata zbatimi të audituara**

| Nr | Objekti | Kontraktori Sipërmarrës | Vlera e kontratës me TVSH |
|---|---|---|---|
| 1 | 2 | 3 | 4 |
| A | 2018 | | - |
| 1 | "Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit "Arjana Arapi" Rrëshen" | | 63,269,169 |
| | Viti 2019 | | |
| 1 | Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar "Ndrec N. Gjoka", Fan Mirditë" | | 69,805,421 |
| 2 | "Rehabilitimi i skemës ujitëse të ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza III)" Rrëshen" | | 47,196,085 |
| B | Viti 2021 | | - |
| 1 | Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen" | | 103,177,350 |
| 2 | Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3)" | | 42,261,108 |
| 3 | Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen" | | 97,860,882 |
| C | Viti 2022 | | - |
| 1 | "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)" | | 187,417,132 |
| 2 | "Rikonstruksion dhe riparimi i ambienteve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, të dëmtuara nga tërmeti, në qytetin Reps, Nj.A. Orosh" | | 183,991,365 |
| 3 | "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) | | 362,526,402 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 2) Rrëshen" | | |
| | **Shuma në lekë me TVSH** | | **1,157,504,914** |

*Burimi: Bashkia Mirditë , përpunuar nga grupi i auditimit.*

**Nga auditimi mbi zbatimin e kontratave për punë publike, në vijim po trajtojmë problematikat e konstatuara:**

**1.** Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "**Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3)",** me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

| **13.** Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3), Mirditë". | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 760 prot., datë 06.05.2021<br>OE "L…" SHPK | **15.Vlera e kontratës**<br>Vl e prev ofertues 42,261,108 lekë me TVSH | **16.Likuiduar:**<br>Sit. 1 në vlerën 2,445,396 lekë me TVSH<br>Sit. 2 në vlerën 4,585,988.73 lekë me TVSH<br>Sit. 3 në vlerën 11,348,619.27 lekë me TVSH<br>Sit. 4 në vlerën 13,086,751.20 lekë me TVSH |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>-Vlera 10,785,957.25 lekë me TVSH. | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Fillimi punimeve: 10.06.2021<br>Përfundimi punimeve sipas kontratës: 09.06.2022<br>Sipas amendimit, përfundimi bëhet me datë 26.02.2022.<br>Përfundimi punimeve sipas faktit: 18.02.2022 | **19. Zgjatja e kontratës**<br>Amendim kontrate |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>OE "A" SHPK | Licenca MK.3503/1 | Kontratë me nr. 1406/6 prot., datë 08.06.2021 |
| 21. Kolaudatori i punimeve<br>JV "T. & S" SHPK | Licenca Nr: MK.---<br>dhe nr. MK. 2272/2 | Kontratë nr. 4679/3 prot, datë 26.11.2021 |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë: 24.02.2022 (Prot në AK me nr. 835/2 prot., datë 24.02.2022) | **23.Akt i marrjes në dorëzim:**<br>Me datë 25.03.2022 (Nr. 1302 prot). | |

**ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:**

**Titulli i Gjetjes:** Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3)".

**Përshkrimi i situatave:**

**Situata 1:**

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara në gërmime, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën **107,375 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

Nga auditimi i zbatimit për zërin: "2(3.25/b) Gërmim me krah, tok e zakonshme", u konstatua:

Situacioni përfundimtar pasqyron volumin 3,032.39 m3 gërmim dheu me krah me çmim 725 lekë.

Libreza e masave pasqyron në mënyrë analitike volumin 3,032.39 m3. Nga auditimi i pasqyrimit në librezë sipas piketave dhe seksioneve konstatohet, se zëri është realizuar në volumin 2,797.39 m3 dhe jo në volumin 3,032.39 m3. Sa më sipër, diferenca prej 235 m3 është librezuar dhe situacionuar më tepër, në vlerën **170,375 lekë pa TVSH** (235 m3 x 725 lekë).

**Situata 2:**

-Projekti i zbatimit është hartuar në shtator 2016 nga shoqëria JV "A. & E." SHPK.
Relacioni teknik për Projektin e Zbatimit si dhe Specifikimet Teknike janë hartuar nga Ing. B. H.
- Për projektin e zbatimit me objekt: "Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3)" nga Titullari i Bashkisë Mirditë z. N. D. është lëshuar Leje Ndërtimi Infrastrukturore me nr. 589/4 prot., datë 10.06.2021, bazuar në nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
Problematikë e konstatuar:
-Për projektin e zbatimit të objektit: "Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3)" nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Mirditë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, **neni 6**, **germa (a)** për ndërtimet publike, i ndryshuar me ligjin nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", ku theksohet: "*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha*:
**a) ndërtimet publike;**
b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;
**c) objektet me akses publik**".
**Kriteri:**
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 760 prot., datë 06.05.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1406/6 prot., datë 26.11.2021.
**Ndikimi/Efekti**: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Mirditë.
**Shkaku:** Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara.
**Rëndësia**: I lartë.
**Rekomandim 1:** Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **170,375 lekë pa TVSH** nga OE "L…" SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 760 prot., datë 06.05.2021, me objekt "Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3), Mirditë", Bashkia Mirditë".
**Rekomandim 2:** Bashkia Mirditë të marrë masa që të pajisin me **Oponencë Teknike** për çdo projekt zbatimi për ndërtimet publike dhe me akses publik, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

**Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi:**
**1. Z. A. B.,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve **(Situata 1)**.
**2. Z. N. D.,** në cilësinë e ish-Kryetari i Bashkisë Mirditë **(Situata 2)**.

**2.** Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "**Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar "Ndrec N. Gjoka", Fan Mirditë",** me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

| 13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "**Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambjenti shkolla e mesme e bashkuar "Ndrec N. Gjoka", Fan Mirditë, Mirditë**". | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 3072 prot., datë 29.07.2019<br>OE "K…" SHPK | **15.Vlera e kontratës**<br>Vl e prev ofertues 69,805,421 lekë me TVSH | **16.Likuiduar:**<br>Sit. 1 në vlerën 7,080,670 lekë me TVSH<br>Sit. 2 në vlerën 18,901,482 lekë me TVSH |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>-Vlera 43,819,248 lekë me TVSH. | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Fillimi punimeve: 14.08.2019<br>Përfundimi punimeve sipas faktit: 24.01.2020. | **19. Zgjatja e kontratës**<br>Amendim kontrate |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>OE "A. …" SHPK | Licenca MK.2643/4 | Kontratë me nr. 2642 prot., datë 24.06.2019 |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>OE "A…" SHPK | Licenca Nr: MK.3503 | Kontratë nr. 2567 prot, datë 14.08.2020 |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë: 18.08.2020 | **23.Akt i marrjes në dorëzim:**<br>Me datë 18.08.2020 (Nr. 2599 prot). Titullari i AK me urdhër nr. 4830 prot., datë 23.11.2021 ka ngritur grupin e marrjes në dorëzim me përbërje: A. D., R. B. dhe F.L.. | |

**ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:**

**Titulli i Gjetjes:** Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin: "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar "Ndrec N. Gjoka", Fan Mirditë".

**Përshkrimi i situatave:**

**Situata 1:**

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve: "19(2.37/5a). Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km", "9(2.37/5a). Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km", "5(2.264). Shtresë llustër çimento 2 cm nën pllaka (Kati përdhe + kati I), seksioni: IV. Punime shtresash dhe hidroizolim", me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën **442,494 lekë pa TVSH**.

**Situata 2:**

-Projekti i zbatimit është hartuar në shtator 2017 nga shoqëria "A. …" SHPK me përbërje të grupit të projektimit: Ing. F. B., Ing. A. S., Ing. I. T., Ing. I. M., Ing. A. S., Ark. Gj. T., Ing. P. M., Arkitekt. A. M.

- Për projektin e zbatimit me objekt: "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambjenti shkolla e mesme e bashkuar "Ndrec N. Gjoka", Fan Mirditë" nga Titullari i Bashkisë Mirditë z. N.D. është lëshuar Leje Ndërtimi për objektin "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambjenti shkolla e mesme e bashkuar "Ndrec N. Gjoka", Fan Mirditë" Nr. 1930, datë 02.05.2019.

Problematikë e konstatuar:

1-Për projektin e zbatimit të objektit: "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambjenti shkolla e mesme e bashkuar "Ndrec N. Gjoka", Fan Mirditë" nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Mirditë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit*", i ndryshuar, **neni 6**, **germa (a)** për ndërtimet publike, i ndryshuar me ligjin nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", ku theksohet: "*Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha*:

**a) ndërtimet publike;**
b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventivuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;
**c) objektet me akses publik**". ***Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi ish-Kryetari i Bashkisë Mirditë.***

**Situata 3:** Kolaudimi i objektit është bërë me datë 18.08.2020 (Prot në AK Bashkinë Mirditë me nr. 2599 prot., datë 18.08.2020). Akti i kolaudimit është nënshkruar nga palët: Sipërmarrësi i punimeve shoqëria "K…" SHPK përfaqësuar nga Z. P. N., Mbikëqyrësi i punimve shoqëria "A. …" SHPK përfaqësuar nga Ing. A. Sh., nga Kolaudatori i punimeve shoqëritë "A…" SHPK përfaqësuar nga Ing. A. B., si dhe, nga Investitori Bashkia Mirditë përfaqësuar nga Kryetari Z. N. D.

Nënshkrimi i aktit të kolaudimit nga Investitori Bashkia Mirditë përfaqësuar nga Kryetari Z. N. D., është në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit" ku thekon se: "...Procesverbali firmoset nga kolaudatori, zbatuesi dhe mbikëqyrësi i punimeve...".

-Gjithashtu, nga auditimi i dokumentacionit të kolaudimit të punimeve, konstatojmë këtë mangësi:

Kolaudimi i objektit "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambjenti shkolla e mesme e bashkuar "Ndrec N. Gjoka", Fan Mirditë" është bërë me datë 18.08.2020 ndërkohë që punimet e ndërtimit kanë përfunduar me datë 24.01.2020, pra, rreth 7 (shtatë) muaj me vonesë, veprim ky në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 12 ku citon se: "Emërimi i kolaudatorit apo i grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t'ia komunikojë personit, institucionit që do të merret me kolaudimin dhe seksionit ose zyrës së urbanistikës të rretheve apo bashkive, **brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve të ndërtimit**" si dhe nenin 15, ku citon se: "Shkeljet e neneve 12 e 14 të këtij ligji**.**
Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë Mirditë.

**Kriteri:**
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3072 prot., datë 29.07.2019.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2642 prot., datë 14.08.2020.

**Ndikimi/Efekti**: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Mirditë.
**Shkaku:** Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara dhe
**Rëndësia**: I lartë.

**Rekomandim 1:** Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **442,494 lekë pa TVSH** nga shoqëria "K…" SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3072 prot., datë 29.07.2019, me objekt "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar "Ndrec N. Gjoka", Fan Mirditë", Mirditë", Bashkia Mirditë".

**Rekomandim 2:** Bashkia Mirditë të marrë masa që të pajisin me **Oponencë Teknike** për çdo projekt zbatimi për ndërtimet publike dhe me akses publik, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

**Rekomandimi 3:** Titullari i Bashkisë Mirditë për zbatimin e kontratave për punë publike, të bëjë emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit, brenda **30 ditëve** nga përfundimit i punimeve të ndërtimit për të hapur rrugën e periudhës së garancisë së defekteve të punimeve.

**Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi:**
**1. Z. A. Sh.,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve **(Situata 1)**.
**2. Z. N. D.,** në cilësinë e ish-Kryetari i Bashkisë Mirditë **(Situata 2, 3)**.

**3.** Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "**Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen" Bashkia Mirditë,** me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

| **13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen".** | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 3974 prot., 13.10.2021<br>OE "U…" SHPK | **15.Vlera e kontratës**<br>Vl e prev ofertues 97,860,882 lekë pa TVSh. | **16.Likuiduar:**<br>Sit. 1 në vlerën 16,947,623 lekë me TVSH<br>Sit. 2 në vlerën 25,463,475 lekë me TVSH<br>Sit. 3 në vlerën 14,576,055 lekë me TVSH<br>Sit. 4 në vlerën 20,854,240 lekë me TVSH |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>-Sit nr. 5 (përfundimtar) në vlerën 6,219,702 lekë me TVSH. | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Fillimi punimeve: 20.10.2021<br>Përfundimi punimeve: 31.08.2022 | **19. Zgjatja e kontratës**<br>S'ka |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>OE "N…" SHPK | Licenca MK.1846/7 | Kontratë me nr. 3975 prot., datë 13.10.2021 |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>OE "…" SHPK | Licenca Nr: MK.2720/7 | Kontratë nr. 3783/7 prot., datë 02.11.2022 |
| **22.Akt Kolaudimi .**<br>Datë: --.--.2022 | **23.Akt i marrjes në dorëzim:**<br>Me datë 19.12.2022. Nga Kryetari i Bashkisë Rrëshen është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit me nr.----, datë ----.. Akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, si dhe nga komisioni me përbërje: D. T., B. D., E. D.. | |

**ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:**

**Titulli i Gjetjes:** Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin: "*Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen" Bashkia Mirditë.*

**Përshkrimi i situatave:**
**Situata 1:**
Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve: "Zëri 3(2.37/5a). Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km", "Zëri 7(2.262/1). Shtresë betoni C 12/15", "Zëri 19 (2.375/1. F.V Dritare d/alumini plastike me dopio xham", "Zëri 23 (2.395/1. F.V Dyer d/alumini plastike me dopio xham", me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Mirditë, në vlerën **277,004.8 lekë pa TVSH**.
**Situata 2:**
-Projekti i zbatimit është punuar nga shoqëria "E..." SHPK në vitin 2020.
- Për ndërtimin e investimit me objekt: "Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen" nga Titullari i Bashkisë Rrëshen është lëshuar Leje Rindërtimi me Nr. 3974, datë 18.10.2021, veprim ky sipas, nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

-Për projektin e zbatimit të objektit: "Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen", nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Rrëshen. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, neni 6, pika 1, ku theksohet: "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:
**a) ndërtimet publike;**
b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;
**c) objektet me akses publik**". Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Mirditë.

**Kriteri:**

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3974 prot., datë 13.10.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3783/7 prot., datë 02.11.2022.

**Ndikimi/Efekti**: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Mirditë si dhe zbatimi i projektit pa kryer oponencën teknike.

**Shkaku:** Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara dhe neglizhencë nga AK për kryerjen e oponencës teknike.

**Rëndësia**: I lartë.

**Rekomandim 1:** Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **277,004.8 lekë pa TVSH** nga shoqëria "U." SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3974 prot., datë 13.10.2021, me objekt "Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen" Bashkia Mirditë, Mirditë", Bashkia Mirditë".

**Rekomandim 2:** Bashkia Mirditë të marrë masa që të pajisin me **Oponencë Teknike** për çdo projekt zbatimi për ndërtimet publike dhe me akses publik, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

**Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi:**
**1. Z. E. N.,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve **(Situata 1)**.
**2. Z. N. D.,** në cilësinë e ish-Kryetari i Bashkisë Mirditë **(Situata 2)**.

**4.** Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "**Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen" Bashkia Mirditë,** me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

| **13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen" Bashkia Mirditë.** | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 39746 prot., 13.10.2021<br>BOE "…" SHPK & "…" SHPK | **15.Vlera e kontratës**<br>Vl e prev ofertues 103,177,350 lekë pa TVSH. | **16.Likuiduar:**<br>Sit. 1 në vlerën 24,320,200 lekë pa TVSH<br>Sit. 2 në vlerën 24,366,880 lekë pa TVSH<br>Sit. 3 në vlerën 23,254,491 lekë pa TVSH |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>-Sit nr. 5 (përfundimtar) në vlerën 103,174,000 lekë pa TVSH. | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Fillimi punimeve: 21.10.2021<br>Përfundimi punimeve: 19.09.2022 | **19. Zgjatja e kontratës**<br>S'ka |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>OE "A…" SHPK | Licenca MK.2463/6 | Kontratë me nr. 3977 prot., datë 13.10.2021 |

| | | |
|---|---|---|
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>OE "…" SHPK | Licenca Nr: MK.2720/7 | Kontratë nr. 3783/7 prot., datë 02.11.2022 |
| **22.Akt Kolaudimi** .<br>Datë: 28.10.2022 | **23.Akt i marrjes në dorëzim:**<br>Me datë 19.12.2022. Nga Kryetari i Bashkisë Rrëshen është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit me nr.----, datë ----.. Akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, si dhe nga komisioni me përbërje: D.T.i, B. D., E. D.. | |

**ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:**

**Titulli i Gjetjes:** Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin: "Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen*" Bashkia Mirditë.*

**Përshkrimi i situatave:**

**Situata 1:** Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve: (*Zëri 3(2.37/5a). Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 5.0 km; Instalimi i mbrojtjes atmosferike; Zëri 23 (2.395/1. F.V Dyer d/alumini plastike me dopio xham për objektin "Rikonstruksion pas dëmtimit nga tërmeti, Muzeu Historik, Bashkia Mirditë"; Zëri 23 (2.395/1. F.V Dyer d/alumini plastike me dopio xham për objektin "Rikonstruksion pas dëmtimit nga tërmeti, Qendra Kulturore e Fëmijëve, Bashkia Mirditë"; Zëri 24 (2.395/1. F.V Dyer d/alumini plastike me dopio xham për objektin "Rikonstruksion pas dëmtimit nga tërmeti, Godina e Bashkisë Rrëshen"*), në vlerën **232,590 lekë** pa TVSH me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Rrëshen,.

**Situata 2:** Projekti i zbatimit është punuar nga shoqëria "E…" SHPK në vitin 2020. Për ndërtimin e investimit me objekt: "Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen" nga Titullari i Bashkisë Rrëshen është lëshuar Leje Rindërtimi me Nr. 3163/2, datë 20.10.2021, veprim ky sipas, nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.

-Për projektin e zbatimit të objektit: "Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen", nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Mirditë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, neni 6, pika 1, ku theksohet: "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:

**a) ndërtimet publike;**

b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;

**c) objektet me akses publik**". Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Rrëshen.

**Kriteri:** Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 39746 prot., datë 13.10.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3977 prot., datë 13.10.2021.

**Ndikimi/Efekti**: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Mirditë si dhe zbatimi i projektit pa kryer oponencën teknike.

**Shkaku**: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara dhe neglizhencë nga AK për kryerjen e oponencës teknike.

**Rëndësia**: I lartë.

**Rekomandim 1:** Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **232,590 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve JV "A…" SHPK & "G." SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 39746 prot., datë 13.10.2021, me objekt "Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen" Bashkia Mirditë.

**Rekomandim 2:** Bashkia Mirditë të marrë masa që të pajisin me **Oponencë Teknike** për çdo projekt zbatimi për ndërtimet publike dhe me akses publik, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

**Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi:**
**1. Z. A. Sh.,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve **(Situata 1)**.
**2. Z. N. D.,** në cilësinë e ish-Kryetari i Bashkisë Mirditë **(Situata 2)**.

**5.** Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: "**Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)",** me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme:

| **13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)" Bashkia Mirditë.** | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 3711/3 Prot., datë 02.12.2022<br>OE "U…" SHPK | **15.Vlera e kontratës**<br>Vl e prev ofertues 187,417,132 lekë pa TVSh. | **16.Likuiduar:**<br>Sit paradhënie në vlerën 18,741,713.20 lekë pa TVSH<br>Sit. 1 në vlerën 27,172,917 lekë pa TVSH<br>Sit. 2 në vlerën 56,768,130 lekë pa TVSH<br>Sit. 4 (përfundimtar) në vlerën 36,253,288 lekë pa TVSH |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>-Sit përf në vlerën 187,415,000 lekë pa TVSH. | **18.Afati i kontratës në dite**<br>Fillimi punimeve: 27.12.2022<br>Përfundimi punimeve: 30.05.2022 | **19. Zgjatja e kontratës**<br>S'ka |
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>OE "…" & "Instituti i Konsulencës në …"SHPK | Licenca MK.1308/1/6 | Kontratë me nr. 3790/19 prot., datë 13.12.2022 |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>OE "…" SHPK | Licenca Nr: MK.1846/7 | Kontratë nr. 2228/4 prot., datë 23.06.2023 |
| **22.Akt Kolaudimi.**<br>Datë: 23.06.2023 | **23.Akt i marrjes në dorëzim:**<br>Me datë 26.06.2023. Nga Kryetari i Bashkisë Rrëshen është ngritur Komision për marrjen në dorëzim të objektit me nr.----, datë ----.. Akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve, mbikëqyrësi i punimeve, kolaudatori i punimeve, si dhe nga komisioni me përbërje: A. D., D. T., B. D.. | |

**ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:**

**Titulli i Gjetjes**: Punime ndërtimi të pa kryera në volumet e situacionuara në objektin: "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)" *Bashkia Mirditë*.

**Përshkrimi i situatave:**
**Situata 1:** Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, për zërat e punimeve (Zëri 3(An-3). Prishje çatie me llamarinë; Zëri 34(An-21). Skeleri metalike me tubo në fasadë >12 m), me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Rrëshen, në vlerën **178,102 lekë** pa TVSH, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të Bashkisë Rrëshen,.
**Situata 2:** Projekti i zbatimit (projekt ide) është hartuar nga AK Bashkia Mirditë dhe, projekti i zbatimit në fakt është hartuar nga shoqëria "U…" SHPK.
- Për ndërtimin e investimit me objekt: "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)" nga Titullari i Bashkisë Mirditë është lëshuar Leje Rindërtimi me Nr. 5404/4 prot, datë 27.12.2022, veprim ky sipas, nenet 27, 29 dhe 39 të ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, dhe nenet 11, 14, 15, 16, 22 dhe 23 të VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.
-Për projektin e zbatimit të objektit: "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)", nuk është kryer oponencë teknike nga Bashkia Mirditë. Ky veprim është në kundërshtim me Ligjin Nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, neni 6, pika 1, ku theksohet: "Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha:
**a) ndërtimet publike;**
b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë;
**c) objektet me akses publik**". Sa më sipër ngarkohet me përgjegjësi ish Kryetarin e Bashkisë Rrëshen.
**Situata 3:** Për kryerjen e shërbimit të kolaudimit të punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 2228/4 prot., datë 23.06.2023 ndërmjet Bashkisë Mirditë, përfaqësuar nga Titullari N. D. dhe, shoqërisë "N…" SHPK përfaqësuar nga Drejtuesi Ligjor Z. …, me nr. lic. MK. 1846/7.
Ngritja e grupit të kolaudimit është bërë rreth **1(një) vit** me vonesë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 12 ku citohet "Emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudimit... brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit" dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e institucionit.
**Kriteri:** Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3711/3 prot., datë 02.12.2022.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3790/19 prot., datë 13.12.2022.
**Ndikimi/Efekti**: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Mirditë si dhe zbatimi i projektit pa kryer oponencën teknike.

**Shkaku**: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara dhe neglizhencë nga AK për kryerjen e oponencës teknike.

**Rëndësia**: I lartë.

**Rekomandim 1:** Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **178,102 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria "U…" SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3711/3 prot., datë 02.12.2022, me objekt "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)" Bashkia Mirditë.

**Rekomandim 2:** Bashkia Mirditë të marrë masa që të pajisin me **Oponencë Teknike** për çdo projekt zbatimi për ndërtimet publike dhe me akses publik, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

**Rekomandim 2:** Titullari i Bashkisë Mirditë për zbatimin e kontratave për punë publike, të bëjë emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit, brenda **30 ditëve** nga përfundimit i punimeve të ndërtimit për të hapur rrugën e periudhës së garancisë së defekteve të punimeve.

**Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi:**

**1. Z. P. P.,** në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve **(Situata 1)**.

**2. Z. N. D.,** në cilësinë e ish-Kryetari i Bashkisë Mirditë **(Situata 2, 3)**.

**6. "Rikonstruksion dhe riparimi i ambienteve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, të dëmtuara nga tërmeti, në qytetin Reps, Nj.A. Orosh", Bashkia Mirditë.**

*Kontratat*

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 5372/15 prot., datë 28.02.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë, të përfaqësuar nga Kryetari z. N.D. dhe të BOE "L…" SHPK & "K…" ShPK, me përfaqësues ligjor znj. R. K. me licencë profesionale përkatësisht NZ 4800/23 dhe 2275/22. Vlera e kontratës është 184,001,854 lekë pa TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 7.5 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Pas kërkesave së sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për shkak të mospagesës në kohë, probleve me banorët dhe moti me rreshje të shumta, është hartuar Amendamenti me nr. 3781/6 prot., datë 08.11.2022, i cili miraton shtyrjen e afatit të punimeve deri në datën 31.12.2022 (1.8 muaj).

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1043/2, datë 15.03.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me BOE "…" SHPK & "I…" ShPK, me përfaqësues z. E. Q., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh përkatësisht MK. 3730/1 dhe MK 2406/1 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 2,346,313 lekë pa tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1043/8 prot., datë 23.12.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE "P. C." SHPK, me drejtues ligjor znj. V. G., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0899/19 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 216,674 lekë pa tvsh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 28.12.2022.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen provizore në dorëzim me datë 29.12.2022, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga përfaqësuesit e autorizuar të investitorit me Urdhrin nr. 416, datë 28.12.2022, znj A. D. Inxhiniere, B. D. inxhinier dhe D. P. me profesion mësues dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë z. N. D.

*Projektpreventivi*

- Për këtë objekt, me Vendimin nr. 22, datë 19.03.2022 të Bashkisë Mirditë është miratuar leje ndërtimi me objekt "Rikonstruksion dhe riparimi i ambienteve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, të dëmtuara nga tërmeti, në qytetin Reps, Nj.A. Orosh".
- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga shoqëria "E…" ShPK në vitin 2018 dhe vulosur nga Bashkia Mirditë.

<u>Zbatimi i punimeve</u>

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 23.03.2022 (Akti i dorëzimit të sheshit) dhe kanë përfunduar me datë 23.12.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

- Nga auditimi i dosjes teknike, rezulton se pas kërkesë propozimit të Mbikëqyrësit të punimeve, protokolluar me nr.3781/2 prot., datë 30.08.2022, nisur nga krahasimi i preventivit me faktin, është hartuar procesverbali për ndryshime volumesh, me punime që shtohen/pakësohen prej 3,632,471 lekë pa TVSH, duke përdorur edhe fondin rezervë në vlerën prej 8,751,504 lekë pa TVSH.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

<table>
<tr><td colspan="5">Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion dhe riparimi i ambienteve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, të dëmtuara nga tërmeti, në qytetin Reps, Nj.A. Orosh", Bashkia Mirditë</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës<br>Nr. 5372/15 prot., datë 28.02.2022</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me tvsh)<br>184,001,854 lekë pa TVSh<br>BOE fitues "L…" SHPK & "K…" ShPK</td><td colspan="2">16.Likuiduar</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar<br>Vlera pa tvsh 183,991,365 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kotratës në dite<br>Parashikuar 7.5 muaj, Zbatuar 275 ditë.<br>Fillimi punimeve: 23.03.2022<br>Perfundimi punimeve 23.12.2022</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës<br>Amendamenti nr. 1, me nr. 3781/6 prot., datë 08.11.2022<br>shtyrja 1.8 muaj, deri në datën 31.12.2022.</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve<br>BOE "…" SHPK & "I…" ShPK</td><td>Licenca Nr:<br>MK 3730/1<br>MK 2406/1</td><td>Kontrata nr. 1043/2, datë 15.03.2022</td><td>Likuiduar<br>lekë</td><td>Pa likuiduar</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve<br>OE "P…" SHPK</td><td>Licenca Nr:<br>MK 0899/19</td><td>Kontrata nr. 1043/8 prot., datë 23.12.2022</td><td>Likuiduar<br>(......lekë)</td><td>Pa likuiduar (........ lekë)</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi<br>Datë 28.12.2022</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim dt 29.12.2022</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja Nr.... datë ..................lekë(për mallrat)</td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume/çmime apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **540,416 lekë pa tvsh**.

**<u>Titulli i Gjetjes:</u>** Diferenca në çmime për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksion dhe riparimi i ambienteve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, të dëmtuara nga tërmeti, në qytetin Reps, Nj.A. Orosh", Bashkia Mirditë, nga zbatuesi i punimeve BOE "L…" SHPK & "K…" SHPK.

**<u>Situata:</u>** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në çmime në zërat e punës “FV përcjellës shirit zinku tokëzimi Zn 40 x 3 mm, çmimi” dhe “FV elektroda tokëzimi, profil zingato e bakerizuar, L=2-2.5 m”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5372/15 prot., datë 28.02.2022.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1043/2, datë 15.03.2022.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1043/8 prot., datë 23.12.2022.
**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Mirditë.
**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
**Rëndësia**: E ulët
**Rekomandime:** Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 540,416 lekë pa tvsh nga BOE “L…” SHPK & “K…” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5372/15 prot., datë 28.02.2022 me objekt “Rikonstruksion dhe riparimi i ambienteve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, të dëmtuara nga tërmeti, në qytetin Reps, Nj.A. Orosh”, Bashkia Mirditë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.
Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 540,416 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
1. Z. E. Q., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. V. G., me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

**7. “Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit “Arjana Arapi” Rrëshen”, Bashkia Mirditë.**

*Kontratat*
Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 4616 prot., datë 23.10.2018, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë, të përfaqësuar nga Kryetari z. N. D. dhe të BOE “A…” SHPK & “J…” ShPK, me përfaqësues ligjor z. Z.K. Vlera e kontratës është 63,269,169 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Pas kërkesave së sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për shkak të motit me rreshje të shuta shirash dhe bore dhe temperaturave shumë të ulëta, është hartuar Amendamenti me nr. 2085 prot., datë 13.05.2019, i cili miraton shtyrjen e afatit të punimeve deri në datën 24.08.2019 (4 muaj).
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 4465/1, datë 11.10.2018, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE “E…” SHPK, me përfaqësues z. G. I., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1015/12 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 831,506 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE "G…" SHPK (e cila nuk administrohet në dosjen teknike), me drejtues ligjor znj. D. P., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1945/12. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 25.11.2019.
Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen provizore në dorëzim me datë 08.12.2019, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga përfaqësuesit e autorizuar të investitorit me Urdhrin nr. 352, datë 05.02.2019, znj. A. D. Inxhiniere, B. D. inxhinier dhe Gj. K. me profesion mësues dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë z. N. D.
*Projektpreventivi*
- Për këtë objekt, me Vendimin nr. 4727, datë 23.11.2018 të Bashkisë Mirditë është miratuar Leja e zhvillimit të objektit. Në dosjen teknike nuk administrohet leje ndërtimi. Sa sipër ngarkohet me përgjegjësi Kryetari i Bashkisë z. N. D.
- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga shoqëria "E…" ShPK në vitin 2018 dhe vulosur nga Bashkia Mirditë.

Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 27.11.2018 dhe kanë përfunduar me datë 24.08.2019, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.
- Nga auditimi i dosjes teknike, rezulton se sasitë në situacionin përfundimtar nuk janë të njëjta me ato të ofertës. Ky fakt, presupozon që janë/duhet të jenë bërë ndryshime nga kontrata bazë. Pra, duhet të jetë hartuar projekti i rishikuar dhe preventivi i ripunuar. Në dosjen teknike nuk administrohet asnjë dokument që të ketë iniciuar ndryshimet në projektin bazë, mungon tabela e ndryshimit të volumeve dhe procesverbali i punimeve që shtohen/hiqen (+/-), të cilat duhet të ishin miratuar nga Investitori. Sa sipër, ngarkohen me përgjegjësi Investitori (Bashkia Mirditë), mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve.
Nga verifikimi në terren, u konstatua se zëri i punës "FV stola dryri me tapiceri në sallën e lojrave për ekipet gjatë ndeshjeve", nuk ishin vendosur sipas specifikimeve teknike, pasi nuk ishin me tapiceri. Vlera prej 1,030,400 lekë e këtij zëri pune, është përdorim pa eficencë e fondeve dhe ngarkon me përgjegjësi Investitorin (Grupin e marrjes së përkohshme në dorëzim nga Bashkia Mirditë), mbikëqyrësin, kolaudatorin dhe sipërmarrësin i punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

| **Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit "Arjana Arapi" Rrëshen", Bashkia Mirditë** | | |
|---|---|---|
| **14.Lidhja e kontratës**<br>Nr. 4616 prot., datë 23.10.2018 | **15.Vlera e kontratës (me tvsh)**<br>63,269,169 lekë<br>**BOE fitues "A…" SHPK & "J…" ShPK** | **16.Likuiduar** |
| **17- Situacioni Përfundimtar**<br>**Vlera me tvsh 63,275,876 lekë**<br>**Vlera pa tvsh 52,729,897 lekë** | **18.Afati i kotratës në dite**<br>Parashikuar 6 muaj, Zbatuar 305 ditë.<br>Fillimi punimeve: 27.11.2018<br>Perfundimi punimeve : 24.08.2019 | **19. Zgjatja e kontratës**<br>Amendamenti nr. 1, me nr. 2085 prot., datë 13.05.2019<br>shtyrja 4 muaj. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **20. Mbikëqyrësi i punimeve**<br>OE E…" SHPK | Licenca Nr:<br>MK 1015/12 | Kontrata nr. 4465/1, datë 11.10.2018 | Likuiduar<br>lekë | Pa likuiduar |
| **21. Kolaudatori i punimeve**<br>OE "G…" SHPK | Licenca Nr:<br>MK 1945/12 | Kontrata nuk ka | Likuiduar<br>(……lekë) | Pa likuiduar (……. lekë) |
| **22.Akt Kolaudimi**<br>Datë 25.11.2019 | **23.Akt i marrjes në dorëzim** dt 08.12.2019 | | **24.** Fletë Hyrja Nr.... datë ……………..lekë<br>(për mallrat) | |

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **638,120 lekë pa tvsh**.

**Titulli i Gjetjes:** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit "Arjana Arapi" Rrëshen", Bashkia Mirditë, nga zbatuesi i punimeve BOE "A…" SHPK & "J…" SHPK, për zërat e punimeve A-2/23, 24 E-2/11 dhe F-1/7.
**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
-Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës "Suva me grafiato h>4 m", "FV dritare alumini dyfish xham", "Shtresë betoni M-150 t = 10 cm" dhe "FV Dollap Garderobë", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4616 prot., datë 23.10.2018.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 4465/1, datë 11.10.2018.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, nëse është lidhur.
**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Mirditë.
**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
**Rëndësia**: E lartë
**Rekomandime:** Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 638,120 lekë pa tvsh nga BOE "A…" SHPK & "J…" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4616 prot., datë 23.10.2018 me objekt "Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit "Arjana Arapi" Rrëshen", Bashkia Mirditë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
1. Z. G. I., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. D.P, me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

**8. "Rehabilitimi i skemës ujitëse të ujëmbledhësit Malaj-2, Faza III" Rrëshen", Bashkia Mirditë.**

*Kontratat*

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 3196 prot., datë 06.08.2019, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë, të përfaqësuar nga Kryetari z. N. D. dhe të OE "A…" SHPK, me përfaqësues ligjor z. Z. K. me licencë profesionale NZ 2802/19. Vlera e kontratës është 47,196,085 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës. Pas kërkesave të sipërmarrësit dhe mbikëqyrësit për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve për shkak të pengimit të punimeve nga ana e banorëve gjatë punës në segmentin nga pik. 559 – pik. 589 (me datë 25 dhe 26.11.2019), është hartuar Amendamenti me nr. 4432 prot., datë 30.10.2019 (ose 25 ditë para ardhjes së kërkesave nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi), i cili miraton shtyrjen e afatit të punimeve deri në datën 05.02.2020 (3 muaj). Shtyrja e afatit të punimeve me 3 muaj, aq sa është edhe afati i përfundimit të punimeve (sikur të mos jetë punuar asnjë ditë deri në miratimin e Amendamentit) dhe para kërkesës zyrtare nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi, është fiktive dhe e paargumentuar teknikisht nga ana e Investitorit. Ky veprim, ngarkon me përgjegjësi titullarin e Bashkisë Mirditë z. N. D., pasi me veprimin e mësipërm është shmangur zbatimi i mundshëm i nenit 34, pika a të Kontratës (Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e punimeve).

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 2706, datë 27.06.2019, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me BOE "A…" ShPK & "E…" SHPK, me përfaqësues z. B. H., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1997/2 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 1,119,139 lekë me tvsh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, nuk administrohet asnjë dokument për kryerjen e këtij shërbimi me ing. B. M. PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1127/2, i cili ka firmosur aktin e kolaudimit. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 14.12.2020.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen provizore në dorëzim me datë 08.12.2019, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga përfaqësuesit e autorizuar të investitorit me Urdhrin nr. 352, datë 05.02.2019, znj A. D. Inxhiniere, B.D. inxhinier dhe E. D. me profesion ekonomiste dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë z. N. D.

*Projektpreventivi*

- Për këtë objekt, me Vendimin nr. 61, datë 07.07.2022 të Bashkisë Mirditë është miratuar Leje ndërtimi Infrastrukturore me objekt " Plotësimi i rrjetit të dytë ujitës të ujëmbledhësit Malaj – 2, Fshati Kodër Rrëshen", .
- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga Bashkimi i Shoqërive "A." ShPK dhe "E." ShPK në vitin 2016 dhe vulosur nga Bashkia Mirditë.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 13.08.2019 dhe kanë përfunduar me datë 05.02.2020, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

- Nga auditimi i dosjes teknike, rezulton se është mbajtur një proceverbal në datën 31.01.2020 "Për sistemim volume pune për objektin", i nënshkruar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve dhe jo nga Investitori (është emri i TAK, por pa firmë), në të cilën janë situacionuar ndryshime në 9 volume pune. Ky procesverbal nuk është i shoqëruar nga tabela e ndryshimeve (+/-), e cila do të saktësonte këto ndryshime me vlerat përkatëse dhe do

të ishte bazë për preventivin e ripunuar, i cili gjithashtu nuk administrohet në dosjen teknike. Sa sipër, ngarkohen me përgjegjësi Investitori (Bashkia Mirditë), mbikëqyrësi dhe sipërmarrësi i punimeve.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar,
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

<table>
<tr><td colspan="5">Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitimi i skemës ujitëse të ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza III)" Rrëshen", Bashkia Mirditë</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës<br>Nr. 3196 prot., datë 06.08.2019</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me tvsh)<br>47,196,085 lekë<br>OE fitues "A…" SHPK</td><td colspan="2">16.Likuiduar</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar<br>Vlera me tvsh 47,183,366 lekë<br>Vlera pa tvsh 39,319,472 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kotratës në dite<br>Parashikuar 3 muaj, Zbatuar 174 ditë.<br>Fillimi punimeve: 13.08.2019<br>Perfundimi punimeve : 05.02.2020</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës<br>Amendamenti nr. 1, me nr. 4432 prot., datë 30.10.2019<br>shtyrja 3 muaj.</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve<br>OE …" ShPK & "…" SHPK</td><td>Licenca Nr:<br>MK 1997/2</td><td>Kontrata nr. 2706, datë 27.06.2019</td><td>Likuiduar<br>lekë</td><td>Pa likuiduar</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve<br>Bashkim Mata PF</td><td>Licenca Nr:<br>MK 1127/2</td><td>Kontrata nuk ka</td><td>Likuiduar<br>(……lekë)</td><td>Pa likuiduar (……..<br>lekë)</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi<br>Datë 14.12.2020</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim dt<br>14.12.2020</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja Nr.... datë<br>………………lekë<br>(për mallrat)</td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **300,924 lekë pa tvsh**.

**Titulli i Gjetjes:** Diferencë në çmim në objektin "Rehabilitimi i skemës ujitëse të ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza III)" Rrëshen", Bashkia Mirditë, nga zbatuesi i punimeve BOE "A…" SHPK & "J…" SHPK, për zërin e punimeve 2.
**Situata:** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
-Ka patur diferenca në çmim në zërin e punës "Gërmim ekskavator shkëmb i butë për trase", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 3196 prot., datë 06.08.2019.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 2706, datë 27.06.2019.
- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, nëse ka.
**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Mirditë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
**Rëndësia**: E ulët
**Rekomandime:** Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 300,924 lekë pa tvsh nga BOE "A…" SHPK & "J…" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4616 prot., datë 23.10.2018 me objekt "Rehabilitimi i skemës ujitëse të ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza III)", Bashkia Mirditë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.
***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
1. Z. B. H., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. B. M., me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

**9. "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 2) Rrëshen", Bashkia Mirditë.**

*Kontratat*
Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 1282/16 prot., datë 13.07.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë, të përfaqësuar nga Kryetari z. N.D.dhe të OE "U…" ShPK, me përfaqësues ligjor z. N. Sh. me licencë profesionale NZ 1718/13. Vlera e kontratës është 362,526,402 lekë pa TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 11 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërimit (sheshi i ndërtimit është dorzuar në 22.08.2022).
Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1474/26, datë 15.07.2022, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE "E…" SHPK, me përfaqësues z. G.I., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1015/14 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 4,272,798 lekë me tvsh.
Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 1894/7 prot., datë 21.06.2023, është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me OE "N…" SHPK, me përfaqësues z. E. N., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1846/7 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 426,000 lekë me tvsh. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 20.07.2020.
Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen provizore në dorëzim me datë 23.06.2023, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga përfaqësuesit e autorizuar të investitorit me Urdhrin nr. 352, datë 05.02.2019, znj A. D. Inxhiniere, B. D. inxhinier dhe D.T. me profesion arkitekt dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë z. N. D.

*Projektpreventivi*
- Për këtë objekt, me Vendimin nr. 67, datë 22.08.2022 të Bashkisë Mirditë është miratuar leja e ndërtimit për këtë objekt.
- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga shoqëria fituese e zbatimit, për shkak të përzgjedhjes së kontratës "me çelësa në dorë" në vitin 2022 dhe miratuar nga Bashkia Mirditë.
Zbatimi i punimeve
Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 22.08.2022 dhe kanë përfunduar me datë 25.05.2023, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

- Në dosjen teknike administrohet procesverbalet e punimeve që shtohen/hiqen (+/-), të cilat janë miratuar nga Investitori. Nga ndryshimet në projekt, dhe verifikimi i procesverbalit (+/-), rezultojnë punime që shtohen/hiqen në vlerën 42,974,976 lekë. Ky ndryshim ka ndodhur për shkak të heqjes nga preventivi të dy objekteve private dhe shtimit të dy objekteve të tjera.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
1. Projekt i zbatimit
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

<table>
<tr><td colspan="5">Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 2) Rrëshen", Bashkia Mirditë</td></tr>
<tr><td>14.Lidhja e kontratës<br>Nr. 1282/16 prot., datë 13.07.2022</td><td colspan="2">15.Vlera e kontratës (me tvsh)<br>362,526,402 lekë<br>OE fitues "U…" ShPK</td><td colspan="2">16.Likuiduar</td></tr>
<tr><td>17- Situacioni Përfundimtar<br>Vlera pa tvsh 362,526,402 lekë</td><td colspan="2">18.Afati i kotratës në dite<br>Parashikuar 11 muaj, Zbatuar 185 ditë.<br>Fillimi punimeve: 22.08.2022<br>Perfundimi punimeve : 25.05.2023</td><td colspan="2">19. Zgjatja e kontratës<br>Nuk ka</td></tr>
<tr><td>20. Mbikëqyrësi i punimeve<br>OE …" SHPK</td><td>Licenca Nr:<br>MK 1015/10</td><td>Kontrata nr. 1474/26, datë 15.07.2022</td><td>Likuiduar<br>lekë</td><td>Pa likuiduar</td></tr>
<tr><td>21. Kolaudatori i punimeve<br>OE "N…" SHPK</td><td>Licenca Nr:<br>MK 1846/7</td><td>Kontrata nr. 1894/7 prot., datë 21.06.2023</td><td>Likuiduar<br>(......lekë)</td><td>Pa likuiduar (........ lekë)</td></tr>
<tr><td>22.Akt Kolaudimi<br>Datë 23.06.2023</td><td colspan="2">23.Akt i marrjes në dorëzim dt<br>23.06.2023</td><td colspan="2">24. Fletë Hyrja Nr.... datë<br>..................lekë (për mallrat)</td></tr>
</table>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **326,400 lekë pa tvsh**.

**<u>Titulli i Gjetjes:</u>** Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 2) Rrëshen", Bashkia Mirditë, nga zbatuesi i punimeve OE "U…" SHPK.
**<u>Situata:</u>** Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:
-Ka patur diferenca në volume në zërin e punës "Veshje fasade me polisterol t=5 cm + rrjetë+suva", për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.
**<u>Kriteri:</u>** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:
- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi", i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1282/16 prot., datë 13.07.2022.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1474/26, datë 15.07.2022.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 1894/7 prot., datë 21.06.2023.
**Ndikimi:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Mirditë.
**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.
**Rëndësia**: E ulët
**Rekomandime:** Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 326,400 lekë pa tvsh nga OE "U…" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1282/16 prot., datë 13.07.2022 me objekt "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 2) Rrëshen", Bashkia Mirditë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

***Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:***
1. Z. G. I., me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Z. E.N., me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

### 2.5 Mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

Bashkia Mirditë ka të miratuar **Planin e Përgjithshëm Vendor** dhe **Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit** me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 2, datë 20.06.2018 (e rishikuar me Vendim nr. 9, datë 14.10.2020).

**Lejet e ndërtimit dhe zhvillimit për periudhën 01.01.2019 - 31.12.2022**

Referuar të dhënave në sistemin elektronik *e-lejet* për Bashkinë Mirditë, rezulton se për afatin e auditimit **01.01.2019 deri në 31.12.2022**, ka pasur **383 aplikime në sistem për lloje të ndryshme lejesh** si: leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe çertifikata përdorimi, etj., përkatësisht 59 aplikime për leje zhvillimi, 88 për leje ndërtimi, 18 çertifikata përdorimi, 8 shtyrje afati leje ndërtimi, 96 deklarata paraprake per kryerje punimesh, 3 ndryshime funksioni, 4 rikonstruksione dhe 16 leje infrastrukture, të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Aneksin 1**.

*Aneksi 1: Tabela mbi aplikimet e kryera në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2019 – 31.12.2021*

| Lloji i lejes | Total | Miratuar | Refuzuar |
|---|---|---|---|
| Leje zhvillimi | 59 | 34 | 25 |
| Leje ndërtimi mbi 250m$^2$ | 11 | 5 | 6 |
| Leje ndërtimi deri 250m$^2$ | 77 | 26 | 51 |
| Deklaratë paraprake për kryerje punimesh | 96 | 66 | 30 |
| Rikonstruksion | 4 | 1 | 3 |
| Çertifikatë përdorimi | 18 | 13 | 5 |
| Shtesë në objekt ekzistues deri në 250 m$^2$ | 22 | 13 | 9 |
| Ndryshim projekti gjatë zbatimit | 4 | 4 | - |
| Ndryshim funksioni | 3 | 3 | - |
| Njoftim fillim punimesh | 40 | 39 | 1 |
| Shtyrje afati leje ndërtimi | 8 | 4 | 4 |
| Leje infrastrukture | 16 | 12 | 4 |

*Burimi: DPKZHT, Bashkia Mirditë* *Përpunoi: Grupi i auditimit*

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Mirditë, leje për ndërtim të ri me siparfaqe më të madhe se 250 $m^2$ janë miratuar **5 leje**, leje ndërtimi për shtësë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe me të madhe se 250 $m^2$ është miratuar **13 leje,** leje ndërtimi për shtësë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 $m^2$ janë miratuar **26 leje**, ndërsa leje ndërtimi për ndërtim të ri deri në 250 $m^2$ janë miratuar **26 leje**, të pasqyruara në tabelën e mësipërme.

Në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar rastet e mëposhtmë të lejeve të ndërtimit për ndërtime me sipërfaqe deri ose më të madhe se 250 $m^2$:

| Nr. | Objekti | Zhvilluesi | Data e lëshimit të lejes | Preventivi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Leje ndërtimi për ndërtim restorant dhe hotel, nr. pas 511, Zona Kadastrale 2125, në pronësi të "A. K." sh.p.k, me sipërfaqe të përgjithshme prone prej 4000 m2, Katund i Vjetër, 4603, Nj. Adm Rubik, Bashkia Mirditë | | 28.09.2022 | 19.908.445,00 lekë |
| 2 | Leje ndërtimi për kompleks shërbimesh në funksion të agroturizmit, nr. pas 352/1, Zona Kadastrale 2768, me sipërfaqe të përgjithshme prone prej 9998 m2, të marrë me kontratë noteriale qiraje nr. 599 rep, nr. 319 kol, datë 13.08.2021, adresë Ndërfanë, 4602, Nj. Adm. Rrëshen, Bashkia Mirditë | | 29.10.2021 | 19.998.945,00 lekë |
| 3 | Leje ndërtimi për godinë banimi 2 kat, në pasurinë nr. pas 71/3, Vol 1, faqe 222, Zona Kadastrale nr. 3219, Rreja e Zezë, Nj. Adm. Rubik, 4603, Bashkia Mirditë | | 08.10.2021 | 14.345.306,09 lekë |
| 4 | Leje ndërtimi për bujtinë, rikonstruksion dhe shtesë 2 kat + papafingo, në pasurinë nr. pas 307/1, Vol 2, faqe 171, Zona Kadastrale nr. 1513, Domgjon, Nj. Adm. Fan, 4608, Bashkia Mirditë. | | 09.11.2021 | 10.752.987,00 lekë |
| 5 | Leje ndërtimi për strukture për impiant uji 1 kat me mexaninë, në pronë të shoqërisë Z. – F. sh.p.k, nr. pas 287, vol 1, faqe 216, zona kadastrale 2943, fshati Petoq, Nj. Adm. Fan, 4608, Bashkia Mirditë | | 30.04.2021 | 32.886.137,00 lekë |
| 6 | Çertifikatë përdorimi për strukturë 2 kat, shërbim kati I – rë, bujtine kati II – të, në adresën fshati Katundi Vjetër, Nj. Adm. Rubik, 4603, Bashkia Mirditë | | 04.02.2021 | - |

Në lidhje auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

**Titulli i gjetjes 1:** Mosrespektimi i kondicioneve urbane.
**Situata:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë, distancat urbane ndërtesë – kufi prone, lartësia maksimale e lejuar e matur me metra dhe numër katesh, intensiteti i ndërtimit dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit. Më konkretisht, këto anomali janë konstatuar në rastet e mëposhtme:
**1.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr.75, nr. 3625/4 prot; datë 28.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Ndërtim restorant dhe hotel"*, me adresë Katund i Vjetër,

4603, Nj. Adm. Rubik, Bashkia Mirditë, me zhvillues "A…" ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

- *Duke qenë se objekti në zhvillim nuk klasifikohet ai agroturizëm, ai duhet të respektojë parametrat urban sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, Neni 35. Nga sa më sipër cituar, konstatohet se objekti me funksion restorant do të duhej të respektonte distancën minimale të përllogaritur sipas formulës d= nr. k +1m, pra 1k + 1m = 2m. Nga informacioni i marrë nga projekti ndërtimor, shprehemi se DPKZHT ka miratuar një leje ndertimi në kushtet e mosrespektimit të distancës minimale të lejuar, ($D_{lejuar}$ = 2m; $D_{miratuar}$ = 1.3; 1.6 m). Gjithashtu, objekti me funksion bujtinë nuk i respekton këto parametra, duke miratuar distancën $D_{miratuar}$ = 0.4; 0.5; 0.6; 0.8; 1.2m;, ndërkohë $D_{lejuar}$ = 3m.*

**2.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 83, nr. 3302 prot; datë 08.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Ndërtim godinë banimi 2 kat"*, me adresë Rreja e Zezë, Nj. Adm. Rubik, 4603, Mirditë, me subjekt zhvillues z. N.N., me problematika si më poshtë vijon:

- *Objekti i miratuar nuk respekton Intenistetin maksimal të lejuar (I) dhe Koeficientin e Shfrytëzimit të Territorit (KSHT). Parcela e marrë në studim bën pjesë në dy njësi strukturore, MR_UB_A2_183/1 dhe MR_B_BA1_498/1. Duke qenë se më shumë se 50% e sipërfaqes së saj i përket njësisë strukturore MR_B_BA1_498/1, objekti ka detyrimin e respektimit të parametrave urban të kësaj njësie. Nga informacioni i marrë nga pasaporta e njësisë strukurore, pjesë e PPV-së Bashkia Mirditë, rezulton se $I_{lejuar}$ = 0.25, ndërsa $I_{miratuar}$ = 0.6; $KSHT_{lejuar}$ = 25%; $KSHT_{miratuar}$ = 30.42%. Si përfundim, shprehemi se ky objekt nuk respekton asnjërin prej këtyre kondicioneve urbane, I dhe KSHT, në kundërshtim me Nenin 38, pika 1 i VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, Ligjin 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"", i ndryshuar, Neni 38, pika 1, si dhe në kundërshtim me pasaportën e njësisë strukturore MR_B_BA1_498/1, sipas Rregullores së Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Mirditë.*

**3.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 100, nr. 4459 prot; datë 09.11.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Bujtina Gj.Ll.i, rikonstruksion + shtesë 2 kt + p/fingo"*, me adresë në Domgjon, Nj. Adm. Fan, 4608, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues z. V.G. Ll., me problematika si më poshtë vijon:

- *Nga këqyrja e projektit ndërtimor dhe krahasimi i parametrave të tij urban me ato të lejuara sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe pasaportës së njësisë strukturore, konstatohet se ky objekt nuk respekton lartësinë maksimale të lejuar, e matur me metra dhe numër katesh. Më konkretisht, lartësia maksimale e lejuar për njësinë strukturore është $H_{lejuar}$ = 2 kate / 8 metra, ndërsa lartësia e objekti të miratuar është $H_{miratuar}$ = 3 kate / 10.2 metra, pa marrë në konsideratë çatinë, kjo në kundërshtim me kriteret urbane sipas Planit të Përgjithshëm Vendor për njësinë strukturore MR_UB_A2_343/2.*

- *Nga këqyrja e projektit ndërtimor dhe krahasimi i parametrave të tij urban me ato të lejuara sipas Planit të Përgjithshëm Vendor dhe pasaportës së njësisë strukturore, konstatohet se ky objekt nuk respekton Intensitetin maksimal të lejuar. Më konkretisht, Intensiteti maksimal i lejuar për njësinë strukturore është $I_{lejuar}$ = 1, ndërsa $I_{miratuar}$ = 1.3. Kjo vlerë është rrillogaritur duke marrë në konsideratë projektin ndërtimor, pasi vlera e Intensitetit e përcaktuar në dokumentat e procedurës së aplikimit është 1.15, dhe do të konsiderohet jo – e saktë, kjo në kundërshtim me kriteret urbane sipas Planit të Përgjithshëm Vendor për njësinë strukturore MR_UB_A2_343/2.*

**4.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin *"Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe*

*mure rrethues"*, me adresë në fshatin Petoq, Nj. Adm. Fan, 4608, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues “Z…” ShPK, me problematika si më poshtë vijon:
*- Objekti i miratuar zhvillohet në njësinë strukturore MR_B_BA1_893/2, në të cilën lejohen të ndërtohen struktura në funksion të banimit, bujqësisë, ekonomisë bujqësore, agroturizëm dhe struktura në funksion të bujqësisë. Në funksion të tyre, në Planin e Përgjithshëm Vendor janë parashikuar Intensitet maksimale të lejuara për secilën nga këto funksione, më konkretisht Imax për bujqësi dhe banim = 0.25; Imax për agroturizëm = 0.15; Imax për struktura në funksion të bujqësisë = 0.2. Referuar rishikimit të PPV-së, me Vendim nr. 9, datë 14.10.2020, shtohet një nënkategori e re, e cila lejon ndërtimin e objekteve që lidhen pazgjidhshmërisht me resurset, kategori tek e cila bën pjesë objekti në fjalë. Për këtë kategori nuk ka përcaktime të reja për Intensitetin maksimal të lejuar. Duke qenë në këto kushte, shprehemi se objekti i miratuar nuk respekton Intensitetin maksimal të lejuar për njësinë strukturore, më konkretisht* $I_{lejuar} = 0.25$, $I_{miratuar} = 0.56$.
*- Për të njëjtat arsye si më sipër, shprehemi se objekti i miratuar nuk respekton KSHT maksimal të lejuar për njësinë strukturore, më konkretisht* $KSHT_{lejuar} = 25\%$, $KSHT_{miratuar} = 53\%$.
**Kriteri:** VKM nr. 408, datë 13.5.2015, *“Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”,* i ndryshuar, Neni 35; Neni 38, pika 1; Ligji 107/2014, *“Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”*, i ndryshuar, Neni 38, pika 1; Rregullorja e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mirditë, e ndryshuar, pasaportat e njësive strukturore MR_B_BA1_498/1, MR_UB_A2_343/2, MR_B_BA1_893/2.
**Ndikimi/Efekti**: Mosrespektimi i parametrave urban ndikon në zhvillimin e kontrolluar urban, duke cënuar parametra të përcaktuar në legjislacion dhe rregullore, si dhe duke ndikuar negativisht në stantartet ndërtimore, kushtet e sigurisë, higjenës, ato mjedisore dhe urbanistike.
**Shkaku:** Neglizhencë dhe mosrespektim i kuadrit ligjor nga ana e DPKZHT, Bashkia Mirditë.
**Rëndësia**: E lartë
**Rekomandime**: Nga DPKZHT, Bashkia Mirditë të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon, të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk i plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara në dispozitat ligjore.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
**- znj. A. D.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
**- z. J. K.**, në funksionin e kontrolluesit të shqyrtimit të aplikimeve pranë DPKZHT;
**- z. B. D.**, në funksionin e përgjegjësit të sektorit pranë DPKZHT;
**- z. N. D.**, në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Mirditë.

**Titulli i gjetjes 2:** Mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi dhe çertifikatë përdorimi.
**Situata:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit u konstatua se në gjashtë raste të audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë dhe i saktë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues, si dhe në dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi dhe përdorimi, më konkretisht:

**1.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr.75, nr. 3625/4 prot; datë 28.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Ndërtim restorant dhe hotel"*, me adresë Katund i Vjetër, 4603, Nj. Adm. Rubik, Bashkia Mirditë, me zhvillues "…" ShPK, me problematika si më poshtë vijon:
*- Për objektin me funksion bujtinë mungojnë fasadat teknike, detaje teknike, pamjet tre dimensionale, kjo në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, i ndryshuar, datë 13.05.2015, pika 1/1, nënpika i).*
*- Për objektin me funksion restorant mungon i gjithë projekti i instalimeve të ngrohje - ftohjes, kjo në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, i ndryshuar, datë 13.05.2015, pika 1/1, nënpika iii).*
*- Për objektin me funksion bujtinë mungon i gjithë projekti i mbrojtjes ndaj zjarrit, kjo në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, i ndryshuar, datë 13.05.2015, pika 1/1, nënpika iv).*
*- Në projektin arkitektonik nuk është paraqitur kati nëntokë, i cili është paraqitur në projektin konstruktiv. Gjithashtu në titullin e lejes së ndërtimit nuk citohet se objekti me funksion restorant ka një kat nëntokë, e gjithë kjo në kundërshtim me Nenin 14 të VKM-së nr. 408, i ndryshuar, datë 13.05.2015, pika 1.*
*- Nga auditimi i dokumentacionit të detyrueshëm për miratimin e lejeve të ndërtimit, konstatohet se jo i gjithë dokumentacioni i ngarkuar është i nënshkruar elektronikisht, kjo në kundërshtim me Nenin 26 të VKM-së nr. 408, i ndryshuar, datë 13.05.2015, pika 5.*
*- Mungon rilevimi topografik, nga topograf i licencuar, kjo në kundërshtim me Nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç).*
*- Objekti nuk respekton përcaktimet ligjore të Vendimit nr. 457,datë 29.6.2022, "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 408, datë 13.05.2015, të Këshillit të Ministrave...", Neni 13, ku kërkohet dorëzimi i projektit ndërtimor në formatin DËG.*
*- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e raportit të vlerësimit në mjedis, kjo në kundërshtim me Nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika g).*
*- Mungojnë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për ushtrimin e aktivitetit për pjesën më të madhe të hartuesve të projekteve ndërtimore, kjo në kundërshtim me Nenit 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë).*
**2.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 96, nr. 3581/6 prot; datë 29.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Kompleks shërbimesh në funksion të agroturizmit"*, me adresë në Ndërfanë, 4602, Nj. Adm. Rrëshen, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues "…" ShPK, me problematika si më poshtë vijon:
*- Plani i rilevimit nuk është i plotësuar me të gjitha detajet e nevojshme, pasi, në zbatim të Nenit 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, duhet të paraqesë konturin e pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të parcelës dhe parcelave kufitare. Gjithashtu ky plan duhet të paraqesë edhe të dhëna mbi rrugët, gjerësinë e tyre, si dhe madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione.*
*- Mungon plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzsituese, dokument i cili jep të dhëna mbi raportin e objektit/objekteve në zhvillimi dhe parcelës, aksesit për në pronë, si dhe të dhëna mbi respektimin e parametrave urbanë, siç janë distancat. Konstatimi i mësipërm është në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika c).*
*- Mungon vërtetimi i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për audituesin e eficencës energjitike të licencuar, kjo në*

*kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika ë) dhe g).*

*- Polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesen e raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, kjo në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika g).*

**3.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 83, nr. 3302 prot; datë 08.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Ndërtim godinë banimi 2 kat"*, me adresë Rreja e Zezë, Nj. Adm. Rubik, 4603, Mirditë, me subjekt zhvillues z. N. N., me problematika si më poshtë vijon:

*- Kartela e pasurisë së paluajtëshme nuk është e rifreskuar përgjatë tre muajve të fundit, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.111/2018 "Për kadastrën", Neni 17 "Certifikatat", pika 4 dhe 6, VKM-së nr. 457, datë 29.6.2022, Neni 18 dhe 21, si dhe VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, Neni 45, pika c). Nga auditimi i kësaj procedure, u konstatua se kartela është rifreskuar në datën 22/02/2021, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 29.08.2021, pra me një diferencë kohore më të madhe se tre muaj.*

*- Projekti arkitektonik nuk është i plotësuar me të gjitha detajet e nevojshme, pasi mungojnë prerje, fasada dhe detaje teknike, kjo në kundërshtim me Nenin 14, pika 1, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar.*

*- Mungon projekti i instalimeve të ngrohje – ftohjes, së bashku me dokumentacionin shoqërues, kjo në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1/1, nënpika iii), gjithashtu pika 1, nënpika ç), e), ë), g).*

*- Mungon vërtetimi i regjistrimit në QKB për të gjithë subjektet që kanë hartuar projektin ndërtimor, përveç hartuesit të projektit elektrik, kjo në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë).*

*- Mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit hidraulik, kjo në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika e).*

*- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesit e raportit të auditimit të eficencës energjitike dhe rilevimit topografik, kjo në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika g).*

**4.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 100, nr. 4459 prot; datë 09.11.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Bujtina Gj.Ll., rikonstruksion + shtesë 2 kt + p/fingo"*, me adresë në Domgjon, Nj. Adm. Fan, 4608, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues z. V. Gj. Ll., me problematika si më poshtë vijon:

*- Nuk është evidentuar gjendja faktike ekzistuese e objektit tek i cili do të do të kryhet rikonstruksioni dhe shtimi i volumeve. Gjithashtu, nga këqyrja e fotografimit satelitor, për parcelën në të cilën do të zhvillohet ndërtimi, konstatohet se nuk ka një objekt mbi të cilin do të kryhet rikonstruksioni dhe shtimi i volumeve. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me qëllimin e lejes së ndërtimit për rikonstruksion dhe shtesë në objekt ekzistues, më konkretisht në kundërshtim me Nenit 13, pika 1, Neni 29, të Ligjit 107/2014, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"", i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme të Bashkisë Mirditë, nr. 4600 prot; datë 27.10.2022, Neni 27, pika 1, nënpika a), si dhe Neni 3.1, pika k)*

*- Mungon projekti i instalimeve të ngrohje-ftohjes (H-VAC), së bashku me relacionin, preventivin për pjesën takuese dhe dokumentat shoqëruese, kjo në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1/1, nënpika iii), pika 1, nënpika dh), e), ë), g);*

*- Mungon rilevimi topografik, së bashku me deklaratën e përgjegjësisë profesionale, kjo në kundërshtim me Nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç), duke qenë se ky objekt nuk ka nevojë për leje zhvillimi, si dhe Nenin 15 i po këtij vendimi, pika 1, nënpika g);*
*- Mungon dokumenti i regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për subjektet që kanë hartuar projektin arkitektonik, konstruktiv, elektrik dhe hidraulik, kjo në kundërshtime me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);*
*- Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale për hartuesin e projektit hidraulik, kjo në kundërshtime me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika g).*
*- Mungon prokura ose autorizimi nga ana e zhvilluesit për aplikantin, kjo në kundërshtim me Nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika b), duke qenë se ky objekt nuk ka nevojë për leje zhvillimi.*
*- Relacioni i projektit konstruktiv gjendet në dy kopje, njëri prej tyre i nënshkruar elektronikisht nga ing. M. C. në datë 05.11.2021, ndërsa tjetri është nënshkruar elektronikisht nga znj. A. D., datë 15.04.2021, aktualisht dhe në kohën e nënshkrimit, me funksionin e drejtoreshës së DPKZHT, Bashkia Mirditë, veprim ky në kundërshtim me Nenin 1 "Qëllimi", të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar.*
**5.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin *"Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe mure rrethues"*, me adresë në fshatin Petoq, Nj. Adm. Fan, 4608, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues "…" ShPK, me problematika si më poshtë vijon:
*- Mungon rilevimi topografik. Edhe pse rilevimi topografik nuk është pjesë e dokumentacionit të kërkuar në mënyrë emërore për aplikimet për pajisje me leje ndërtimi, ai duhet të jetë pjesë e planvendosjes së miratuar në lejen e zhvillimit, kjo në kundërshtim me Nenin 10 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, pika 1, nënpika ç).*
*- Raporti i auditimit të eficencës energjitike dhe çertifikata përfundimtare e saj nuk janë të nënshkruara elektronikisht në mënyrë të rregullt, pasi të dy këto dokumenta janë të skanuar, gjithashtu edhe nënshkrimi elektronik është i skanuar. Vlen të theksohet se aplikanti dhe hartuesi i raportit të auditimit të eficencës energjitike nuk kanë ngarkuar në sistem asnjë nga dokumentacioni shoqërues, siç janë vërtetimi i regjistrimit në QKB, ekstrakt historik / i thjeshtë i subjektit, licenca e audituesit AEE, deklaratë e përgjegjësisë profesionale, policën e sigurimit të përgjegjësisë profesionale. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Nenin 9 të Ligjit nr.9880, datë 25.02.2008, si dhe në kundërshtim me Nenin 6 të Ligjit nr. 10 273, datë 29.04.2010.*
*- Kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhornuara gjatë 3 muajve të fundit, në kundërshtim me Ligjin nr.111/2018 "Për kadastrën", Neni 17 "Certifikatat", pika 4 dhe 6, si dhe VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, Neni 45, pika c). Nga auditimi i kësaj procedure, vihet re se kartela e pasurisë së paluajtshme është rifreskuar në datën 11.07.2019, ndërsa aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 27.03.2021.*
*- Për hartuesin e projektit arkitektonik, mungojnë vërtetimi i regjistrimit në QKB, licenca profesionale, deklarata e përgjegjësisë profesionale, polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale; Për hartuesin e projektit konstruktiv, mungon vërtetimi i regjistrimit në QKB; Për hartuesin e projektit hidraulik, mungojnë relacioni i projektit, vërtetimi i regjistrimit në QKB, polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale; Për hartuesin e raportit të auditimit të eficencës energjitike mungojnë vërtetimi i regjistrimit në QKB, licenca profesionale, deklarata e përgjegjësisë profesionale, polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale; Për*

*hartuesin e raportit të vlerësimit të ndikimit nëmjedis, mungojnë deklarata e përgjegjësisë profesionale, polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale; Për hartuesin e studimit sizmiko-gjeologjik, mungojnë deklarata e përgjegjësisë profesionale, polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale. Konstatimet e mësipërme janë në kundershtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika ç), e), ë) dhe g).*

**6.** Çertifikatë përdorimi miratuar me vendim rr. 6, nr. 4959 prot; datë 04.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë për objektin *"Strukturë 2kt, shërbim kati I-rë, bujtinë kati II-të"*, në adresën fshati Katundi i Vjetër, Nj. Adm. Rubik, 4603, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues z. K.M., me problematika si më poshtë vijon:

*- Aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit nuk janë të plota, pasi mungojnë akti i kontrollit të ngritjes së kantierit të punimeve, përfshirë murin rrethues; përfundimi i fasadave dhe rifiniturave të strukturës së re, përfshirë instalimet elektrike, të ngrohjes, ftohjes, hidraulike, të komunikimit elektronik; përfundimi i sistemimit të jashtëm, në planin e vendosjes së strukturës së re, përfshirë vendosjen e kutisë postare dhe lidhjen me infrastrukturat publike ekzistuese, këto në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 27/1, pika 1.*

*- Mungon akti përkatës i lëshuar nga institucionet kompetente për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika ë).*

*- Mungon akti përkatës i lëshuar nga shoqëria "Ujësjellës-Kanalizime" ShA, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika ë).*

*- Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë planimetria e katit papafingo, prerjet, fasadat dhe detajet teknike, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika g).*

*- Mungon projekti as-built, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika g). Projekti as-built, duhet të ngarkohet në çdo rast kur objekti nuk ka respektuar projektin arkitektonik të miratuar.*

*- Projekti për mirëmbajtjen e objektit nuk është i plotë, pasi mungojnë të dhënat mbi objektin dhe profesionistët që kanë realizuar projektet dhe objektin, nuk ka të dhëna mbi manualin e përdoruesit, manualin e mirëmbajtjes dhe afatet e mirëmbajtjes, gjithashtu nuk ka të dhëna për nënzërat e secilit kapitull, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 27/2, pika 1, nënpika gj).*

**Kriteri:** VKM nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, Neni 10, pika 1, nënpika b), ç); Neni 14, pika 1; Neni 15, pika 1, nënpika c), ç), dh), e), ë), g), pika 1/1, nënpika i), iii), iv); Neni 26, pika 5; Neni 27/1, pika 1, nënpika ë); Neni 27/2, pika 1, nënpika ë), g), gj); VKM nr. 457, datë 29.06.2022, *"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.05.2015...",* Neni 13, Neni 18, Neni 21; Ligji nr.111/2018 *"Për kadastrën",* Neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6; Ligji 107/2014, *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit",* i ndryshuar, Neni 13, pika 1; Neni 29; Rregullore e Brendshme e Bashkisë Mirditë, nr. 4600 prot; datë 27.10.2022, Neni 27, pika 1, nënpika a); Neni 3.1, pika k); Ligji nr. 9880, datë 25.02.2008, *"Për nënshkrimin elektronik",* i ndryshuar, Neni 9; Ligji nr. 10 273, datë 29.04.2010, *"Për dokumentin elektronik"*, i ndryshuar, Neni 6.

**Ndikimi/Efekti:** Mangësitë në projektin ndërtimor, si dhe në dokumentacionin shoqërues të tij, ndikojnë në cilësinë dhe garatimin e ndërtimeve sipas standarteve, kushteve higjeno-sanitare dhe të sigurisë, nga subjekte të cilat duhet të plotësojnë kriteret e ushtrimit të profesionit, sipas legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, mungesat ose parregullsitë në

dokumentacionin e kërkuar me ligj për aplikimin për pajisje me leje ndërtimi dhe përdorimi ndikon në dhënien e garancisë mbi zhvillimin e kontrolluar të territorit, sipas planeve ose rregulloreve të miratuara.
**Shkaku:** Neglizhencë dhe moszbatim i kuadrit lligjor dhe rregullator në fuqi, nga ana e DPKZHT Mirditë.
**Rëndësia**: E lartë
**Rekomandime**: **1.** Nga DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi ose përdorimi me mangësi si, policat dhe deklaratat e përgjegjësisë profesionale, licencat profesionale, projektet teknike që përbëjnë projektin ndërtimor, plani i rilevimit, projekti arkitektonik në formatin DËG, plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzsituese, kartelat e pasurisë së paluajtëshme të rifreskuara përgjatë tre muajve të fundit, etj. DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të marri masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, si dhe vlefshmërinë sipas afateve për ato dokumenta që kanë përcaktime ligjore mbi vlefshmërinë.
**2.** Nga DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të merren masa të kërkojnë në çdo rast vërtetimin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për subjektet që kanë hartuar projektet ndërtimore, si dhe vërtetimet mbi statusin e subjekteve, sipas kuadrit ligjor në fuqi, për të marrë sigurinë e nevojshme se këto subjekte kanë të drejtën e ushtrimit të aktivitetit.
**3.** Nga DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të merren masa për të kontrolluar nënshkrimin elektronik në të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e-lejet, të vërtetojë nëse këto dokumenta janë nënshkruar ose jo elektronikisht, nëse ky nënshkrim është kryer sipas përcaktimeve ligjore dhe nëse është kryer nga personat përgjegjës për hartimin e këtyre dokumentave.
**4.** Nga DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të merren masa, që për të gjitha aplikimet për ndërhyrje në objekte ekzistuese, si shtesa anësore ose në lartësi, të kryejnë verifikime në terren për ekvidentimin e gjendjes ekzistuese të objektet, si dhe të kërkojnë evidentimin e kësaj gjendjeje në të gjitha projektet teknike që në tërësinë e tyre përbëjnë projektin ndërtimor.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
**- znj. A. D.**në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
**- z. J. K.**, në funksionin e kontrolluesit të shqyrtimit të aplikimeve pranë DPKZHT;
**- z. B. D.**, në funksionin e përgjegjësit të sektorit pranë DPKZHT;
**- z. N.D.**, në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Mirditë.

**Titulli i gjetjes 3:** DPKZHT dhe Bashkia Mirditë nuk ka kërkuar dhe / ose respektuar mendimin e autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.
**Situata:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste të audituara, nuk është kërkuar dhe / ose respektuar mendimi i autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, më konkretisht:
**1.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr.75, nr. 3625/4 prot; datë 28.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Ndërtim restorant dhe hotel"*, me adresë Katund i Vjetër,

4603, Nj. Adm. Rubik, Bashkia Mirditë, me zhvillues "…" ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

*- Parcela mbi të cilën zhvillohet objekti shtrihet mbi dy njësi strukturore të sistemeve të ndryshme, urban dhe bujqësore. Si e tillë, në rishikimin e PPV-së për Bashkinë Mirditë, me Vendim nr. 9, datë 14.10.2020, në pikën 2, nënpika c, përcaktohet se lejohet zhvillimi i aktiviteteve agro-turistike në njësitë strukturore të sistemit urban, bujqësor dhe natyror, me kushtin që duhet të bashkërendojnë dhe të marrin konformitetin nga institucionet përgjegjëse për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe zonave të rëndësisë kombëtare. Si përfundim, shprehemi se DPKZHT dhe Bashkia Mirditë nuk kanë kërkuar mendimin e AKZM-së, si dhe nuk kanë marrë konformitetin nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, por janë mjaftuar me miratimin në heshtje nga ana e kësaj të fundit, kjo në kundërshtim me dokumentin e rishikimit të PPV-së për Bashkinë Mirditë, me Vendim nr. 9, datë 14.10.2020, në pikën 2, nënpika c, si dhe në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 10/1, pika 6. Gjithashtu, AKM është shprehur me anë të shkresës me lëndë "Mbi aplikimin AN150820220104, në sistemin e-leje, të subjektit "E.", se ky objekt duhet t'i nënshtrohet Procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Edhe pse objekti është pajisur me raportin e vlerësimit në mjedis, hartuar nga ekspert mjedisi i licencuar, nuk është rikërkuar mendimi i AKM-së, për të marrë miratimin e saj për vazhdimin e procedurave.*

**2.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 96, nr. 3581/6 prot; datë 29.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Kompleks shërbimesh në funksion të agroturizmit"*, me adresë në Ndërfanë, 4602, Nj. Adm. Rrëshen, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues "…" ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

*- Nga auditimi i ushtruar mbi praktikën e miratimit të kësaj leje ndërtimi, konstatohet se nuk i është kërkuar mendimi të gjithë autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, siç janë Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM), duke qenë se parcela shtrihet pranë një resursi ujor, Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT), Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) ose Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), duke qenë se në prani të parcelës në zhvillim ka një hidrocentral, Policia për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH), Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), si dhe operatori Ujësjellës Kanalizime rajonal (UK). Gjithashtu, në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, nuk u gjet asnjë dokument nga ana e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM), që të vërtetojë dhënien e miratimit nga ana e këtij autoriteti për vazhdimin e procedurave për miratimin e lejes së ndërtimit. AKM është shprehur me anë të shkresës me lëndë: "Mbi aplikimin AN200920210027, në sistemin e-leje, subjektit "E.", se procedura është në proçes shqyrtimi për Procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Edhe në këto kushte, Bashkia Mirditë ka vazhduar me miratimin e kësaj leje ndërtimi. Konstatimi i mësipërm është në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 10/1, pika 6.*

**3.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 83, nr. 3302 prot; datë 08.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Ndërtim godinë banimi 2 kat"*, me adresë Rreja e Zezë, Nj. Adm. Rubik, 4603, Mirditë, me subjekt zhvillues z. N. N., me problematika si më poshtë vijon:

*- Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 10/1, pika 6, DPKZHT ka kërkuar mendimin e tyre përgjatë procedurës së aplikimit për pajisje me leje zhvillimi. Në kthim – përgjigje me nr. 70 prot; datë 18.03.2021, UPT IGJEUM shprehet se subjekti duhet të realizojë studimet "Inxhiniero-Sizmologjik" dhe "Gjeologo-Inxhinierik", që më pas ky autoritet të shprehi mendim për studimin në fjalë. Këto studime nuk u gjendën në procedurën*

*e aplikimit për pajisje me leje ndërtimi, gjithashtu nuk i është rikërkuar mendim këtij autoriteti.*

**4.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin *"Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe mure rrethues"*, me adresë në fshatin Petoq, Nj. Adm. Fan, 4608, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues "…" ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

*Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 10/1, pika 6 dhe nga shyrtimi i dokumentacionit për aplikimin për pajisje me leje zhvillimi dhe leje ndërtimi, shprehemi se:*

*- Nuk është respektuar mendimi i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, e cila ka njoftuar aplikantin dhe zhvilluesin në kthim-përgjigjen e dërguar gjatë fazës së aplikimit për leje zhvillimi se subjekti, paraprakisht, duhet të aplikojë për leje përdorimi burimi ujor për imbotilim, nëpërmjet sistemit e-albania, "Aplikim për përdorim burimi ujor". Një dokument i tillë nuk u gjet në asnjë prej procedurave të aplikimit për pajisje me leje zhvillimi / ndërtimi, kjo në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, i ndryshuar, Neni 10/1, pika 6. Mungesa e lejes së përdorimit të burimeve ujore për imbotilim është në kundërshtim me Ligjin nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar, Neni 33; VKM-në nr. 550, datë 15.07.2020, "Për miratimin e formularëve për miratimin, në parim, për dhënien me koncension..." pika III.*

*- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) është shprehur në kthim – përgjigjen gjatë fazës së aplikimit për pajisje me leje zhvillimi se objekti nën shqyrtim duhet t'i nënshtrohet procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Edhe pse aplikanti ka ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve raportin e vlerësimit të ndikimit në mjedis të hartuar nga ekspert mjedisor i licencuar, nuk i është rikërkuar mendimi këtij autoriteti për dhënien e konformitetit dhe lejes mjedisore.*

*Vlen të theksohet se Bashkia Mirditë dhe DPKZHT kanë njoftuar aplikantin se duhet të plotësojnë dokumentacionin e kërkuar nga autoritetet. Edhe pse në kushtet e mosplotësimit të këtyre kërkesave, është proceduar me miratimin e lejes së zhvillimit dhe ndërtimit.*

*- Nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Eficencës Energjitike.*

**Kriteri:** VKM nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit",* i ndryshuar, Neni 10/1 *"Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi"*, pika 6; Plani i Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Mirditë, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 2, datë 20.06.2018 (e rishikuar me Vendim nr. 9, datë 14.10.2020), dokumenti i rishikimit, pika 2, nënpika c); Ligji nr. 111/2012, *"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"*, i ndryshuar, Neni 33; VKM nr. 550, datë 15.07.2020, *"Për miratimin e formularëve për miratimin, në parim, për dhënien me koncension..."*, pika III.

**Ndikimi/Efekti**: Mosmarrja e mendimit nga të gjithë autoritetet të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, ndikon në zhvillimin e pakontrolluar dhe të paplanifikuar të territorit, cënon kompetencat e që ligji ju njeh këtyre autoriteteve, si dhe cënon infrastrukturën dhe projektet e këtyre autoriteteve.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT Mirditë

**Rëndësia**: E lartë

**Rekomandime**: Nga DPKZHT Mirditë të merren masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, sipas rastit. Gjithashtu, DPKZHT Mirditë, të shqyrtojë me përparësi të gjitha kërkesat e parashtruara nga këto autoritete dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi deri në plotësimin e kërkesave.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
**- znj. A. D.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
**- z. J.K.**, në funksionin e kontrolluesit të shqyrtimit të aplikimeve pranë DPKZHT;
**- z. B.D.**, në funksionin e përgjegjësit të sektorit pranë DPKZHT;
**- z. N. D.**, në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Mirditë.

**Titulli i gjetjes 4:** Zhvilluesi ka filluar ndërtimin e objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit.
**Situata:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një nga rastet e audituara, zhvilluesi ka filluar ndërtimin e objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, më konkretisht:
**1.** Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin *"Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe mure rrethues"*, me adresë në fshatin Petoq, Nj. Adm. Fan, 4608, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues "…" ShPK, me problematika si më poshtë vijon:
*- Objekti ka filluar ndërtimin përpara pajisjes me leje ndërtimi. Leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 30.04.2021. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Korrik, 2019, vihet re se objekti ka qënë në fazë ndërtimi. Pra, subjekti zhvillues e ka filluar ndërtimin e objektit pa marrë miratimin e autoriteti përgjegjës, në këtë rast Bashkia Mirditë, kjo në shkelje të Nenit 39 të Ligjit 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.*
**Kriteri:** Ligji 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*", i ndryshuar, Neni 39.
**Ndikimi/Efekti**: Lejimi i zhvillimit të objekteve në mungesë të lejeve të posaçme, si dhe miratimi i lejeve të ndërtimit në ato raste kur ndërtimi ka filluar përpara marrjes së miratimit për të ndërtuar cënon qëllimin e vet lejes së ndërtimit, që është marrja e sigurisë së domosdoshme mbi sigurinë, qëndrueshmërinë, respektimin e parametrave urban dhe të të drejtës mbi pronës, si dhe të kushteve higjeno – sanitare, sipas legjislacionit në fuqi.
**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT Mirditë
**Rëndësia**: E lartë
**Rekomandime**: Bashkia Mirditë dhe DPKZHT të marrë masa dhe të përdorë të gjithë instrumentat për të kryer kontrollet e nevojshme deri në marrjen e sigurisë së plotë se objektet për të cilat aplikohet për leje zhvillimi / ndërtimi nuk kanë filluar ndërtimin pa marrë miratimet e nevojshme sipas ligjit. Në çdo rast të evidentuar, Bashkia Mirditë, DPKZHT dhe IMTV duhet të ndjekin procedurat ligjore për të gjithë ata subjekte që zhvillojnë objekte pa miratimin e organeve kompetente.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:
**- znj. A.D.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
**- z. J. K.**, në funksionin e kontrolluesit të shqyrtimit të aplikimeve pranë DPKZHT;
**- z. B. D.**, në funksionin e përgjegjësit të sektorit pranë DPKZHT;
**- z. N.D.**, në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Mirditë.

**Titulli i gjetjes 5:** Objekti i ndërtuar dhe i pajisur me çertifikatë përdorimi, ndryshon nga projekti i miratuar.

**Situata:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të çertifikatave të përdorimit u konstatua se në një nga rastet e audituara, objekti i ndërtuar dhe i pajisur me çertifikatë përdorimi, ndryshon nga projekti i miratuar, më konkretisht:

**1.** Çertifikatë përdorimi miratuar me vendim rr. 6, nr. 4959 prot; datë 04.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë për objektin *"Strukturë 2kt, shërbim kati I-rë, bujtinë kati II-të"*, në adresën fshati Katundi i Vjetër, Nj. Adm. Rubik, 4603, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues z. K. M., me problematika si më poshtë vijon:

*- Nga verifikimi në terren dhe këqyrja e dokumentacionit fotografik të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, objekti nuk është zbatuar sipas projektit të miratuar, pasi në fasadën lindore dhe perëndimore, kati papafingo, janë realizuar çarje të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në projektin e miratuar. Gjithashtu në fasadën veriore konstatohet ndërtimi i një hapësire, i përbërë nga mure dhe soletë beton/arme, të paparashikuar në projektin e miratuar, e cila lidh objektin me murin mbajtës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Nenin 39 të Ligjit 107/2014, "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.*

**Kriteri:** Ligji 107/2014*, "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit",*i ndryshuar, Neni 42, pika 1; Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007, *"Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme",* i ndryshuar, Neni 1.

**Ndikimi/Efekti**: Shmangiet e konstatuar midis objektit të zhvilluar dhe projektit të miratuar ndikojnë në zhvillimin e kontrolluar të territorit, cenojnë parametrat urban, kushtet e sigurisë dhe ato higjeno – sanitare.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPKZHT  Mirditë

**Rëndësia**: E lartë

**Rekomandime**: Bashkia Mirditë, DPKZHT dhe IMTV të marrin masa për të mos lejuar asnjë objekt në zhvillim të devijojë nga projekti i miratuar, në kushtet e mungesës së lejeve të posaçme. Bashkia Mirditë të mos miratojnë asnjë çertifikatë përdorimi kur konstatohet se ky objekt ka shmangie nga projekti i miratuar, pa proceduar paraprakisht me ndjekjen e hapave ligjor, deri në ndryshimin e objektit sipas projektit të miratuar, si dhe ndëshkimin e personave përgjegjës.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

**- znj. A. D.**, në funksionin e drejtorit të DPKZHT;
**- z. J. K.**, në funksionin e kontrolluesit të shqyrtimit të aplikimeve pranë DPKZHT;
**- z. B. D.**, në funksionin e përgjegjësit të sektorit pranë DPKZHT;
**- z. N. D.**, në funksionin e Kryetarit të Bashkisë Mirditë.

***Konkluzion i përgjithshëm mbi miratimin e lejeve të ndërtimit dhe çertifikatave të përdorimit:***

**1.** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë, distancat urbane ndërtesë – kufi prone, lartësia maksimale e lejuar e matur me metra dhe numër katesh, intensiteti i ndërtimit dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit.

**2.** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit u konstatua se në gjashtë raste të audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, siç janë, mangësi në rilevimin topografik, mangësi në projektet ndërtimore dhe relacionet teknike të tyre, licencat profesionale të hartuesve të projekteve, deklaratat e përgjegjësisë profesionale, polica e sigurimit të përgjegjësisë profesionale,

mangësi në dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve, projekti ndërtimor në formatin DËG, problematika me rifresikimin e kartelave të pasurisë së paluajtshme. Në një rast, Relacioni i projektit konstruktiv është nënshkruar elektronikisht nga **znj. A. D.**, datë 15.04.2021, aktualisht dhe në kohën e nënshkrimit, me funksionin e drejtoreshës së DPKZHT, Bashkia Mirditë.

**3.** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste të audituara, DPKZHT dhe Bashkia Mirditë nuk kanë kërkuar dhe/ose respektuar mendimin e autoriteteve të tjera publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Edhe në rastet kur këto autoritete janë shprehur se projektet ndërtimore duhet të plotësohen me dokumentacion shtesë ose duhet të reflektojnë ndryshime, DPKZHT ka proceduar me miratimin e lejeve, pa marrë në konsideratë sugjerimet e autoriteteve.

**4.** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në 1 rast, zhvilluesi e ka filluar ndërtimin e objektit përpara pajisjes me leje ndërtimi, më konkretisht, për lejen e ndërtimit miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin "Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe mure rrethues", me adresë në fshatin Petoq, Nj. Adm. Fan, 4608, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues "…" ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

*Objekti ka filluar ndërtimin përpara pajisjes me leje ndërtimi. Leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 30.04.2021. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Korrik, 2019, vihet re se objekti ka qënë në fazë ndërtimi. Pra, subjekti zhvillues e ka filluar ndërtimin e objektit pa marrë miratimin e autoriteti përgjegjës, në këtë rast Bashkia Mirditë.*

**5.** Nga auditimi i procedurave të miratimit të çertifikatave të përdorimit u konstatua se në një rast të audituar, ka ndryshime midis projektit të miratuar dhe objektit të ndërtuar, më konkretisht për çertifikatën e përdorimit miratuar me vendim rr. 6, nr. 4959 prot; datë 04.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë për objektin "Strukturë 2kt, shërbim kati I-rë, bujtinë kati II-të", në adresën fshati Katundi i Vjetër, Nj. Adm. Rubik, 4603, Bashkia Mirditë, me subjekt zhvillues z. K. M., me problematika si më poshtë vijon:

*Nga verifikimi në terren dhe këqyrja e dokumentacionit fotografik të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, objekti nuk është zbatuar sipas projektit të miratuar, pasi në fasadën lindore dhe perëndimore, kati papafingo, janë realizuar çarje të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në projektin e miratuar. Gjithashtu në fasadën veriore konstatohet ndërtimi i një hapësire, i përbërë nga mure dhe soletë beton/arme, të paparashikuar në projektin e miratuar, e cila lidh objektin me murin mbajtës.*

### 2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtes së Territorit.

Inspektoriati i Mbrojtjes Territorit në Bashkinë Mirditë është i organizuar në nivel qendër dhe njësie administrative sipas tabelës së mëposhtëme;

| Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV) | Emër Mbiemër | Periudha Kohore |
|---|---|---|
| Kryeinspektor | | 15.04.2016 - Vazhdon |
| Inspektor i Mbrojtjes së Territorit | | 08.10.2012-Vazhdon |
| Inspektor i Mbrojtjes së Territorit | | 25.11.2020-Vazhdon |
| Inspektor i Mbrojtjes së Territorit | | 18.09.2018-2023 Larguar |

Arsimimi i kryeinspektorit të IMTV Bashkia Mirditë është në përputhje me ligjin 9780, Ndërsa arsimimi Inspektorit **G. Ll.** nuk është konform kërkesës së Nenit 11 të ligjit 9780 ku përcaktohet se : Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisje vendore

duhet të kenë arsimin e lartë të ndryshëm professional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit. Nga të dhënat e marra nga drejtoria e burimeve njerëzore, është konstatuar se inspektori G. Ll. është diplomuar në Universitetin e Tiranës si Specialist i Gjeografisë dhe jo në përputhje me ligjin.
Në bazë te process-verbaleve të kundravajtjes,vendimeve të gjobave,vendimeve të prishjeve të objekteve të kundraligjshëm, të vëna në dispozicion nga IMTV bashkia Mirditë janë ilustruar si më poshtë.

| **Nr. PV** | **Data-Viti** | **Subjekti** | **Kundërvajtja** | **Vendim/gjobe 000/lekë.** | **Vendim Prishje** | **Vendim Pezullimi** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | 29.01.2019 | | Godinë banimi 1-10 kate | - | - | - |
| 11 | 06.02.2019 | | Rikonstruksion objekti | - | - | - |
| 12 | 21.11.2019 | | Ndërtim bazament betoni | 500 | Po | - |
| 13 | 03.08.2020 | | Mbarim objekti 1-vjeçar i lejes së ndërtimit | 100 | - | - |
| 14 | 02.12.2020 | | Bllokim rruge me portë | - | - | - |
| 15 | 15.12.2020 | | Bllokim rruge me shtyllë betoni | - | - | - |
| 16 | 27.05.2021 | | Ndërtim pa leje me konstruksion druri | 500 | Po | - |
| 17 | 28.05.2021 | | Ndërtim objekti shtesë betoni dhe pishinë | 500 | Po | - |
| 18 | 31.05.2021 | | Hapje shesh ndërtimi konstruksion druri | 500 | | - |
| 19 | 15.06.2021 | | Kalim afati të lejes | 150 | | - |
| 20 | 16.06.2021 | | Ndërtim pa dokumentacion | 500 | Po | - |
| 21 | 16.06.2021 | | Rrethim pa dokumentacion | 500 | Po | - |
| 22 | 26.10.2021 | | Rrethim pa dokumentacion | 500 | Po | - |
| 23 | 16.03.2022 | | Kalim afati të lejes | 150 | - | - |
| 24 | 13.06.2022 | | Rrethim pa dokumentacion | - | Po | - |

***1. Mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje zhvillimi.***
Nga të dhënat e IMTV, vënë në dispozicion grupit të auditimit është konstatuar se: Në total shuma e gjobave rezulton në vlerën 3,900,000 lekë, nga e cila janë arkëtuar 400,000 lekë në total.
Lidhur me praktikat ligjore të mbajtura nga IMTV, paraqiten rastet specifike të mospërputhshmërisë së praktikave të (Proces –verbal konstatimi - Vendim i dënimit me gjobë -vendim i prishjes së objektit) dhe arsyet e mospërputhjes, **dhe konkretisht:**
**-Vendimi nr.12 datë 07.06.2019, nr serial 036 për dënim me gjobë**, ndaj subjektit “T… “ Shpk, është mbajtur në zbatim të urdhërit nr 38 datë 04.02.2019, të kryetarit të Bashkisë Mirditë, referuar rekomandimeve të KLSH-së. Nr 468 prot. Pra nuk është shoqëruar me PVKK dhe vendim prishje, pasi nuk aplikohen.
**-Vendimi nr. 13 datë 07.06.2019, nr serial 036 i dënimit me gjobë** ndaj subjektit “D…” Shpk, është mbajtur në zbatim të urdhërit nr 36 datë 04.02, 2019, të kryetarit të Bashkisë Mirditë, referuar rekomandimeve të KLSH-së. Nr 466prot, mungojnë procedurat e tjera, pasi nuk aplikohen.
**-Vendimi nr.16 datë 10.08.2020, nr 040 serie i dënimit me gjobë**, është vendim i aplikuar ndaj subjektit Shoqëria “A. … “ për mos aplikim në afat nga subjekti për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit dhe mungojnë procedurat e tjera, pasi nuk aplikohen.
**- Vendimi nr.22 i dënimit me gjobë, datë 18.06.2021, nr serial 046**, ndaj subjektit “L… “ Sh.a, është vendim i aplikuar ndaj subjektit për mos aplikim në afat nga subjekti për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit dhe mungojnë procedurat e tjera, pasi nuk aplikohen.

**<u>-Vendimi nr.24, i dënimit me gjobë datë 18.03.2022, nr serial 048,</u>** ndaj subjektit "M…" shpk, është vendim i aplikuar ndaj subjektit për mos aplikim në afat nga subjekti për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit dhe mungojnë procedurat e tjera, pasi nuk aplikohen.
**<u>-Vendimi nr.25, datë 07.02.2023, nr 29 serie i dënimit me gjobë,</u>** është vendim i aplikuar ndaj subjektit "S…" Shpk, për mos aplikim në afat nga subjekti për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit dhe mungojnë procedurat e tjera, pasi nuk aplikohen.
Lidhur me procedurat ligjore të mbajtura, referuar praktikave të miratuara me VKM nr 894 datë 04.11.1015 " *Për Unifikimin e Procedurave të Kontrollit të Territorit nga Inspektorati Kombetar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësise Vendore*", se përsa i përket vendimeve të dënimit me gjobë të pa arkëtuara, janë dërguar për urdhër ekzekutimi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër.
Subjektet debitorë dhe të arkëtuar.
1. Kundravajtësi N.B., i dënuar me masën administrative 500,000 lek gjobë, është në proces gjyqësor me nr.akti 507/1329, me objekt shfuqizimin e masës së dënimit me gjobë dhe vendimit të prishjes së objekteve. **Vendimi i prishjes është ekzekutuar me datën 07.09.2022**. Vendimi i dënimit me gjobë është dërguar për titull ekzekutiv me datën 31.03.2023, nr.400 prot.
Ndaj kundravajtësit Z. N. B., është depozituar kallzimi penal me nr. 5200 prot, datë 15.12.2021, pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë, Lezhë.
2. Kundravajtësi subjekti M…''shpk, nipt K81313013K, Administrator K. B., adresa e subjektit Rruga Sulejman delvina, hyrja nr1, apartamenti 17, ndërtesa nr 1834, pranë Stadiumit ''Dinamo'' Tiranë, vendimi nr 24, nr 0048 serial i dënimit me gjobë, datë 16.03.2022 në masën 150,000 (njëqint e pesëdhjetë mijë) lek. **(është likuiduar)**
3. Kundravajtësi Z.LL., i dënuar me masën administrative 500.000 lek gjobë, është në proces gjyqësor, nr akti 429/1211, me objekt shfuqizimin e masës së dënimit me gjobë dhe vendimit të prishjes së objekteve. Vendimi i prishjes është ekzekutuar me datën 07.09.2022. Vendimi i dënimit me gjobë është dërguar për titull ekzekutiv me datën 31.03.2023, nr. 399 prot.
Ndaj Z. Z. LL. nuk është bërë kallzim, pasi në momentin e konstatimit të ndërtimit të kundraligjshëm, Z. Z.LL. dispon218nte formularin e aplikimit për legalizim të objektit, por që pas kërkesës tonë zyrtare Drejtorisë së ASHK-së Lezhë, për mundësinë e legalizimit të objektit nuk morëm përgjigje pozitive, IMT Mirditë ka vijuar me procedurat e prishjes. **Vendimi i prishjes është ekzekutuar.**
4-Per kundravajtësin B.T., i dënuar me masën administrative 500,000 lek gjobë, eshtë pushuar gjykimi me kërkesë e tij për sigurim padie nr. 594/890, datë 16.09.2021. Momentalisht jemi në kushtet e **ankimit të IMTV-së Mirditë me nr.422 prot, datë 13.06.2023, në Gjykatën e Apelit Tiranë**, të vendimit nr. 68/375, datë 27.04.2023 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, ndaj refuzimit të kërkesës për lëshim urdhër ekzekutimi.
5-. Subjekti "L..." Sha, i dënuar me vendimin nr.22, datë 18.06.2021, me masën administrative dënim me gjobë në mësën 150,000 lek, **është likuiduar**.
6- Për kundravajtësin Znj. M.G.N., dënuar me masën administrative 500.000 lekë gjobë, është kërkuar lëshimi i urdhërit të ekzekutimit me kërkesën nr.397 prot, datë 21.03.2023 dhe është ankimuar refuzimi i kërkesës tonë pranë Gjykatës së apelit Tiranë nga ana e IMT-së Mirditë, me datën 06.06.2023, nr 418.prot. Kalzim penal nr.187, datë 18.06.2021.
**Vendimi i prishjes është ekzekutuar.**
7. Për kundravajtësin L. A., dënuar me gjobë në masën 500,000 lek, Është kërkuar lëshim urdhër ekzekutimi me nr. 396 prot, datë 21.03.2023, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së parë Shkodër. Me datën 16.06.2023, nr. 2215, jemi njoftuar zyrëtarisht për

rrëzimin e kërkesë padisë që Z. L. A. kishte paraqitur pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër. Kallzim Penal, nr.125prot, datë 14.06.2021.

**Vendimi i prishjes është ekzekutuar.**

-Për kundravajtësin Gj. P. N. me mase sigurim padie nga Gjykata Administrative e shkallës së parë Shkodër dhe **pranim të kërkesë-padisë për mos-ekzekutim të vendimit të prishjes,** është ankimuar me datën 05.12.2022, nr 36 9prot i IMT-së dhe 5083 i Bashkisë Mirditë, protokolluar pranë Gjykatës administrative të Apelit Tiranë me nr.1950/1, datë 07.12.2022.

-Për subjektin "S..." Shpk, i dënuar me vendimin nr. 25, datë 07.02.2022 me masën administrative dëmim me gjobë në masën 100,000lek, **është likuiduar**.

Bazuar në korespondencën shkresore me IKMT, konstatohet se për periudhën 1 Tetor 2018-31 Dhjetor 2022 kanë dalë me vendim prishje objektesh 7 raste, nga të cilat janë ekzekutuar vetëm 4 raste prej tyre dhe janë pa u ekzekutuar 3 raste të tjera të ndërtimeve pa dokumentacion tekniko ligjor (pa leje ndërtimi, dhe shkelje të lejes) dhe 3 raste kanë sigurim padie dhe 1 rast është në proces gjyqësor. Objekte të cilat 4 prej tyre janë të pa identifikuara se nga kush janë ndërtuar ndërsa 4 të tjera janë të identifikuara. Në total janë ekzekutuar (vendim prishje) 17.7 % e rasteve të konstatuara për një periudhë dy vjecare, cka tregon nivel të ulët të zbatueshmërisë së kërkesave të ligjit.

**2.** ***Mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV, për subjektet të cilët kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV.***

Në 15 raste është konstatuar se kanë mbajtur process-verbal kundravajtje dhe kanë dalë me vendime gjobe në 10 raste.

Nuk është mbajtur proves-verbal dënimi me gjobë në 5 raste në kundërshtim me ligjin 9780 për për inspektimin dhe kontrollin e territorit, Neni 5 Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore. Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

b) vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

c) paraqet pranë organeve përkatëse kërkesën për heqje të licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, në rast të ndërtimit të kundërligjshëm, si dhe në rastet kur vëren shkelje të kushteve teknike të zbatimit, projektimit dhe shkelje të masës së pezullimit të ndërtimit;

ç) vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

d) vendos prishjen e ndërtimit të kundër-ligjshëm; dh) përgatit kallëzimin penal për veprat penale të konstatuara gjatë ushtrimit të kontrollit dhe e paraqet atë pranë organeve përgjegjëse, sipas legjislacionit në fuqi;

e) detyrohet t'i japë informacionin dhe/ose dokumentacionin e kërkuar Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit brenda një afati kalendarik 5-ditor nga data marrjes së kërkesës, si dhe krijon të gjitha lehtësitë për përmbushjen e detyrave të këtij inspektorati;

ë) merr vendim zhdëmtimi në ngarkim të subjektit kundërvajtës për shpenzimet e prishjes së ndërtimit dhe të kthimit të truallit në gjendjen e mëparshme;

f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave "b", "c", "ç", "d", "dh", të këtij neni.

Fjala "ndërtim/punim", sipas këtij neni, përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen ose instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që

zhvillohen nën dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gërmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes 4 aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit".

Për periudhën 2018-2022 në një rast nuk është mbajtur mbajtur vlera e gjobës sipas vlerës së punimeve të kryera, në kundërshtim me ligjin 107/2014 Neni **52/e** Kundërvajtjet administrative kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.

**3.** ***Mbi procedursat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me DPKZHT (Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit të Bashkisë).***

Puna e kryer nga IMTV është bazuar më shumë gjatë kontrolleve në territor nga ky inspektoriat dhe nuk ka evidence shkresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë I domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundëshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, kjo duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë si: Akt-kontrollet në të gjitha fazat e ndërtimit të cilat janë si bazë e informacionit me të dhëna që nga projekti e deri në përfundim të objekteve. Gjatë auditimit dhe është konstatuar se: Nga verifikimi I ndryshimeve në zonë, marrë nga pamje satelitore, në zonën Katun I Vjetër, pjesë e Njësisë Administrative Rrubik, Bashkia Mirditë, është identifikuar **1 objekt pa leje** në njësinë strukturore si mëposhtë:

**Objekti 1**. Katun i Vjetër

**MR_N_N_2274/1**

**Sistemi; N_Natyror**

**Kategori 1: Tokë Natyrore 100%**

Objekti ka filluar ndërtimin në muajin Mars të vitit 2022 dhe I përket kategorisë Objekt 1 kat, me bazament betoni me çati, me funksion shërbime (restorant).

**Objekti 2.** Fshati Fang, njësia administrative Rrubik.

**MR_N_N_72/1**

**Sistemi; N_Natyror**

**Kategori 1: Tokë Natyrore 100%**

Objekti ka filluar ndërtimin në muajin Mars të vitit 2022 dhe I përket kategorisë Objekt 1 kat, me bazament betoni me çati, me funksion shërbime (restorant) që i përket Xh. O.

Objekti 3.

**Objekti 3.** Fang, Njësia Administrative Rubik.

**MR_N_N4_72/1 (shkurre)**

**Sistemi; N_Natyror**

**Kategori 1: Tokë Natyrore 100%**

Objekti I identifikuar si Kioskë Metalike me xhama që shërben si Lokal (Bar-Kafe), I gjendur anës rrugës së kombit, pranë ish uzinës ALB-Bakër.

Nga Kryeinspektori I IMVT Mirditë nuk janë marrë masat në kohë për parandalimin e këtyre ndërtimeve pa leje, ndonëse në zona lehtësisht të dukshme dhe të aksesueshme. Nuk ka process verbale konstatimi apo ndonjë masë tjetër administrative.

***Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet e konstatuara mbajnë përgjegjësi:***

***z.N. P.,*** me dëtyrë Kryeinspektor i IMTV për periudhën 01.10.2018 deri më datë 31.12.2022.

***z.N. D., ish/Kryetar Bashkie për emërimin në pozicionin e Inspektorit të IMTV pa arsimin përkatës.***

**Titulli i gjetjes:** Mospërmbushje e detyrave funksionale nga Kryeinspektori i IMTV dhe mospërputhshmëria e emërimit të inspektorëve për shkak të arsimimit.
**Situata:** Arsimimi i Inspektorit **G.Ll.** nuk është konform kërkesës së Nenit 11 të ligjit 9780 ku përcaktohet se: *Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të ndryshëm professional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisi*t. Nga të dhënat e marra nga drejtoria e burimeve njerëzore, është konstatuar se inspektori G. Ll. është diplomuar në Universitetin e Tiranës si Specialist i Gjeografisë dhe është emëruar jo në përputhje me ligjin.
Puna e kryer nga IMTV është bazuar më shumë gjatë kontrolleve rutinë në territor dhe nuk ka evidencë shkresore të ndërveprimit me DPZHKT,veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundëshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, kjo duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë si: Akt-kontrollet në të gjitha fazat e ndërtimit të cilat janë si bazë e informacionit me të dhëna që nga projekti e deri në përfundim të objekteve, kryesisht atyre mbi 250 m2 të cilat kanë shtrirë dhe mund të vijojnë aktivitetin e ndërtim në zona të përcaktuara me rëndësi kombëtare, të ndaluara ose të mbrojtura. Gjatë auditimit dhe është konstatuar se: Nga verifikimi I ndryshimeve në zonë, marrë nga pamje satelitore, në zonën Katun I Vjetër, pjesë e Njësisë Administrative Rrubik, Bashkia Mirditë, është identifikuar **1 objekt pa leje** në njësinë strukturore si mëposhtë:
**Objekti 1**. Katun i Vjetër
**MR_N_N_2274/1**
**Sistemi; N_Natyror**
**Kategori 1: Tokë Natyrore 100%**
Objekti ka filluar ndërtimin në muajin Mars të vitit 2022 dhe I përket kategorisë Objekt 1 kat, me bazament betoni me çati, me funksion shërbime (restorant).
**Objekti 2.** Fshati Fang, njësia administrative Rrubik.
**MR_N_N_72/1**
**Sistemi; N_Natyror**
**Kategori 1: Tokë Natyrore 100%**
Objekti ka filluar ndërtimin në muajin Mars të vitit 2022 dhe I përket kategorisë Objekt 1 kat, me bazament betoni me çati, me funksion shërbime (restorant) që i përket Xh. O.
Objekti 3.
**Objekti 3.** Fang, Njësia Administrative Rubik.
**MR_N_N4_72/1 (shkurre)**
**Sistemi; N_Natyror**
**Kategori 1: Tokë Natyrore 100%**
Objekti I identifikuar si Kioskë Metalike me xhama që shërben si Lokal (Bar-Kafe), I gjendur anës rrugës së kombit, pranë ish uzinës ALB-Bakër.
Nga Kryeinspektori I IMVT pranë Bashkisë Mirditë nuk janë marrë masat në kohë për parandalimin e këtyre ndërtimeve pa leje, ndonëse në zona lehtësisht të dukshme dhe të aksesueshme. Nuk ka process verbale konstatimi apo ndonjë masë tjetër administrative për këto raste.
Mos mbajtja në kontroll e territorit sipas përcaktimeve ligjore është dhe mund të jetë shkak për pasoja jo vetëm në mbrojtjen e territorit por bëhet shkak dhe për shmangien nga detyrimet që parashikohen për taksat e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja.

**<u>Kriteri:</u>** Në kundërshtim me, ligjin 9780, I ndryshuar, neni. 11 ku përcaktohet se: Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit.
Ligjin 107/2014 Neni **52/e** Kundërvajtjet administrative kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera.
**<u>Ndikimi:</u>** Vijueshmëria e fenomenit të ndërtimeve jashtë lejeve të miratuara dhe atyre pa leje ndërtimi, e cila ka sjellë dhe mund të sjellë pasoja sociale, ekonomike, poashtu në kundërshtim me planet e miratuara urbanistike e mjedisore.
**<u>Shkaku:</u>** Mos marrja në kohë e masave me qëllim parandalimin e fenomenit të ndërtimeve pa leje. Rekrutimi i punonjësve (inspektorë) pa formimin e duhur arsimor sipas kërkesave të ligjit. Mos bashkepunimi ndërsektorial me DPZHKT për aplikantët për leje zhvillimore e ndërtimore.
**<u>Rëndësia:</u>** E Lartë.
**<u>Për këtë rekomandojmë:</u>** Kryetari i Bashkisë të marrë masa që: IMTV të ketë bashkpunim me DPZHKT, Policinë Bashkiake, Policinë e Shtetit, administratorët e njësive vendore, kryepleq apo dhe cdo organ në nivel qendror e vendor, të dërgojnë e kërkojnë informacione periodike mbi gjendjen në territor. Të ushtrojnë inspektime të planifikuara mbi zona të caktuara por sidomos ato me rëndësi kombëtare, pyje, lumenj apo zona të mbrojtura.

**2.7 Të ndryshme të dala gjatë auditimit.**

**1. Ankesa e z. P.P., protokolluar në KLSH me nr. 620 prot., datë 04.07.2023**
Në ankesën e z. P. P. drejtuar KLSH-së, pretendohet se nga Zyra e Urbanistikës së Bashkisë, nuk është dërguar dokumentacioni në Këshillin Bashkiak për miratimin e banesës dhe për këtë veprim, shkresave të dërguara prej tij, nuk i është kthyer asnjë përgjigje nga Bashkia Mirditë.
Nga verifikimet e kryera rezulton se:
Bazuar ne Aktin Normativ nr. 9, date 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", pas tërmetit të datës 26.11.2019, është bërë vetëdeklarimi me nr. 344 prot. datë 25.02.2020, nga z. P. Gj. P., për objektin me adresë Rr. Gjergj Fishta, P.26, Shk. 1, Ap. 12, Rrëshen, Mirdite.
- Sipas Certifikatës së pronësisë nr. 307480, datë 31.08.2012, ky apartament është në pronësi të z. Gj. Ll. P., i cili nga ana e tij ka bërë aplikim vetëdeklarimi për dëmtimin e apartamentit.
- Dëmtimet e pallatit 5-katësh janë konstatuar nga Komisioni i Bashkisë i ngritur për këtë qëllim. Më pas nga ana e Institutit të Ndërtimit është bërë një Vlerësim më i thelluar i Aftësisë mbajtëse të strukturave të ndërtesës me koordinata: 41.769288, 19.875522.
- Në zbatim të akteve ligjore e n/ligjore, me Vendimin nr. 70, datë 21.07.2020, të Këshillit të Bashkisë Mirditë, Bashkia ka miratuar listën e përfituesve nga Programet e zhvillimit të zonave të reja dhe programi i rindërtimit të godinave në të njëjtin truall, për Bashkinë Mirditë (bashkëngjitur Vendimi nr. 70, datë 21.07.2020).
Duke qenë se z. P. P. nuk është në përbërjen familjare (sipas certifikatës familjare) të Z. Gj. P., nuk është as në dokumentin e pronësisë së këtij apartamenti (sipas certifikatës së pronësisë), pra nuk është "kurorë", duke u nisur nga prejardhja e tij familjare, është bashkëngjitur si përfitues në të njëjtën strukturë.
Për sa më sipër, sipas Vendimit Nr.70, datë 21.07.2020 "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i zhvillimit të zonave të reja dhe programi i rindërtimit të godinave në të njëjtin truall, Bashkia Mirditë", e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë, me nr.600/2 prot, datë 23.07.2020, sipas listës së objekteve përfituese në Njësinë Administrative Rrëshen, me nr.

Rendor 13, Z. P. Gj. P. është trajtuar me strukture përfituese 2+1, në të njëjtin banesë m familjen bazë, me kryefamiljar, Z. Gj. Ll. P.

Për trajtimin e kësaj ankese janë shqyrtuar dokumentet si më poshtë:
- Aplikimi në Portalin e Rindërtimit i z. P. P..
- Certifikata familjare e Z. P. P..
- Certifikata e pronësisë nr. 307480, date 31.08.2012, për objektin me adresë Rr. Gjergj Fishta, P.26, Shk. 1, Ap. 12, Rreshen, Mirdite.
- Vlerësim më i thelluar nga Instituti i Ndërtimit, i Aftësise mbajtëse të strukturave të ndërtesës me koordinata: 41.769288,19.875522.
-Vendimi Nr.70, datë 21.07.2020 "Për miratimin e listës së përfituesve nga programi i zhvillimit të zonave të reja dhe programi i rindërtimit të godinave në të njëjtin truall, Bashkia Mirditë".
Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar për këtë ankesë, rezultoi se nga ana e administratës së Bashkisë Mirditë, janë ndjekur procedurat ligjore deri në Vendimin e Këshillit Bashkiak.

**2. Ankesa e z. Gj. T., protokolluar në KLSH me nr. 642 prot., datë 12.07.2023**
Ankuesi z. Gj.T. është me detyrë Komandant grupi i Shërbimit Zjarrfikës, pranë Bashkisë Mirditë. Ankesa e z. T. konsiston në moszbatimin nga ana e Bashkisë Mirditë të VKM nr. 203, datë 10.04.2019 "Për përcaktimin e kritereve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin". Nga shqyrtimi i kësaj ankese, konstatohet se nuk është specifikuar se cili nga kapitujt e kësaj VKM-je (shtesa mbi pagën, pushimet vjetore, apo lejet e pagueshme dhe pa të drejtë page) nuk është zbatuar. Nga informacioni i marrë nga Burimet Njerëzore pranë Bashkisë Mirditë, nuk rezulton që të ketë mozbatim të kësaj VKM-je.
Për ankesën verbale të bërë nga z. T. në zyrat e Bashkisë Mirditë gjatë auditimit në Bashkinë Mirditë, në lidhje me dosjen personale të z. T., konstatuam se kjo dosje dhe dosjet e tjera të punonjësve të shërbimit zjarrfikës, janë në zyrën e përgjegjësit të këtij shërbimi dhe jo në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore. Ky veprim, bie ndesh me Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë Mirditë, pika 28.2.1, germa d, në lidhje me detyrat e Përgjegjësit të Sektorit të Burimeve Njerëzore, sipas të cilës *"...Kontrollon dhe administron dosjet personale për çdo nëpunës të bashkisë, të plotësuara me të gjitha dokumentet e nevojshme konform akteve normative përkatës, duke bërë edhe përditësimet e nevojshme*", si dhe në lidhje me detyrat e përgjegjësit të MZSH, në të cilat në asnjë pikë nuk citohet që do të administrojë dosjet personale të punonjësve të varësisë. Sa sipër, ngarkohen me përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun z. F. C..

**3. Ankesa e z. B. J. ("J..." ShPK), protokolluar në KLSH me nr. 788 prot., datë 14.09.2023.**
Kjo ankesë është e përsëritur, pasi e njëjta ankesë ka ardhur në Bashkinë Mirditë, por nuk na është vënë në dispozicion nga administrata e Bashkisë Mirditë.
Kjo ankesë konsiston në pretendimin se nga grupi i auditimit të kontrollit të mëparshëm është nxjerrë padrejtësisht një detyrim 9,419,530 lekë për shoqërinë "J..." ShPK (ku 5,214,218 lekë janë principal dhe 4,205,315 lekë kamat vonesa) pasi është llogaritur gabim kamatvonesa për objektin "Blloku C + çerdhe + Qendër shëndetësore, Blloku B + pistë, Blloku A". Pas këtij veprimi, IMTV ka bërë propozimin për heqje licence dhe Drejtoria e Tatim Taksave nuk lëshon vërtetime, pa i paguar edhe kamatëvonesat. Nga ankuesi kërkohet:

- Zhbllokimi i ASHK Mirditë nga Bashkia, për pallatin oranë spitalit dhe kompleksin tek çerdhj dhe qendra shëndetësore;
- Urdhërimin për dhënien e lejes së përdrimit për bllokun C;
- Lëshimin e urdhrit nga taksat për tu paguar shuma prej 5,214,218 lekë, ndërsa për shumën 4,205,315 lekë, nëse nuk arrini në konjkluzion se duhet hequr nga ana juaj, e kërkoj në rrugë gjyqësore;
- Evidentimin e faktit që propozimi nga IKMT-ja për heqje licence, është i pasaktë dhe se pretendimet për të, nuk qëndrojnë.

Në lidhje me këtë ankesë kemi kërkuar sqarim në Drejtorinë e Taksave Vendore Bashkia Mirditë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se:

Ky është një detyrim i mbartur nga viti 2010, pra ne vitin 2015 me ndarjen e re territoriale dhe bashkimin e të gjitha njësive vendore në një të vetme, subjekti "J. K." ShPK, ka rezultuar debitor.
Nga Drejtoria e Taksave Vendore është kërkuar likujdimi i taksës në infrastrukturë nga ky subjekt në vlerën e detyrimit 7.214.220 lekë.
Në vitin 2019 Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me shkresën nr. 142 prot., datë 29.01.2019, ka kërkuar informacion për nevoja hetimi mbi pagesën e kësaj takse, ku nga ana e Bashkisë Mirditë, janë dhënë sqarime me shkresën nr. 421/1, datë 13.02.2019.
Sipas kësaj shkrese, rezulton se subjekti ankues ka paguar si taksë e ndikimit në infrastrukturë shumën prej 8,000.000 lekë, duke mbetur debitorë në Bashkinë Mirditë në vlerën 9,419,530 lekë për shoqërinë "J..." ShPK (ku 5,214,218 lekë janë principal dhe 4,205,315 lekë kamat vonesa).
Nga Bashkia Mirditë, është kërkuar në mënyrë shkresore disa herë pagesa e këtij detyrimi, derisa, nga mospagesa, është vazhduar me rrugët e tjera ligjore (barrë hipotekore, bllokim llogarie), të cilat në auditimin e bërë në ASHK Mirditë, janë lënë si rekomandim edhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.
Në dokumentacionin e paraqitur bashkëlidhur ankesën, nuk gjendet asnjë dokument (vendim gjyqësor të formës së prerë), që të detyrojë Bashkinë Mirditë të heq dorë nga kërkesa për likuidim të detyrimit të subjektit "J..." ShPK.
Të gjitha këto mosveprime dhe anomali financiare, e kanë zanafillën nga zbardhja e tre lejeve të ndërtimit datë 28.10.2010 për këtë subjekt nga ana e Bashkisë Mirditë, pa bërë pagesën e taksave vendore, në kundërshtim me ligjin nr.8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", sipas të cilit "... Dokumenti i lejes së ndërtimit i jepet personit fizik/juridik, jo më vonë se 1 ditë pas datës së depozitimit të dokumentit të pagesës në dosjen e objektit".

Në ish-Bashkinë Rrëshen apo tani në Bashkinë Mirditë, nuk ka asnjë aktmarreveshje për ndarje me këste për pagesën e detyrimit.

Sa sipër, me dokumentacionin që kemi në dispozicion, kërkesa e subjektit "J..." ShPK, nuk është e bazuar në argumente ligjorë.

## IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

**Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

## A. MASA ORGANIZATIVE.

**1. Gjetje nga auditimi:**Gjendja e llogarisë *212 "Ndërtesa Konstruksione"* paraqitet në vlerë historike në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 1,690,376,124 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 2,506,661,463 lekë. Për këto aktive nuk është kryer inventarizim fizik për të verifikuar nëse gjendja fizike përputhet me atë kontabël. Këto veprime janë në kundërshtim me me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85**,** me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 54 -74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**1.1. Rekomandim:** Strukturat Drejtuese në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit në Bashkinë Mirditë të marrin masa, që të kryhet procesi inventarizimit dhe vlerësimit të i aktiveve të llogarisë 212 "Ndërtesa dhe konstruksione".

***Brenda datës 31.03.2024***

**2. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm" nuk paraqet gjendje të saktë të detyrimeve të prapambetura që ka njësia vendore ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime e investime të kryera e të pafinancuara, për shkak të mungesës së fondeve. Kjo llogari ka vlerën zero lekë në pasqyrat financiare, por në fakt duhet të kishte vlerën 55,803,024 lekë, vlerë e cila është paraqitur në llogarinë 401-408 " "furnitorë e llogari të lidhura me to" dhe përfaqson përdaqson 32 fatura të prapambetura. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar Kreu 3.1 pika 42,Aneksi nr.1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" Kap 3.3"Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)pika (b,d). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 54-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*
**2.1. Rekomandim:** Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe Buxhetit në Bashkinë Mirditë të marrin masa, që faturat e prapambetura që paguhen në periudha të ardhshme të kontabilizohen në llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm", ndërsa faturat e fund vitit ushtrimor që paguhen në janar-shkurt të vitit pasardhës për llogari të vitit ushtrimor të kontabilizohen në llog. 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to".

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga testet e transaksioneve financiare të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi se në vitin 2022, në 41 raste nëpërmjet urdhër shpenzimeve, janë kryer pagesa të faturave me vlerë 41,896,055 lekë, mbi afatin 30 ditor nga momenti i mbritjes së faturës tatimore në Bashkinë Mirditë, për shpenzime mallra e shërbime e investime. Nga sa më sipër, 34 raste në vlerën 10,956,731,lekë i përkasin faturave për mallra e shërbime l(log. 602 "shpenzime operative"), 7 raste në vlerën 36,012,981,lekë për investime (llog.231), të cilat në pjesën më të madhe të rasteve janë krijuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mbërritje me vonesë e faturave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52, me ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 44 "Kontrolli i shpenzimeve". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 54-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandim:** Nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të marrin masa për likujdimin e detyrimeve ndaj të tretëve, brenda afatit 30 ditor nga data e faturës së operatorit ekonomik, me qëllim eleminimin e krijimit të detyrimeve të prapambetura.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2018-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 11 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kritereve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit dhe nuk i përshtaten procedurës së zhvilluar, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", neni 1, 2, 20, si dhe neni 26, pika 5 të VKM-së nr. 914, datë 24.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik*", me Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 74-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>**4.1. Rekomandim:**</u> Kryetari i Bashkisë Mirditë, në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 12 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2018-31.12.202, u konstatua se në 9 raste, në vlerën totale të kontratave prej 544,136,534 lekë, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, neni 1 "*Objekti dhe qëllimi*" pika 2, shkronjat a), b), d) dhe dh), neni 2 "*Parimet e përzgjedhjes*" shkronjat (a), b) dhe c), neni 46 "*Kualifikimi i ofertuesve*" pika 1 dhe neni 55 "*Shqyrtimi i ofertave*" pika 3 dhe VKM-në nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin rregullave të prokurimit publik*", me Ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 74-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>**5.1. Rekomandimi:**</u> Kryetari i Bashkisë Mirditë, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla. Të vlerësohen në maksimum kriteret e DST të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e DST, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 6 procedurave të prokurimit me "*vlerë e vogël*", u konstatua se në të gjitha rastet e blerjeve mall, shërbime e punë publike, me operatorin ekonomik të shpallur fitues, është lidhur kontrata e shërbimit dhe blerjes me afate dhe kushte të realizimit ndërsa për procesin e marrjes në dorëzim të mallrave nuk është ngritur komision nga titullari në përputhshmëri me kërkesat ligjore. Mallrat e blera kanë kaluar nga furnitori duke u bërë hyrje në magazinë pa pasur një hallkë kontrolli mbi sasinë, llojin dhe cilësinë e kërkuar sipas kërkesave së procedurës e prokuruar. Në kundërshtim me Pikën 42, 43, 52, 53, 54 të UMF 30 datë 27.11.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 74-127 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**6.1 Rekomandim:** Titullari i njësisë vendore apo personi i autorizuar prej tij të miratojë për

çdo rast urdhrin për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara për sasinë, cilësinë, llojin, plotësinë e tyre dhe të dokumentacionit shoqërues. Komisioni të përbëhet nga specialistë të fushës sipas llojit të aktiveve dhe, në rast nevoje, edhe nga ekspertë të jashtëm. Në komision duhen të bëjnë pjesë jo më pak se tre veta, duke përfshirë edhe punonjësin me përgjegjësi material.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV Mirditë u konstatua se, formimi arsimor i një inspektori nuk është konform kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi. Konkretisht nga të dhënat e marra nga drejtoria e burimeve njerëzore, është konstatuar se Z. G. Ll. është diplomuar në Universitetin e Tiranës si Specialist i Gjeografisë dhe është emëruar se inspektori i IMT, veprim në kundërshtim me kërkesën e Nenit 11 të ligjit 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme", i ndryshuar, neni 11 ku përcaktohet se "Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisje vendore duhet të kenë arsimin e lartë të ndryshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidro-gjeologjisë dhe mjedisit" *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 161-166 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Mirditë, të marrë masa që plotësimi i pozicioneve të punës për inspektorët e IMTV-së, sipas kërkesave të përcaktuara në ligj, lidhur me arsimin përkatës.

***Menjëherë***

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së IMTV Mirditë u konstatua mos përmbushje e detyrave funksionale nga Kryeinspektori i IMTV.

Puna e kryer nga IMTV është bazuar më shumë gjatë kontrolleve rutinë në territor dhe nuk ka evidencë shkresore të ndërveprimit me DPZHKT, veprim i cili duhet të ishte dhe të jetë i domosdoshëm për evidentimin në kohë të devijimeve të mundshme të punimeve të ndërtimit për zhvilluesit, kjo duke marrë informacion për secilin subjekt zhvillues që në hapat e parë si: Akt-kontrollet në të gjitha fazat e ndërtimit të cilat janë si bazë e informacionit me të dhëna që nga projekti e deri në përfundim të objekteve, kryesisht atyre mbi 250 $m^2$, të cilat kanë shtrirë dhe mund të vijojnë aktivitetin e ndërtim në zona të përcaktuara me rëndësi kombëtare, të ndaluara ose të mbrojtura. Gjatë auditimit është konstatuar se: Nga verifikimi i ndryshimeve në zonë, marrë nga pamjet satelitore, janë identifikuar ndërtime pa leje në zonën Katund i Vjetër, pjesë e Njësisë Administrative Rubik, Bashkia Mirditë, Objekt 1 kat, me bazament betoni me çati, me funksion shërbime (restorant);

Në zonën Fshati Fang, njësia administrative Rubik, objekti ka filluar ndërtimin në muajin Mars të vitit 2022 dhe I përket kategorisë Objekt 1 kat, me bazament betoni me çati, me funksion shërbime (restorant) që i përket subjektit Xh.O.; në zonën Fang, Njësia Administrative Rubik, objekti i identifikuar si Kioskë Metalike me xhama që shërben si Lokal (Bar-Kafe), i gjendur anës rrugës së kombit, pranë ish uzinës ALB-Bakër.

Nga Kryeinspektori i IMVT pranë Bashkisë Mirditë nuk janë marrë masat në kohë për parandalimin e këtyre ndërtimeve pa leje, ndonëse në zona lehtësisht të dukshme dhe të aksesueshme. Nuk ka proces verbale konstatimi apo ndonjë masë tjetër administrative për këto raste.

Mos mbajtja në kontroll e territorit sipas përcaktimeve ligjore është dhe mund të jetë shkak për pasoja jo vetëm në mbrojtjen e territorit por bëhet shkak dhe për shmangien nga detyrimet që parashikohen për taksat e Ndikimit në Infrastrukturë nga Ndërtimet e Reja. Bazuar në

Ligjin 107/2014 Neni **52/e** Kundërvajtjet administrative kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera, por këto kërkesa ligjore nuk janë zbatuar nga K/inspektori i IMT. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 161-166 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**8.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Mirditë të marrë masa që IMTV të ketë bashkëpunim me DPZHKT, Policinë Bashkiake, Policinë e Shtetit, administratorët e njësive vendore, kryepleq apo dhe çdo organ në nivel qendror e vendor, të dërgojnë e kërkojnë informacione periodike mbi gjendjen në territor. Të ushtrojnë inspektime të planifikuara mbi zona të caktuara por sidomos ato me rëndësi kombëtare, pyje, lumenj apo zona të mbrojtura, si dhe të marrë masa për parandalimin e ndërtimeve pa leje dhe monitorimin e zbatimit të lejeve të ndërtimit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**9. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zhvillimit i zbatimit të kontratave për punë publike me objekte: "Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3), Mirditë" fituar nga shoqëria "L. VII" SHPK me kontratë me nr. 760 prot., datë 06.05.2021 dhe me vlerë 42,261,108 lekë; "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar "Ndrec N. Gjoka", Fan Mirditë" fituar nga shoqëria "K." SHPK me kontratë me nr. 3072 prot., datë 29.07.2019 dhe me vlerë 69,805,421 lekë; "Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen" Bashkia Mirditë" fituar nga shoqëria "U..." SHPK me kontratë me nr. 3974 prot., datë 13.10.2021 dhe me vlerë 97,860,882 lekë; "Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen" Bashkia Mirditë fituar nga "A..." SHPK & "G..." SHPK me kontratë me nr. 39746 prot., datë 13.10.2021 dhe me vlerë 103,177,350 lekë; "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)" Bashkia Mirditë, fituar nga shoqëria "U..." SHA me ofertë 187,417,132 lekë me TVSH, u konstatua se nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Mirditë nuk është kryer Oponenca Teknike, veprim në mospërputhje me Ligjin Nr. 120/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", neni 6, *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Mirditë të marrë masa që të pajisin me Oponencë Teknike për çdo projekt zbatimi, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit, kushtet teknike të zbatimit, si dhe me destinacionin e tyre.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**10. Gjetje nga auditimi**: Në **3 (tre)** raste nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratave për punë publike, u konstatua se kolaudimi i punimeve është bërë me vonesë dhe konkretisht:
**a)** Për kontratën me objekt "Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar "Ndrec N. Gjoka", Fan Mirditë", Mirditë", Bashkia Mirditë", me vlerë 69,805,421 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria "K…" SHPK, për kolaudimin e punimeve, është lidhur kontrata me nr. 2567 prot., datë 14.08.2020 ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë "A…" SHPK. Kolaudimi i objektit është bërë me datë 18.08.2020 , ndërkohë që punimet e kontratës kanë përfunduar me datë 24.01.2020, rreth 7(shtatë) muaj me vonesë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 12.

**b)** Për kontratën me objekt "*Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)*", Bashkia Mirditë", me vlerë 187,417,132 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria "U…" SHPK, për kolaudimin e punimeve, është lidhur kontrata me nr. 2228/4 prot., datë 23.06.2023 ndërmjet Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë "N…" SHPK. Kolaudimi i objektit është bërë me datë 23.06.2023, ndërkohë që punimet e kontratës kanë përfunduar me datë 30.02.2022, rreth 16 muaj me vonesë në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 12 dhe, ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 148-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>10.1 Rekomandimi:</u>** Titullari i Bashkisë Mirditë për zbatimin e kontratave për punë publike, të bëjë emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit, brenda 30 ditëve nga përfundimit i punimeve të ndërtimit për të hapur rrugën e periudhës së garancisë së defekteve të punimeve.

***Menjëherë***

**11. Gjetje nga auditimi**: Në **2 (dy)** raste nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratave për punë publike, u konstatua se mungonte kontrata e kolaudimit të punimeve në objektet si më poshtë:

**a)** Për kontratën me nr. 4616 prot., datë 23.10.2018, me objekt "Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit "Arjana Arapi" Rrëshen", Bashkia Mirditë, ku kolaudator i objektit rezulton të jetë OE "…" SHPK.

**b)** Për kontratën me nr. 3196 prot., datë 06.08.2019, me objekt *"Rehabilitimi i skemës ujitëse të ujëmbledhësit Malaj-2, Faza III" Rrëshen", Bashkia Mirditë,* ku kolaudator i objektit rezulton të jetë ing. Bashkim Mata PF.

Në dosjet teknike të këtyre dy objekteve administrohet akti i kolaudimit i objektit por nuk vërtetohet të jetë lidhur kontratë për këtë shërbim. Sa sipër është në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, neni 12 dhe ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Bashkisë *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 148-181 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**<u>11.1 Rekomandimi:</u>** Titullari i Bashkisë Mirditë për zbatimin e kontratave për punë publike, të bëjë emërimin e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit, me qëllim formalizimin zyrtar të këtij shërbimi dhe funksionimin e tij bazuar në një kontratë dy palëshe.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste nuk janë respektuar kondicionet urbane të parashikuara në ligj, siç janë distancat urbane ndërtesë – kufi prone, lartësia maksimale e lejuar e matur me metra dhe numër katesh, intensiteti i ndërtimit dhe koeficienti i shfrytëzimit të territorit. Anomalitë e mësipërme janë konstatuar në rastet e mëposhtme:

- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr.75, nr. 3625/4 prot; datë 28.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Ndërtim restorant dhe hotel"*, me zhvillues "A…" ShPK;
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 83, nr. 3302 prot; datë 08.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Ndërtim godinë banimi 2 kat"*, me subjekt zhvillues z. N. N.;
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 100, nr. 4459 prot; datë 09.11.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Bujtina Gj. Ll., rikonstruksion + shtesë 2 kt + p/fingo"*, me subjekt zhvillues z. V. Gj.Ll.;

- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin *"Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe mure rrethues"*, me subjekt zhvillues "Z..." ShPK;
Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, më konkretisht me VKM-në nr. 408, datë 13.5.2015, *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit",* i ndryshuar, Neni 35; Neni 38, pika 1; Ligjin 107/2014, *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit",* i ndryshuar, Neni 38, pika 1; Rregulloren e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Mirditë, e ndryshuar, pasaportat e njësive strukturore MR_B_BA1_498/1, MR_UB_A2_343/2, MR_B_BA1_893/2 *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 146-159 të Projekt Raportit të Auditimit).*

**12.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT, Bashkia Mirditë, të merren masa për të respektuar të gjitha kushtet dhe kondicionet urbane të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret mbi të cilat ky institucion funksionon, të kërkohen të kryhen të gjitha ndryshimet e nevojshme mbi projektet ndërtimore deri në përputhjen e plotë sipas ligjit, në të kundërt, të mos miratohet asnjë leje ndërtimi që nuk i plotëson të gjitha kondicionet urbane të parashikuara në dispozitat ligjore.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se në gjashtë raste të audituara, projekti ndërtimor nuk është i plotë, si dhe mungon dokumentacioni shoqërues, siç janë mangësi në dokumentin e rilevimit topografik, projekti arkitektonik nuk është i plotësuar me të gjitha detajet e domosdoshme, mangësi në deklaratat, policat dhe licencat e projektuesit, mangësi në projektin ndërtimor, kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhurnuara gjatë 3 muajve të fundit, mungon prokura ose autorizimi nga ana e zhvilluesit për aplikantin, nuk është evidentuar gjendja faktike ekzistuese e objektit tek i cili do të do të kryhet rikonstruksioni dhe shtimi i volumeve, jo i gjithë dokumentacioni i ngarkuar është i nënshkruar elektronikisht, si dhe në një rast, relacioni i projektit konstruktiv është nënshkruar nga drejtoresha e DPKZHT, etj. Anomalitë e mësipërme janë konstatuar në rastet e mëposhtme:
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr.75, nr. 3625/4 prot; datë 28.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Ndërtim restorant dhe hotel"*, me zhvillues "…" ShPK;
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 96, nr. 3581/6 prot; datë 29.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Kompleks shërbimesh në funksion të agroturizmit"*, me subjekt zhvillues "…" ShPK;
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 83, nr. 3302 prot; datë 08.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Ndërtim godinë banimi 2 kat"*, me subjekt zhvillues z. N. N.;
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 100, nr. 4459 prot; datë 09.11.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Bujtina Gj. Ll., rikonstruksion + shtesë 2 kt + p/fingo"*, me subjekt zhvillues z. V. Gj. Ll.;
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin *"Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe mure rrethues"*, me subjekt zhvillues "…" ShPK;
- Certifikatë përdorimi miratuar me vendim rr. 6, nr. 4959 prot; datë 04.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë për objektin *"Strukturë 2kt, shërbim kati I-rë, bujtinë kati II-të"*, me subjekt zhvillues z. K. M.
Anomalitë e mësipërme nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, më konkretisht me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të*

*Territorit",* i ndryshuar, Neni 10, pika 1, nënpika b), ç); Neni 14, pika 1; Neni 15, pika 1, nënpika c), ç), dh), e), ë), g), pika 1/1, nënpika i), iii), iv); Neni 26, pika 5; Neni 27/1, pika 1, nënpika ë); Neni 27/2, pika 1, nënpika ë), g), gj); VKM-në nr. 457, datë 29.06.2022, *"Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 408, datë 13.05.2015...",* Neni 13, Neni 18, Neni 21; Ligjin nr.111/2018 *"Për kadastrën",* Neni 17 *"Certifikatat"*, pika 4 dhe 6; Ligjin 107/2014, *"Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit",* i ndryshuar, Neni 13, pika 1; Neni 29; Rregulloren e Brendshme e Bashkisë Mirditë, nr. 4600 prot; datë 27.10.2022, Neni 27, pika 1, nënpika a); Neni 3.1, pika k); Ligjin nr. 9880, datë 25.02.2008, *"Për nënshkrimin elektronik",* i ndryshuar, Neni 9; Ligjin nr. 10 273, datë 29.04.2010, *"Për dokumentin elektronik"*, i ndryshuar, Neni 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 146-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**13.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi ose përdorimi me mangësi si, policat dhe deklaratat e përgjegjësisë profesionale, licencat profesionale, projektet teknike që përbëjnë projektin ndërtimor, plani i rilevimit, projekti arkitektonik në formatin DWG, plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzsituese, kartelat e pasurisë së paluajtëshme të rifreskuara përgjatë tre muajve të fundit, etj. DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të marri masa për të kontrolluar të gjithë dokumentacionin e dorëzuar mbi saktësinë dhe plotësinë e tij, si dhe vlefshmërinë sipas afateve për ato dokumenta që kanë përcaktime ligjore mbi vlefshmërinë.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

- Nga DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të merren masa të kërkojnë në çdo rast vërtetimin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për subjektet që kanë hartuar projektet ndërtimore, si dhe vërtetimet mbi statusin e subjekteve, sipas kuadrit ligjor në fuqi, për të marrë sigurinë e nevojshme se këto subjekte kanë të drejtën e ushtrimit të aktivitetit.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

- Nga DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të merren masa për të kontrolluar nënshkrimin elektronik në të gjithë dokumentacionin e dorëzuar në sistemin e-lejet, të vërtetojë nëse këto dokumenta janë nënshkruar ose jo elektronikisht, nëse ky nënshkrim është kryer sipas përcaktimeve ligjore dhe nëse është kryer nga personat përgjegjës për hartimin e këtyre dokumentave.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

- Nga DPKZHT dhe Bashkia Mirditë të merren masa, që për të gjitha aplikimet për ndërhyrje në objekte ekzistuese, si shtesa anësore ose në lartësi, të kryejnë verifikime në terren për ekvidentimin e gjendjes ekzistuese të objektet, si dhe të kërkojnë evidentimin e gjendjes ekzsituese të objektit në të gjitha projektet teknike që në tërësi përbëjnë projektin ndërtimor.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në katër raste të audituara, nuk është kërkuar dhe/ose respektuar mendimi i autoriteteve të tjera publike, që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, për lejet si më poshtë:

- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr.75, nr. 3625/4 prot; datë 28.09.2022 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Ndërtim restorant dhe hotel"*, me zhvillues "…" ShPK.

- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 96, nr. 3581/6 prot; datë 29.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Kompleks shërbimesh në funksion të agroturizmit"*, me subjekt zhvillues "…" ShPK.
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 83, nr. 3302 prot; datë 08.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objekti *"Ndërtim godinë banimi 2 kat"*, me subjekt zhvillues z. N. N.
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin *"Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe mure rrethues"*, me subjekt zhvillues "…" ShPK.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015, *"Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit"*, i ndryshuar, Neni 10/1 *"Shqyrtimi i kërkesave për leje zhvillimi"*, pika 6; Planin e Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Mirditë, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr. 2, datë 20.06.2018 (e rishikuar me Vendim nr. 9, datë 14.10.2020), dokumenti i rishikimit, pika 2, nënpika c); Ligjin nr. 111/2012, *"Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore"*, i ndryshuar, Neni 33; VKM-në nr. 550, datë 15.07.2020, *"Për miratimin e formularëve për miratimin, në parim, për dhënien me koncension..."*, pika III. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 146-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**14.1. Rekomandim:** Nga DPKZHT Mirditë të merren masa për të kërkuar në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, sipas rastit. Gjithashtu, DPKZHT Mirditë, të shqyrtojë me përparësi të gjitha kërkesat e parashtruara nga këto autoritete dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi deri në plotësimin e kërkesave.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në një nga rastet e audituara, zhvilluesi ka filluar ndërtimin e objektit përpara miratimit të lejes së ndërtimit, më konkretisht:
- Leje ndërtimi miratuar me vendim nr. 25, nr. 1364 prot; datë 30.04.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë, për objektin *"Strukturë për impiant ambalazhi uji 1 kat me mexaninë dhe mure rrethues"*, me subjekt zhvillues "…" ShPK. Objekti ka filluar ndërtimin përpara pajisjes me leje ndërtimi. Leja e ndërtimit për objektin në fjalë është miratuar në datën 30.04.2021. Nga këqyrja e fotografimit satelitor të periudhës Korrik, 2019, vihet re se objekti ka qënë në fazë ndërtimi. Pra, subjekti zhvillues e ka filluar ndërtimin e objektit pa marrë miratimin e autoriteti përgjegjës, në këtë rast Bashkia Mirditë, kjo në shkelje të Nenit 39 të Ligjit 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 146-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**15.1. Rekomandim:** Bashkia Mirditë dhe DPKZHT të marrë masa dhe të përdorë të gjithë instrumentat për të kryer kontrollet e nevojshme deri në marrjen e sigurisë së plotë se objektet për të cilat aplikohet për leje zhvillimi / ndërtimi nuk kanë filluar ndërtimin pa marrë miratimet e nevojshme sipas ligjit. Në çdo rast të evidentuar, Bashkia Mirditë, DPKZHT dhe IMTV duhet të ndjekin procedurat ligjore për të gjithë ata subjekte që zhvillojnë objekte pa miratimin e organeve kompetente.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të certifikatave të përdorimit u konstatua se në një nga rastet e audituara, objekti i ndërtuar dhe i pajisur me çertifikatë përdorimi, ndryshon nga projekti i miratuar, më konkretisht:

**-** Certifikatë përdorimi miratuar me vendim nr. 6, nr. 4959 prot; datë 04.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë për objektin *"Strukturë 2kt, shërbim kati I-rë, bujtinë kati II-të*, me subjekt zhvillues z. K.M.. Nga verifikimi në terren dhe këqyrja e dokumentacionit fotografik të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, objekti nuk është zbatuar sipas projektit të miratuar, pasi në fasadën lindore dhe perëndimore, kati papafingo, janë realizuar çarje të cilat nuk kanë qenë të parashikuara në projektin e miratuar. Gjithashtu në fasadën veriore konstatohet ndërtimi i një hapësire, i përbërë nga mure dhe soletë beton/arme, të paparashikuar në projektin e miratuar, e cila lidh objektin me murin mbajtës. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Nenin 39 të Ligjit 107/2014, "Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 146-159 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**16.1. Rekomandim:** Bashkia Mirditë, DPKZHT dhe IMTV të marrin masa për të mos lejuar asnjë objekt në zhvillim të devijojë nga projekti i miratuar, në kushtet e mungesës së lejeve të posaçme. Bashkia Mirditë të mos miratojnë asnjë çertifikatë përdorimi kur konstatohet se ky objekt ka shmangie nga projekti i miratuar, pa proceduar paraprakisht me ndjekjen e hapave ligjor, deri në ndryshimin e objektit sipas projektit të miratuar, si dhe penalizimin e personave përgjegjës.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**B. MASA SHPËRBLIM DËMI.**

**1. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt "Rikonstruksion dhe riparimi i ambienteve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, të dëmtuara nga tërmeti, në qytetin Reps, Nj.A. Orosh", Bashkia Mirditë, me vlerë të kontratës (pa tvsh) 184,001,854 lekë, realizuar nga BOE "L…" SHPK & "K…" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 540,416 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5372/15 prot., datë 28.02.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë dhe BOE "L…" SHPK & "K…" SHPK.
*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**1.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **540,416 lekë pa tvsh** nga BOE "L…" SHPK & "K…" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5372/15 prot., datë 28.02.2022, me objekt "Rikonstruksion dhe riparimi i ambienteve të përbashkëta dhe në bashkëpronësi, të dëmtuara nga tërmeti, në qytetin Reps, Nj.A. Orosh", Bashkia Mirditë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit "Arjana Arapi" Rrëshen", Bashkia Mirditë,*** me vlerë të kontratës (me tvsh) 63,269,169 lekë, realizuar nga BOE "A…" SHPK & "J…" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 638,120 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4616 prot., datë 23.10.2018 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë dhe BOE "A…" SHPK & "J…" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**2.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **638,120 lekë pa tvsh** nga BOE "…" SHPK & "J…" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 4616 prot., datë 23.10.2018, me objekt "Rikonstruksion i plotë Pallati i Sportit

"Arjana Arapi" Rrëshen", Bashkia Mirditë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**3. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Rehabilitimi i skemës ujitëse të ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza III)", Bashkia Mirditë,*** me vlerë të kontratës (me tvsh) 47,196,085 lekë, realizuar nga OE "A…" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 300,924 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3196 prot., datë 06.08.2019 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë dhe OE "A…" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**3.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **300,924 lekë pa tvsh** nga OE "A…" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 3196 prot., datë 06.08.2019, me objekt "Rehabilitimi i skemës ujitëse të ujëmbledhësit Malaj-2 (Faza III)", Bashkia Mirditë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**4. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt ***"Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 2) Rrëshen", Bashkia Mirditë,*** me vlerë të kontratës (pa tvsh) 362,526,402 lekë, realizuar nga OE "U…" SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 326,400 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1282/16 prot., datë 13.07.2022 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Mirditë dhe OE "U…" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**4.1. Rekomandim:** Nga Bashkia Mirditë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **326,400 lekë pa tvsh** nga OE "U…" SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1282/16 prot., datë 13.07.2022, me objekt "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 2) Rrëshen", Bashkia Mirditë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Menjëherë**

**5. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt "Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3), Mirditë", me vlerë 42,261,108 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria "L…" SHPK, *rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara*, për zërin e punimeve: "2(3.25/b) Gërmim me krah, tokë e zakonshme" në vlerën **170,375 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 760 prot., datë 06.05.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë "L…" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**5.1 Rekomandim:** Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **170,375 lekë pa TVSH** nga shoqëria "L…" SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 760 prot., datë 06.05.2021, me objekt "Rehabilitim i kanalit ujitës Malaj-Tarazh (Faza 3), Mirditë".

***Menjëherë***

**6. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar “Ndrec N. Gjoka”, Fan Mirditë”, me vlerë 69,805,421 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “K…” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **457,017 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3072 prot., datë 29.07.2019 SHPK të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë “K…” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**6.1 Rekomandim:** Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **457,017 lekë pa TVSH** nga shoqëria “K…” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3072 prot., datë 29.07.2019, me objekt “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palester dhe sistemim ambienti shkolla e mesme e bashkuar “Ndrec N. Gjoka”, Fan Mirditë”, Mirditë”, Bashkia Mirditë”.

***Menjëherë***

**7. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “*Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen” Bashkia Mirditë*, me vlerë 69,805,421 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “U…” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **277,004 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3974 prot., datë 13.10.2021, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë “U…” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**7.1 Rekomandim:** Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **277,004 lekë pa TVSH** nga shoqëria “U…” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3974 prot., datë 13.10.2021, me objekt “Rikonstruksion të objekteve arsimore në qytetin Rrëshen” Bashkia Mirditë, Mirditë”, Bashkia Mirditë”.

***Menjëherë***

**8. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen*” Bashkia Mirditë*, me vlerë 103,177,350 lekë me TVSH, fituar nga sipërmarrësi i punimeve JV “…SHPK & “G. …” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, në vlerën **232,590 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 39746 prot., datë 13.10.2021, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe JV “A…” SHPK & “…” SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**8.1 Rekomandim:** Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **232,590 lekë pa TVSH** nga JV “A…” SHPK & “G. …” SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 39746 prot., datë 13.10.2021, me objekt “Rikonstruksion të objekteve publike në qytetin Rrëshen”, Bashkia Mirditë”.

***Menjëherë***

**9. Gjetje nga auditimi**: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)” *Bashkia Mirditë*, me vlerë 187,417,132 lekë me TVSH, fituar nga shoqëria “U…” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara në vlerën **412,102 lekë pa TVSH**. Veprimet

e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 3711/3 prot., datë 02.12.2022, të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Mirditë dhe shoqërisë "U…" SHPK. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 127-146 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandim:** Bashkia Mirditë të arkëtojë vlerën prej **412,102 lekë pa TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria "U…" SHPK, për punime të pakryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3711/3 prot., datë 02.12.2022, me objekt "Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)" Bashkia Mirditë".

***Menjëherë***

## C. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RRITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

**1. Gjetje nga auditimi:** Referuar akt-rakordimeve për të ardhurat konstatohet se për disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet në vlera të ulta dhe në disa taksa dhe tarifa realizimi paraqitet shumë mbi planin, gjë që tregon se planifikimi i të ardhurave nuk është real, ka rezerva në planifikim e për pasojë ndikon negativisht në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore, ky plan nuk pasqyron saktë burimin e të ardhurave**.** Vlera totale e borxhit tatimor në mënyrë progresive në fund të vitit 2021 është në vlerën **16,418,632 lekë,** vlera e borxhit e krijuar **gjatë vitit 2022** është **6,160,335 lekë** dhe gjendja e debitorëve në mënyrë progresive **në fund të vitit 2022** është në vlerën **22,578,967 lekë** e cila përbëhet nga**:**
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesit të vogël në shumën 2,045,473lekë;
- Detyrimet nga taksat dhe tarifat e Biznesit të madh në shumën 5,694,982lekë;
- Detyrime nga personat fizikë/juridikë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë" në vlerën prej 14,838,512 lekë, që i përkasin 4 subjekteve të mbartura që nga viti 2010.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 9 pika1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 "Për sistemin e taksave vendore", me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore", me ndryshime, Kreut XI-"Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara" neni 89,90,91 93 dhe 94, me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime neni 181. me VKB nr. 100, datë 24.11.2021 "Për miratimin e paketës fiskale vendore 2022". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandim:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën progresive 22,578,967 lekë, ku përveç masave shtrënguese të marra si urdhër bllokimet e llogarive bankare, kërkesa për vendosjen e barrës siguruese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),n*ë funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar:*

-Të angazhohet për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar dhe n*ëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet*, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, të merren masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

- Të bashkërendojë punën me QKB Bashkia Mirditë, për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv ose mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.
- Në regjistrat e debitorëve, të evidentohen vlera e detyrimit të pa arkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Në Bashkinë Mirdite aktualisht familjet ngarkohen me detyrime për taksën e ndërtesës e truallit dhe tarifat pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Nga të dhënat e vendosura në dispozicion, në Bashkinë Mirditë dhe NJA taksohen gjithsej 4848 familje, numër i cili shërben për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore për kategorinë "familjar". Nga familjarët e taksuar konstatohet se **në fund të vitit 2021** janë trashëguar 1461 familje me vlerë debitorë prej 4,646,301 lekë dhe në fund të vitit 2022 në Bashkinë Mirditë dhe NJA, janë gjithsej 2536 familje debitore për vlerën 4,596,239 lekë, nga të cilat 558 familje janë të trashëguara nga viti 2021, te cilat nuk janë paguar as në vitin 2022 dhe 1978 janë debitor të krijuar brenda vitit 2022. Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr.100, datë 24.11.2021, "Për miratimin e paketës fiskale 2022",pika C.1, me ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar neni 9 pika1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, me ligjin nr. 9632, datë 30/10/2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, neni 4 pika 7,me ligjin nr. 9920, datë 19/5/2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenin 70 dhe 117. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandim:** Bashkia Mirditë nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksa dhe tarifat vendore të debitorëve familjarë në vlerën 4,596,239 lekë, si dhe të plotësojë e përditësojë regjistrin për taksapaguesit e kategorisë familjare me të gjitha të dhënat e nevojshme, i cili të shërbejë si bazë për të bërë llogaritjen e detyrimeve vendore, që ju lindin familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Mirditë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se, realizimi i taksës bujqësore është në vlerën 51,278 mijë lekë nga 188,700 mijë lekë ose në masën 27%. Nga kryqëzimi i informacionit të administruar nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore me informacionin e administruar nga Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Pyjore/Sektori i Kadastrës mbi sipërfaqen e tokës bujqësore, që familjet kanë në pronësi apo në përdorim rezultoi se, në planifikim është marrë në konsideratë vetëm sipërfaqja e fermerëve që kanë tapitë e tokave (ATM) për sipërfaqe të ndarë prej 932 ha, duke përjashtuar pjesën tjetër prej 2915 ha të ndarë sipas ligjit 7501. Debitorët për taksën e tokës bujqësore në fund të vitit 2021 janë në vlerën 188,474 lekë, gjatë vitit 2022 janë krijuar debitorë në vlerën 278,627 lekë dhe në fund të vitit 2022 debitorët në vlerë progresive janë 197,777 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 23 pika1, Aneksi 1 dhe me VKB nr.nr. 100 datë 24.11.2021 "Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022",pika A.2 nën pika (b). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandim:** Bashkia Mirditë, nëpërmjet Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksën e taksës bujqësore nga debitorët fermerë në vlerën 197,777 lekë. Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe

Pyjore/Sektori i Kadastrës të marrin masa për të identifikuar numrin e familjeve, që kanë në pronësi apo në përdorim tokë bujqësore si dhe sipërfaqen e saktë që ato zotërojnë, me qëllim krijimin e një regjistri me të dhëna të plota dhe të sakta. Ky regjistër më pas të shërbejë si bazë për të bërë, planifikimin e plotë dhe përllogaritjen e detyrimeve që ju lindin këtyre familjeve referuar paketës fiskale të miratuar të Bashkisë Mirditë.

*Menjëherë dhe në vijimsi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit financiar të pagesave për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet e ndërtimeve informale rezulton se, në Bashkinë Mirditë ka detyrime të papaguara në vlerën 1,282,663 lekë për 40 objekte, që janë legalizuar që nga viti 2019 deri në 31.12.2021. Nga korrespondenca zyrtare e Bashkisë Mirditë me ASHK Rajonale Lezhë për periudhën objekt auditimi rezulton se, gjatë vitit 2022 është krijuar gjendje debitore prej 635,484 lekë e 27 përfituesve dhe në fund të vitit 2022 vlera progresive debitore është 1,972,156 lekë të 67 përfituesve të legalizimit, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mirditë. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 4, neni 27, me ligjin nr. 95/2018 "për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 9, pika 3/c, me ligjin nr. 98/2020 "Për disa ndryshime dhe shtesanë ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006,"Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, neni 1, "në nenin 27, pika 3, shkronja "c", me VKM nr. 860, datë 10.12.2014 " Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim" pika 5 dhe me VKB nr. 100, datë 24.11.2021 "Për miratimin e paketës fiskale vendore 2022", pika A.4, nënpika (f). *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandim:** Drejtorisë së Planifikimit, Zhvillimit të Territorit dhe Strehimit në Bashkinë Mirditë të dërgojë periodikisht informacion në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore mbi subjektet debitorë për "Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimet" dhe në bashkëpunim të marrin masa administrative e ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë **për 67** debitorë në vlerën 1,972,156 lekë**,** si dhe në vijimësi nga të gjitha ndërtimet e reja që legalizohen. Gjithashtu, nga strukturat e Bashkisë Mirditë të bashkëpunohet me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) për të marrë informacion periodik lidhur me legalizimet e reja që kryhen, me qëllim evidentimin objekteve të legalizuara, evidentimin e pagesave dhe mbi bazën e tyre evidentimin e debitorëve..

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Mirditë për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim dhe krijimit të të ardhurave prej dhënies me qira të tyre ka lidhur 43 kontrata për dhënien me qira të tyre. Nga të dhënat e nxjerra nga dokumentacioni i dosjeve dhe ai financiar rezulton se, në fund të vitit 2021 paraqiten 5 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të pa paguara **me vlerë progresive debitore prej 15,176,566 lekë,** ndërsa në **fund të vitit 2022** paraqiten 12 subjekte qiramarrës me detyrime kontraktore të pa paguara në ***vlerën debitorë progresive prej 14,945,988 lekë,*** vlerë e cila nuk rakordon me kontabilitetin. Në këtë gjendje debitorësh detyrime të pa paguara më të mëdha i kanë subjektet e dy kontratave: Subjekti qiramarrës "S…"shpk me aktivitet "HEC", kontrate e vitit 2017 me afat 10 vjecar, me detyrime të papaguara në vlerën 10,569,197 lekë, me aktivitet te pezulluar dhe Subjekti …me aktivitet "HEC" kontrate e vitit 2018 me afat 10 vjecar, me detyrime të papaguara në vlerën 1,784,791 lekë lekë, me aktivitet te pezulluar.

Gjithashtu referuar të dhënave të faqes së AKBN-së, rezulton se në territorin e Bashkisë Mirditë ushtrojnë aktivitetin 8 subjekte private për prodhim dhe nxjerrje minerare dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullosor, asete të Bashkisë Mirditë. Nga Bashkia nuk është lidhur në asnjë rast kontratë qiradhënie të hapësirës për vend depozitimit të mineralit në rastet e subjekteve me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim minerali si dhe shfrytëzim karriere dhe shtrati lumi, me lloj aktiviteti nxjerrje prodhim inertesh, duke sjellë të ardhura të mungura për Bashkinë Mirditë. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 826-840, me ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" dhe me kontratat përkëtëse neni 5 "Pagesa e tarifës së qirasë"*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandim:** Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mirditë, të marrë masat dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës prej 14,945,988 lekë, që lind nga mos pagesa e kontratave të qirasë për 12 subjekte qiramarrës, si dhe të bëjë llogaritjen e kamatëvonesave për këto detyrime, referuar kushteve të kontratave. Në rast të mos kryerjes së spagesave nga qiramarrësi, të ndërmerrn hapa ligjor sipas parashikimeve të bëra në kontratë.

Gjithashtu nga strukturat drejtuese për 8 rastet e subjekteve private për prodhim dhe nxjerrje minerare e inertesh, që ushtrojnë aktivitetin e licencuar në parcelat e fondit pyjor-kullosor, asete të Bashkisë Mirditë, të shqyrtohet dokumentacioni i tyre dhe të kryhen kontrolli dhe matja në terren i parcelave, që shfrytëzohen dhe finalizimi i procesit me lidhjen e kontratave të qiradhënies për sigurimin e të ardhurave dhe rehabilitimin e sipërfaqeve nga zhfrytëzimi nga ana e këtyre subjekteve të aseteve të bashkisë. Nëse ka pengesë në realizimin e këtij procesi të ndiqen të gjitha hapat ligjore, duke bashkëpunuar me institucionet përkatëse deri në pezullimin e veprimtarisë.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**6. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Mirditë ka pajisur rast pas rasti me autorizim/licencë subjektet që ushtrojnë aktivitet për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë dhe ka hartuar akt marrëveshje me to lidhur me pagesën e detyrimit për autorizimin. Marrëveshja konsiston në krijimin e mundësisë për subjektet që detyrimin e autorizimit në vlerën prej 1,000,000 lekë për 5 vite ta paguajnë me këste vjetore në vlerën 200,000 lekë. Në territorin e Bashkisë Mirditë për periudhën objekt auditimi kanë ushtruar aktivitet në fushën e tregtimit të lëndëve djegëse me pakicë 14 subjekte nga të cilat, 4 subjekte konstatohet se kanë detyrime të papaguara në vlerën 2,650,000 lekë, si: Shoqëria "K…" shpk në vlerën 600,000 lekë, Shoqëria "L…" shpk në vlerën 850,000 lekë, Shoqëria "D…" shpk në vlerën 200,000 lekë dhe Shoqëria "N…" shpk ka detyrim të hershëm në vlerën 1000,000 lekë, ku aktiviteti i tyre figuron i pezulluar apo i mbyllur. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999,nenet 4,15 dhe 20/2"dhe me VKM nr. 970, datë 02.12.2015, "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj", kreu II, pika 3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 25-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1 Rekomandim:** Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore të marrë masa administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për tarifën e autorizim/licencën për ushtrimin e aktivitetit të shitjes së hidrokarbureve, nga subjektet: Shoqëria "K…" shpk në vlerën 600,000 lekë, Shoqëria "L…" shpk në vlerën 850,000 lekë, Shoqëria "D…" shpk në vlerën 200,000 lekë dhe Shoqëria "N…" shpk në vlerën 1,000,000 lekë si dhe të ndjekë rregullisht pagesat periodike të autorizimeve për të gjithë subjektet e tjera me qëllim, që të bëjë të mundur pagesat e plota brenda afateve. Bashkia Mirditë të ndërpresë praktikën e hartimit të aktmarrveshjeve për pagesën me këste të detyrimit të për paisjen me autorizim për shitjen e lëndëve djegëse me pakicë.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**D. MASA DISIPLINORE.**

Për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit nga KLSH-ja **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Mirditë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, t'i kërkojë Komisionit Disiplinor pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë për çdo punonjës të atakuar dhe marrjen e masave disiplinore përkatëse, në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17/12/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", VKM nr. 115, datë 05/03/2014, "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil", i ndryshuar, si dhe të kontratës individuale për **15 punonjës**, si më poshtë:

**I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

Mbështetur në Nenin 15 *"Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së"*, shkronja (c), të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, Nenin 58 *"Llojet e masave disiplinore"*, të Ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *"Për nëpunësin civil"*, i ndryshuar, në VKM-në nr. 115, datë 05.03.2014 *"Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil"*, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Mirditë**, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore përkatëse, si më poshtë:

a. **"Vërejtje" deri në "Largim nga shërbimi civil"**, sipas shkeljeve të konstatuara për punonjësit si më poshtë:

1. **Z. M. P., në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;**
2. **Z. T. P., në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave;**
3. **Zj. A. D.**, në cilësinë e antarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për moszbatim të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nenit 53, pika 4, si dhe në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në procedurat si më poshtë:

- Për procedurën e prokurimit, "Rikonstruksion i plote Pallati i Sportit 'Arjana Arapi' Rrëshen" - viti 2018, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;

- Për procedurën e prokurimit, “Ndërtim Kopshti Fëmijëve Qyteti Rrëshen, Mirditë” - viti 2018, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Rehabilitimi i skemës ujitëse Ujëmbledhësi Malaj 2 (faza2)” - viti 2019, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Rehabilitimi i skemës ujitëse Ujëmbledhësi Malaj 2 (faza3)” - viti 2019, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti Shkolla e Mesme e Bashkuar “Ndrec N. Gjoka” Fan” - viti 2019, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Rikonstruksion i plotë i kompleksit të godinës “Pashko Vasa” Rrëshen”, Bashkia Mirditë” - viti 2019, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Ndërtimi I Ujësjellësit qyteti Rubik”, Bashkia Mirditë”, viti 2020, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;
- Për procedurën e prokurimit, “Blerje Automjet teknologjik (kamion) për grumbullimin dhe konteniere (kosha) të përshtatshëm për grumbullimin e mbeturinave për Bashkinë Mirditë” - viti 2021, KVO duhet të kishte bërë propozimin tek titullari i AK për anulimin e procedurës dhe fillimin e një procedure të re;

**4. Zj. M. D.**, në cilësinë e antarit të Njësisë së Prokurimit;
**5. Z. B. D.**, në cilësinë e antarit të Njësisë së Prokurimit;
**6. Zj. M. M.**, në cilësinë e antarit të Njësisë së Prokurimit;
**7. Z. A. M.**, në cilësinë e antarit të Njësisë së Prokurimit.
Për moszbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 23, pika 1 dhe VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 26, pika 5, si dhe në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
Për procedurën e prokurimit:
- “Rikonstruksion i plote Pallati i Sportit 'Arjana Arapi' Rrëshen” - viti 2018;
- “Ndërtim Kopshti Fëmijëve Qyteti Rrëshen, Mirditë” - viti 2018;
- “Rehabilitimi i skemës ujitëse Ujëmbledhësi Malaj 2 (faza3)” - viti 2019;
- “Rikonstruksion i plotë i kompleksit të godinës “Pashko Vasa” Rrëshen - viti 2019;
- “Rikonstruksion dhe sistem ngrohje, palestër dhe sistemim ambienti Shkolla e Mesme e Bashkuar “Ndrec N. Gjoka” Fan” - viti 2019.
- “Ndërtimi I Ujësjellësit qyteti Rubik”, Bashkia Mirditë”, viti 2020;
- “Rehabilitim I rrjetit ujitës Malaj-Tarazh”, Bashkia Mirditë, viti 2021
- “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të perbashketa në ndërtesa (pallate), rikonstruksionit të objekteve arsimore dhe publike si dhe përgatitja e shesheve të ndërtimit per banesat individuale”, Viti 2021;
- “Ndërtimi I Ujësjellësit qyteti Rubik (Shtesë projekti)”, viti 2022
- “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), ne qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)”, viti 2022

**8. A.P.**, në cilësinë e antarit të Njësisë së Prokurimit për procedurat e prokurimit:

- “Rehabilitim i rrjetit ujitës Malaj-Tarazh”, Bashkia Mirditë”, viti 2021
- Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të perbashketa në ndërtesa (pallate), rikonstruksionit të objekteve arsimore dhe publike si dhe përgatitja e shesheve të ndërtimit per banesat individuale”, Viti 2021;
- “Ndërtimi i Ujësjellësit qyteti Rubik (Shtesë projekti)”, viti 2022
- “Rikonstruksion dhe riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate), ne qytetin Rrëshen dhe Rubik (Faza 3)”, viti 2022;

**9. N. N.**, në cilësinë e antarit të Njësisë së Prokurimit, për procedurën e prokurimit, “Blerje Automjet teknologjik (kamion) për grumbullimin dhe konteniere (kosha) të përshtatshëm për grumbullimin e mbeturinave për Bashkinë Mirditë” - viti 2021,
**10. F. C.**, në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun, pasi nuk ka administruar sipas legjislacionit në fuqi dosjet personale të nëpunësve të MZSH.

**b. “Vërejtje me paralajmërim” për:**

**11. Z. J. K.,** në funksionin e kontrolluesit të shqyrtimit të aplikimeve pranë Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit;
Për shkeljet e konstatuara që kanë të bëjnë me problemet dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, më konkretisht, për miratimin e lejeve të ndërtimit kur objekti nuk respekton kondicionet urbane në 4 (katër) raste, kur janë konstatuar mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi dhe çertifikatë përdorimi në 6 (gjashtë) raste, për mos-kërkimin dhe respektimin e mendimit të autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit në 4 (katër) raste, për miratimin e lejes së ndërtimit pa marrë sigurinë e plotë se zhvilluesi nuk e ka filluar ndërtimin e objektit përpara marrjes së miratimit në 1 (një) rast, për miratimin e certifikatës së përdorimit kur objekti i zbatuar ka ndryshime nga ai i miratuar në 1 (një) rast.

**c -“Vërejtje”** neni 58 shkronja (a), për katër punonjës si më poshtë:

**12. Zj. D. N.** me detyrë Drejtore e Drejtorisë të Taksave dhe Tarifave Vendore
**13. Zj. M. N.** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Taksave dhe Tarifave.

<u>Për mangësitë e konstatuara:</u>
Në mospërputhje me kërkesat e VKB nr.100, datë 24.11.2021, “Për miratimin e paketës fiskale 2022”, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar, neni 9 pika1.3, neni 35, me ligjin nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, neni 12 pika 1, ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, nenet neni neni 3/3 neni 4/1,7, neni 6/3 neni 23neni 24,neni 4 pika 7,nenet 89, 90, 91,93,94 si:
- Mos planifikim i të ardhurave mbi bazë reale, duke mospasqyruar saktë bazën e tatueshme dhe burimin e të ardhurave, proces i cili sjell ndikim negativ në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore.
- Mos marrjen e masave për mbledhjen e detyrimeve tatimore nga biznesi i madh dhe i vogël, të cilat në fund të vitit 2022 jane në vlerën progresive debitore prej 22,578,967 lekë për taksa e tarifa vendore.

- Mos mbajtje të regjistrave të plotë, planifikim jo i saktë dhe mos vjelje e taksës së ndërtesës e truallit, tarifat pastrim-ndriçim-gjelbërim-arsim të taksapaguesve të kategorisë "Familjar" dhe mos identifikim i plotë i familjeve, që kanë detyrim për këto taksa e tarifa, ku vlera debitore progresive në fund të vitit 2022 është në vlerën 4,596,239 lekë lekë, që i përkasin 2536 familjeve debitorë.
- Planifikim jo i saktë i taksës bujqësore, pasi në planifikim është marrë në konsideratë vetëm sipërfaqja e fermerëve që kanë tapitë e tokave (ATM) për sipërfaqe të ndarë prej 932 ha, duke përjashtuar pjesën tjetër prej 2915 ha të ndarë sipas ligjit 7501. Mos arkëtim i taksës bujqësore, ku realizimi i saj është në masën 27% dhe detyrimet debitore progresive në fund të vitit 2022 janë në vlerën 197,777 lekë.

**14.** Zj.**E. V.** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Pronave të Paluajtshme, Aseteve, Riskut në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.
**15.** Z. **E. D.** me detyrë specialiste e menaxhimit të aseteve në Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore.
*<u>Për mangësitë e konstatuara:</u>*
Në mospërputhje me kërkesat e ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 826-840, me ligjin nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore, neni 36, me VKM nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar, me VKM nr. 391 datë 21.06.20006, ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" dhe me kontratat përkëtëse neni 5 "Pagesa e tarifës së qirasë" si:
- Për mos marrjen e masave për arkëtimin e detyrimeve kontraktore nga 12 subjekte qiramarrës në vlerën 14,945,988 lekë, të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë.
- Mosmenaxhim i aseteve të Bashkisë Mirditë që shfrytëzohen nga subjekte private pa qira dhe si rezultat nuk është marrë asnjë masë për përgatitjen e procedurave për lidhjen e kontratave për shfrytëzim të parcelave pyjore në 8 raste të subjekteve që ushtrojnë aktivitet për nxjerrje, prodhim dhe shfrytëzim minerali dhe inertesh, në parcela të fondit pyjor-kullosor, asete të Bashkisë Mirditë.

**II. Për punonjësit që rregullojnë marrëdhëniet e punës me Kodin e Punës:**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "*Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*", neni 15 "*Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së*", shkronja c, në Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë, neni 37 "*Masat Disiplinore*" dhe në kontratën individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Mirditë, që për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit, bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve, të vlerësojë shkallën e përgjegjësisë dhe të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore "**Ndërprerje e kontratës së punës**", për punonjësin:

**16. Z. N. P.,** me detyrë, Kryeinspektor i IVMT për periudhën nën auditim, 2018-2022, për shkeljet si vijon:
- Për mungesë profesionale dhe mosmarrjen e masave në kohë, me qëllim parandalimin e ndërtimeve pa leje në kundërshtim me ligjin.
- Për periudhën 2018-2022 vetëm në një rast është mbajtur mbajtur vlera e gjobës sipas vlerës së punimeve të kryera, ndërsa për rastet e tjera nuk është ndjekur kjo praktikë, në

kundërshtim me ligjin 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Neni 52/e, "Kundërvajtjet administrative".
- Nga Kryeinspektori I IMVT Mirditë nuk janë marrë masat në kohë, nuk ka proces verbale konstatimi apo ndonjë masë tjetër administrative, për parandalimin e tre ndërtimeve pa leje, ndonëse në zona lehtësisht të dukshme dhe të aksesueshme, si më poshtë:

- Në njësinë strukturore MR_N_N_2274/1, "Objekti 1 kat, me bazament betoni me çati, me funksion shërbime (restorant)", ka filluar ndërtimin në muajin Mars të vitit 2022;
- Njësia strukturore MR_N_N_72/1, Fshati Fang, njësia administrative Rrubik, "Objekt 1 kat, me bazament betoni me çati, me funksion shërbime (bar-restorant)" që i përket Xh. O., objekti ka filluar ndërtimin në muajin Mars të vitit 2022;
- Njësia strukturore MR_N_N4_72/1. Fang, Njësia Administrative Rubik, objekti I identifikuar si Kioskë Metalike me xhama që shërben si Lokal (Bar-Kafe), I gjendur anës Rrugës së Kombit, pranë ish uzinës ALB-Bakër.

## E. MASA ADMINISTRATIVE:

-Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar në pikën 4 faqe 84-124 të Raportit Përfundimtar të Auditimit, mbështetur në nenin 15 shkronja (c, ç) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Mirditë** që në zbatim të nenit 132, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", **t'i kërkojë Agjencisë së Prokurimit Publik (APP)**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave **administrative** në raport me shkeljet e konstatuara, për **9 (nëntë) punonjësit,** të cituar tek masat disiplinore për shkeljet në fushën e prokurimeve.
**-** Referuar shkeljeve të konstatuara në evidentimin e ndërtimeve pa leje, në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", Neni 1, Neni 15, dhe Ligji 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*",i ndryshuar, Neni 51, pika 1, bazuar në Nenin 15 dhe Nenin 30, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Mirditë t'i kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të bëjë propozimin për fillimin e procedurës disiplinore me gjobë, për **Z. N. P.,** me detyrë Kryeinspektor i IVMT për periudhën nën auditim, 2018-2022, për shkak se nuk janë marrë masat në kohë për parandalimin e ndërtimeve pa leje, ndonëse në zona lehtësisht të dukshme dhe të aksesueshme.
- Në zbatim të detyrimeve dhe kompetencave që rrjedhin nga Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 "*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*", Neni 1, dhe Ligji 107/2014 "*Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit*",i ndryshuar, Neni 52, pika 5, bazuar në Nenin 15 dhe Nenin 30, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, *"Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"*, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Mirditë t'i kërkojë **Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor**, Bashkia Mirditë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe të nisë procedurat për marrjen e masave të parashikuara në ligj, për subjektin ndërtues, projektues, mbikëqyrësin dhe kolaudatorin e punimeve, për objektin e miratuar me çertifikatë përdorimi me vendim nr. 6,

nr. 4959 prot; datë 04.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Mirditë "Strukturë 2kt, shërbim kati I-rë, bujtinë kati II-të", me subjekt zhvillues z. K. M.

**F. PËR PUNONJËSIT E LARGUAR**.

Për ish punonjësit e mëposhtëm nuk rekomandojmë masa disiplinore edhe sepse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre.

Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte "Vërejtje" përkatësisht:

**1. Z. T. M.** me detyrë ish-Drejtor i Agjencisë së Shërbimit Bujqësor dhe Pyjor (larguar shtator 2023).

**2. Z. R. B.** anëtar i NJP dhe specialist i fushës.

**G. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTARTËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Burimeve Njerëzore e Institucionit, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë**:

**1.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

**2.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

**Në vijimësi**

**Shënim:** Në fazën e auditimit në terren, për shkaqe objektive, megjithë komunikimin e grupit të auditimit dhe subjektit me APP-në, nuk u bë i mundur aksesimi në kohë i SPE, për të kryer auditimin e katër procedurave të prokurimit, të realizuara me fondet e Buxhetit të Shtetit për Rindërtimin, nga të cilat një procedurë e vitit 2021 dhe 3 procedura të vitit 2022, me vlerë totale të fondit limit 1,057,677,987 lekë pa TVSH dhe konkretisht:

- "Rikonstruksion dhe riparim i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në Bashkinë Mirditë (qyteti Reps)";
- "Rikonstruksion dhe riparim i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesa (pallate) në Bashkinë Mirditë, qyteti Rrëshen dhe Rubik, faza 2";
- "Rikonstruksioni i godinave, spitali "Shenjta Mari" dhe Drejtoria e Shëndetit Publik (ish-Spitali Infektiv), Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë";
- "Ndërtimi i godinës kopsht/çerdhe në zonën e re për zhvillim, Njësia Administrative Rrëshen, Bashkia Mirditë".

Këto procedura do të jenë objekt auditimi në auditimin e ardhshëm në Bashkinë Mirditë.

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

**V. ANEKSET**

Detyrimet e prapambetura të detajuara paraqiten në Aneks: Llogaria 401-404

në lekë

| Nr. | Subjekti | Objekti I kontratës | Numri I faturës | Data e faturës | Gjendje me 31.12.2021 | Pagesat gjatë vitit 2022 | Shtuar gjatë vitit 2022 | Gjendje në 31.12.2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | Lyrje objektesh | 809 | 06.10.2017 | 150 635 | 0 | 0 | 150 635 |
| 2 | | Materjale pastrimi | 30 | 13.12.2017 | 97 560 | 0 | 0 | 97 560 |
| 3 | | Materjale elektrike | 32 | 10.04.2018 | 252 960 | 0 | 0 | 252960 |
| 4 | | Dru zjarri | 15 | 20.02.2018 | 565 440 | 0 | 0 | 565 440 |
| 5 | | Mbikqyrje rruga koder rreshen | 56 | 17.05.2018 | 33 557 | 0 | 0 | 33 557 |
| 6 | | Kolaudim punimesh ujmbledhesi malaj | 143 | 18.12.2018 | 25 448 | 0 | 0 | 25 448 |
| 7 | | Kolaudim punimesh ndertim kalqeto Reps | 144 | 18.12.2018 | 16 099 | 0 | 0 | 16 099 |
| 8 | | Kolaudim punimesh shpatullat e ures jezull | 145 | 18.12.2018 | 25 065 | 0 | 0 | 25 065 |
| 9 | | Kolaudim mbrojtja lumore zmeja e madhe | 146 | 18.12.2018 | 28 705 | 0 | 0 | 28 705 |
| 10 | | Kolaudim punimesh skema ujitëse fshati Bukmirë | 147 | 18.12.2018 | 22 640 | 0 | 0 | 22 640 |
| 11 | | Emergjenca e bores | 34 | 15.04.2019 | 243 000 | 0 | 0 | 243 000 |
| 12 | | Rikonstruksion I zyrave NJ.A Rubik | 315 | 30.10.2020 | 100 382 | 0 | 0 | 100 382 |
| 13 | | Kolaudim punimesh furnizim me energji godina e bashkise | 47 | 31.12.2020 | 65 218 | 0 | 0 | 65 218 |
| 14 | | Blerje automjet teknologjik | 04 | 21.09.2021 | 1 977 780 | 1 940 580 | 0 | 37 200 |
| 15 | | Nafte | 75 | 03.03.2022 | 0 | 0 | 146240 | 146 240 |
| 16 | | Mbikqyrje punimesh godina e sherb qytetare | 16 | 13. 12. 2018 | 99 600 | 99 600 | 0 | 0 |
| 17 | | Oponence teknike Malaj 1 | 89 | 10.12.2020 | 204 273 | 204 273 | 0 | 0 |
| 18 | | Rikonstruksion I plote I kompleksit god 1 2 3 | 106 | 12.09.2020 | 5 112 170 | 5 112 170 | 0 | |
| 19 | | Rikonstruksion shkolla e mesme N.N.Gjoka Fane | 14 | 06.05.2020 | 3 232 701 | 3 232 701 | | |
| 20 | | Gjelberim qyteti | 4-9 | 4/5-07.10.21 | 2 718 316 | 2 718 316 | 0 | 0 |
| 21 | | Gaz I lengshem | 18 | 30.06.2021 | 69 511 | 69 511 | | |
| 22 | | Blerje buke | 45 | 31.07.2021 | 7 884 | 7 884 | | |
| 23 | | Blerje buke | 113 | 02.09.2021 | 8 424 | 8 424 | | |
| 24 | | Blerje buke | 168 | 01.10.2021 | 24 516 | 24 516 | | |
| 25 | | Blerje buke | 212 | 29.10.2021 | 61 992 | 61 992 | | |
| 26 | | Blerje Mish | 15 | 30.06.2021 | 67 920 | 67 920 | | |
| 27 | | Blerje Mish | 27 | 31.08.2021 | 31 020 | 31 020 | | |
| 28 | | Blerje Mish | 30 | 30.09.2021 | 106 860 | 106 860 | | |
| 29 | | Blerje Mish | 34 | 29.10.2021 | 126 540 | 126 540 | | |
| 30 | | Siguracion automjete | 284440 | 27.08.2021 | 39 080 | 39 080 | | |
| 31 | | Siguracion volejbollistet | 21818 | 28.09.2021 | 12 500 | 12 500 | | |
| 32 | | Federim ekipi I velejbollit | 47 | 22.10.2021 | 218 000 | 218 000 | | |
| 33 | | Blerje dru zjarri | 03 | 08.04.2021 | 2 321 280 | 2 321 280 | | |
| 34 | | Ushqime | 518 | 31.07.2021 | 91 836 | 91 836 | | |
| 35 | | Ushqime | 564 | 31.08.2021 | 58 782 | 58 782 | | |
| 36 | | Ushqime | 679 | 30.09.2021 | 224 766 | 224 766 | | |
| 37 | | Ushqime | 746 | 29.10.2021 | 305 184 | 305 184 | | |
| 38 | | Nafte | 08 | 31.05.2021 | 310 000 | 310 000 | | |
| 39 | | Nafte | 11 | 31.05.2021 | 310 000 | 310 000 | | |
| 40 | | Nafte | 13 | 16.06.2021 | 310 000 | 310 000 | | |
| 41 | | Nafte | 15 | 29.06.2021 | 696 000 | 696 000 | | |
| 42 | | Nafte | 22 | 24.07.2021 | 320 000 | 320 000 | | |
| 43 | | Nafte | 04 | 24.07.2021 | 320 000 | 320 000 | | |
| 44 | | Nafte | 07 | 13.08.2021 | 480 000 | 480 000 | | |
| 45 | | Akt ekspertize | 301 | 27.07.2021 | 125 120 | 125 120 | | |
| 46 | | Materjale ndertimi lyrje | 48 | 23.07.2021 | 468 000 | 468 000 | | |
| 47 | | Kancelari | 2006 | 11.08.2021 | 583200 | 583200 | | |
| 48 | | Materiale pastrimi | 113 | 02.09.2021 | 540000 | 540000 | | |
| I. | | **Totali I** | | | **23,209,964** | **2,546,055** | **146,240** | **1,810,149** |
| II | | **Fatura te palikujd me financim nga FZHR (AKUM)** | | | | | | |
| 49 | | Ndertim ujsjellsi Rubik | 18 | 06.04.2021 | 24 690 402 | 20 000 000 | 0 | 4 690 402 |
| 50 | | Mbikqyrje punimesh ndertim ujsjellësi Rubik | 25 | 20.09.2021 | 733 255 | 350 000 | 0 | 383 255 |
| 51 | | Ndertim ujsjellsi Rubik | 80 | 06.11.2021 | | | 6 581 032 | 6 581 032 |
| 52 | | Mbikqyrje punimesh ndertim ujsjellësi Rubik” | 45 | 06.12.2021 | | | 107 922 | 107 922 |
| 53 | | Ndertim ujsjellsi Rubik | 90 | 09.12.2021 | | | 9 169 099 | 9 169 099 |
| 54 | | Ndertim ujsjellsi Rubik | 05 | 12.01.2022 | | | 7 841 624 | 7 841 624 |
| 55 | | Ndertim ujsjellsi Rubik” | 19 | 28.02.2022 | | | 4 866 212 | 4 866 212 |
| 56 | | Ndertim ujsjellsi Rubik | 41 | 06.05.2022 | | | 2 392 154 | 2 392 154 |
| 57 | | Ndertim ujsjellsi Rubik | 63 | 07.07.2022 | | | 9 542 197 | 9 542 197 |
| 58 | | Ndertim ujsjellsi Rubik | 75 | 08.08.2022 | | | 1 614 725 | 1 614 725 |
| 59 | | Ndertim ujsjellsi Rubik | 81 | 09.09.2022 | | | 5 490 776 | 5 490 776 |
| | | **TOTALI II** | | | **25 423 657** | **20 350 000** | **47 605 741** | **52 679 398** |
| III | | **Rindërtimi** | | | | | | |
| 60 | | Oponence teknike | 118 | 15.02.2022 | | | 100 000 | 100,000 |
| 61 | | Akt ekspertiza | 548 | 27.05.2022 | | | 50 589 | 50 589 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 62 | | Akt ekspertiza | 603 | 13.06.2022 | | | 43 000 | 43 000 |
| 63 | | Akt ekspertiza | 760 | 21.07.2022 | | | 47 000 | 47 000 |
| 64 | | Akt ekspertiza | 942 | 09.09.2022 | | | 8 400 | 8 400 |
| 65 | | Akt ekspertiza | 1007 | 30.09.2022 | | | 283 458 | 283 458 |
| 66 | | Akt ekspertiza | 1008 | 30 .09.2022 | | | 781 030 | 781 030 |
| | | **TOTALI III** | | | | | **1 313 477** | **1 313 477** |
| | | **TOTALI I Pergjithshem ME 31.12.2022 I+II+III** | | | **48 633 621** | **41 896 055** | **49 065 458** | **55 803 025** |
| | | 5% të ngurtësuar 31.12.2022 | | | 17 095 904 | 1 894 490 | 59 131 049 | 74 332 463 |
| | | | | | **65 729 525** | **43 790 545** | **108 196 507** | **130 135 488** |

Planifikimi i të ardhurave nga taksat familjare paraqitet në Aneks:

| | **NjësitëAdministrative** | | Sipërfaqjanë/m² | | | TotaliTaksës | **Tarifë** | | | TotaliTarifave | Shuma | **Numrisubjekteve** | **NumriFamiljeve** | *Familjemelehtësirafiskale* | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Tokë | Truall | Ndërtesë | | **Pastrimi** | **Ndriçimi** | **Gjelbërimi** | | | | | *PensionistëtëVetmuar* | *NdihmëEkonomike* | *InvalidëPune* |
| 1 | Fanë | Fshatrat | 1,062,180 | 111,518 | 24,210 | 422,526 | --- | --- | --- | --- | 422,526 | 29 | 700 | --- | --- | --- |
| 2 | KaçinarFshatrat | | 232,038 | 38,580 | 9,904 | 162,083 | --- | --- | --- | --- | 162,083 | 4 | 177 | 2 | 2 | 1 |
| 3 | KthellëFshatrat | | 3,364,590 | 67,923 | 29,866 | 613,532 | --- | --- | --- | --- | 613,532 | 4 | 428 | --- | --- | --- |
| 4 | Orosh | Q.Reps+Fshatrat | 409,613 | 59,348 | 23,595 | 375,221 | 172,500 | 21,000 | 31,500 | 225,000 | 600,221 | 22 | 397 | 66 | 56 | 1 |
| 5 | Selitë | Fshatrat | 218,631 | 34,710 | 7,802 | 129,958 | --- | --- | --- | --- | 129,958 | 1 | 141 | 1 | 1 | 1 |
| 6 | Rreshën | QytetiRreshën | --- | --- | 89,836 | 1,886,563 | 1,806,000 | 240,800 | 361,200 | 2,408,000 | 4,294,563 | 286 | 1209 | 154 | 3 | 5 |
| | | FshatratRreshënit | 3,243,853 | 199,181 | 61,005 | 1,463,957 | 249,300 | --- | --- | 249,300 | 1,713,257 | | 786 | 3 | --- | --- |
| 7 | Rubik | QytetiRubik | --- | --- | 34,337 | 506,474 | 772,500 | 103,000 | 154,500 | 1,030,000 | 1,536,474 | 90 | 516 | 5 | 4 | 1 |
| | | FshatrateRubikut | 785,045 | 120,670 | 39,213 | 631,344 | 252,900 | --- | --- | 252,900 | 884,244 | | 494 | 24 | 11 | --- |
| *TOTALI* | | | 932ha | 631,930m² | 319,769m² | 6,191,658 | 3,253,200 | 364,800 | 547,200 | 4,165,200 | 10,356,858 | **436** | 4848 | **255** | **77** | 9 |
| | | | | | | | | | | | | | | **7.03%** | | |

**Kontratat aktive dhe jo aktive për asetet e dhëna me qira**

| Nr. | Subjekti | Aktiviteti | Afati I Kontratës | | Vlera Vjetore e Qirasë | Debitor 31.12.2021 | Detyrimi në 2022 | Shuma e detyrimit | Paguar | Debitore 31.12.2022 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Fillimi | Mbarimi | | | | | | |
| 1 | | Antenë | 29/10/2018 | 28/10/2027 | 140,120 | | 140,120 | 140,120 | 0 | 140,120 |
| 2 | | Antenë | 22/09/2016 | 21/09/2021 | 200,000 | | 200,000 | 200,000 | 0 | 200,000 |
| 3 | | Antenë | 01/01/2021 | 31/12/2025 | 170,000 | | 170,000 | 170,000 | 0 | 170,000 |
| 4 | | Antenë | 02/09/2018 | 01/09/2027 | 55,900 | | 55,900 | 55,900 | 55,900 | |
| 5 | | Antenë | 02/09/2018 | 01/09/2027 | 123,600 | | 123,600 | 123,600 | 123,600 | |
| 6 | | Antenë | 22/09/2018 | 21/09/2023 | 258,000 | | 258,000 | 258,000 | 258,000 | |
| 7 | | Antenë | 12/03/2017 | 11/03/2023 | 328,000 | | 328,000 | 328,000 | 328,000 | |
| 8 | | Antenë | 10/12/2018 | 09/12/2023 | 60,300 | | 60,300 | 60,300 | | 60,300 |
| 9 | | Antenë | 14/10/2018 | 13/10/2023 | 500,000 | | 500,000 | 500,000 | 500,000 | |
| 10 | | Antenë | 01/06/2017 | 31/05/2023 | 275,000 | | 275,000 | 275,000 | 275,000 | |
| 11 | | Antenë | 02/01/2018 | 01/01/2024 | 209,400 | | 209,400 | 209,400 | 209,400 | |
| 12 | | Antenë | 05/02/2021 | 04/02/2030 | 335,000 | | 335,000 | 335,000 | 335,000 | |
| 13 | | Antenë | 02/06/2017 | 01/06/2022 | 280,000 | | 280,000 | 280,000 | | 280,000 |
| 14 | | Antenë | 21/12/2020 | 20/12/2029 | 247,500 | | 247,500 | 247,500 | | 247,500 |
| 15 | | Antenë | 16/06/2022 | 15/06/2023 | 292,635 | | 292,635 | 292,635 | 292,635 | |
| 16 | | Antenë | 19/07/2019 | 18/07/2024 | 170,000 | | 170,000 | 170,000 | 170,000 | |
| 17 | | Antenë | 26/04/2021 | 25/04/2030 | 28,000 | | 28,000 | 28,000 | 28,000 | |
| 18 | | Matje Erës | 29/04/2022 | 28/04/2023 | 10,200 | | 10,200 | 10,200 | 10,200 | |
| 19 | | Matje Erës | 18/11/2022 | 17/11/2025 | 65,560 | | 65,560 | 65,560 | 0 | 65,560 |
| 20 | | Ndërtesë | 30/09/2016 | 30/09/2026 | 821,304 | | 821,304 | 821,304 | 821,304 | |
| 21 | | Turizëm | 21/09/2020 | 20/09/2030 | 406,157 | | 406,157 | 406,157 | 406,157 | |
| 22 | | Turizëm | 15/07/2021 | 14/07/2031 | 80,000 | | 80,000 | 80,000 | 80,000 | |
| 23 | | Turizëm | 03/04/2019 | 03/04/2029 | 353,738 | | 353,738 | 353,738 | 301,096 | 52,642 |
| 24 | | Fabrikë Uji | 10/12/2018 | 09/12/2028 | 760,750 | | 760,750 | 760,750 | 760,750 | |
| 25 | | Turizëm | 08/07/2022 | 07/07/2023 | 15,000 | | 15,000 | 15,000 | 15,000 | |
| 26 | | Minierë | 07/11/2011 | 06/11/2026 | 3,082,020 | | 3,082,020 | 3,082,020 | 3,082,020 | |
| 27 | | HEC | 31/10/2019 | 30/10/2024 | 247,675 | | 247,675 | 247,675 | 247,675 | |
| 28 | | HEC | 26/02/2018 | 25/02/2028 | 1,079,425 | | 1,079,425 | 1,079,425 | 1,079,425 | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 29 | | HEC | 04/04/2018 | 03/04/2028 | 405,995 | 596,407 | 405,995 | 1,002,402 | 1,002,402 | 0 |
| 30 | | HEC | 20/06/2018 | 19/06/2028 | 610,471 | 1,220,942 | 610,471 | 1,831,413 | 1,567,954 | 263,459 |
| 31 | | HEC | 10/02/2018 | 11/02/2028 | 379,675 | | 379,675 | 379,675 | 379,675 | 0 |
| 32 | | HEC | 05/12/2018 | 04/12/2023 | 1,005,229 | 1,005,229 | 1,005,229 | 2,010,458 | 1,005,229 | 1,005,229 |
| 33 | | HEC | 20/11/2019 | 19/11/2022 | 113,450 | | 113,450 | 113,450 | 113,450 | 0 |
| 34 | | Kullota | 06/06/2019 | 05/06/2022 | 16,760 | | 16,760 | 16,760 | 16,760 | |
| 35 | | Kullota | 06/06/2019 | 05/06/2022 | 25,000 | | 25,000 | 25,000 | 25,000 | |
| 36 | | Kullota | 12/06/2020 | 11/06/2023 | 15,420 | | 15,420 | 15,420 | 15,420 | |
| 37 | | Kullota | 15/07/2021 | 14/07/2030 | 123,950 | | 123,950 | 123,950 | 123,950 | |
| 38 | | Kullota | 16/07/2021 | 15/07/2030 | 52,500 | | 52,500 | 52,500 | 52,500 | 0 |
| 39 | | Kullota | 15/09/2021 | 14/09/2030 | 156,800 | | 156,800 | 156,800 | 156,800 | |
| 40 | | Kullota | 06/12/2022 | 05/12/2025 | 20,200 | | 20,200 | 20,200 | 20,200 | |
| 41 | | Kullota | | | 21,200 | | 21,200 | 21,200 | 21,200 | |
| 42 | | Kullota | 06/12/2022 | 05/12/2032 | 137,100 | | 137,100 | 137,100 | 137,100 | |
| 43 | | Depo Dher | 20/07/2022 | 19/07/2023 | 95,429 | | 95,429 | 95,429 | 95,429 | 0 |
| | | | | | | 2,822,578 | 13,774,463 | 16,597,041 | 14112231 | 2,484,810 |
| | | HEC | 25.10.2017 | 24.10.2020 | 10,569,197 | 10,569,197 | 0 | 10,569,197 | 0 | 10,569,197 |
| | | HEC | 19.11.2018 | 18.11.2028 | | | | | | 1,776,137 |

**TABELA PERMBLEDHESE E 5% TE PALIKUJDUAR ME 31.12.2022 llogaria 466**

| Nr. | Emertimi I Investimit | Emri I Firmes | Gjendja me 31.12.2021 | Paguar deri me 31.12.2022 | Ngurtesuar 2022 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Rikons Rruga Shen Vicenzo di Paoli | | 914,035 | | |
| 2 | Rikonstruk rruga Gjergj Fishta 5 | | 135,417 | | |
| 3 | Rikonstruksion pallati kultures 2008 | | 97,723 | | |
| 4 | Rehabilitim i ianalit Nderfushaz | | 188,084 | | |
| 5 | Rikonstruksion rruga hyrese | | 298,576 | | |
| 6 | Rikons rruga Bukmire-Simon-Kaçinare | | 148,599 | | |
| 7 | Rehabilitimi i rezervuarit Malaj 2 Faza 2-te | | 7,484 | | |
| 8 | Rehabilitim kanali ujites nderfushaz | | 88,725 | | |
| 9 | Rikonstruksion rruga klos xhuxhaj margjecaj | | 74,811 | | |
| 10 | Rikonst rruga koder-rreshen Valce | | 73,501 | | |
| 11 | Rikonst i shkolles 9-vjeçare Pashko Vasa | | 1,438,214 | | |
| 12 | Mbrojtja lumore zmeja e madhe unaza Rreshen | | 128,352 | | |
| 13 | Ndertim fushe sportive ( Kalçeto) Reps | | 69,585 | | |
| 14 | Riparim i urave te ndryshme | | 85,923 | | |
| 15 | Furnizim me energji godina e bashkise | | 135,871 | 135,871 | |
| 16 | Rikonstruk i zyrave te njesise administrative Rubik | | 319000 | 319000 | |
| 17 | Rehabilitimi i ujeleshuesit ,ujembledhesit Sheshaj | | 47,706 | | |
| 18 | Godina e sherbimit per qytetaret shtese kontrate | | 959,589 | 959,589 | |
| 19 | Rehabilitim i kanalit vadites Fang Rubik | | 308,173 | 308,173 | |
| 20 | Ndertim i ujesjellesit Rubik | | 3,339,277 | | 1,000,000 |
| 21 | Rikonstruksion i ambjenteve te perbashketa pallatet rr-r f.1 | | 3,807,631 | | 14,107,501 |
| 22 | Rikonstruksion i ambjenteve arsimore | | 996,919 | | |
| 23 | Rikonstruksion i objekteve publike qyteti Rreshen | | 1,086,176 | | |
| 24 | TVSH Rehabilitim i kanalit vadites Malaj-Tarazh | | 919,001 | | |
| 25 | Rikonstruksion i sistemit te ngrohjes shkolla 9-vjeçare Rubik | | 398,198 | | |
| 26 | Mirembajtje rrugeve te brendeshme te komunes Kaçinar | | 96,260 | | |
| 27 | Mirembajtje e rrugeve Komuna Fane | | 44,760 | | |
| 28 | Ndertim lere uji ( mulli) komuna Selite | | 29,280 | | |
| 29 | Ndertim ujesjellesi Lekgegaj Komuna Kthella | | 404,573 | | |
| 30 | Rikonstruksion shpella e Valit, Komuna Kthelle | | 13,766 | | |
| 31 | Ndertim rrugeve te brendeshme,Komuna Selite | | 136,389 | | |
| 32 | Rikonstruksion qender shendetsore, Komuna Fane | | 49,309 | | |
| 33 | Riparime e mirembajtje rruge te brendshme Komuna Fane | | 171,857 | 171,857 | |
| 34 | Montim çmontim ure, Komuna Fane | | 38,744 | | |
| 35 | Ndertim ure pasarele Xhuxhe-Gjakez, Komuna Fane | | 26,880 | | |
| 36 | Ndertim rruge varrezat Perlat i eperm Komuna Kthelle | | 17,516 | | |
| 37 | Plotesimi i rrjetit ujites Malaj 2 | | | | 375855 |
| 38 | Plotesimi i rrjetit ujites fshati K/Rreshen lagja Zalli Zmese | | | | 75000 |
| 39 | Rikonstruksion i ambjenteve te perbashketa pallatet rr-r f..2 | | | | 13,938,690 |
| 40 | Rikonstruksion i ambjenteve te perbashketa pallatet rr-r f.3 | | | | 1,358,646 |
| 41 | Rikons ambjenteve te perbashketa pallatet Reps | | | | 9,199,569 |
| 42 | Rikonstruksion i ambjenteve arsimore | | | | 3,896,054 |
| 43 | Prishje e pergatitje shesh ndertimi per banesat individuale | | | | 1,058,071 |
| 44 | Rikonstruksion i objekteve publike qyteti Rreshen | | | | 4,072,525 |
| 45 | Ndertim godina kopesht/çerdhe zona e re per zhvillim | | | | 959,510 |
| 46 | Rik.godina spitalit Shenjta Mari dhe DSHP ish spitali infektiv | | | | 7,823,472 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 47 | TVSH Rehabilitim i kanalit vadites Malaj-Tarazh | | | | 1,193,636 |
| 48 | Rik.pusetave hyrese ujeleshuesi,ujembledhesi Geziq | | | | 52,620 |
| 49 | Zhbllokimi i pusetave hyrese ujelesh, ujembledhsi Geziq | | | | 19,900 |
| | Pullat e gjendjes civile | | 0 | 1,416,500 | 1,416,500 |
| | TOTALI BASHKIA + NJESITE ADMINISTRATIVE | | **17,095,904** | **3,310,990** | **60547549** |

## Formati nr.2 "Pasqyra e përformancës financiare"

| Nr. rresht | Nr. Llogari | P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE | VITI USHTRIMOR 2022 | VITI I MEPARSHEM 2021 |
|---|---|---|---|---|
| **a** | **b** | **c** | 1 | 2 |
| **1** | **A** | **TE ARDHURAT** | **817,369,359** | **1,039,825,336** |
| **2** | *70* | ***I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET*** | **39,352,886** | **43,130,043** |
| **3** | **700** | **1.Tatimi mbi te Ardhurat** | **106,620** | **7,986,990** |
| **4** | 7000 | Tatim mbi te ardhurat personale | | 6,303,709 |
| **5** | 7001 | Tatim mbi Fitimin | | 1,683,281 |
| **6** | 7002 | Tatim mbi Biznesin e vogel | 106,620 | |
| **7** | *7009* | *Te tjera Tatime mbi te ardhurat* | | |
| **8** | **702** | **2.Tatimi mbi Pasurine** | **14,437,878** | **18,115,018** |
| **9** | 7020 | Tatim mbi Pasurine e palujtshme | 14,437,878 | 18,115,018 |
| **10** | 7021 | Tatim mbi shitjen e pasurise se palujtshe | | |
| **11** | 7029 | Te tjera tatime mbi Pasurine | | |
| **12** | **703** | **3.Tatime mbi mallrat e sherbimet brenda vendit** | **24,808,388** | **17,028,035** |
| **16** | 7033 | Takse mbi perdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie | 19,523,515 | 11,546,766 |
| **17** | 7035 | Taksa vendore mbi perdorimin e mallrave e lejim veprimtarie | 5,284,873 | 5,481,269 |
| **18** | **704** | **4.Takse mbi tregtine dhe transaksionet nderkombtare** | **0** | **0** |
| **24** | **708** | **6.Te tjera Tatime e Taksa kombtare** | | |
| **25** | **709** | **7.Gjoba e Kamat vonesa** | | |
| **26** | *75* | ***II.KONTRIBUTE SIGURIME SHOQERORE E SHENDETESORE*** | | |
| **34** | *71* | ***III.TE ARDHURA JO TATIMORE*** | **24,528,129** | **12,682,009** |
| **35** | **710** | **1.Nga ndermarrjet dhe pronesia** | **4,593,830** | **3,159,979** |
| **38** | 7109 | Te tjera nga ndermarrjet dhe pronesia | 4,593,830 | 3,159,979 |
| **39** | **711** | **2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare** | **19,934,299** | **9,522,030** |
| **40** | 7110 | Tarifa administrative dhe rregullatore | 385,220 | |
| **41** | 7111 | Te ardhura sekondare e pagesa sherbimesh | 19,549,079 | 9,522,030 |
| **42** | 7112 | Takse per veprime gjyqsore e noteriale | | |
| **43** | 7113 | Te ardhura nga shitja e mallrave e sherbimeve | | |
| **44** | 7114 | Te ardhura nga biletat | | |
| **45** | 7115 | Gjoba, kamatvonesa, sekuestrime e zhdemtime | | |
| **46** | 7116 | Te ardhura nga transferimi prones,Legalizimi i ndertimeve pa leje | | |
| **47** | **719** | **3.Te tjera te ardhura jo tatimore** | | |
| **48** | *76* | ***IV.TE ARDHURA FINANCIARE*** | **0** | **0** |
| **53** | *72* | ***V.GRANTE KORENTE*** | **753,975,617** | **982,309,795** |
| **54** | **720** | **1.Grant korent I Brendshem** | **753,975,617** | **982,309,795** |
| **55** | 7200 | Nga Buxheti per NJQP(Qendrore) | | |
| **56** | 7201 | Nga Buxheti per NJQP(Vendore) | 668,061,008 | 972,383,695 |
| **59** | 7204 | Pjesmarrje e institucioneve ne tatime nacionale | | |
| **60** | 7205 | Financim shtese per te ardhurat e krijuara brenda sistemit | | |
| **61** | 7206 | Financim I pritshe nga buxheti | 85,914,609 | |
| **62** | 7207 | Sponsorizime te brendshme( nga te trete) | | 9,926,100 |
| **63** | 7209 | Te tjera grante korente te brendshme | | |
| **64** | **721** | **2.Grant korent I Huaj** | **0** | **0** |
| **67** | | ***VI.TE ARDHURA TE TJERA*** | 0 | 0 |
| **73** | *73* | ***VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE 487,273*** | **-** | **1,703,489** |
| **74** | **B** | **SHPENZIMET** | **730,669,777** | **723,699,706** |
| **75** | **600** | **I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE** | **207,279,911** | **205,772,129** |
| **76** | 6001 | Paga, personel I perhershem | 207,279,911 | 205,772,129 |
| **77** | 6002 | Paga personel I Perkohshem | | |
| **78** | 6003 | Shperblime | | |
| **79** | 6009 | Shpenzime te tjera per personelin | | |
| **80** | **601** | **II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE** | **33,879,917** | **34,316,690** |
| **81** | 6010 | Kontributi I Sigurimeve Shoqerore | 33,879,917 | 34,316,690 |
| **82** | 6011 | Kontributi I Sigurimeve Shendetesore | | |
| **83** | **602** | **III.BLERJE MALLRA E SHERBIME** | **93,820,110** | **87,508,504** |
| **84** | 602 | Mallra dhe sherbime te tjera | | |
| **85** | 6020 | Materiale zyre e te pergjitheshme | 2,032,800 | 1,702,267 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **86** | 6021 | Materiale dhe sherbime speciale | 7,055,202 | 5,292,636 |
| **87** | 6022 | Sherbime nga te trete | 60,939,136 | 72,464,459 |
| **88** | 6023 | Shpenzime transporti | 19,971,322 | 4,693,812 |
| **89** | 6024 | Shpenzime udhetimi | 1,377,115 | 649,462 |
| **90** | 6025 | Shpenzime per mirembajtje te zakonshme | 1,374,960 | 1,353,060 |
| **91** | 6026 | Shpenzime per qeramarrje | | 1,352,808 |
| **92** | 6027 | Shpenzime per detyrime per kompesime legale | 1,069,575 | |
| **93** | 6028 | Shpenzime te lidhura me huamarrjen per hua | | |
| 94 | 6029 | Shpenzime te tjera operative | | |
| **95** | **603** | **IV.SUBVECIONE** | **0** | **0** |
| **101** | | **V.TRANSFERIME KORENTE** | **396,177,112** | **394,398,894** |
| **102** | **604** | **1.Transferime korente te brendshme** | **6,482,804** | |
| **103** | 6040 | Transferime korente tek nivele tjera te Qeverise | 6,482,804 | |
| **107** | **605** | **2.Transferime korente me jashte** | | |
| **112** | **606** | **3.Transferime per Buxhetet familjare e Individe** | **389,694,308** | **394,398,894** |
| **113** | 6060 | Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH | | |
| **114** | 6061 | Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor | 389,694,308 | 394,398,894 |
| **115** | | **VI.SHPENZIME FINANCIARE** | | |
| **125** | | **VII.KUOTA AMORTIZIMI DHE SHUMA TE PARASHIKUARA** | | |
| **130** | *63* | ***VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT*** | **-487,273** | **1,703,489** |
| **131** | | ***IX.SHPENZIME TE TJERA*** | | |
| **132** | *85* | **TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES** ***(Rezultati I Veprimtarise se vititUshtrimor)*** | **86,699,582** | **402,046,251** |

# ANEKS: Lejet e ndërtimit

| N | Subjekti/Ind | Objekti | Adre | Nr i Vendimit të | Lloji i lejes | Nr. autori | Sipër faq. | Vlera/l | Da të e | Pag uar |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | Strukturë bujqësore 1kt | Fushë Lumth | nr. 5189, dt.16.01.2 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 5648 prot, dt. | 192 | 188110 | 04.01.20 | Po |
| 2 | | Ndërtim për qëllime blegtorale | Perlat Qender | nr. 8, dt. 01.04.201 9 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m2 | nr. extra prot, dt. 20.03.2019 | 99.12 | 32370 | 26.03.20 19 | Po |
| 3 | | Strukturë banimi 2kt | Fan | nr. 10, dt. 12.04.201 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. extra prot, dt. | 189.2 | 123577 | 11.04.20 | Po |
| 4 | | Ndryshim destinacioni nga banim në dy | Rrëshe | nr. 7, dt. 01.04.201 | Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim | nr. extra prot, dt. | | 2202 | 28.03.20 | Po |
| 5 | | Banesë Individuale 1kt + 1 kt | Prosek | nr. 15, dt. 15.05.201 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. extra prot, dt. | 210.4 | 137424 | 13.05.20 | Po |
| 6 | | Ndryshim destinacioni nga një njësi | Rrëshe | nr. 22, dt. 01.07.201 | Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim | nr. 2274/2 prot, dt. | | 1108 | 27.06.20 | Po |
| 7 | | Shtesë 1kt banimi mbi banesën | Vau–Shkjez | nr. 23, dt. 15.07.201 | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, | nr. 2596/3 prot, dt. | 48.15 | 31449 | 12.07.20 | Po |
| 8 | | Strukturë bujqësore 1kt | Prosek | nr. 26, dt. 30.07.201 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 2703/3 prot, dt. | 150 | 48987 | 02.07.20 | Po |
| 9 | | Rikonstruksion dhe shtesë anësore e objektit shtëpi banimi 1kt | Prosek | nr.285 4, dt. | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe | nr. 2854/3 prot, dt. | 48.22 | 31495 | 06.08.20 | Po |
| 10 | | Magazinë bujqësore | Rrasfik | nr. 32, dt. 17.09.201 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m2 | nr. 3144/3 prot, dt. | 43.87 | 14327 | 04.09.20 | Po |
| 11 | | Rikonstruksion dhe shtesë kati e objektit ekzistues shtëpi banimi | Nënsh | nr. 37, dt. 08.11.201 | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe | nr. 3145/3 prot, dt. | 77 | 50293 | 10.10.20 | Po |
| 12 | | Rikonstruksion I objektit ekzistues godine banimi 1-katëshe dhe shtesë gjysmë kati | Rraj a e | nr. 33, dt. 20.09.201 | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe | nr. 3431/3 prot, dt. | 70 | 45721 | 20.09.20 | Po |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 13 | | Ndërtim shtëpi banimi 1kt | Prosek | nr. 34, dt. 27.09.201 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 3432/3 prot, dt. | 67.4 | 44023 | 26.09.20 | Po |
| 14 | | Strukturë shërbimi 1kt | Fushë Lumth | nr. 35, dt. 24.10.201 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 3580/4 prot, dt. | 24 | 39190 | 14.10.20 | Po |
| 15 | | Bujtinë 1kt | Fushë Lumth | nr. 36, dt. 24.10.201 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 3605/5 prot, dt. | 149 | 48660 | 20.11.20 | Po |
| 16 | | Fabrikë për përpunimin dhe ambalazhimin e ujit të | Thirrë | nr. 38, dt. 11.11.201 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 | nr. 3673/5 prot, dt. | 5060.5 | 4957974. | 08.11.20 | Po |
| 17 | | Bujtinë 2kt + 2kt papfingo + 1 kt | Perlat Qender | nr. 1, dt. 23.01.202 | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, | nr. 50503 prot, dt. | 657.8 | 214824.3 | 22.01.20 | Po |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 18 | | Ndërtim shtëpi banimi 2kt | Fushë Lumth | nr. 3, dt. 13.02.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 157/3 prot, dt. | 215.1 | 280989 | 07.02.20 | Po |
| 19 | | Rikonstruksion + shtesë | Rubik | nr. 6, dt. 26.03.202 | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe | nr. 4538/3 prot, dt. | 40.28 | 26309 | 26.03.20 | Po |
| 20 | | Banesë 1kt | Shmri | nr. 7, dt. 12.06.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 1461/3 prot, dt. | 112.36 | 110083 | 08.06.20 | Po |
| 21 | | Ndërtim kati parë (shtesë kati) | Prosek | nr. 20, dt. 15.09.202 | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe | nr. 2557/3 prot, dt. | 64 | 62704 | 11.09.20 | Po |
| 22 | | Strukturë bujqësore dhe | Perlat Qender | nr. 37, dt. 26.10.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 3196/3 prot, dt. | 240 | 78380 | 14.10.20 | Po |
| 23 | | Strukturë bujqësore (tharje dhe | Tarazh | nr. 5, dt. 03.02.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 273/2 prot, dt.02.02.2021 | 93.6 | 30568 | 02.02.20 | Po |
| 24 | | Strukturë 2kt, shërbim kati I – rë, | Katund i | nr. 6, dt. 04.02.202 | Çertifikatë përdorimi | nr. 272/2 prot, dt. | 284 | 10000 | 03.02.20 | Po |
| 25 | | Punime në banesë për ndryshim | Rubik | nr. 22, dt. 14.04.202 | Leje për ndryshimin e funksionit | nr. 31/3 prot, dt.31.03.2021 | 248.44 | 18825.07 | 12.04.20 | Po |
| 26 | | NDËRTIM BUJTINE 2KT | Gurth - Spaç | nr. 3, dt. 03.02.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 420/4 prot, dt. | 249.6 | 91515 | 01.02.20 | Po |
| 27 | | Strukturë bujqësore dhe | Perlat Qender | nr. 20, dt.26.03.2 | Çertifikatë përdorimi | nr. 1027 prot, dt. | 240 | 10000 | 04.03.20 | Po |
| 28 | | Strukturë shërbimi 1kt | Fushë Lumth | nr. 19, dt. 26.03.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 1234 prot, dt. | 31 | 60620 | 25.03.20 | Po |
| 29 | | Strukturë bujqësore 1kt | Prosek | nr. 23, dt. 14.04.202 | Çertifikatë përdorimi | nr. 1235 prot, dt. | 75 | 10000 | 30.03.20 | Po |
| 30 | | Banesë 1kt | Shmri | nr. 26, dt. 30.04.202 | Leje për ndryshimin e projektit | nr. 1154/3 prot, dt. | 112.36 | 5000 | 19.04.20 | Po |
| 31 | | Strukturë për impiant paketimi uji 1 kat | Petoq | nr. 25, dt. 30.04.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më | nr. 1364/4 prot, dt. | 1138 | 1124945 | 22.04.20 | Po |
| 32 | | Rikonstruksion i objektit 2kt | Klos | nr. 41, dt. 01.07.202 | Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim | nr. 2408/3 prot, dt. | 299.92 | 75419 | 29.06.20 | Po |
| 33 | | Ambjente shërbimi për | Rubik | nr. 94, dt. 22.10.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 2972/5 prot, dt. | 196 | 74010 | 22.10.20 | Po |
| 34 | | Prishje objekt banimi 1kt dhe ndërtim i | Perlat Qender | nr. 74, dt. 15.09.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 3052/3 prot, | 202 | 207908 | 10.09.20 | Po |
| 35 | | Strukturë shërbimi 1kt | Fushë Lumth | nr. 73, dt. 15.09.202 | Çertifikatë përdorimi | nr. 3053/4 prot, dt. | 31 | 10000 | 10.09.20 | Po |
| 36 | | Prishje objekt banimi 1kt dhe ndërtim i | Fushë Lumth | nr. 78, dt. 01.10.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 3054/5 prot, | 240 | 245137.6 | 29.09.20 | Po |
| 37 | | Ambjente ndihmëse për | Lufaj | nr. 105, datë | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m2 | nr. 4404/1 prot, dt. | 160 | 62252 | 10.11.20 | Po |
| 38 | | Shtesë + punime në banesë | Rrëshe | nr. 79, dt. 07.10.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 3166/5 prot, dt. | 42.68 | 51815 | 30.09.20 | Po |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 39 | | Ndërtim objekt banimi 1kt | Fushë Lumth | nr. 64, dt. 01.09.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 3287/3 prot, dt. | 50 | 58987 | 31.08.20 | Po |
| 40 | | Ndërtim godine banimi 2kt | Rraja e Zezë | nr. 83, dt. 08.10.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më | nr. 3302/3 prot, dt. | 426 | 427370 | 05.10.20 | Po |
| 41 | | Kompleks shërbimesh në funksion të | Ndërfa | nr. 96, dt. 29.10.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më | nr. 3581/5 prot, dt. | 438 | 218391 | 29.10.20 | Po |
| 42 | | Ndërtim i objektit i 2kt i llojit | Kodër Rrëshe | nr. 99, dt. 09.11.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 3978/3 prot, dt. | 120 | 49190 | 05.11.20 | Po |
| 43 | | Bujtina Gj. Ll., Rikonstruksion + | Domgj | nr. 100, dt. | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, | nr. 4546/1 prot, dt. | 355.5 | 126100 | 09.11.20 | Po |
| 44 | | Kompleks shërbimesh në funksion të | Ndërfa | nr. 55, dt. 24.06.202 | Leje për ndryshimin e projektit | nr. 639/3 prot, dt. | 438 | 5000 | 23.06.20 | Po |
| 45 | | Ndërtim godinë banimi 1kt | Ndërfa | nr. 43, dt. 20.05.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 1615/3 prot, dt. | 65 | 73683 | 20.05.20 | Po |
| 46 | | Banesë njëfamiljare me 2 | Gëziq | nr. 58, dt. 01.07.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 2442/3 prot, dt. | 109.5 | 117282 | 28.06.20 | Po |
| 47 | | Vendosje e shtylles matëse për | Rrasfi | nr. 65, dt. 15.07.202 | Leje Infrastrukture | nr. 2749/1 prot, dt. | 400 | 2369 | 07.07.20 | Po |
| 48 | | Bujtinë 2kt + 2kt papfingo + 1 kt | Perlat Qende | nr. 51, dt. 23.06.202 | Leje për shtyrjen e afatit të lejes së | nr. 2706/3 prot, dt. | 657.8 | 5000 | 23.06.20 | Po |
| 49 | | Ndërtim restorant dhe hotel | Katu ndi | nr. 75, dt. 28.09.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m2 | nr. 3625/3 prot, dt. | 1134.9 | 1814028 | 22.09.20 | Po |
| 50 | | Prishje objekt banimi 1kt dhe ndërtim i | Perlat Qende | nr. 74, dt. 16.09.202 | Leje për ndryshimin e projektit | nr. 3837/3 prot, dt. | 202 | 5000 | 06.09.20 | Po |
| 51 | | "PUNIME NË OBJEKT + NDËRTIM | Rreshe | nr. 82, dt. 11.10.202 | Leje për rikonstruksion pa | nr. 4008/3 prot, dt. | 399.4 | 255301 | 10.10.20 | Po |
| 52 | | RIKONSTRUKSION + SHTESË E OBJEKTIT | Vau – | nr. 84, dt. 18.10.202 | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe deri në 250 m2 | nr. 4455/3 prot, dt. | 90 | 39392 | 18.10.20 | Po |
| 53 | | "RIKONSTRUKSION SHTËPI BANIMI 2KT, PA | Rreshe | nr. 101, dt. | Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni | nr. 4949/3 prot, dt. | 76.7 | 63785 | 05.12.20 | Po |
| 54 | | "ND. AMBJENTE SHËRBIMI DHE | Fushë Lumth | nr. 38, dt. 01.06.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe | nr. 1439/4 prot, dt. | 245 | 341479 | 24.05.20 | Po |
| 55 | | SHTESE KATI, SHTËPI | Vau – | nr. 34, dt. 12.05.202 | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe deri në 250 m2 | nr. 1770/4 prot,dt. | 203.4 | 111102 | 12.05.20 | Po |
| 56 | | "NDËRTIM SHTËPI | Rreshe | nr. 49, dt. 26.06.202 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe deri në 250 m2 | nr. 2335/4 prot, dt. | 206 | 201826 | 26.06.20 | Po |